



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Ekstra V

Gusht

2002

Akte të Papublikuara

Prill 1999

PËRMBAJTJA

Vendim i KM
nr.205, datë 13.4.1999

Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit
Doganor.....

Faqe

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr.205¹, datë 13.04.1999

PËR

MIRATIMIN E DISPOZITAVE ZBATUESE TË KODIT DOGANOR

KËSHILLI I MINISTRAVE:

mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

mbështetur në ligjin nr.8449, datë 27.01.12.1998 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", që këtu e në vijim do të quhet "Kodi", dhe në veçanti në nenin 299 të tij,

duke pasur parasysh që Kodi përmbledh të gjithë legjislacionin doganor ekzistues në një instrument të vetëm ligjor; që në të njëjtën kohë Kodi i ka bërë disa ndryshime këtij legjislacioni për t'a bërë atë më koherent, për t'a thjeshtuar dhe për të plotësuar disa mangësi në legjislacionin ekzistues; që ai më pas do të përbëjë një legjislacion të plotë në këtë fushë;

duke pasur parasysh që të njëjtat arsye, të cilat çuan në miratimin e Kodit, janë të vlefshme edhe për aktet nënligjore zbatuese në fushën doganore; që është rasti të përmbledhen në një dokument të vetëm legjislativ të gjitha dispozitat zbatuese të së drejtës doganore të cilat momentalisht janë të shpërndara në një numër të madh rregulloresh ose udhëzimesh;

duke pasur parasysh që në dispozitat zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë të

përcaktuara në vijim, do të duhej të figuronin edhe rregullat doganore që momentalisht zbatohen; që gjithsesi është rasti që duke marrë parasysh eksperiencën e fituar:

- të bëhen ndryshime në rregullat në fjalë për ti përshtatur me dispozitat e Kodit,
- të zgjerohet fusha që mbulojnë këto dispozita të veçanta, të cilat momentalisht zbatohen vetëm për disa regjime doganore, në mënyrë që të realizohet zbatimi i gjithanshëm i Kodit,
- të saktësohen rregullat në fjalë për të siguruar një garanci më të madhe juridike në zbatimin e tyre;

që ndryshimet e bëra kanë të bëjnë mbi të gjitha me dispozitat që lidhen me borxhin doganor; dhe

duke pasur parasysh që masat e reja të parashikuar nga këto dispozita janë në përputhje edhe me opinionin e Misionit të Asistencës Doganore në Shqipëri të financuar nga Komisioni Europian,

VENDOSI TË MIRATOJË këto Dispozita Zbatuese të Kodit Doganor:

¹ Këtij vendimi i janë bërë disa ndryshime me vendimin e Keshillit të Ministrave nr.543, datë 24.11.1999. Ky tekst është i azhurnuar me ndryshimet e bëra.

PJESA I
DISPOZITA ZBATUESE TË PËRGJITHSHME
TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU 1

Përkufizime të përgjithshme

Neni 1

Për qëllim të këtij Vendimi përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. *Kod* do të thotë: Ligji nr 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8473, datw 14.04.1999;
2. *"ATA Carnet"* do të thotë: një dokument doganor ndërkombëtar për lejimin e përkohshëm, të përcaktuar me anë të Konventës ATA;
3. *"TIR Carnet"* do të thotë: një dokument ndërkombëtar transporti që lejon transportimin e mallrave nga zyra doganore e nisjes për në zyrën doganore të destinacionit nën procedurën TIR, të përcaktuar me anë të Konventës TIR;
4. *"Të dhëna të hollësishme që përdoren për identifikimin e mallrave"* do të thotë: nga njera anë të dhëna që nevojiten për të identifikuar mallrat nga pikpamja tregtare, duke u dhënë kështu mundësinë autoriteteve doganore të përcaktojnë klasifikimin tarifor dhe, nga ana tjetër, për të përcaktuar sasinë e mallrave;
5. *"Mallra të natyrës jo tregtare"* do të thotë: mallra, vendosja e të cilave nën një regjim doganor bëhet në mënyrë të rastësishme dhe, natyra dhe sasia e të cilave tregon se ato do të përdoren vetëm për qëllime private, vetjake ose familjare të marrësit ose të personave që i transportojnë, ose mallra që duket qartë se do të dhurohen;
6. *"Masa të politikës tregtare"* do të thotë: masa jo tarifore, të vendosura si pjesë e politikës tregtare, në formën e dispozitave që rregullojnë importin dhe eksportin e mallrave, kufizimet ose limitet sasiore, dhe ndalimet e importit ose eksportit;
7. *"Nomeklatura e mallrave"* do të thotë: një prej nomeklaturave të përcaktuara në nenin 28(6) të Kodit;
8. *"Sistem i harmonizuar"* do të thotë: Sistemi i Harmonizuar mbi Përshkrimin dhe Kodifikimin e Mallrave.

KREU 2

Përkufizime që lidhen me regjime të veçanta

Neni 2

1. Për qëllim të nenit 25 deri 29

- a) *"Informacion tarifor i detyrueshëm"* do të thotë: informacioni tarifor që është i detyrueshëm për administratën doganore kur plotësohen kushtet e përcaktuara në nenet 25 dhe 26;

- b) *"Kërkues"* do të thotë: një person i cili u ka kërkuar autoriteteve doganore informacion tarifor të detyrueshëm;

- c) *"Mbajtës"* do të thotë: një person në emër të të cilit lëshohet një informacion tarifor i detyrueshëm.

2. Për qëllim të nenit 44 deri 53:

- a) *"Fabrikim"* do të thotë: të gjitha llojet e punimeve ose përpunimeve, duke përfshirë ketu edhe montimin, ose operacione të tjera specifike;

- b) *"Material"* do të thotë: çdo ingrendient, lëndë e parë, përbërës ose pjesë etj., e përdorur në procesin e fabrikimit;

- c) *"Produkt"* do të thotë: çdo produkt i fabrikuar, edhe në qoftë se ai do të përdoret më tej në një operacion tjetër fabrikimi;

- d) *"Mallra"* do të thotë si materiale ashtu edhe produkte;

- e) *"Vlerë doganore"* do të thotë: vlera siç është përcaktuar në përputhje me Marrëveshjen për zbatimin të nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë e vitit 1994 (Marrëveshja e Organizates Botërore të Tregtisë - OBT mbi Vlerën Doganore);

- f) *"Çmimi ex-works"* - në listën e Aneksit 4 do të thotë çmimi që i paguhet fabrikuesit i cili ka ndërmarrë punimin ose transformimin e fundit të produktit. Ky çmim duhet të përmbajë në vetvete vlerën e të gjithë materialeve të përdorura në fabrikim, pasi të jenë zbritur detyrimet e brendshme që faktikisht janë rimbursuar ose që mund të rimbursohen kur produkti i përfutur eksportohet;

- g) *"Vlerë"* në listën e Aneksit 4 do të thotë vlera doganore në çastin e importimit të materialeve me origjinë jo shqiptare të përdorura ose, në qoftë se kjo vlerë nuk njihet dhe nuk mund të përcaktohet, çmimi i parë i verifikueshëm i paguar për materialet në fjalë në Republikën e Shqipërisë, në kuadrin e nenit 47(1). Ky parim zbatohet *mutatis mutandis* (me ndryshimet përkatëse), kur është e nevojshme të përcaktohet vlera e materialeve me origjinë shqiptare që janë përdorur në fabrikim;

- h) *"Kapitull"* dhe *"kre"* do të thotë: kapitujt dhe krerët (me kode 4 shifrore), të përdorura në një nomenklaturë që bazohet në Sistemin e Harmonizuar;

- i) *"Klasifikim"* do të thotë: gjetja e kreut përkates ku përfshihet një produkt ose material;

- j) *"Dërgesë"* do të thotë: produkte të cilat ose janë dërguar në të njëjtën kohë nga një

eksportues tek një marrës i vetëm, ose që paraqiten në një dokument të vetëm transporti i hartuar për dërgimin e këtyre produkteve nga eksportuesi tek marrësi, ose në mungesë të një dokumenti të tillë, me një faturë të vetme.

3. Për qëllim të nenit 54 deri 81:

- a) "*Mallra të prodhuara*" do të thotë: mallra të kultivuara, të fabrikuara dhe të nxjerra nga nëntoka ose burimet minerale;
- b) "*Mallra identike*" do të thotë: mallra të prodhuara në të njëjtin vend, të cilat janë të njëjta nga çdo pikëpamje, duke përfshirë edhe karakteristikat fizike, cilësinë dhe reputacionin. Ndryshime të vogla në pamje nuk përbëjnë shkak për t'u konsideruar jo identike mallrat të cilat në gjithshka tjetër përputhen me përkufizimin.
- c) "*Mallra të ngjashme*" do të thotë: mallra të prodhuara në të njëjtin vend, të cilat edhe pse nuk janë të ngjashme në çdo pikëpamje, kanë karakteristika dhe materiale përbërëse të ngjashme, të cilat bëjnë të mundur që ato të kryejnë të njëjtat funksione dhe të jenë të shkëmbyeshme me njëra-tjetrën nga ana tregtare; cilesia e mallrave, reputacioni i tyre dhe ekzistenca e një marke tregtare janë ndër elementet që merren parasysh për të përcaktuar nëse mallra të caktuara janë të ngjashme apo jo;
- d) "*Mallra të të njëjtës kategori ose lloj*" do të thotë: mallra të cilat klasifikohen brenda një grupi ose sërë mallrash të prodhuara nga një sektor i veçantë industrial, dhe ku përfshihen mallra identike ose të ngjashme.

Shprehjet "*mallra identike*" dhe "*mallra të ngjashme*", sipas rastit, nuk zbatohen për mallra të cilat në vetvete trupëzojnë ose pasqyrojnë punime inxhenerike, zhvillimi, artistike, projektuese, si dhe vizatime dhe skica për të cilat nuk është bërë ndonjë rregullim sipas nenit 37(1)(b)(iv) të Kodit, për shkak se këto veprime kanë qenë ndërmarrë në Republikën e Shqipërisë.

4. Për qëllim të nenit 79:

- a) "*Sistem mbartës*" nuk përfshin qarqet e integruara, gjysmëpërcjellesit dhe pajisje ose artikujt e tjerë ku janë trupëzuar këto qarqe ose pajisje;
- b) "*Të dhëna ose udhëzime*" nuk përfshin regjistrimet zanore, kinematografike dhe videot.

5. Për qëllim të nenit 118 deri 120:

- a) "*Mallra të falsifikuara*" do të thotë:
 - i) mallrat, duke përfshirë edhe ambalazhin e tyre, mbi të cilat është vendosur pa autorizim një markë tregtare, identike me atë që është regjistruar rregullisht për të njëjtat lloje mallrash, ose që në thelb është e padallueshme nga kjo markë tregtare, dhe gjë që, në bazë të legjislacionit në fuqi, përbën shkelje të të drejtave të mbajtësit të

markës në fjalë,

- ii) çfarëdo shenje tjetër identifikuese (stemë, etiketë, etiketa vetëngjithëse, fletëpalosje, fletë ilustruese, dokument garancie), edhe nëse paraqiten veçmas, dhe që janë në të njëjtën gjëndje me mallrat e përmendura në nënparagrafin (i),
- iii) ambalazhet mbi të cilët janë shënuar markat e mallrave të falsifikuara të paraqitura veçmas, që janë në të njëjtën gjëndje me mallrat e përmendura në (i);
- b) "*Mallra pirate*" do të thotë: mallra që janë ose përmbajnë kopje të bëra pa pëlqimin e mbajtësit të së drejtës së autorit apo të ndonjë të drejtë të ngjashme me të, ose të mbajtësit të së drejtës së modelimit, nëse këto janë regjistruar ose jo sipas legjislacionit kombëtar, ose të një personi të autorizuar në mënyrën e duhur nga mbajtësi i së drejtës në vendin e prodhimit, nëse berja e këtyre kopjeve përbën shkelje të së drejtës në fjalë, në bazë të legjislacionit shqiptar që rregullon fushën përkatëse;
- c) "*Mbajtësi i së drejtës*" do të thotë: mbajtësi i një marke tregtare që përmendet në paragrafin (a), dhe/ose të njëjës prej të drejtave që përmenden në paragrafin (b), ose dhe çdo person tjetër i autorizuar të përdorë markën tregtare dhe/ose të drejtat, ose përfaqësimin e mbajtësit;
- d) "*Deklaratë për vendosje në qarkullim të lirë, eksport ose riekспорт*" do të thotë: deklaratat e bëra në përputhje me neni 86 të Kodit;

Quhen mallra të falsifikuara ose pirate, sipas rastit, edhe çdo stampë ose matricë e projektuar posaçërisht ose e përshtatur për fabrikimin e një marke të falsifikuar ose të një malli që mban këtë markë ose për fabrikimin e një malli pirat në rastet kur përdorimi i këtyre stampave ose matricave përbën shkelje të së drejtës të mbajtësit të së drejtës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Për qëllim të nenit 182 deri 233:

- a) "*Mjet transporti*" do të thotë: mjete, në veçanti:
 - i) çdo mjet rrugor, rimorkio ose gjysëm-rimorkio, çdo vagon treni ose vagon mallrash,
 - ii) çdo varkë ose anije,
 - iii) çdo mjet fluturimi
 - iv) çdo kontenier në kuptim të nenit 29 (g);
- b) "*Zyrë nisje*" do të thotë: zyra doganore ku fillon operacioni i tranzitit;
- c) "*Zyrë destinacioni*" do të thotë: zyra doganore ku mallrat e vëna nën regjimin e tranzitit duhet të paraqiten për të përfunduar operacionin e tranzitit;
- d) "*Zyra e garancisë*" do të thotë: zyra doganore ku është dhënë garancia globale.

7. Për qëllim të nenit 234 deri 427:

- a) *"Zyrë doganore mbikqyrëse"* do të thotë: zyra doganore e autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për mbikqyrjen e regjimit, siç përcaktohet në autorizim;
- b) *"Zyrë e vënies nën regjim"* do të thotë: zyra apo zyrat doganore të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për pranimin e deklarave që venë mallrat nën regjimin që përcaktohet në autorizim;
- c) *"Zyrë e mbylljes së regjimit"* do të thotë: zyra apo zyrat doganore të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për të pranuar, siç është treguar në autorizim, deklaratat për t'u caktuar mallrave një destinacionin doganor, pasi ato kanë qenë të vendosura në një regjim doganor ekonomik.
8. Për qëllim të nenit 272 deri 325:
- a) *"Produkte kompensuese kryesore"* do të thotë: produktet kompensuese për përfitimin e të cilave është dhënë autorizim për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv;
- b) *"Produkte kompensuese dytësore"* do të thotë: produkte kompensuese të ndryshme nga ato kryesore të cilët që përfitohen domosdoshmërisht si produkt shoqërues gjatë operacioneve të përpunimit;
- c) *"Humbje(/firo)"* do të thotë: pjesa e mallrave të importuara të cilat shkatërrohen dhe humbasin gjatë përpunimit, veçanërisht për shkak të avullimit, tharjes, çlirimit në trajtë gazi ose nga shpërthim;
- d) *"Metoda e matjes sasiore"* do të thotë: llogaritja e asaj pjese të mallrave të importuara të trupëzuara në produkte të ndryshme kompensuese në raport me sasinë e mallrave të importuara;
- e) *"Metoda e matjes mbi bazën e vlerës"* do të thotë: përllogaritja e asaj pjese të mallrave të importuara të trupëzuara në produktet të ndryshme kompensuese në raport me vlerën e këtyre të fundit;
- f) *"Operator"* do të thotë: personi që kryen të gjithë ose një pjesë të operacioneve të përpunimit;
- g) *"Afat i ri eksportimit"* do të thotë: afati brenda të cilit produkteve duhet t'u caktohet një destinacion doganor siç përshkruhet në nenin 112 të Kodit;
9. Për qëllim të nenit 342 deri 402:
- a) *"Zyrë doganore e hyrjes"* do të thotë: zyra doganore nëpërmjet të cilës mallrat e shoqëruara nga një *Carnet ATA*, hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;
- b) *"Zyrë doganore e daljes"* do të thotë: zyra doganore nëpërmjet të cilës mallrat e shoqëruara nga një *Carnet ATA*, dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;
- c) *"Mjete transporti"* do të thotë: çdo mjet i përdorur për transportin e personave ose të mallrave. Termi i mësipërm përfshin edhe pjesët e këmbimit, aksesoret dhe pajisjet e zakonshme, duke përfshirë këtu edhe pajisjet që nevojten për të stivuar, fiksuar ose siguruar mallrat kur materiale të tilla importohen së bashku me mjetet e transportit;
- d) *"Person i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë"* do të thotë: një person fizik i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ose një person juridik i cili ka selinë tregtare të regjistruar jashtë këtij territori;
- e) *"Përdorim tregtar"* do të thotë: përdorimi i një mjeti transporti për transportimin e personave për qëllime përfitimi, ose transportimin industrial apo tregtar të mallrave për qëllime përfitimi ose jo;
- f) *"Përdorim privat"* do të thotë: përdorim nga ana e një personi e një mjeti transporti vetëm për përdorim vetiak, duke përjashtuar përdorimin tregtar;
- g) *"Konteiner"* do të thotë: një lloj pajisje transporti që:
- përbën një ndarje të mbyllur plotësisht ose pjesërisht për të mbajtur mallra;
 - ka karakter të përhershëm dhe njëkohësisht është rezistent në atë masë që të mund të përdoret në mënyrë të përsëritur,
 - është projektuar në mënyrë të tillë që lehtëson transportin e mallrave, nëpërmjet një ose disa mënyrash transporti, pa pasur nevojë për ngarkim-shkarkime të ndërmjetme,
 - është projektuar për t'u manovruar lehtësisht, sidomos gjatë transbordimit nga një lloj transporti në një tjetër,
 - është projektuar në mënyrë të tillë që mbushtet dhe zbrazet lehtësisht, me një vëllim të brendshëm prej 1 m³ e më shumë.
- Edhe platformat e sheshta trajtohen si konteinerë. Termi *"konteiner"* përfshin aksesoret dhe pajisje të konteinerit, të përshtatshme për llojin në fjalë, me kusht që të transportohen bashkë me konteinerin. Ky term nuk përfshin automjetet, aksesoret ose pjesë këmbimi të tyre, ambalazhe dhe paleta. Duke anashkaluar nënparagrafin g(v), termi *"konteiner"* zbatohet edhe për konteineret e përdorur në transportin ajror me vëllim të brendshëm më të vogël se 1 m³;
- h) *"Transport nën plumbosjen doganore"* do të thotë: përdorimin e konteinerëve për transportin e mallrave, identifikimi i të cilave sigurohet me anën e plumbosjes së konteinerit;
- i) *"Karroceri e levizshme"* do të thotë: një ndarje për ngarkim, e cila nuk ka mjete të pavarura lëvizjeje dhe është e projektuar posaçërisht për t'u transportuar mbi mjetet

rrugore në të cilat shasia dhe platforma e të cilave është projektuar për këtë qëllim. Ky përkufizim përfshin kasat e levizshme të cilat formojnë ndarje për ngarkesë të projektuara posqërisht për transport të kombinuar;

- j) *"Kontainerë pjesërisht të mbyllur"* do të thotë: një strukturë e cila në përgjithësi përbëhet nga një platformë e vetme dhe nga katër mbajtëse vertikale që kufizojnë një hapësirë ngarkimi të barazvlefshme me atë të një kontaineri të mbyllur; superstruktura përbëhet zakonisht nga elementë metalikë që formojnë kornizën e një kontaineri; kontainerë të këtij karakteri mund të përbëhen edhe një ose disa parete anësore ose ballore; në raste të caktuara ka vetëm një tavan të lidhur me katin me anën e katër elementëve të superstrukturës vertikale. Kontainerë të këtij lloji përdoren zakonisht për transportimin e mallrave me vëllim të madh (p.sh. automjete);
- k) *"Platforma të sheshta"* do të thotë: platforma të levizshme ngarkimi, të sheshta, pa struktura të ndërtuara mbi to, ose me struktura të pjesshme, me gjatësi dhe gjerësi të njëjtë me kontainerët dhe që ka kënde të sipërme dhe të poshtme të vendosura në qoshtet e kontainerëve për të mundësuar vendosjen e pajisjeve të stivosjes dhe ngritjes që përdoren për kontaineret;
- l) *"Aksesorë dhe pajisje të kontainerit"* do të thotë: veçanërisht pajisjet e mëposhtme, të levizshme ose jo:
 - i) pajisje për kontrollin, ndryshimin dhe ruajtjen e temperaturës brenda kontainerëve;
 - ii) pajisje të vogla si regjistruar të temperaturës, ose të goditjeve, të projektuara në mënyrë të tillë që të tregojnë ndryshimet në kushtet mjedisore dhe goditjet;
 - iii) ndarës të brendshëm, paleta, rafte, mbështetës, çengela, dhe pajisje të tjera për stivimin e mallrave;
- m) *"Paleta"* do të thotë: një pajisje në sipërfaqe të të cilës mund të vendosen së bashku një sasi mallrash duke formuar një njësi ngarkese për qëllime transporti, levizjeje ose ruajtje apo stivim të mallit, duke përdorur aparatura të tjera mekanike. Pajisja në fjalë përbëhet nga dy kate që lidhen me njëri tjetrin me anë të traversave ose nga një kat i vetëm i mbështetur mbi këmbë, ose nga një kat i veçantë që përdoret për transportin ajror; lartësia e saj e përgjithshme duhet të jetë aq sa të bëjë të mundur levizjen me vinça pirun ose karrelet e paletave. Paletat mund të kenë edhe superstrukturë të ngritur mbi to;
- n) *"Përdorues të një kontaineri ose paletë"* do të

thotë: personi i cili, është ose jo pronari i kontainerit, kontrollon faktikisht lëvizjet e tyre;

- o) *"Përdorues i një kontaineri ose paletë"* do të thotë: përdoruesi i kontainerit ose paletës, ose përfaqësuesi i tij;
- p) *"Trafik i brendshëm"* do të thotë: transporti i personave ose mallrave që kanë hipur ose janë ngarkuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për të zbritur ose për t'u shkarkuar në një vend tjetër brenda këtij territori.

10. Për qëllim të nenit 403 deri 427:

- a) *"Produkte kompensuese kryesore"* do të thotë: produktet kompensuese për përfundimin e të cilave është lëshuar autorizim për përdorimin e regjimit të përpunimit pasiv;
- b) *"Produkte kompensuese dytësore"* do të thotë: produkte kompensuese të ndryshme nga produktet për të cilat u dha autorizimi dhe që përftohen domosdoshmërisht si produkt shoqërues nga operacionet e përpunimit pasiv;
- c) *"humbje(/firo)"* do të thotë: pjesa e mallrave të eksportuara përkohësisht të cilat humbasin gjatë përpunimit, veçanërisht për shkak të avullimit, tharjes, shkarkimit në trajtë gazi ose humbjes për shkak të shpëlarjes;
- d) *"Metoda e matjes sasiore"* do të thotë: përlllogaritja e asaj pjese të mallrave të eksportit të trupezuara në produktet kompensuese të ndryshme në funksion të sasisë së mallrave të importit;
- e) *"Metoda e matjes mbi bazën e vlerës"* do të thotë: përlllogaritja e asaj pjese të mallrave të eksportit të trupëzuara në produktet kompensuese të ndryshme në funksion të vlerës së këtyre të fundit;
- f) *"Importim paraprak"* do të thotë: sistemi i parashikuar në nenin 174 (4) të Kodit;
- g) *"Shuma për t'u zbritur"* do të thotë: shuma e detyrimeve doganore të importit të cilat do të duhej të paguheshin për mallrat e eksportit të përkohshëm, nëse keto të fundit do të importoheshin në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga ai vend në të cilin iu nënshtuan operacioneve të përpunimit ose operacioneve të fundit të përpunimit;
- h) *"Shpenzime ngarkimi, transporti, dhe sigurimi"* do të thotë: gjithë shpenzimet që janë bërë në lidhje me ngarkimin, transportin dhe sigurimin e mallrave, duke përfshirë:
 - i) komisionet dhe shpenzimet e ndermjëtesisë, duke përfshirë

komisionet e blerjes;

- ii) kostot e mbajtësve të mallrave (shishe, flakonë, çanta, kuti, thasë, dhe mbajtës të tjerë të kësaj natyre) që nuk janë pjesë përbërëse e mallrave të eksportuara përkohësisht;
- iii) kostot e ambalazhimit, duke përfshirë materialet dhe punën e krahut;
- iv) shpenzimet e bëra për trajtimin e mallrave, lidhur me transportin e tyre.

11. Për qëllim të nenit 442 deri 472: "operator" do të thotë çdo person i cili kryen një aktivitet që përfshin ruajtjen, punimin, përpunimin, shitjen ose blerjen e mallrave në një zonë të lirë ose në një magazinë të lirë.

12. Për qëllim të nenit 477 deri 560:

- a) "Sende personale" do të thotë: sendet që nevojiten për përdorim personal të të interesuarit ose për nevoja familjare të këtij të fundit. Përbëjnë, në veçanti, sende personale, sendet e poshtme:
 - i) sendet shtëpiake,
 - ii) biçikleta dhe motoçikleta, automjetet private dhe rimorkiot e tyre, ruletat e kampingut, mjetet ajrore për dëfrim dhe avionet private,
 - iii) furnizimet shtëpiake në masën dhe për llojin që i përshtaten përdorimit shtëpiak, manarët shtëpiake dhe kuajt e shalës. Gjithashtu përbëjnë pronë vetiake edhe instrumenta të tjerë portativë të arteve të aplikuara dhe të profesioneve të lira, që nevojiten për ushtrimin e profesionit nga i interesuari. Sendet vetiake duhet të importohen në sasi dhe të jenë të një

natyre të tillë që të duket qartë se nuk po importohen për qëllime tregtare;

- b) "Sende shtëpiake" do të thotë: sendet vetiake, shtresa dhe mbulesa për përdorim shtëpiak, mobilje, dhe pajisje të tjera për përdorim personal të të interesuarit ose për të plotësuar nevojat e tij shtëpiake;
- c) "Produkte alkoolike" do të thotë: produktet (si p.sh. birrë, verë, aperitive me përmbajtje vere ose likeri, konjak, likerna, ose pije të tjera alkoolike, etj), që përfshihen në kërret nga 2203 deri 2208 të Nomenklaturës së Kombinuar.

13. Për qëllim të nenit 571 deri 613:

- a) "Zyrë doganore e kontabilizimit" do të thotë: zyra doganore në të cilën kontabilizohen detyrimet e importit ose eksportit, për të cilat kërkohet rimbursimi ose shuarja e tyre;
- b) "Autoritet doganor vendimarrës" do të thotë: autoritetet doganore kompetente për të vendosur rimbursimin ose shuarjen e detyrimeve të importit ose eksportit;
- c) "Zyrë doganore mbikqyrëse" do të thotë: zyra doganore nën juridiksionin e së cilës gjenden edhe mallrat, për kontabilizimin e detyrimeve doganore të importit ose eksportit për të cilat kërkohet rimbursim ose shuarje, zyrë kjo që kryen kontrollet e nevojshme për vlerësimin e kërkesës;
- d) "Zyrë doganore zbatuese" do të thotë: zyra doganore që zbaton masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e rregullt të vendimit për rimbursimin ose shuarjen e detyrimeve të importit ose eksportit.

TITULLI II

ORGANIZIMI I ADMINISTRATËS DOGANORE, I PERSONELIT DHE I VEPRIMTARISË DOGANORE

KREUI

Organizimi dhe përgjegjësite e Administratës Doganore Qëndrore në përputhje me paragrafin 3, neni 9, të Kodit.

Neni 3

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave organizohet në 3 Departamentet e mëposhtëm:

- a) Departamenti Administrativ;
- b) Departamenti Teknik;
- c) Departamenti Operativ dhe Hetimor.

Çdo departament drejtohet nga një Nëndrejtor i Përgjithshëm, i emëruar në përputhje me nenin 14 të Kodit. Drejtoritë dhe Sektorët në përbërje të Departamenteve drejtohen respektivisht nga zyrtarë

të kategorisë A dhe të kategorisë B.

Nëndrejtorët e Përgjithshëm dhe Kryetarët e Drejtorive Rajonale varen drejtpërsëdrejti nga Drejtori i Përgjithshëm.

Drejtoria e Marredhenieve me Jashtë dhe Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm varen drejtpërsëdrejti nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 4

Departamenti Administrativ përbëhet nga Drejtoritë dhe Sektorët e mëposhtëm, të cilave u janë caktuar përgjegjësite kryesore që vijojnë:

1. Drejtoria e Administrimit dhe e Trajnimit të Personelit:

- a) Sektori i Administrimit të Personelit:

Në përputhje me legjislacionin ekzistues për administrimin publik, Sektori i Administrimit të Personelit ka përgjegjësitë kryesore që vijnë: Procedurat e rekrutimit të personelit doganor. Përcaktimi i nivelit të pagës, emërimet, përparimi në detyrë, zbatimi i masave disiplinore dhe shkarkimet nga detyra. Administrimi dhe transferimi i personelit brenda zyrave të Administratës Doganore, duke përfshirë edhe dërgimin e përkohshëm në detyrë. Orari i punës, organizimi i turneve të shërbimit dhe kontrolli i pranisë së personelit në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme. Organizimi i dërgimit dhe i marrjes së korrespondencës. Lëshimi i Kartave të Shërbimit dhe të Identitetit për personelin doganor. Organizimi i zyrës së Marrëdhënieve Publike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Administrimi i arkivit të Drejtorisë së Përgjithshme.

b) Sektori i Trajnimit:

Në përputhje me legjislacionin ekzistues për administrimin publik, Sektori i Trajnimit ka përgjegjësitë kryesore që vijnë: Hartimi i programeve bazë, të rifreskimit e të specializimit për trajnimin e personelit. Organizim kursesh, seminaresh dhe aktiviteteve të tjera trajnuese për personelin doganor. Administrimi i qëndrave të trajnimit. Bashkërendimi i veprimtarive trajnuese dhe të ndihmës teknike që jepet nga Administrata Doganore të huaja dhe Organizata të tjera Ndërkombëtare.

2. Drejtoria e Kompjuterizimit

Përcaktimi i nevojave të zyrave të Drejtorisë së Përgjithshme, si dhe të zyrave lokale në fushën e kompjuterizimit, duke përfshirë pajisjet e nevojshme për funksionimin e këtij sistemi. Projektimi, përpunimi dhe administrimi i *software*-it. Përgatitja e udhëzimeve për personelin doganor për përdorimin e sistemit të kompjuterizuar.

3. Drejtoria e Investimeve dhe e Logjistikës

Planifikimi, në bashkëpunim me zyrat e Departamentit Teknik, i blerjeve, ndërtimit dhe rindërtimit të mjediseve dhe blerjen e makinerive dhe të pajisjeve të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë doganore, duke përfshirë kompjutera, mjete transporti, pajisje për laboratorin e doganës, uniformat e personelit dhe orënditë e zyrave. Realizon procedurat e blerjes, në bashkëpunim me zyrat e tjera të interesuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Administrimi dhe mirëmbajtja e mjediseve të Drejtorisë së Përgjithshme.

4. Drejtoria e Financës

Analizat financiare dhe të bilancit. Përgatitja e planit vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe përdorimi i burimeve financiare. Mbajtja e kontabilitetit, shpërndarja dhe akordimi i fondeve të nevojshme për funksionimin e zyrave qëndrore e lokale dhe për pagimin e personelit doganor. Dhënia e pagave dhe e shpërblimeve të tjera shtesë personelit të Drejtorisë së

Përgjithshme.

Neni 5

Departamenti Teknik përbëhet nga Drejtoritë dhe Sektorët e mëposhtëm, të cilëve u janë caktuar përgjegjësitë kryesore që vijnë:

1. Drejtoria e Procedurave Doganore dhe e Vjeljes së Detyrimeve.

a) Sektori i Procedurave:

Procedurat doganore që kanë të bëjnë me personat dhe me përfaqësuesit e tyre. Lëshimi i autorizimeve për agjentët doganore. Levizja e mallrave dhe e bagazheve brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Deklaratat përmbledhëse dhe magazinimi i përkohshëm i mallrave. Deklarimi doganor. Dispozitat që kanë të bëjnë me turizmin ndërkombëtar. Procedurat e vendosjes në qarkullim të lirë dhe të eksportit. Procedurat e tranzitit, të përpunimit aktiv dhe pasiv, të përpunimit nën kontroll doganor, lejimi i përkohshëm, procedurat e magazinimit doganor. Zonat e lira dhe magazinat e lira. Magazinat e furnizimit dhe *Duty Free Shops*. Furnizimet dhe pajisjet për përdorim në bord të mjeteve të transportit. Ndalimet dhe kufizimet në importin dhe eksportin e mallrave, edhe për mallrat me karakter fito-sanitar, ambientalist e kulturor. Rregullat e kontrollit të transferimit fizik të valutës.

b) Sektori i vjeljes së detyrimeve doganore:

Procedurat doganore për lindjen dhe rikuperimin e borxhit doganor. Procedurat e dhënies së garancisë. Udhëzimet për kontabilizimin e të ardhurave nga detyrimet e importit ose eksportit, vjeljen e detyrimeve, rimbursimin ose shlyerjen e borxhit doganor. Dhënia e udhëzimeve për përdoruesit në lidhje me sistemet e të dhënave, të formularëve, të regjistrave dhe blloqeve përkatës të nevojshëm për mbajtjen e llogarive doganore.

2. Drejtoria e Origjinës, e Vlerës dhe e Tarifës

Nomenklatura doganore, tarifa doganore dhe shënimet shpjeguese për tarifën. Informacioni i detyrueshëm tarifor. Vlera doganore. Origjina e mallrave dhe administrimi i marrëveshjeve preferenciale përkatëse. Procedurat e leshimit të certifikatave të origjinës preferenciale. Kurset e shkëmbimit. Përfashtimet dhe pezullimet tarifore. Zbatimin e masave të politikës tregtare, kuotave dhe tavaneve tarifore, dhe masave *antidumping*.

3. Drejtoria Juridike

Hartimi i propozimeve ligjore për çështje që kanë të bëjnë me fushën doganore. Këshillim ligjor zyrave të tjera të Departamenteve të administrates qëndrore, rajonale dhe zyrave lokale, me kërkesë të tyre. Përgatitja e kontratave në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Administrimi i mosmarrëveshjeve doganore dhe lidhjet me organet gjyqësore. Ndihmë ligjore zyrave doganore për vjeljen e borxheve doganore.

4. Drejtoria e Statistikës

Mbledhja e të dhënave për lëvizjen e mallrave shqiptare dhe jo-shqiptare që hyjne e dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë. Analiza e të dhënave dhe përgatitja e dokumenteve përkatëse që do të jenë objek i vlerësimit nga zyrat e interesuara. Shpërndarja e këtyre dokumenteve pranë autoriteteve përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi. Administrimi i qendrës kombëtare për përpunimin e të dhënave.

5. Drejtoria e Laboratorit Kimik Doganor

Studime mbi metodat dhe teknikat për analizën kimike, teknologjike dhe mercologjike të mallrave. Administrimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të Laboratorit Kimik Doganor. Analiza e mostrave të marra nga zyrat lokale dhe lëshimi i certifikatave përkatëse për verifikimin e llojit të mallrave dhe klasifikimin tarifor të tyre.

Neni 6

Departamenti Operativ dhe Hetimor përbëhet nga drejtoritë dhe sektorët e mëposhtëm, të cilëve u janë caktuar përgjegjësitë kryesore që vijojnë:

1. Drejtoria e Anti-Kontrabandës

Përpunimi i strategjive dhe i planit anti-kontrabande. Instruktimi dhe koordinimi i veprimtarive të Zyrës Mbështetëse Rajonale të Anti-kontrabandës. Kryerja e kontroleve fizike dhe dokumentare mbi bazën e informacioneve dhe analizimit të riskut, në çdo vend brënda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke ndërmarrë shqyrtime të mallrave, të personave dhe të mjeteve të transportit për të zbuluar dhe frenuar kontrabandën brënda territorit doganor shqiptar dhe nga territori i vendeve të tjera. Nëpërmjet kryerjes së kontroleve identifikon dhe i jep të dhëna rreth veprimtarisë ose personave të dyshimtë për *data base-in* e informacionit. Jep ndihmë në hetimin e shkeljeve doganore.

2. Drejtoria Hetimore dhe e Informimit

Në zbatim të paragrafit 3, neni 11 të Kodit, ndërmerr kontrole të dokumenteve dhe kontrole fizike, duke përfshirë kontrollin pranë ambjenteve të operatorëve ekonomike, me qëllim që të hetojë çdo shkelje doganore të mundshme në çdo pikë të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Mbledh informacione për *data base-in* e informacionit. Përgatit raporte për ndjekjet penale.

Mbledh, në përputhje me nenin 294 të Kodit, të dhëna dhe informacion mbi shkeljet doganore të dyshuara, faktike ose të mundshme. Kryen kërkime duke shfrytëzuar marrëveshje të Asistencës Administrative dypalëshe të nënshkruara me administratat doganore të vendeve të tjera. Analizon të dhëna dhe informacione rreth veprimtarive ose personave të dyshimtë dhe siguron udhëzime dhe mbështetje për personelin që vepron në fushën e hetimit dhe të anti-kontrabandës. Administrimi dhe përdorimi i *data base-it* të shërbimit informativ.

Neni 7

Varen drejtpërsëdrejti nga Drejtori i Përgjithshëm drejtoritë e mëposhtme, të cilave u janë caktuar përgjegjësitë kryesore që vijojnë:

1. Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm:

Analiza e të ardhurave doganore, duke pasur si qëllim një kontroll të përgjithshëm të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Kontrolli dhe mbikqyrja e veprimtarisë së Drejtorive Rajonale nga pikëpamja financiare dhe administrative. Inspektimi i Drejtorive Rajonale dhe i zyrave doganore për të verifikuar saktësinë e zbatimit të procedurave administrative të kryera nga personeli doganor. Përgatitja e raporteve për Drejtorin e Përgjithshëm ose, në rast se është e nevojshme, për Komitetin Disiplinor të parashikuar në nenin 17, Kreun 6, të këtij Titulli.

2. Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë:

Përgatitja, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, e Marrëveshjeve të Asistencës Administrative dypalëshe për çështje doganore. Bashkëpunimi ndërkombëtar. Marrëdhëniet me Administratat Doganore të vendeve të tjera dhe me Bashkimin Europian. Organizimi i vizitave të delegacioneve doganore të huaja në Shqipëri. Shërbime përkthimi.

KREU 2

Organizimi dhe përgjegjësitë e Administratës Doganore Lokale në përputhje me paragrafin 3, neni 9 të Kodit

Neni 8

1. Në përputhje me nenin 9, paragrafi 3 të Kodit, zyrat lokale të Administratës Doganore organizohen në 5 Drejtori Rajonale.

2. Pesë Drejtoritë Rajonale janë kompetente për territorin doganor që do të kenë në përbërjen e tyre qarqet e mëposhtme:

Drejtorja Rajonale Nr.1: Lezhë, Shkodër, Malsi e Madhe, Tropojë, Has, Pukë, Mirditë dhe Kukës.

Drejtorja Rajonale Nr.2: Krujë, Kurbin, Dibër, Bulqizë, Mat, Tiranë, Peqin, Elbasan, Gramsh, Durrës dhe Kavajë..

Drejtorja Rajonale Nr.3: Librazhd, Pogradec, Korçë, Devoll dhe Kolonjë

Drejtorja Rajonale Nr.4: Vlorë, Mallakastër, Berat, Skrapar, Kuçovë, Fier dhe Lushnjë.

Drejtorja Rajonale 5: Tepelenë, Përmet, Gjirokastër, Delvinë, dhe Sarandë.

3. Drejtoria Rajonale Nr.1 e ka selinë në Shkodër dhe ka në varësi degët doganore Shkodër (Hani i Hotit, Bajzë); Lezhë (Shëngjin); Kukës (Morinë); Has (Qafë-Prush).

Drejtorja Rajonale Nr.2 e ka selinë në Tiranë dhe ka në varësi degët doganore: Tiranë; Rinas; Durrës; Elbasan; dhe Peshkopi (Billadë).

Drejtoria Rajonale Nr.3 e ka selinë në Pogradec dhe ka në varësi degët doganore: Pogradec (Qafë Thanë, Tushemisht); Korçë (Goricë); Kapshticë.

Drejtoria Rajonale Nr.4 e ka selinë në Vlorë dhe ka në varësi degët doganore: Berat, Fier; Vlorë(Vlorw, Himarw).

Drejtoria Rajonale Nr.5 e ka selinë në Gjirokastër dhe ka në varësi degët doganore: Gjirokastër (Kakavia); Sarandë

Drejtoritë Rajonale Doganore drejtohen nga zyrtarë të kategorisë A, të cilët emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Ata janë përgjegjës për mbikqyrjen e territorit doganor nën përgjegjësi të tyre dhe për mbikqyrjen e degëve doganore në varësi të tyre, si edhe për drejtimin dhe administrimin e këtyre degëve në lidhje me efektshmërinë dhe veprimtaritë e tyre.

Drejtoritë Rajonale organizohen në katër Sektorët e mëposhtëm dhe drejtohen nga zyrtarë të kategorisë B, të cilët emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm në përputhje me nenin 11 (9):

a) Sektor i Çështjeve të Përgjithshme dhe i Personelit: përgjigjet për administrimin e çështjeve për personelin që nuk është nën përgjegjësi e ndonjëres prej Drejtorisë së Përgjithshme dhe përgjigjet për çështjet e përgjithshme dhe ato doganore që nuk janë nën përgjegjësinë e ndonjërit prej Sektorëve të Drejtorisë Rajonale;

b) Sektori i Kontrollit të Brendshëm: përgjigjet për mbikqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë së kryer nga zyrtar doganore rajonale;

c) Sektori i Mbështetjes së Anti-kontrabandës: përgjigjet për kontrollin dhe mbikqyrjen doganore brenda zonave doganore, në zonat e mbikqyrjes bregdetare, në kufirin tokësor, në aeroportet dhe në ujrat e brendshme në kompetencë të Drejtorisë Rajonale, si dhe i jep ndihmë e informacion Drejtorisë së Anti-kontrabandës të Departamentit Operativ dhe Hetimor me kërkesë të saj. Edhe pse në përbërje të Drejtorisë Rajonale nga pikëpamja hierarkike dhe funksionale ky sektor varet nga Departamenti Operativ dhe Hetimor;

d) Sektori i Shërbimit të Informatikës e të Statistikës: përgjigjet për administrimin, në nivel lokal, të sistemeve informatike dhe për mbledhjen e të dhënave statistikore nga zyrtarë të tij, për t'i dërguar pranë Drejtorisë së Statistikës të Departamentit Teknik.

Neni 9

Degët Doganore të përmendura në nenin 8 drejtohen nga zyrtarë të kategorisë B ose C1 kur zbatohet dispozita e parashikuar në nenin 10(2), paragrafi i fundit. Çdo degë doganore mund të organizohen në zyrtarë e mëposhtëm:

a) Zyra e çështjeve të përgjithshme, e marrëdhënieve publike, e administrimit të logjistikës dhe pajisjeve të zyrës, duke përfshirë ambjentet për magazinim të përkohshëm;

b) Zyra e pranimit dhe e regjistrimit të deklaratave doganore;

c) Zyra e kontabilitetit;

d) Zyra e kontrolleve dokumentare dhe fizike;

e) Pika e kontrollit, siç parashikohet në paragrafin 5, neni 11 të Kodit;

f) Zyra për kontrollin e jashtëm, duke përfshirë mbikqyrjen doganore;

g) Zyra ligjore për administrimin e procedurave të mosmarrëveshjeve administrative e penale.

KREU 3

Klasifikimi, rekrutimi, përgjegjësitë dhe vlerësimi i personelit

Neni 10

1. Në përputhje me nenin 13, paragrafi 2 të Kodit, personeli i Administratës Doganore kategorizohet si më poshtë:

a) drejtues të lartë: zyrtarë të kategorisë A dhe B;

b) doganierë drejtues: zyrtarë të kategorisë C1;

c) doganierë: zyrtarë të kategorisë C2;

d) personel tjetër doganor: personel i kategorisë D1 dhe D2;

2. Në zbatim të nenit 13, paragrafi 3 të Kodit, personelit të Administratës Doganore i janë ngarkuar funksionet dhe detyrat e mëposhtme:

Drejtori i Përgjithshëm: Kreu i Administratës Doganore. Përveç përgjegjësi të parashikuar në Kod, është përgjegjës për hartimin e strategjisë mbi politikën doganore, për drejtimin, koordinimin dhe mbikqyrjen e të gjithë veprimtarisë doganore, si dhe për drejtimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të Administratës Doganore.

Nëndrejtori i Përgjithshëm: Drejtues i një Departamenti. Drejton, bashkërendon dhe mbikqyr veprimtarinë e kryer nga zyrtarë e Departamentit të tij.

Zyrtar i kategorisë A: Drejtor i një Drejtorie të një Departamenti ose Drejtor i një Drejtorie Rajonale. Drejton, bashkërendon dhe mbikqyr veprimtaritë e kryera nga Drejtoria e tij.

Zyrtar i kategorisë B: Përgjegjës i një Sektori të një Departamenti ose i një Sektori të Drejtorisë Rajonale, ose Kryetar i një dege doganore. Drejton, bashkërendon dhe mbikqyr veprimtaritë e kryera nga Sektori ose dega doganore e drejtuar prej tij. Inspektor kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit të Brendshëm

Zyrtar i kategorisë C1: Kryetar i një zyre brenda degës doganore ose hetues doganor. Bashkërendon veprimtarinë e kryer nga sektori i tij, si edhe veprimtaritë e shërbimit informativ dhe hetimor. Drejtues turnesh. Specialistë në

Drejtoritë e Drejtorisë së Përgjithshme. Veprimtari kontrolli dhe analiza statistikore, këshillim dhe/ose ndihmë ligjore. Analiza të mallrave në Laboratorin Kimik Doganor.

Zyrtar i kategorisë C2: Doganier. Merret me regjimet doganore, kontrolle dhe mbikqyrje doganore në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Veprimtari për parandalimin dhe verifikimin e shkeljeve doganore, detyra të posaçme për t'i dhënë ndihmë të specializuar zyrave qendrore e lokale.

Personel doganor i kategorisë D1: Personel tjetër doganor. Kryen pranimin dhe regjistrimin e deklarave doganore. Llogaritar dhe arketar. Futja e të dhënave në sistemin informatik. Jep ndihmë Laboratorit Kimik Doganor. Veprimtari administrative.

Personel doganor i kategorisë D2: Personel tjetër doganor. Centralist, sportelist, shofer, shërbime sanitare dhe mirëmbajtje të zyrave.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave mund të vendosë, me propozim të Ministrit të Financave, që një kategori e ndryshme nga ato të përmendura më sipër mund të përdoret për një personel të caktuar, duke marrë parasysh shtrirjen dhe përgjegjësitë e pozicionit të tyre.

3. Ligji për Shërbimin Civil dhe aktet e tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tij duhet të zbatohen "*mutatis mutandis*" për Drejtorin e Përgjithshëm, Nëndrejtorët e Përgjithshëm dhe personelin e kategorisë A, B, dhe C.

Personeli i kategorisë D mbulohet nga Kodi i Punës në fuqi.

Neni 11

1. Në përputhje me nenin 14 të Kodit dhe pa rënë ndesh me legjislacionin në fuqi për Shërbimin Publik si dhe duke marrë parasysh specifikat e veprimtarisë doganore, vendet e lira të punës në administratën doganore zihen në varësi të kategorisë dhe llojit të postit, në përputhje me ndonjë nga procedurat e mëposhtme ose kombinimit të tyre:

- a) transferim i personelit doganor brenda së njëjtës kategori;
- b) ngritje në përgjegjësi nëpërmjet emërimit të personelit doganor ekzistues nga një kategori më e ulët;
- c) rekrutimit të personelit nga jashtë administratës.

2. Procedurat për emërimin nga jashtë përdoren për emërimin e personelit doganor të të gjitha kategorive. Emërimet për postin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Nëndrejtorëve të Përgjithshëm bëhen në përputhje me nenin 14(2) të Kodit., nëpërmjet një përzgjedhjeje ndërmjet kandidaturave të paraqitura nga brenda administratës doganore ose nga institucione të tjera të shërbimit publik. Emërimi në vendet e lira të punës në kategoritë C1

dhe C2, si dhe në disa vende në kategorinë B, bëhet nëpërmjet rekrutimit nga jashtë, në përputhje me procedurat e përcaktuara në paragrafin 10. Në qoftë se për këto vende konkurojnë edhe zyrtarë të brendshëm, ata do t'u nënshtrohen të njëjtave procedura përzgjedhjeje si edhe kandidatët e jashtëm. Emërimin në vendet e lira të punës për kategoritë D1 dhe D2 bëhet me emërim në përputhje me dispozitat e kësaj pike.

3. Përzgjedhja e kandidatëve duhet të bazohet gjithmonë në vlerësimin e përshtatshmërisë së tyre në raport me kërkesat e dhëna në përshkrimin vendit të lirë të punës, të cilat janë specifikuar edhe në Aneksin 1 të këtyre Dispozitave Zbatuese. Pavarësisht nga lloji i vendit të punës, kategoria e kërkuar si dhe procedura e përzgjedhjes, asnjë kandidat për një post nuk emërohet pa u intervistuar. Me përjashtim të rasteve tepër të veçanta, të parashikuara në këto dispozita zbatuese, kandidatët për transferime ose ngritje në përgjegjësi nëpërmjet procedurave që ndiqen vetëm për kandidatët e brendshëm, duhet të kenë shërbyer në vendin ekzistues të punës për të paktën një vit para se të kenë të drejtë të kërkojnë transferim ose ngritje në përgjegjësi.

4. Kërkesë për vendin e Drejtorit të Përgjithshëm mund të bëjnë vetëm: Nëndrejtorët e Përgjithshëm dhe të gjithë zyrtarët e shërbimit publik të kategorive të barazvlefshme me atë të Drejtorit e Përgjithshëm ose Nëndrejtorit të Përgjithshëm. Drejtoria e Administrimit dhe Trajnimit të Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave bën njoftimin e vendeve të lira të punës në përputhje me procedurat e përcaktuara në paragrafin 10. Të gjithë personat e interesuar duhet të bëjnë një kërkesë e cila duhet të mbështetet nga një vlerësim i aftësisë së tyre kundrejt kërkesave të postit, të bërë nga eprori i tyre, bazuar në punën e kryer në postin ekzistues. Ministri i Financave, ndërmjet kandidaturave të paraqitura, duke pasur parasysh aftësitë e treguara nga kandidatët dhe kërkesat e vendit të punës, zgjedh njerin prej tyre, si më të përshtatshëm, për t'ja propozuar Këshillit të Ministrave.

5. Kërkesë për vendin e Nëndrejtorit të Përgjithshëm mund të bëjnë: zyrtarët e kategorisë A të administratës doganore si dhe të gjithë zyrtarët e shërbimit publik të kategorive të barazvlefshme me kategorinë e Nëndrejtorit të Përgjithshëm ose me kategorinë A të administratës doganore. Drejtoria e Administrimit dhe Trajnimit të Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave bën njoftimin e vendeve të lira të punës në përputhje me procedurat e përcaktuara në paragrafin 10. Të gjithë personat e interesuar duhet të bëjnë një kërkesë e cila duhet të mbështetet nga një vlerësim i aftësisë së tyre kundrejt kërkesave të postit, të bërë nga eprori i tyre, bazuar në punën e kryer në postin ekzistues. Drejtori i Përgjithshëm, ndërmjet kandidaturave të paraqitura, duke pasur parasysh aftësitë e treguara nga kandidatët kundrejt kërkesave të vendit të punës, zgjedh njerin prej tyre, si më të përshtatshëm, për t'ja propozuar Ministrit të Financave.

6. Kërkesat për emërimë në kategorinë A janë të hapura vetëm për zyrtarët e kategorisë B që aktualisht punojnë në administratën doganore dhe në raste të veçanta që gjykohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, janë të hapura dhe për zyrtarë të shërbimit publik të kategorive të barazvlefshme me kategorinë B të Administratës Doganore. Vendet e lira duhet t'u njoftohen të gjithë kandidatëve që plotësojnë kriteret, kërkesa e të cilëve duhet të mbështetet nga një vlerësim i aftësisë së tyre kundrejt kërkesave të vendit të punës, të bërë nga eprori i tyre, bazuar në punën e kryer në postin egzistues. Për shqyrtimin e kërkesave, formohet një Komision Përzgjedhjeje i përbërë nga Drejtori i Përgjithshëm, si kryetar, dy prej Nëndrejtorëve të Përgjithshëm dhe dy personalitete akademike të fushave të ekonomisë dhe jurisprudencës, të cilët emërohen në përputhje me procedurat e parashikuara në paragrafin 10(e). Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve do të kryhet në përputhje me paragrafin 8. Emërohet në vendin përkatës kandidati që, sipas kësaj procedure, arrin të marrë numrin më të madh të pikëve në intervistë.

7. Në rastet kur ka vende të lira në kategorinë B, Drejtori i Përgjithshëm përcakton nëse përzgjedhja do të jetë e hapur edhe për kandidatë të jashtëm. Vendimi përkatës duhet të bazohet jo vetëm në vlerësimin e aftësive të veçanta që kërkojnë për vendin e lirë, si edhe në konsiderata strategjike lidhur me nevojat e së ardhmes për zyrtarë të lartë, duke marrë në konsideratë mundësitë për t'i zënë vendet e lira, që mund të krijohen sipas rastit, me kandidatë të përshtatshëm të përzgjedhur nga personeli egzistues. Kur merret një vendim për t'i rezervuar emërimet vetëm për personelin e brendshëm, formohet një Komision Përzgjedhjeje nga një Nëndrejtor i Përgjithshëm, si kryetar, dy zyrtarë të kategorisë A dhe dy personalitete akademike të fushave të ekonomisë dhe jurisprudencës, të cilët emërohen në përputhje me procedurën e përcaktuar në paragrafin 10(e). Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve kryhet në përputhje me paragrafin 8.

8. Në rrethanat e përshkruara në paragrafët 6 dhe 7, dhe kur përzgjedhja nuk përfshin një provim me shkrim, do të zbatohet procedura e mëposhtme:

- a) lajmërimi për vendet e lira duhet të tregojë kriterin e përzgjedhjes, bazuar në atë të treguar në Aneksin I dhe të përshkruar në përkatës të vendit të punës; dokumentet që duhet të paraqiten, vendin dhe afatin e paraqitjes së tyre;
- b) formulari i kërkesës, që do të plotësohet nga kandidati, duhet të përmbajë edhe një vlerësim të një eprori të tij, i kategorisë jo më të ulët se A ose të barazvlefshme me këtë, lidhur me kryerjen e detyrës në postin egzistues dhe aftësitë e tij në raport me kërkesat e vendit të ri të punës. Kandidati ka të drejtë të lexojë komentet e bëra për të;
- c) pas përfundimit të afatit për paraqitjen e kërkesës, Komisioni i Përzgjedhjes bën një

përzgjedhje paraprake duke identifikuar kandidatët që dukshëm nuk i plotësojnë kriteret përkatës arsimore dhe profesionale. Kërkesa e këtyre kandidatëve refuzohet;

- d) pas kësaj, Komisioni i Përzgjedhjes shqyrton me kujdes kandidaturat e mbetura duke vlerësuar me një notë, që shkon deri në 100, aftësitë e treguara nga kandidati në kërkesë dhe që lidhen me kërkesat e vendit të punës;
- e) Komisioni i Përzgjedhjes zgjedh të gjithë kandidatët që janë vlerësuar të përshtatshëm për intervistë;
- f) kandidatët e përzgjedhur do të intervistohen nga Komisioni i Përzgjedhjes për të vlerësuar aftësitë e tyre në raport me kërkesat e vendit të punës. Të gjithë kandidatëve duhet t'u jepen mundësi të barabarta për të treguar aftësitë e tyre para Komisionit të Përzgjedhjes, i cili duhet t'i vlerësojë me notë, që shkon deri në 100. Paraqitja jo e mirë në intervistë bën që kandidati të mos përzgjidhet pavarësisht nga nota që ka marrë në vlerësimin e dokumenteve;
- g) nota përfundimtare për çdo kandidat, i cili kalon me sukses procesin e intervistimit, do të jetë shuma e dy notave të marra;
- h) Komisioni i Përzgjedhjes duhet t'u bëjë të njohur kandidatëve rezultatet e arritura, duke treguar edhe bazën e një vlerësimi të tillë;
- i) kandidatët për vendet e lira në kategoritë A dhe B, kanë të drejtë të ankohen me shkrim kundër vendimit të Komisionit të Përzgjedhjes tek Drejtori i Përgjithshëm brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e njoftimit duke treguar edhe arsyet e paraqitjes së ankimit. Drejtori i Përgjithshëm merr një vendim brenda 15 ditësh nga marrja e ankimit, i cili është i formës së prerë.

9. Kur në përputhje me pikën 11.7 të këtyre dispozitave, Drejtori i Përgjithshëm vendos të pranojë, për poste të kategorisë B, edhe kandidatura nga jashtë, formohet një Komision Provimi sipas mënyrës së treguar në pikën 11.10(e) të këtyre dispozitave. Përzgjedhja bëhet mbi bazën e një provimi me shkrim dhe të një interviste. Procedurat për njoftimin e vendeve të lira të punës dhe të përzgjedhjes së kandidatëve përshkruhen në pikën 11.10. të këtyre dispozitave.

10. Procedurat për zgjedhjen e kandidatëve nga jashtë për kategoritë B dhe C1 e C2 do të jenë si më poshtë:

- a) njoftimi për punësim duhet të publikohet në të gjitha gazetatat e përditshme kryesore shqiptare të paktën 20 ditë pune para afatit përfundimtar të dorzimit të kërkesave. Njoftimi duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- i) numrin e vendeve të lira të punës për çdo kategori;
 - ii) cila do të jetë procedura e përzgjedhjes;
 - iii) data, koha dhe vendi ku do të kryhet provimi me shkrim;
 - iv) lënda për provimin me shkrim;
 - v) cilësitë e kërkuara për të hyrë në konkurim;
 - vi) kufizimet në moshë;
 - vii) ndonjë kërkesë specifike që lidhet me ndonjë post të veçantë;
 - viii) listën e dokumenteve që duhet të paraqiten;
 - ix) afati i dorëzimit të kërkesave.
- b) që kandidatët të kenë mundësinë të kualifikohen për konkurim ata duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat paraprake dhe kufizimet kohore të publikuara në gazetë;
- c) formulari i kërkesë dhe dokumentet e kërkuara të cilave u referohet shkronja a(viii) e kësaj pike duhet të dërgohen ose të depozitohen pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Trainimit të Personelit. Në qoftë se ato depozitohen, zyra e lartpërmendur duhet të lëshojë një faturë për marrjen në dorëzim.
- d) provimi me shkrim zhvillohet një muaj pas afatit përfundimtar të dorëzimit të kërkesave.
- e) përzgjedhja e kandidatëve organizohet dhe mbikëqyret nga një Komisioni Provimi i përbërë nga një kryetar dhe katër antarë të emëruar nga Ministri i Financave. Dy antarë të Komisionit të propozuar nga Drejtori i Përgjithshëm duhet të jenë zyrtarë të kategorisë A në administratën doganore. Të tjerët, përfshirë edhe kryetarin zgjidhen nga Ministri i Financave ndërmjet personaliteteve akademike të fushave të ekonomisë dhe jurisprudencës. Të tre antarët akademikë të komisionit kanë të drejtë të marrin një shpërblim ditor për çdo ditë punë të komisionit. Masa e shpërblimit caktohet nga Ministri i Financave, dhe paguhet nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
- f) procedura e përzgjedhjes konsiston në një provim me shkrim dhe një intervistë. Vlerësimi për secilën fazë bëhet mbi bazën e një sistemi prej 100 pikësh. Vetëm kandidatët që arrinë të marrin më shumë se 50 përqind të pikëve në provimin me shkrim do të thirren për intervistë. Fazën e intervistës e kalojnë vetëm ata kandidatë që marrin jo më pak se 70 përqind të pikëve të caktuara për këtë fazë. Në intervistë vlerësimi i kandidatëve do të bëhet duke

marrë parasysh përvojën e tyre jetësore dhe profesionale si dhe aftësinë e tyre për të demonstruar para Komisionit të Provimit që cilësitë e tyre janë në përputhje me kërkesat e vendit përkatës të punës.

- g) Komisioni i Provimit duhet të hartojë dhe publikojë listën e të gjithë kandidatëve që kanë kaluar si provimin me shkrim ashtu edhe intervistën, të renditur sipas vlerësimit total të arritur. Emërimet do të bëhen duke filluar nga kandidatët që kanë arritur rezultatin më të lartë dhe që janë më të përshtatshëm, deri sa të plotësohen të gjitha vendet e lira. Në rastet e kategorive C1 dhe C2, Drejtori i Përgjithshëm, kur një gjë e tillë nevojitet, mund të vendosë të zerë ndonjë vend të lirë me një kandidat që ka numrin më të lartë të pikëve nga kandidatët e tjerë që vijnë nga e njëjta zonë banimi. Lista e kandidatëve të pranueshëm mbetet e hapur për një vit dhe do të përdoret për të plotësuar çdo vend të lirë që mund të krijohet, duke ndjekur parimet e vendosura në këtë shkronjë.
- h) kandidatët që nuk zgjidhen kanë të drejtë të ankohen kundër Komisionit të Provimit pranë Departamentit të Administratës Publike brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e shpalljes së listës. Ankesa duhet të bëhet me shkrim duke shpjeguar edhe arsyet për të cilat ajo bëhet.
- i) të gjithë kandidatët që emërohen në përputhje me procedurat e përshkruara në këtë paragraf i nënshtrohen një periudhe prove gjashtë mujore, në rastet e kategorisë B dhe tre mujore në rastet e kategorisë C1 dhe C2, periudhë e cila fillon nga data e emërimit të tyre.

11. Personeli i kategorisë D punësohet nga Drejtori i Përgjithshëm me emërim, në përputhje me nenin 14(3) të Kodit. Ata rekrutohen me anë të përzgjedhjes, nga një komision i përbërë nga Drejtori i Drejtorisë së Administrimit dhe Trajnimit të Personelit dhe dy zyrtarë të kategorisë B, duke ndjekur procedurat e përshkruara në paragrafin 10, por pa ju nënshtruar një provimi me shkrim. Ata i nënshtrohen një periudhe prove tre mujore duke filluar nga data e emërimit të tyre.

12. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave mund që herë pas here, në përputhje me nevojat, të transferojë personelin ndërmjet dy posteve të së njëjtës kategori. Në këto raste, Drejtori i Përgjithshëm duhet të marrë në konsideratë aftësitë e treguara dhe eksperiencën e kandidatit të mundshëm në raport me kërkesat e vendit të lirë të punës. Duhet të kihet gjithashtu parasysh edhe preferencat personale të kandidatit të mundshëm, i cili në rrethana normale, duhet të ketë të paktën një vit në postin aktual para se të transferohet.

Neni 12

1. Të gjithë punonjësit e administratës doganore i nënshtrohen një vlerësimi vjetor, në përputhje me

mjaftueshme për të mbuluar, kur një gjë e tillë mund të përlogaritet, diferencën mes shumës së nxjerrë në bazë të të dhënave të deklaratës doganore dhe shumës maksimale që duhet paguar për mallrat, sipas rezultateve të analizave kimike. Sasia e mallit e marrë si mostër nuk zbritet nga sasia e deklaruar.

7. Deklaruesi ose përfaqesuesi i tij duhet të japë, me shpenzimet e tij, të gjithë ndihmën e nevojshme për të kryer të gjitha kontrollat e sipërpërmendura. Në qoftë se deklaruesi refuzon të jetë i pranishëm gjatë kontrollit fizik ose refuzon të caktojë një person të aftë për t'u ofruar autoriteteve doganore ndihmën e nevojshme, këto të fundit, në zbatim të nenit 100(a) të Kodit, vijnë me verifikimin e mallrave duke kërkuar, kur është e nevojshme, edhe ndihmën e ekspertëve. Rreziqet dhe shpenzimet për kryerjen e verifikimeve janë në ngarkim të deklaruesit. Rezultatet e kontroleve të ushtruara nga autoritetet doganore në bazë të këtij paragrafi, kanë të njëjtën vlefshmëri me kontrollat e ushtruara në praninë e deklaruesit.

8. Nëse nga kontrollat nuk rezultojnë diferenca në lidhje me deklaratën doganore doganieri përgjegjës shënon rezultatet e kontrollit, datën dhe e firmos atë. Me pas deklarata i dërgohet sektorit të kontabilitetit, i cili merr masat e nevojshme për vjeljen e detyrimeve doganore, ose marrjen e garancisë përkatëse. Një kopje e deklaratës doganore përkatëse, e hartuar sipas rregullave, i kthehet deklaruesit për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë dhe nxjerrjen e tyre nga zona doganore.

9. Kur Autoritetet Doganore shesin mallra shqiptare në përputhje me pikën (b) të nenit 100 të Kodit, kjo bëhet në përputhje me procedurat në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

10. Kur gjatë kontroleve gjenden diferenca në lidhje me deklaratën doganore që përbëjnë shkelje administrative doganieri përgjegjës përgatit një procesverbal me shkrim në të cilin shënohen rezultatet e kontrollit, detyrimet më të larta të mundshme dhe ndëshkimet që mund të zbatohen për deklaruesin si edhe shumën e detyrimeve të cilat duhet të rimbursohen ose shlyhen. Raporti me shkrim, i hartuar në dy kopje, prej të cilave një kopje i dërgohet deklaruesit, firmoset nga doganieri që ka kryer kontrollin si edhe nga deklaruesi. Kundër vendimit të marrë nga doganieri përgjegjës për kontrollat e kryera, deklaruesi mund të ankohet në përputhje me nenet 19 dhe 20 të Kodit ose të nenit 289 të Kodit, sipas rastit. Mallrat mbeten nën mbikqyrjen doganore deri sa të kenë përfunduar të gjitha kontrollat. Në qoftë se rasti përbën kontrabandë, procedohet në bazë të dispozitave të Pjesës VIII të Kodit për kontrabandën.

11. Pa rënë ndesh me zbatimin e dispozitave të përmendura në paragrafin 6, kur mallrat nuk mund të çlirohen për njërin nga arsyet e përmendura në nenin 100 (a) të Kodit, autoritetet doganore ftojnë deklaruesin për të rregulluar situatën brënda 10 ditëve. Kur brënda kufirit kohor të sipërpërmendur, deklaruesi nuk e ka rregulluar

situatën, deklarata doganore anulohet siç parashikohet në nenin 91 (3) dhe autoritetet doganore, pa rënë ndesh me zbatimin e neneve 91 (1) dhe 197 të Kodit, fillojnë procedurën për shitjen a mallrave, siç parashikohet nga normat në fuqi në këtë fushë. Autoritetet doganore njoftojnë deklaruesin për fillimin e kësaj procedure. Autoritetet doganore, mund të transferojnë mallrat në fjalë në ambjente të tjera të cilat konsiderohen të përshtatshme për një gjë të tillë nën mbikqyrjen doganore dhe të gjitha rreziqet dhe shpenzimet për kryerjen e transferimit janë në ngarkim të deklaruesit.

12. Për të kontrolluar nëse të gjitha mallrat që dalin nga një zone doganore korrespondojnë me të dhënat në dokumentet doganore shoqëruese, Kryetari i zyrës doganore organizon kontrollat që parashikohen në nenin 11, paragrafi 5 të Kodit.

13. a) Autoritetet doganore që kryejnë formalitetet për çlirimin e mallrave, mund të procedojnë në mënyrë të pavarur, ose me kërkesë të deklaruesit, për të bërë rivlerësimin e deklaratës doganore edhe pse mallrat janë çliruar, ose kanë dalë nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë në përputhje me nenin 102 të Kodit. Kërkesa nga ana e deklaruesit duhet të paraqitet brënda afatit 3-vjeçar pasi mallrat janë çliruar, dhe në rast se brënda 30 diteve nga dita e paraqitjes së kërkesës deklaruesi nuk informohet për ndonjë ratifikim, kërkesa konsiderohet e refuzuar. Kundër refuzimit të hapur ose të tërthortë të kërkesës, deklaruesi mund të ankohet, brënda 10 ditëve, tek Drejtori Rajonal përkatës i cili do të marrë një vendim për këtë çështje brënda 20 diteve. Për të rivlerësuar deklaratën doganore, autoritetet doganore mund:

i) t'i kërkojnë deklaruesit, nëpërmjet një shkrese me shkrim, të arsyetuar, të paraqesë pranë doganës brënda 15 ditësh, dokumentet dhe/ose të dhënat tregtare për mallrat në fjalë. Të njëjtat informacione dhe dokumente mund t'u kërkojnë nga zyra doganore edhe personave të tjerë të cilët rezultojnë se janë përfshirë në mënyrë direkte ose të tërthortë në aktivitetin tregtar;

ii) të kryejnë inspektime, me një autorizim përkatës lëshuar nga Kryetari i zyrës doganore, pranë ambjenteve të deklaruesit ose çdo personi tjetër të përfshirë në mënyrë direkte ose të tërthortë në një operacion të tillë, ose të çdo personi tjetër që për arsye të karakterit tregtar ka në zotërim libra kontabiliteti dhe dokumentacion tregtar e doganor për mallrat që janë objekt i deklaratës doganore që po rivlerësohet. Autoritetet doganore gjithashtu mund të procedojnë edhe me kontrollimin e mallrave kur ato janë ende në gjendje të paraqiten.

- b) Kur kontrollet *a-posteriori* të përmendura në shkronjen i) dhe ii) të këtij paragrafi të mësipërm dëshmojnë se dispozitat që rregullojnë regjimin doganor në fjalë janë zbatuar mbi bazën e informacioneve të paplota ose të pasakta, Autoritetet Doganore duhet të procedojnë me rivlerësimin e deklaratës doganore. Këto korrigjime duhet t'i njoftohen deklaruesit brënda periudhës 3-vjeçare nga data kur mallrat janë vendosur për qarkullim të lirë, duke specifikuar arsyet e korrigjimeve, elementët e deklaratës doganore që janë korrigjuar, si edhe shumën e detyrimeve kryesore të importit që deklaruesi duhet të paguajë ose shumën e detyrimeve të importit që duhen rimbursuar ose falur.
- c) Deklaruesi mund të apelojë me shkrim kundër korrigjimit të deklaratës doganore në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet 19 dhe 20 të Kodit ose nenin 289 të Kodit, sipas rastit. Në qoftë se korrigjimi pranohet, zyra doganore e interesuar fillon menjëherë procedurat për vjeljen e borxhit doganor, për rimbursimin ose faljen e ndonjë detyrimi të importit të paguar në tepicë, në bazë të dispozitave të përmendura në Pjesën VII, Kreu 3 dhe 5 për zbatimin e sanksioneve të parashikuara në Pjesën VIII të Kodit.
- d) Në bazë të normave të përcaktuara në këtë nen zyrat doganore mund të procedojnë edhe me verifikimet kontabël të përgjithshme për të rivlerësuar një ose më shumë deklarata doganore, si edhe për të hetuar ndonjë shkelje të Kodit ose ligjeve të tjera zbatimi i të cilave i është ngarkuar Administratës Doganore. Verifikimet kontabel me kërkesë të Administratave Doganore të huaja në zbatim të Marrëveshjeve dypaleshe për Asistencë Administrative të firmosura me autoritete kompetente të vendeve të tjera.

KREU 6

Shkeljet dhe masat disiplinore

Neni 16

Në përputhje me nenin 16, paragrafi 5 të Kodit, ky Kre përcakton procedurat që duhen ndjekur për zbatimin e masave disiplinore për personelin doganor. Masat disiplinore të përcaktuara në Ligjin Nr. 8095, date 21.03.1996 për Sherbimin Civil do të zbatohet "*mutatis mutandis*" për personelin doganor të të gjithë kategorite me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 17(2).

Neni 17

1. Drejtori i Përgjithshëm krijon një Komitet Disiplinor që përbëhet nga 3 anëtarë, nga Kryetari i Departamentit Administrativ me funksionin e Presidentit, dhe nga 2 zyrtarë të kategorisë A. Këta të fundit duhet të zëvendësohen çdo 2 vjet me zyrtarë të tjerë të së njëjtës kategori.

2. Komiteti Disiplinor merret me gjithë personelin

doganor, me përjashtim të rasteve kur masat disiplinore zbatohen për Drejtorin e Përgjithshëm ose për një nga Nëndrejtorët e Përgjithshëm. Për keta të fundit keto masa merren nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Financave.

Neni 18

1. Pa rënë ndesh me zbatimin e dispozitave të parashikuara nga Kodi Penal, kushdo që konstaton se një punonjës dogane kryen njërën nga shkeljet disiplinore të përmendura në këtë paragraf mund të informojë menjëherë, me një raport me shkrim, kryetarin e zyrës doganore pranë së cilës punon punonjësi i sipërpërmendur.

- a) shkelje të Kodit Doganor dhe të këtyre Dispozitave, e në veçanti të dispozitave të parashikuara në paragrafi 2, 3, dhe 4, neni 16 të Kodit;
- b) mos kryerja e detyrës, pa ndonjë arsye të pranueshme, ose kryerja e saj me neglizhencë;
- c) shkatërrimi, pa ndonjë arsye të pranueshme, i pronës shtetërore ose krijimi i kushteve për shkatërrime të tilla;
- d) veprime, pa ndonjë arsye të pranueshme, në kundërshtim me etikën e shërbimit civil, ose çdo lloj veprimi kundër punonjesve civile ose shërbimeve dhe institucioneve shtetërore pavarësisht nga fakti nëse është kryer brënda ose jashtë orarit zyrtar;

2. Drejtuesi i zyrës përkatëse doganore i dërgon Komitetit Disiplinor, brënda 10 diteve, raportet e përmendura në paragrafin 2, së bashku me raportin e vlerësimit dhe Komiteti duhet të vlerësojë rastin brenda 30 diteve nga dita e marrjes së raportit. Komiteti i sipërpërmendur, me qëllim që të vlerësojë rastin, mund t'i kërkojë zyrës doganore përkatëse të japë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Pas shqyrtimit të rastit, Komiteti Disiplinor duhet të thërrasë punonjësin në fjalë për të dëgjuar versionin e këtij të fundit për faktet që kanë ngjarë. Nëpunësi i interesuar ka të drejtë të ketë një ndihmë ligjore, e cila mbulohet me shpenzimet e tij, gjatë kohës që dëgjohet nga Komiteti. Komiteti Disiplinor, mbi bazën e të gjitha fakteve të shqyrtuara dhe të informacionit të mbledhur, i propozon Drejtorit të Përgjithshëm arkivimin e rastit, ose mbi bazën e shkallës së shkeljes, zbatimin e njërës prej masave disiplinore të mëposhtme:

- a) paralajmërim me shkrim;
- b) gjobë jo më të madhe se paga e 10 diteve pune të punonjësit;
- c) pezullim nga puna, për një periudhë jo më shumë se 10 ditë dhe mos pagimin e pages për një periudhë kohore të barabartë me dyfishin e ditëve që ai është pezulluar nga puna;
- d) ulje të nivelit të pages, deri në tre shkallë më poshtë por jo më shumë se një vit;
- e) largim nga puna dhe heqje e të drejtës për të

punuar në sherbimin civil. Kjo mase shoqërohet me heqje të statusit të punonjësit civil dhe çdo të drejtë që garanton ky status.

Për të njëjtën shkelje disiplinore mund të zbatohet vetëm njëra nga masat disiplinore të sipërpërmendura.

3. Në qoftë se masat disiplinore e përmendura në shkronjën a) deri b), paragrafi 2 të këtij neni përsëriten disa herë Komiteti Disiplinor mund t'i propozojë Drejtorit të Përgjithshëm pushimin nga puna të punonjësit.

4. Drejtori i Përgjithshëm mund të pranojë ose jo propozimin e Komitetit Disiplinor. Në qoftë se Drejtori i Përgjithshëm vendos të mos pranojë këtë propozim, ai duhet të motivojë vendimin e tij me një raport me shkrim dhe t'ia dergojë Komitetit Disiplinor që më pas informon nëpunësin e interesuar. Në qoftë se Drejtori i gjykon të drejta masat disiplinore të propozuara nga Komiteti Disiplinor, ai merr një vendim që i dërgohet Drejtorisë së Personelit dhe Trajnimit për zbatimin e tij.

5. Masat disiplinore të marra regjistrohen në dosjen personale të nëpunësit.

Neni 19

Punonjësi i interesuar mund të paraqesë pranë Departamentit të Administratës Publike një ankesë kundër vendimit të marrë nga Drejtori i Përgjithshëm brenda 10 ditësh nga dita e njoftimit

të vendimit. Departamenti i Administratës Publike duhet të marrë një vendim brenda 30 ditësh nga dita e paraqitjes së ankesës. Nëpunësi mund të paraqesë një ankesë kundër vendimit të Departamentit të Administratës Publike tek autoritetet gjyqësore, në përputhje me procedurat në fuqi në këtë fushë.

KREU 7

Bashkëpunimi me policinë

Neni 20

1. Në brendësi të zonave doganore dhe zonave të mbikqyrjes doganore, Autoritetet Doganore janë i vetmi autoritet përgjegjës për zbatimin e normave të përcaktuara nga legjislacioni doganor.

2. Drejtoria e Antikontrabandës e Departamentit Operativ dhe Hetimor është përgjegjëse për bashkërendimin e veprimtarisë doganore me policinë, në veçanti me policinë kufitare dhe me agjensitë e tjera të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm brenda dhe jashtë zonave doganore të përmendura në paragrafin 1.

Neni 21

Në zbatim të nenit 11, paragrafi 8 dhe 9 të Kodit, me kërkesën e shprehur qartë nga njëra ose të dy palët, autoritetet doganore dhe ato policore duhet të ofrojnë ndihmë dypalëshe në kryerjen e kontrolleve nën kompetencën e tyre.

TITULLI III

VENDIMET DHE INFORMACIONI TARIFOR I DETYRUESHËM

KREU 1

Vendimet

Neni 22

Kur një person që bën një kërkesë për marrjen e një vendimi nuk ka mundësi të paraqesë të gjitha dokumentet dhe informacionin e nevojshëm për të marrë vendimin, autoritetet doganore duhet të japin të gjitha dokumentet dhe informacionin që këta të fundit kanë në dispozicion.

Neni 23

Një vendim që ka të bëjë me garancinë, dhe që është në favor të një personi që ka marrë përsipër të paguajë shumat që duhen paguar me kërkesën e parë me shkrim të autoriteteve doganore, do të revokohet kur personin nuk ka përmbushur detyrimin që ka marrë përsipër.

Neni 24

Një revokim nuk do të zbatohet për mallrat të cilat në çastin e hyrjes në fuqi të revokimit, ishin vendosur tashmë nën një regjim tjetër mbi bazën e autorizimit të revokuar.

Megjithatë, autoritetet doganore mund të kërkojnë që këtyre mallrave t'u jepet një nga destinacionet doganore të lejuara brenda një afati të caktuar prej tyre.

KREU 2

Procedurat për marrjen e informacionit tarifor të detyrueshëm. Njoftimi i informacionit për kërkuesit.

Për qëllim të nenit 25 deri 29²:

- "Informacioni tarifor i detyrueshëm" do të thotë: informacioni tarifor që është i detyrueshëm për administratën doganore kur plotësohen kushtet e përcaktuara në nenet 25 dhe 26;
- "Kërkues" do të thotë: një person i cili u ka kërkuar autoriteteve doganore informacion tarifor të detyrueshëm;
- "Mbajtës" do të thotë: një person në emër të të cilit lëshohet një informacion tarifor i detyrueshëm.

Neni 25

1. Kërkesat për informacionin tarifor të detyrueshëm bëhen me shkrim, në adresë të autoriteteve kompetente doganore të cilat duhet të lëshojnë informacionin, ose të autoriteteve kompetente doganore të territorit ku është vendosur kërkuesi. Organet doganore kompetente i kalojnë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

² Shiko nenin 2(1). Ky tekst është rishikuar këtu për lehtësi përdorimi të termave të përkufizuar.

kërkesën për informacionin tarifor të detyrueshëm brenda dy diteve nga data e pranimit.

2. Kërkesa për informacionin tarifor të detyrueshëm lidhet vetëm me një lloj malli.

3. Kërkesa duhet të përfshijë të dhënat e mëposhtëme:

- a) emrin e mbajtësit dhe adresën;
- b) emrin dhe adresën e kërkuarit, kur ky i fundit nuk është mbajtësi;
- c) nomenklaturën e harmonizuar në të cilën duhet të klasifikohet malli. Kur një kërkuar kërkon të marrë klasifikimin e mallrave në njërën nga nomenklaturat e referuara në nenin 28(3)(b) dhe (6)(b) të Kodit, kërkesa për informacion tarifor të detyrueshëm duhet të përmendë shprehimisht nomenklaturën në fjalë;
- d) një përshkrim të hollësishëm të mallrave që lejon identifikimin e tyre dhe përcaktimin e klasifikimit të tyre në nomenklaturën doganore;
- e) përbërjen e mallrave dhe çdo mënyrë ekzaminimi të përdorur për të përcaktuar këtë përbërje kur klasifikimi i mallrave varet nga përbërja;
- f) mostra, fotografi, vizatime, kataloge ose dokumenta të tjera të disponueshme të cilat mund të ndihmojnë autoritetet doganore për të bërë klasifikimin e saktë të mallrave në nomenklaturën doganore, që bashkëngjiten si anekse;
- g) klasifikimin e parashikuar;
- h) marrëveshjen për të dhënë edhe një përkthim të dokumentave përkatëse në gjuhën shqipe, nëse kjo do të shihet e nevojshme nga autoritetet doganore shqiptare;
- i) hollësitat që konsiderohen konfidenciale;
- j) shënime të ofruara nga kërkuari, që tregojnë qofte edhe mbi bazën e njohurive të tij se informacioni tarifor i detyrueshëm është zbatuar apo lëshuar faktikisht në Shqipëri për mallra identike ose të ngjashme;
- k) pranimin prej kërkuarit që informacioni i dhënë prej tij mund të depozitohet në një Bazë të Dhënash të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave; megjithatë, përveç nenit 25 të Kodit, zbatohen edhe dispozitat në fuqi lidhur me mbrojtjen e informacionit.

4. Kur autoritetet doganore konsiderojnë që kërkesa nuk përmban të gjitha të dhënat që ato kërkojnë për të dhënë një mendim të argumentuar, kërkuarit i kërkohet të plotësojë informacionin që mungon.

5. Informacioni tarifor i detyrueshëm lëshohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Neni 26

1. Informacioni tarifor i detyrueshëm i njoftohet kërkuarit me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur. Nëse nuk ka qenë e mundur që t'i njoftohet kërkuarit informacioni tarifor i detyrueshëm brenda dy muajsh nga pranimi i kërkesës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave do të kontaktojë kërkuarin për t'i shpjeguar arsyen e vonës dhe t'i tregojë kur pritët të jetë në gjendje t'i njoftojë informacionin.

2. Informacioni tarifor i detyrueshëm i njoftohet kërkuarit nëpërmjet formularit që konfirmohet në shembullin e treguar në Aneksin 2. Njoftimi duhet të tregojë ato të dhëna të cilat konsiderohen se janë dhënë në mënyrë konfidenciale. Po kështu, duhet të tregohet edhe mundësia e apelimit sipas nenit 19 dhe 20 të Kodit.

KREU 3

Dispozita që zbatohen në rastet e mospërputhjeve në informacionin tarifor të detyrueshëm.

Neni 27

Në rastet kur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave konstaton se ekzistojnë informacione tarifore të detyrueshme të ndryshme për mallra me natyrë të njëjtë, nëse është e nevojshme do të marrë masa për zbatimin e njëjtë të nomenklaturës doganore.

KREU 4

Vlefshmëria ligjore e informacionit tarifor të detyrueshëm.

Neni 28

1. Pa rënë ndesh me nenet 17 dhe 89 të Kodit, informacioni tarifor i detyrueshëm mund të kërkojë vetëm nga mbajtësi.

2. Autoritetet doganore mund t'i kërkojnë mbajtësit, gjatë kryerjes së formaliteteve, të informojë autoritetet doganore nëse ai është mbajtës i një informacioni tarifor të detyrueshëm edhe për mallrat që po cirohen në dogane.

3. Mbajtësi i informacionit tarifor të detyrueshëm mund t'a përdorë atë informacion edhe në lidhje me mallra të tjera, me kusht që autoritetet doganore përkatëse të binden plotësisht se mallrat në fjalë përputhen në gjithë drejtimit me ato të përshkruara në informacionin e paraqitur.

Neni 29

1. Pasi ndermerret ndonjë nga masat ose veprimet të cilave u referohet neni 22(5) i Kodit, autoritetet doganore marrin të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar që informacioni tarifor i detyrueshëm të lëshohet vetëm në përputhje me veprimet ose masat në fjalë.

2. Për qëllim të paragrafit më sipër, data llogaritet sipas kritereve që vijojnë:

- ditën që bëhen të zbatueshme rregulloret e

parashikuara në nenin 22(5)(a) të Kodit lidhur me ndryshimet në nomenklaturën doganore të mallrave;

- ditën që hyjnë në fuqi rregulloret e parashikuara në pikën (a) të të njëjtit nen dhe paragraf, të cilat përcaktojnë ose influencojnë

mbi klasifikimin e mallrave në nomenklaturën e harmonizuar;

- ditën që hyjnë në fuqi masat e parashikuara në pikën (b) të të njëjtit nen dhe paragraf, lidhur me ndryshime në notat shpjeguese të Nomenklaturës së Sistemit të Harmonizuar.

TITULLI IV

E DREJTA E PËRFAQËSIMIT

Neni 30

1. Në zbatim të nenit 17 të Kodit, të gjitha përfaqësimet e tërthorta duhet të bëhen vetëm nga agjentë doganore të autorizuar.

2. Agjentë doganorë konsiderohen personat fizike, të licencuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për të kryer formalitetet doganore.

3. Agjentët doganore të licencuar mund të organizohen në agjensi doganore si person juridik, aktiviteti kryesor i të cilëve ka të bëjë me kryerjen e të gjithë formaliteteve doganore për çdo lloj regjimi doganor në emër të tij por për llogari të një personi tjetër.

4. Duke filluar nga dita në të cilën hyn në fuqi Kodi, agjentëve doganore të regjistruar në regjistrat përkatës të mbajtur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund t'u jepet e drejta e kryerjes së përfaqësimit të tërthortë.

5. Licenca për të vepruar si agjent doganor mund t'i leshohet një personi fizik që plotëson kërkesat e mëposhtme:

- a) ka shtetësi shqiptare;
- b) ka diplomë universitare;
- c) gjykohet i besueshëm nga administrata doganore;
- d) kalon provimin e parashikuar në nenin 3 më poshtë;
- e) depoziton një garanci në shumën 5 milion Lek, pranë administratës doganore në përputhje me nenet 204 deri 215 të Kodit.

6. Licenca për të vepruar si agjent doganor mund ti leshohet gjithashtu edhe një personi fizik që punon për një person juridik.

- a) Personi fizik në këto raste duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:
 - i) ka shtetësi shqiptare;
 - ii) ka diplomë universitare;
 - iii) gjykohet i besueshëm nga administrata doganore;
 - iv) kalon provimin e parashikuar në nenin 3 më poshtë;

b) Personi juridik në këto raste duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

- i) gjykohet i besueshëm nga administrata doganore;
- ii) paraqet një kopje të vendimit të gjykatës për regjistrimin e tij si person juridik;
- iii) paraqet një kopje të licences për ushtrimin e profesionit lëshuar nga organet tatimore;
- iv) depoziton një garanci në shumën 10 milion Lek në përputhje me nenet 204 deri 215 të Kodit.

7. Personat që kanë kryer shkelje të qëllimshme ose të përsëritura të legjislacionit doganor ose atij fiskal, si edhe që janë përfshirë në ndonjë aktivitet të paligjshëm, ose që janë dënuar për vepra penale, nuk kanë të drejtë të marrin licencë për të vepruar si agjent doganor. Po kështu nuk kanë të drejtë të rimarrin licensë ata persona të cilëve u është revokuar nga autoritetet doganore licenca e lëshuar për agjensitë doganore në bazë të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 7599, datë 02.09.1992 "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë".

Neni 31

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave lëshon licenca pa afat për të vepruar si agjent doganor kur plotësohen të gjitha kushtet.

Neni 32

1. Kërkesa për të marrë licencën e agjentit doganor paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Kërkesa duhet bërë me shkrim dhe shoqërohet me dokumentet e kërkuara në përputhje me nenin 1, paragrafi 5 dhe 6. Dokumentet duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave jo më vonë se 15 ditë para dates së provimit.

2. Provimet për marrjen e licencës së agjentit doganor organizohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dy herë në vit, në muajt qershor dhe dhjetor, dhe konsistojnë në një kontroll me shkrim mbi njohuritë e përgjithshme teorike si dhe zbatimin praktik të legjislacionit doganor.

3. Komisioni që drejton provimin emërohet nga Ministri i Financave dhe kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave dhe ka në përbërjen e tij

Kryetarin e Drejtorisë së Regjimeve dhe Vjeljes së Detyrimeve Doganore ose Kryetarin e një prej Sektoreve në këtë Drejtori dhe dy Kryetarë Zyrash Doganore.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave lëshon licencën për të vepruar si agjent doganor vetëm për kandidatet që kalojnë provimin dhe përmbushin të gjitha kushtet e tjera të përcaktuara. Kjo licensë lëshohet brenda një muaji nga data kur të gjitha keto kushte janë plotësuar. Çdo agjenti doganor i jepet një numër identifikimi individual.

Neni 33

1. Agjentët doganore qofshin persona fizike ose juridik mund të punësojnë personel ndihmës për t'i ndihmuar ata në kryerjen e formaliteteve doganore. Personeli ndihmes duhet të autorizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

- a) ka shtetësi shqiptare;
- b) është mbi moshën 23 vjeç;
- c) gjykohet i besueshëm nga administrata doganore;
- d) kalon provimin e parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni.

2. Menyra e organizimit të provimit që duhet të kalojë personeli ndihmës parashikohet me udhëzime të nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

3. Personeli ndihmes nuk lejohet të nenshkruajë asnjë deklaratë doganore. Deklaratat nënshkruhen vetëm nga një agjent doganor i autorizuar. Të gjitha dokumentet e nënshkruara nga një agjent doganor duhet të vulosen me vulën e tij personale. Kjo vulë duhet të ketë emrin e agjentit, emrin e personit juridik, nëse është rasti, dhe numrin identifikues të tij.

4. Agjentët doganorë, pa rënë ndesh me përgjegjësinë ligjore të vetë personelit, mbajnë përgjegjësi të plotë për veprimet e ndërmarra nga personeli i tyre ndihmës gjatë kryerjes së formaliteteve doganore.

Neni 34

Administrata doganore pajis agjentët doganore dhe personelin e tyre ndihmës me Kartë Identiteti të cilën ata duhet t'a paraqesin pranë autoriteteve doganore kurdo dhe në çdo vend ku ata ushtrojnë aktivitetin e tyre. Forma dhe përmbajtja e Kartes së Identitetit parashikohet me udhëzime të nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Neni 35

Të gjithë agjentët doganorë të licensuar dhe personeli ndihmës i tyre regjistrohen në një regjistër që mbahet në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Neni 36

Për çdo operacion doganor, me kërkesë të

autoriteteve doganore, agjenti doganor paraqet autorizimin që i jep të drejtën të ushtrojnë përfaqësimin e tërthortë për kryerjen e formaliteteve doganore. Ky autorizim duhet të përmbajë të paktën të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin e autorizuesit;
- b) shtrirjen (vëllimin e tagrave të përfaqësimit)
- c) numrin e NIPT-it në rast se autorizuesi është person juridik;
- d) firmën e autorizuesit.

Neni 37

1. Agjentët doganore duhet të mbajnë një regjistër ku regjistrohen të gjitha operacionet e kryera prej tyre. Forma dhe përmbajtja e këtij regjistri përcaktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

2. Në përputhje me kufirin kohor të përcaktuar në nenin 26 të Kodit, agjentët doganorë duhet të ruajnë autorizimet e përfaqësimit, regjistrat dhe dokumentet që dëshmojnë se kanë paguar të gjitha detyrimet.

Neni 38

Agjentëve doganorë qofshin persona fizike ose juridike u kërkohet të paguajnë çdo borxh doganor që lind në përputhje me nenin 216(3) të Kodit.

Neni 39

Të gjithë agjentët doganorë janë të detyruar të njoftojnë brenda 15 ditësh Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për të gjitha ndryshimet e adresave të tyre, të statusit ligjor dhe të atij informacioni që u është dhënë autoriteteve doganore kur kanë paraqitur kërkesën e tyre për t'u bërë agjent doganor.

Neni 40

Agjentët doganore që punojnë për një person juridik janë përgjegjës si persona fizikë për çdo informacion të dhënë në një deklaratë doganore. Gjithashtu janë përgjegjës si persona fizikë, kur veprojnë si përfaqësues të tërthortë dhe kryejnë ndonjë shkelje siç parashikohet në Pjesën VIII të Kodit.

Neni 41

1. Pa rënë ndesh me gjithë formalitetet e parashikuara nga Kodi për vjeljen e borxhit doganor, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, me një vendim të arsyetuar mirë, mund të pezullojë licencën e agjentit doganor në rast mospagimi të detyrimeve që duhen paguar ose mosplotësimi të ndonjë detyrimi tjetër ndaj autoriteteve doganore. Pezullimi zgjat për aq kohë sa detyrimet doganore nuk janë paguar ose për aq kohë sa detyrimet e tjera nuk janë përmbushur.

2. Drejtori i Përgjithshëm, me një vendim të arsyetuar mirë, duhet të shfuqizojë licencën dhe më pas çregjiston nga regjistri agjentët doganore të cilët:

- a) nuk arrijnë të përmbushin ndonjë nga

kushtet e parashikuara në nenin 30(1), paragrafi 5 (a, c deri e) ose paragrafi 6 (a) (i, ii, deri iv) ose paragrafi 6 (b) (i deri iv);

- b) kryejnë në mënyrë të qëllimshme ose të përsëritur një nga shkeljet e parashikuara në Pjesën VIII të Kodit;
- c) janë dënuar për shkelje të tjera fiskale ose penale.

3. Vendimi për shfuqizimin ose pezullimin e licencës duhet t'i njoftohet personit të interesuar brenda 10 ditëve nga dita e marrjes së vendimit. Agjenti doganor mund të apelojë kundër vendimit të marrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave tek Ministri i Financave. Në këto raste zbatohen *mutatis mutandis* (me ndryshimet përkatëse) nenet 19 dhe 20 të Kodit.

4. Paraqitja e apelimit nuk ndërpret efektet ligjore të shfuqizimit ose pezullimit.

Neni 42

1. Për qëllim të zbatimit të këtyre akteve nënligjore, licencat e lëshuara agjensive doganore në bazë të nenit 38 të Ligjit nr.7599, datë 2.09.1992 dhe akteve nënligjore të tij do të jenë të vlefshme për një periudhë kalimtare që do të zgjasë deri më 01.01.2000. Pas kësaj date, të gjithë agjentët doganorë të licencuar në bazë të nenit 38 të Ligjit nr.7599, datë 2.09.1992 duhet të përmbushin të gjitha kushtet e këtij akti nënligjor me përjashtim të nenit 30, paragrafi 5 (b) dhe 6 (a) (ii).

2. Gjatë periudhës kalimtare të gjithë agjentët doganorë që janë licencuar në përputhje me nenin 38 të Ligjit nr.7599, datë 2.09.1992, duhet të veprojnë në përputhje me nenet 33 (4) dhe nenet 36 dhe 38 deri 41.

Neni 43

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave mund të nxjerrë udhëzime në zbatim të neneve për agjentin doganor.

TITULLI V

ORIGJINA E MALLRAVE

KREU I

Origjina jo preferenciale

Për qëllim të nenit 44 deri 53³:

- a) "Fabrikim" do të thotë: të gjitha llojet e punimeve ose përpunimeve, duke përfshirë ketu edhe montimin ose operacione të tjera specifike;
- b) "Material" do të thotë: çdo ingredient, lëndë e parë, përbërës ose pjesë etj., e përdorur në procesin e fabrikimit;
- c) "Produkt" do të thotë: çdo produkt i fabrikuar, edhe në qoftë se do të përdoret më tej në një operacion tjetër fabrikimi;
- d) "Mallra" do të thotë si materiale ashtu edhe produkte;
- e) "Vlerë doganore" do të thotë: vlera siç është përcaktuar në përputhje me Marrëveshjen për zbatimin të nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë e vitit 1994 (Marrëveshja e Organizatës Botërore të Tregtisë - OBT mbi Vlerën Doganore);
- f) "Çmimi ex-works" - në listën e Aneksit 4 do të thotë çmimi që i paguhet fabrikuesit i cili ka ndërmarrë punimin ose transformimin e fundit të produktit. Ky çmim duhet të përmbajë në vetvete vlerën e të gjithë materialeve të përdorura në fabrikim, pasi të jenë zbritur detyrimet e brendshme që faktikisht janë rimbursuar ose që mund të rimbursohen kur

produkti i përfutur eksportohet;

- g) "Vlerë" në listën e Aneksit 4 do të thotë vlera doganore në çastin e importimit të materialeve me origjinë jo shqiptare të përdorura ose, në qoftë se kjo vlerë nuk njihet dhe nuk mund të përcaktohet, çmimi i parë i verifikueshëm i paguar për materialet në fjalë në Republikën e Shqipërisë, në kuadrin e nenit 47(1). Ky parim zbatohet *mutatis mutandis* (me ndryshimet përkatëse), kur është e nevojshme të përcaktohet vlera e materialeve me origjinë shqiptare që janë përdorur në fabrikim;
- h) "Kapitull" dhe "kre" do të thotë: kapitujt dhe krerët (me kode 4 shifrore), të përdorura në një nomenklaturë që bazohet në Sistemin e Harmonizuar;
- i) "Klasifikim" do të thotë: gjetja e kreut përkates ku përfshihet një produkt ose material;
- j) "Dërgesë" do të thotë: produkte të cilat ose janë dërguar në të njëjtën kohë nga një për dërgimin e këtyre produkteve nga eksportuesi tek marrësi, ose në mungesë të një eksportues tek një marrës i vetëm, ose që paraqiten në një dokument të vetëm transporti i hartuar dokumenti të tillë, me një faturë të vetme.

Neni 44

Në zbatim të nenit 29 të Kodit, kur origjina e mallrave në import duhet të provohet nëpërmjet paraqitjes së një çertifikate të origjinës, kjo e fundit duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a) të jetë lëshuar nga një autoritet ose agjensia e autorizuar në mënyrën e duhur për këtë qëllim nga vendi ku lëshohet;
- b) të përmbajë të gjitha të dhënat e nevojshme

³ Shiko nenin 2(2). Ky tekst është rishikuar këtu për lehtësi përdorimi të termave të përkufizuar.

për identifikimin e produkteve të cilave u referohet, e veçanërisht:

- i) numrin e kolive, llojin e tyre, markat (shenjat identifikuese) dhe numrat që ato mbajnë,
- ii) llojin e produktit,
- iii) peshën bruto dhe peshën neto të produktit; megjithatë, këto tregues mund të zëvendësohen me të tjerë si p.sh. numri dhe vëllimi, kur produkti i nënshtrohet ndryshimeve në peshë gjatë transportit ose kur nuk është e mundur të përcaktohet pesha, apo kur normalisht identifikohet me tregues të tjerë,
- iv) emri i dërguesit.
- c) të provojë në mënyrë të qartë që produkteve të cilave u referohet kanë origjinën nga një vend i caktuar;
- d) certifikata dhe kërkesat që lidhen me to, do të bëhet në formularë që janë në përputhje me modelet e dhëna në Aneksin 3.

Neni 45

1. Për mallrat shqiptare, certifikata e origjinës lëshohet nga Dhoma e Tregtisë mbi bazën e një kërkesë me shkrim nga personi i interesuar. Kur e justifikojnë rrethanat, veçanërisht kur i interesuari ka aktivitet të rregullt eksporti, Dhoma e Tregtisë mund të vendosë të mos kërkojë paraqitjen e një kërkesë për çdo operacion eksporti, me kusht që të respektohen dispozitat në fuqi përsa i përket origjinës.

2. Kur e justifikojnë nevojat tregtare, mund të lëshohet një ose disa kopje shtesë të certifikatës së origjinës.

Neni 46

1. Në kuadrin e bashkëpunimit administrativ me vende të tjera, Dhoma e Tregtisë do t'i përgjigjet kërkesave të autoriteteve kompetente doganore të vendit ku janë importuar mallrat për kontrolle *a posteriori*, qoftë edhe nëpërmjet autoriteteve doganore shqiptare.

2. Rezultatet e kontrollit *a posteriori* duhet t'i komunikohen autoriteteve kërkuese sa më shpejt që të jete e mundur. Koha maksimale për përgjigje nuk duhet të kalojë 6 muajt.

KREU 2

Origjina preferenciale

Neni 47

1. Në zbatim të nenit 32 të Kodit, rregullat mbi origjinën preferenciale duhet të përcaktojnë kushtet që produktet duhet të plotësojnë për përfitimin e origjinës dhe për të mundur të përfitojnë nga masat tarifore preferenciale të parashikuara në kuadrin e marrëveshjeve që Republika e Shqipërisë ka nënshkruar me vende të caktuara ose grupe

vendesh, ose në kuadrin e lehtësirave të njohura prej vetë këtyre vendeve ose grupi vendesh në mënyrë të njëanshme. Rregullat përkatëse të origjinës vendosen në kuadrin e marrëveshjeve të veçanta.

2. Megjithatë, mund të konsiderohen se e kanë origjinën nga Shqipëria:

- a) produkte të përfutuara tërësisht në Shqipëri,
- b) produkte të përfutuara në Shqipëri, për fabrikimin e të cilave janë përdorur produkte të ndryshme nga ato të paragrafit (a), me kusht që të tilla produkte të jenë objekt i punimeve ose transformimeve të mjaftueshme në kuptimin e nenit 49 (1).

Neni 48

1. Konsiderohen tërësisht të përfutuara në Republikën e Shqipërisë në kuptimin e nenit 47(2)(a):

- a) produktet minerale të nxjerra nga toka ose shtrati detar i saj;
- b) produktet bimore të mbledhura, të korrura ose të vjelura aty;
- c) kafshët e gjalla të lindura dhe të rritura aty;
- d) produkte të prejardhura nga kafshë të gjalla të atjeshme;
- e) produkte gjahu dhe peshkimi të atjeshëm;
- f) produkte peshkimi detar dhe produkte të tjera të nxjerra nga deti me anijet shqiptare;
- g) produkte të përfutuara në bordin e anijeve fabrike shqiptare, të prodhuara ekskluzivisht me produkte të paragrafit (f) më sipër;
- h) produkte të përdorura që janë mbledhur po aty,
- i) me kusht që t'i shërbejnë për t'u përdorur vetëm si lëndë e parë;
- j) mbetjet dhe hedhurinat e prejardhura nga operacione prodhimi të kryera aty;
- j) produktet e nxjerra nga shtrati dhe nëntoka detare të ndodhura jashtë ujrave territoriale të Republikës së Shqipërisë, me kusht që kjo e fundit të ushtrojë të drejta ekskluzive me qëllim shfrytëzimi mbi këtë shtrat dhe nëntokë detare;
- k) mallrat e prodhuara aty ekskluzivisht me produktet e përmendura më sipër në paragrafet (a) tek (j).

2. Shprehja "*mjete lundruese*" e përmendur në paragrafin 1(f) përdoret vetëm për mjetet lundruese:

- a) që janë matrikulluar ose regjistruar në Republikën e Shqipërisë;
- b) që mbajnë flamurin shqiptar;

- c) që i përkasin të paktën 50% shtetasve shqiptare ose një shoqërie selia e të cilës ndodhet në Republikën e Shqipërisë dhe administratorët e të cilës, presidenti i këshillit administrativ ose i këshillit të mbikqyrjes dhe shumica e anëtarëve të këtij këshilli janë shtetas të Republikës së Shqipërisë, dhe për raste ortakërie të personave ose shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, kapitali i të cilave i përket të paktën 50% Republikës së Shqipërisë ose enteve publike ose shtetasve të Republikës së Shqipërisë;
- d) kapiteni dhe oficerët e të cilës janë të gjithë shtetas shqiptarë; dhe
- e) ekuipazhi i të cilës përbëhet prej të paktën 75% nga shtetas të Republikës së Shqipërisë.

3. Shprehja "Republika e Shqipërisë" përfshin edhe ujërat territoriale.

4. Mjetet lundruese që ushtrojnë aktivitet në det të hapur, duke përfshirë edhe anijet fabrikë, në bordin e të cilave kryhet punimi ose transformimi i produkteve të peshkimit, konsiderohet sikur bëjnë pjesë në territorin e Republikës së Shqipërisë, mjaft që t'i përgjigjen kushteve të përshkruara në paragrafin 2 më sipër.

Neni 49

1. Për qëllim të nenit 47 (2) (b), materialet me origjinë jo shqiptare konsiderohet se janë punuar ose transformuar mjaftueshëm kur produkti i përftuar klasifikohet në një kre të ndryshëm nga ai në të cilin klasifikohet secili material me origjinë jo shqiptare që nevojitet për fabrikimin e atij produkti, pa rënë ndesh me dispozitat e paragrafit (2) dhe (3) më poshtë.

2. Për produktet e përmendura në kolonën (1) e (2) të listës së dhënë në Aneksin 4, në vend të rregullit të paragrafit (1) më sipër zbatohen kushtet e vendosura për këto produkte në kolonën 3.

3. Për qëllim të nenit 47 (2) (b)(b), konsiderohen të pamjaftueshme për të dhënë karakterin e produktit me origjinë nga vendi përkatës, punimet dhe transformimet si më poshtë vijon, pavarësisht nëse kreu ndryshon apo jo:

- a) operacionet që kanë për qëllim të ruajnë në kushte të mira produktet gjatë transportit dhe magazinimit (ventilim, hapje për tharje, ftohje, zhytje në ujë të kripur, dioksid squfuri ose solucione të tjera ujore, heqjen e pjesëve të dëmtuara ose operacione të ngjashme);
- b) operacionet e thjeshta të pastrimit të pluhurit, shoshitje ose sitje, përzgjedhje, klasifikime, kombinimet (duke përfshirë këtu edhe formimin e kompeteve me disa artikuj), larje, ndarje në pjesë;
- c) i) ndryshim i ambalazheve si dhe ndarja ose bashkimi i dërgesave,

ii) operacionet e thjeshta të vendosjes në shishe, flakone, çanta, thasë, dhe qese, kuti, si dhe vendosje në karton në kuti, si dhe çdo operacion tjetër i thjeshtë ambalazhimi;

- d) vendosja mbi produktet ose mbi ambalazhin e tyre e markave, etiketave ose të tjera shenja dalluese të ngjashme;
- e) përzjerja e thjeshtë e produkteve, qofshin këta të njëjtë apo të ndryshëm, kur një ose disa përbërës të përzjerjes nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë Titull, për t'u mundësuar atyre fitimin e origjinës shqiptare;
- f) montimi i thjeshtë i pjesëve të një produkti për të formuar një produkt të plotë;
- g) kryerja e dy ose më shumë prej operacioneve të parashikuara në paragrafet e mësipërm nga (a) tek (f);
- h) therja e bagëtive.

Neni 50

1. Çertifikatat e origjinës preferenciale, në përputhje me nenin 32(2) të Kodit, lëshohen nga zyra doganore pranë së cilës paraqitet deklarata doganore e eksportit, kur produktet që do të eksportohen plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 16 për produktet me origjinë nga Republika e Shqipërisë.

2. Çertifikata e origjinës preferenciale lëshohet vetëm mbi bazën e kërkesës me shkrim nga eksportuesi, ose përfaqësuesi i tij. Eksportuesi, ose përfaqësuesi i tij i bashkëngjit kërkesës gjithë dokumentat mbështetës që janë lëshuar për të provuar që produktet për t'u eksportuar përmbushin kushtet për t'u lëshuar një çertifikatë origjine preferenciale.

3. Me qëllim që të verifikohet nëse janë plotësuar kushtet e parashikuara në paragrafin 1, autoritetet doganore kompetente kanë të drejtë të kërkojnë dokumente shtesë, ose të vazhdojnë të kryejnë çdo kontroll që ato konsiderojnë të nevojshëm.

4. Është detyrë e autoriteteve doganore të verifikojnë nëse çertifikatat dhe kërkesat janë plotësuar siç duhet.

Neni 51

1. Çertifikata e origjinës preferenciale lëshohet nga zyra doganore në çastin e eksportimit të produkteve të cilave u referohet. Ajo vihet në dispozicion të eksportuesit sapo kryhet eksportimi, ose kur është e sigurtë që eksportimi do të kryhet.

2. Në raste të jashtëzakonshme, çertifikata e origjinës preferenciale mund të lëshohet edhe pas eksportimit të produkteve të cilave ajo i referohet (lëshim "a posteriori"), në qoftë se nuk është lëshuar në çastin e eksportimit për shkak të ndonjë gabimi ose lënie pas dore në mënyrë të pavullnetshme, ose në rrethana të tjera të veçanta që gjykohen të

vlefshme dhe të pranueshme nga zyra doganore.

3. Zyra doganore kompetente mund të lëshojë një certifikatë pas kryerjes së eksportimit 'a posteriori', vetëm pasi të këtë vërtetuar që treguesit e përmbajtur në kërkesën e eksportuesit janë në përputhje me dokumentacionin e eksportimit të produkteve në fjalë dhe që në çastin e eksportimit nuk është lëshuar asnjë certifikatë origjine preferenciale.

4. Çertifikata e origjinës preferenciale e lëshuar a posteriori duhet të mbajë në rubrikën përkatëse shënimin *issued retrospectively* (kuptimi i së cilës është "lëshuar a posteriori").

Neni 52

1. Në rast grabitjeje, humbjeje ose shkatërrimi të një certifikate të origjinës preferenciale, eksportuesi mund të kërkojë nga zyra kompetente doganore që e ka lëshuar atë, një dublikatë në bazë të dokumentave të eksportimit që ka në disponim kjo zyrë. Kopja e certifikatës duhet që së bashku me datën e lëshimit dhe numrin e serisë së certifikatës origjinale, të përmbajë edhe shënimin "duplicate".

2. Dublikata është e vlefshme që nga data e lëshimit të certifikatës origjinale.

KREU 3

Metoda të bashkëpunimit administrativ

Neni 53

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të informojë autoritetet kompetente të vendeve ose grupeve të vendeve të cilave u referohet neni 47 listën e emrave dhe adresat e zyrave doganore të cilat janë të autorizuar të lëshojnë certifikatat e origjinës preferenciale, dhe faksimile të vulave që përdoren nga këto zyra, si dhe emrin dhe adresën e zyrës ose zyrave përgjegjëse për kontrollin e certifikatave të origjinës preferenciale.

2. Për qëllim të kontrollit 'a posteriori' të certifikatës së origjinës preferenciale, zyra doganore që lëshon dokumentin përkatës duhet të ruajë për të paktën 2 vjet nga dita e lëshimit të certifikatës, kopje të certifikatave dhe kopje të dokumentave të eksportimit.

3. Në rast se kërkohet të bëhet kontroll a posteriori mbi vërtetësinë dhe rregullsinë e certifikatës së origjinës preferenciale të lëshuar nga zyrat doganore shqiptare, autoritetet doganore kryejnë të gjitha kontrollet e nevojshme në mënyrë që, brenda një afati 6 mujor, t'i përgjigjen kërkesës për kontroll të ardhur nga autoritete të huaja.

TITULLI VI

VLERA DOGANORE

KREU 1

Dispozita të përgjithshme

Për qëllim të nenit 54 deri 81⁴:

- "Mallra të prodhuara" përfshijnë mallra të kultivuara, të fabrikuar dhe të nxjerra nga nëntoka ose burimet minerale;
- "Mallra identike" do të thotë: mallra të prodhuara në të njëjtin vend, të cilat janë të njëjta nga çdo pikpamje, duke përfshirë edhe karakteristikat fizike, cilesinë dhe reputacionin. Ndryshime të vogla në pamje nuk përbëjnë shkak për t'u konsideruar jo identike mallrat të cilat në gjithshka tjetër përputhen me përkufizimin.
- "Mallra të ngjashme" do të thotë: mallra të prodhuara në të njëjtin vend, të cilat edhe pse nuk janë të ngjashme në çdo pikpamje, kanë karakteristikë dhe materiale përbërëse të ngjashme, të cilat bëjnë të mundur që ato të kryejnë të njëjtat funksione dhe të jenë të shkëmbyeshme me njëra-tjetrën nga ana tregtare; cilesia e mallrave, reputacioni i tyre dhe ekzistenca e një marke tregtare janë ndër

elementet që merren parasysh për të përcaktuar nëse mallra të caktuara janë të ngjashme apo jo;

- "Mallra të të njëjtave kategori ose lloj" do të thotë mallra të cilat klasifikohen brenda një grupi ose sërë mallrash të prodhuara nga një sektor i veçantë industrial, dhe ku përfshihen mallra identike ose të ngjashme.

Shprehjet "mallra identike" dhe "mallra të ngjashme", sipas rastit, nuk zbatohen për mallra të cilat në vetvete trupëzojnë ose pasqyrojnë punime inxhenerike, zhvillimi, artistike, projektuese, si dhe vizatime dhe skica për të cilat nuk është bërë ndonjë rregullim sipas nenit 37(1)(b)(iv) të Kodit, për shkak se këto veprime kanë qenë ndërmarrë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 54

1. Në zbatim të dispozitave të neneve 27, 33 deri 40 të Kodit dhe dispozitave të këtij Titulli, autoritetet doganore zbatojnë dispozitat e parashikuara në Aneksin 6.

Dispozitat e parashikuara në kolonën e parë të Aneksit 6 zbatohen në bazë të shënimeve interpretuese të kolonës së dytë.

2. Nëse për të përcaktuar vlerën doganore del nevoja të bëhen referime në parimet e përgjithshme

⁴ Shiko nenin 2(3). Ky tekst është rishikuar këtu për lehtësi përdorimi të termave të përkufizuar.

të kontabilitetit, zbatohen dispozitat e parashikuara në Aneksin 3.

Neni 55

1. Për qëllim të nenit 34(1)(d) dhe nenit 35(2)(c) të Kodit, dy ose më shumë persona quhen se janë të lidhur vetëm nëse:

- a) njëri prej tyre është anëtar ose drejtues i organeve drejtuese të biznesit të tjetrit dhe anasjelltas;
- b) janë ligjërisht të njohur si ortakë në biznes;
- c) njëri është punëdhënës i tjetrit;
- d) njëri zotëron, kontrollon ose mban, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të paktën 5% ose më shumë të aksioneve me të drejtë vote;
- e) njëri prej tyre kontrollon tjetrin drejtpërdrejt ose tërthorazi;
- f) të dy së bashku, kontrollohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një person i tretë; ose
- g) të dy së bashku kontrollojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi një person të tretë;
- h) janë anëtarë të së njëjtës familje. Personat quhen se janë anëtarë të së njëjtës familje vetëm nëse ata kanë ndonjërin prej marrëdhënieve të mëposhtme me njeri-tjetrin:
 - i) burrë dhe grua,
 - ii) të paralindur dhe të paslindur, në vijë të drejtë, në shkallë të parë (prindër dhe fëmijë),
 - iii) vëlla e motër (pavarësisht nëse janë me gjak të plotë ose jo),
 - iv) të paralindur dhe të paslindur, në vijë të drejtë, në shkallë të dytë (gjysh/gjyshe dhe nip/mbesë),
 - v) dajë/xhaxha ose teze/hallë dhe nip/mbesë,
 - vi) vjehërr/vjehërrë dhe dhëndër/nuse,
 - vii) kunetër dhe kunata.

2. Për qëllim të këtij Titulli, persona që janë të lidhur në biznes me njëri-tjetrin, për shkak se njëri prej tyre është i vetmi agjent, shpërndarës, ose koncesionar i tjetrit, sido që të jetë emërtimi, quhen të lidhur vetëm në qoftë se hyjnë në njërin prej marrëdhënieve të paragrafit 1.

Neni 56

Për të përcaktuar vlerën doganore të mallrave sipas nenit 34 të Kodit, çmimi i të cilave ende nuk është paguar në çastin që merret parasysh për përcaktimin e vlerës doganore, kjo vlerë përgjithësisht do të bazohet në çmimin që do të paguhet për mallrat në fjalë.

Neni 57

1. Kur mallrat e deklaruar për qarkullim të lirë janë pjesë e një sasi më të madhe mallrash të njëjtë, të blera në një transaksion të vetëm, çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar, sipas nenit 34(1) të Kodit, për këto mallra është çmimi i llogaritur në mënyrë përpjestimore duke u mbështetur në raportin midis sasisë së deklaruar me sasinë totale të blerë.

2. Zbatimi i kriterit përpjestimor të llogaritjes së çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar vlen edhe në rast të humbjes së pjesshme të dërgesës ose kur mallrat që vlerësohen janë dëmtuar përpara vendosjes në qarkullim të lirë.

Neni 58

Për qëllim të nenit 34(1) të Kodit, kur çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar përfshin edhe një shumë që i përket një takse të brendshme, që zbatohet në vendin e origjinës ose të eksportimit të mallrave në fjalë, kjo shumë nuk bën pjesë në vlerën doganore, me kusht që autoritetet doganore të interesuara binden se këto mallra janë shkarkuar nga këto detyrime në përfitim të blerësit.

Neni 59

1. Për qëllim të nenit 34 të Kodit, vetë mallrat të cilat janë objekt i një shitjeje, deklarohen për qarkullim të lirë, quhet tregues i mjaftueshëm që ato kanë qenë shitur për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Ky tregues vlen edhe në rastet e shitjeve të mëtejshme, që janë bërë para vlerësimit; në të tilla raste, çdo çmim që rrjedh nga këto shitje mund të merret si bazë për vlerësim.

2. Megjithatë, kur mallrat janë përdorur në një vend tjetër ndërmjet kohës së shitjes dhe kohës që ato janë vendosur në qarkullim të lirë, vlera doganore nuk mund të jetë vlera e transaktuar.

3. Blerësi nuk është e nevojshme të plotësojë kushte të tjera, veç atyre të cilat lidhen me qenien palë në një kontratë shitjeje.

Neni 60

Në çdo rast që në zbatim të nenit 34(1)(b) të Kodit, përcaktohet që shitja ose çmimi i mallrave të importuara i nënshtrohet një kushti ose shqyrtimi vlera e të cilit mund të përcaktohet në lidhje me mallrat që po vlerësohen, kjo vlerë konsiderohet si një pagesë e tërthortë nga blerësi tek shitësi dhe si pjesë e çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar, vetëm nëse ky kusht ose shqyrtim nuk lidhet me:

- a) ndonje aktivitet për të cilin zbatohet neni 34(3)(b) i Kodit; ose
- b) ndonjë element që i shtohet çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar sipas dispozitave të nenit 37 të Kodit.

Neni 61

1. Për qëllim të nenit 34(3)(b) të Kodit, shprehja "aktivitete marketingu" do të thotë çdo aktivitet që lidhet me reklamën dhe nxitjen e shitjes së mallrave në fjalë dhe çdo aktivitet që lidhet me garancitë e dhëna në lidhje me to.

2. Këto aktivitete të ndërmarra nga blerësi konsiderohen të jenë ndërmarrë për llogari të tij, edhe në rast se ato rrjedhin nga një detyrim i blerësit, sipas një marrëveshje me shitësin.

Neni 62

1. Në zbatim të nenit 35(2)(a) të Kodit, (vlera e transaktuar e mallrave identike), vlera doganore përcaktohet duke iu referuar vlerës së transaktuar të mallrave identike në një shitje në të cilën niveli tregtar dhe sasia e mallrave të shitura është në thelb e njëjtë me mallrat që vlerësohen. Kur nuk gjenden shitje të tilla, përdoret vlera e transaktuar e mallrave identike të shitura në një nivel tregtar dhe/ose në sasi të ndryshme, e rregulluar duke marrë parasysh ndryshimet që i përkasin nivelit tregtar dhe/ose sasi, me kusht që këto rregullime të bëhen mbi bazën e paraqitjes së provave të cilat përcaktojnë qartë arsyen dhe saktësinë e rregullimit, pavarësisht nëse këto ndikojnë në rritje ose ulje të vlerës.

2. Kur vlera e transaktuar përmban në vetvete shpenzimet të cilave u referohet neni 37(1)(e) i Kodit, bëhet një korigjim, për të marrë parasysh ndryshimet thelbësore të këtyre shpenzimeve ndërmjet mallrave të importuara dhe mallrave identike në fjalë, ndryshime këto që rrjedhin nga ndryshimet në largësi dhe mënyrat e transportit.

3. Nëse, në zbatimin e këtij neni, gjendet më shumë se një vlerë e transaktuar për mallra identike, për të përcaktuar vlerën doganore të mallrave të importuara, përdoret vlera më e ulët prej tyre.

4. Për të zbatuar këtë nen, do të merret parasysh vlera e transaktuar e mallrave të prodhuara nga një person tjetër, vetëm atëherë kur, sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, nuk mund të gjendet një vlerë transaksioni për mallra identike me mallrat që po vlerësohen, të prodhuara nga i njëjti person.

5. Për qëllim të këtij neni, vlerë e transaktuar e mallrave identike të importuara do të thotë një vlerë doganore, e përcaktuar sipas nenit 34 të Kodit, e korigjuar sipas dispozitave të paragrafit 1(b) dhe 2 të nenit në fjalë.

Neni 63

1. Në zbatim të nenit 35(2)(b) të Kodit, (vlera e transaktuar e mallrave të ngjashme), vlera doganore përcaktohet duke iu referuar vlerës së transaktuar të mallrave të ngjashme në një shitje në të cilën niveli tregtar dhe sasia e mallrave të shitura është në thelb e njëjtë me mallrat që vlerësohen. Kur nuk gjenden shitje të tilla, përdoret vlera e transaktuar e mallrave të ngjashme të shitura në një nivel tregtar dhe/ose në sasi të ndryshme, e rregulluar duke marrë parasysh

ndryshimet që i përkasin nivelit tregtar dhe/ose sasisë, me kusht që këto rregullime të bëhen mbi bazën e paraqitjes së provave të cilat përcaktojnë qartë arsyen dhe saktësinë e rregullimit, pavarësisht nëse këto ndikojnë në rritje ose ulje të vlerës.

2. Kur vlera e transaktuar përmban në vetvete shpenzimet të cilave u referohet neni 37(1)(e) i Kodit, duhet të bëhet një korigjim, për të marrë parasysh ndryshimet thelbësore të këtyre shpenzimeve ndërmjet mallrave të importuara dhe mallrave të ngjashme në fjalë, ndryshime këto që rrjedhin nga ndryshimet në largësi dhe mënyrat e transportit.

3. Nëse, në zbatimin e këtij neni, gjendet më shumë se një vlerë e transaktuar për mallra të ngjashme, për të përcaktuar vlerën doganore të mallrave të importuara, përdoret vlera më e ulët prej tyre.

4. Për të zbatuar këtë nen, do të merret parasysh vlera e transaktuar e mallrave të prodhuara nga një person tjetër, vetëm atëherë kur, sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, nuk mund të gjendet një vlerë transaksioni për mallra të ngjashme me mallrat që po vlerësohen, të prodhuara nga i njëjti person.

5. Për qëllim të këtij neni, vlerë e transaktuar e mallrave të ngjashme të importuara do të thotë një vlerë doganore, e përcaktuar sipas nenit 34 të Kodit, e korigjuar sipas dispozitave të paragrafit 1(b) dhe 2 të nenit në fjalë.

Neni 64

1. (a) Nëse mallra të importuara ose mallra identike apo të ngjashme të importuara janë shitur në Republikën e Shqipërisë në gjendjen në të cilën u importuan, vlera doganore e mallrave të importuara, e përcaktuar në përputhje me nenin 35(2)(c) të Kodit, bazohet në çmimin për njësi me të cilin janë shitur mallrat e importuara ose mallra identike apo të ngjashme me ato të importuara, në sasinë, më të madhe në total, në të njëjtën ose afërsisht të njëjtën kohë me importimin e mallrave që vlerësohen, personave të cilët nuk lidhen me personat prej të cilëve ata blejnë këto mallra, duke zbritur si me mëposhtme:

- i) komisionin që zakonisht paguhet ose bihet dakort të paguhet, ose shtesat që zakonisht bëhen për qëllime fitimi dhe shpenzime të përgjithshme (duke përfshirë kostot e drejpërdrejta ose të tërthorta që bëhen për marketingun e mallrave në fjalë) në lidhje me shitjen, në Republikën e Shqipërisë, të mallrave të së njëjtës kategori ose lloj me mallrat e importuara,
- ii) shpenzimet e zakonshme të kryera në Republikën e Shqipërisë në lidhje transportimin dhe sigurimin e mallrave, si dhe kostot shtesë që shoqërojnë këto dy kategori,

iii) detyrimet doganore të importit dhe pagesa të tjera që duhet të paguhet në Republikën e Shqipërisë, për shkak të importimit ose shitjes së mallrave.

(b) Në rast se as mallrat e importuara, as mallrat identike apo të ngjashme të importuara nuk janë shitur në të njëjtën, ose afërsisht në të njëjtën kohë, me importimin e mallrave që po vlerësohen, vlera doganore e mallrave të importuara, e përcaktuar sipas këtij neni, pa rënë ndesh me dispozitat e paragrafit 1(a), bazohet në çmimin për njësi me të cilin mallrat e importuara, dhe mallrat identike ose të ngjashme të importuara, janë shitur në vend në kushtet në të cilat u importuan, në datën më të parë pas importimit të mallrave që i nënshtrohen vlerësimit, por jo më vonë se 90 ditë pas importimit.

2. Në rast se mallrat e importuara ose mallra identike ose të ngjashme nuk janë shitur në vend në kushtet në të cilat janë importuar, nëse importuesi kërkon një gjë të tillë, vlera doganore duhet të bazohet në çmimin për njësi me të cilin mallrat e importuara pas përpunimit të mëtejshëm, u janë shitur në sasinë më të madhe totale në Shqipëri personave që nuk janë të lidhur me personat nga të cilët ata i blejnë këto mallra, duke marrë parasysh rritjen e vlerës si pasojë e përpunimit dhe zbritjet e parashikuara në paragrafin 1(a) të këtij neni.

3. Për qëllim të këtij neni, çmimi për njësi me të cilin mallrat e importuara janë shitur në sasinë më të madhe në total, është çmimi me të cilin numri më i madh i njësive i është shitur personave të cilët nuk janë të lidhur me personat prej të cilëve ata kanë blerë këto mallra në nivelin e parë tregtar, në të cilin kryhen këto shitje pas importimit.

4. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, nuk merret parasysh shitje të kryera në Shqipëri nga persona që furnizojnë, drejtpërsëdrejtë ose tërthorazi, falas ose me çmim të reduktuar ndonjë prej elementeve të specifikuar në nenin 37(1)(b) të Kodit, për t'u përdorur në kuadrin e prodhimit dhe shitjes për eksport të mallrave të importuara.

5. Për qëllim të paragrafit 1(b), "data më e parë", është data në të cilën mallrat e importuara ose mallra të ngjashme apo identike të importuara janë shitur në sasi të mjaftueshme për të përcaktuar çmimin për njësi.

Neni 65

1. Në zbatim të nenit 35(2)(d) të Kodit, (vlera e llogaritur), autoritetet doganore nuk mund të kërkojnë ose detyrojnë një person që nuk është vendosur në Republikën e Shqipërisë të paraqesë për kontroll ose të lejojë marrjen e informacionit për kontabilitetin ose të dhëna të librave për qëllim të përcaktimit të kësaj vlere. Megjithatë, informacioni i paraqitur nga prodhuesi i mallrave, për përcaktimin e vlerës doganore të tyre sipas këtij neni, mund të verifikohet në një vend të huaj nga autoritetet doganore shqiptare, me miratimin e prodhuesit dhe me kusht që këto autoritete të kenë njoftuar

paraprakisht dhe në mënyrën e duhur autoritetet doganore të vendit në fjalë dhe që këto të fundit të mos kenë kundërshtim për hetimin.

2. Kostoja ose vlera e materialeve dhe fabrikimit, të cilave u referohet neni 35(2)(d)(i) i Kodit, përfshin koston e elementeve të specifikuar në nenin 37(1)(a)(ii) dhe (iii) të Kodit.

3. Po kështu kostoja të cilës i referohet paragrafi i mësipërm përfshin vlerën e përpjësuar përkatësisht për çdo produkt ose shërbim, të përmendur në nenin 37(1)(b) të Kodit, vlerë kjo e cila paraqitet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga blerësi për shkak të përdorimit për prodhimin e mallrave të importuara. Vlera e elementeve të përmendur në nenin 37(1)(b)(iv) të Kodit, të cilat janë ndërmarrë në Republikën e Shqipërisë, përfshihet vetëm në masën që këto elemente i ngarkohen prodhuesit.

4. Në rast se për të llogaritur vlerën e llogaritur përdoren informacione të ndryshme nga ato të paraqitura prej ose për llogari të prodhuesit, autoritetet doganore informojnë deklaruesin, në qoftë se ky i fundit kërkon një gjë të tillë, lidhur me burimin e këtij informacioni, të dhënat e përdorura dhe përlogaritjet e bazuara në këto të dhëna, pa rënë ndesh me nenin 25 të Kodit.

5. "Shpenzime të përgjithshme" të cilave u referohet neni 35(2)(d)(ii) i Kodit, mbulojnë kostot e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të prodhimit dhe shitjes së mallrave për eksport, të cilat nuk mbulohen nga neni 35(2)(d)(i) i Kodit.

Neni 66

Kur mbajtesit e mallrave të cilëve u referohet neni 37(1)(a)(ii) i Kodit do t'i nënshtrohen importimit të përsëritur, kostoja e tyre, me kërkesë të deklaruesit përpjesëtohet sipas nevojës, në përputhje me parimet e përgjithshme të pranuar në kontabilitet.

Neni 67

Për qëllim të nenit 37(1)(b)(iv) të Kodit, kostoja e veprimtarive kërkimore dhe projekteve nuk përfshihet në vlerën doganore.

Neni 68

Kur vlera doganore përcaktohet duke zbatuar një metodë të ndryshme nga vlera e transaktuar, neni 38(c) i Kodit zbatohet *mutatis mutandis*.

KREU 2

Dispozita mbi royalties dhe të drejtat e licencës

Neni 69

1. Për qëllim të nenit 37(1)(c) të Kodit, royalties dhe të drejta licence do të thotë, veçanërisht, çdo pagesë e bërë për përdorimin e të drejtave lidhur me:

a) fabrikimin e mallrave të importuara (veçanërisht për patentat, projektet, modelet dhe "instruksionet e fabrikimit" "know how"); ose

b) shitjen për eksport të mallrave të importuara (veçanërisht për markat

tregtare, modelet e regjistruara); ose

- c) përdorimin ose rishitjen e mallrave të importuara (veçanërisht për të drejtën e autorit, për procedurën e fabrikimit që është trupëzuar në mënyrë të pandarë në mallrat e importuara).

2. Pa rënë ndesh me nenin 37 (4) të Kodit, kur vlera doganore e mallrave të importuara përcaktohet sipas dispozitave të nenit 34 të Kodit, çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar duhet t'i shtohet edhe një *royalty* dhe e drejta e licencës, vetëm në rastet kur kjo pagesë:

- a) ka të bëjë me mallrat që janë objekt i vlerësimit; dhe
- b) është kusht shitjeje për mallrat në fjalë.

Neni 70

1. Kur mallrat e importuara janë vetëm një element ose pjesë përbërëse e mallrave të fabrikuar në Republikën e Shqipërisë, çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar duhet të korrigjohet vetëm nëse *royalty* ose e drejta e licencës u referohet këtyre mallrave.

2. Nëse mallrat importohen të pamontuara ose duhet t'u nënshtrohen vetëm përpunimeve të vogla përpara se të rishiten, siç është hollimi (i substancave që mund të hollohen) ose ambalazhimi, kjo nuk përjashton mundësinë që një *royalty* ose e drejtë licence të jetë paguar për mallrat e importuara.

3. Nëse *royalties* ose të drejtat e licencës u referohen pjesërisht mallrave të importuara dhe pjesërisht elementeve ose përbërësve të tjerë që u janë shtuar mallrave pas importimit, ose veprimtarive apo shërbimeve të kryera pas importimit, bëhet një ndarje e përshtatshme, e bazuar vetëm në të dhëna objektive dhe të llogaritshme, në përputhje me shënimin interpretues të nenit 37 (2) të Kodit dhënë në Aneksin 6.

Neni 71

Çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar për mallrat e importuara i shtohet *royalty* ose e drejta e licencës lidhur me të drejtën e përdorimit të një marke tregtare vetëm kur:

- a) *royalty* ose e drejta e licencës i referohet mallrave, të cilat janë rishitur në të njëjtën gjendje ose që janë objekt vetëm i përpunimeve të vogla pas importimit;
- b) mallrat janë tregtuar me markën tregtare, të vendosur përpara ose pas importimit, për të cilën është paguar *royalty* ose e drejta e licencës; dhe
- c) blerësit nuk i lejohet të marrë të tilla mallra nga furnizues të tjerë që nuk kanë lidhje me shitësin.

Neni 72

Kur blerësi i paguan *royalties* ose të drejtat e

licencës një pale të tretë, kushtet e parashikuara në nenin 69(2) konsiderohen të plotësuar vetëm nëse shitësi ose një person tjetër që ka lidhje me të i kërkon blerësit që të bëjë këtë pagesë.

Neni 73

Kur metoda e përlogaritjes së shumës së një *royalty* ose të drejtë licence bazohet në çmimin e mallrave të importuara, mund të konsiderohet në mungesë të provave për të kundërtën, që pagesa e kësaj *royalty* ose pagesë licence lidhet me mallrat që janë objekt vlerësimi. Megjithatë, pagesa e *royalty* ose të drejtës së licencës kur shuma e kësaj *royalty* ose të drejtë licence përlogaritet pa marrë parasysh çmimin e mallrave të importuara mund t'i referohet mallrave që janë objekt vlerësimi.

Neni 74

Në zbatim të nenit 37 (1) (c) të Kodit, vendbanimi i përfituesit të pagesës së *royalty*-s ose të drejtës së licencës është i parëndësishëm.

KREU 3

Dispozita mbi vendin e hyrjes në Republikën e Shqipërisë

Neni 75

1. Për qëllim të nenit 37(1)(e) dhe nenit 38(a) të Kodit, vendi i hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë është:

- a) për mallrat e transportuara në rrugë detare, porti i shkarkimit, ose porti i transbordimit, me kusht që ky transbordim të jetë i autorizuar nga autoritetet doganore të portit në fjalë;
- b) për mallrat e transportuara në rrugë detare dhe më pas pa transbordim, nëpërmjet ujërave të brendshme, porti i parë - në grykëderdhjen e lumit ose të kanalit ose diku më tej në thellësi - ku mund të kryhet shkarkimi i mallrave, me kusht që t'i provohet autoriteteve doganore se shpenzimet e transportit deri në portin e shkarkimit janë më të mëdha se shpenzimet përkatëse deri në portin e parë në fjalë;
- c) për mallrat e transportuara në rrugë hekurudhore, në rrugë të brendshme ujore, ose në rrugë automobilistike, vendi ku ndodhet zyra e parë doganore;
- d) për mallrat e transportuara në rrugë të tjera, vendi ku kalohet kufiri tokësor i territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Vlera doganore e mallrave të futura në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe më pas të transportuara në rrugë detare, me destinacion në një pjesë tjetër të këtij territori, përcaktohet duke iu referuar vendit të parë të hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që mallrat të transportohen nëpërmjet një itinerari të zakonshëm, drejt e për në vendin e destinacionit.

KREU 4

Dispozita mbi shpenzimet e transportit

Neni 76

Në zbatim të nenit 37 (1) (e) dhe 38 (a) të Kodit:

- a) kur mallrat transportohen me të njëjtën mënyrë transporti deri në një pikë që ndodhet përtej vendit të hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, shpenzimet e transportit vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me largësinë e përshkuar jashtë dhe brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke përjashtuar rastet kur autoriteteve doganore u jepet një provë mbi shpenzimet që do të ishin bërë në përputhje me tarifën zakonshme që zbatohet për transportin e mallrave deri në vendin e hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;
- b) kur mallrat janë faturuar me një çmim të vetëm deri në mbërritjen në destinacion, i cili përkon me çmimin deri në vendin e hyrjes, shpenzimet e transportit brenda Republikës së Shqipërisë nuk zbriten nga ky çmim. Megjithatë, kjo zbritje lejohet me kusht që t'u provohet autoriteteve doganore që çmimi deri në mbërritjen në kufi, është më i ulët sesa çmimi i njëjtë deri në mbërritjen në destinacion.
- c) kur transporti është falas ose në ngarkim të blerësit, vlera doganore përfshin shpenzimet e transportit deri në vendin e hyrjes, të llogaritura në bazë të tarifës që zbatohet zakonisht për të njëjtat mënyra transporti.

Neni 77

1. Vlera doganore e mallrave përfshin të gjitha detyrimet postare në lidhje me mallrat e dërguara me postë deri në vendin e destinacionit, me përjashtim të çdo takse postare shtesë që vendoset në Republikën e Shqipërisë.

2. Për përcaktimin e vlerës doganore dërgesave të mallrave jo tregtara, nuk do të bëhet asnjë rregullim i vlerës së deklaruar në lidhje me këto detyrime.

3. Paragrafet 1 dhe 2 nuk zbatohen për mallrat e transportuara me anë të shërbimeve të shpejta postare të njohura si Express Mail Service-Datapost (EMS-Datapost) si për shembull EMS-Jetpost në Danimarkë, EMS-Kurierpostendungen në Gjermani, CAI-Post në Itali.

Neni 78

Shpenzimet e transportit ajror që duhet të përfshihen në vlerën doganore të mallrave përcaktohen duke zbatuar përqindjet e dhëna në Aneksin 8.

KREU 5

Vlerësimi i sistemeve informatike mbartëse të të dhënave të destinuara për tu përdorur në pajisjet e përpunimit të të dhënave

Për qëllim të nenit 79⁵:

- a) "Sistem mbartës" nuk përfshin qarqet e integruara, gjysmëpërcjellesit dhe pajisje ose artikujt e tjerë ku janë trupëzuar këto qarqe ose pajisje;
- b) "Të dhëna ose udhëzime" nuk përfshin regjistrimet zanore, kinematografike dhe videot.

Neni 79

Pa rënë ndesh me nenet 34 deri 38 të Kodit, për përcaktimin e vlerës doganore të sistemeve informatike që mbartin të dhëna ose udhëzime të destinuara për përdorim në pajisjet e përpunimit të të dhënave, merret parasysh vetëm kostoja ose vlera e vetë sistemit mbartës. Pra, vlera doganore e sistemeve mbartëse të importuara nuk përfshin koston ose vlerën e të dhënave ose udhëzimeve, gjithmonë me kusht që kjo kosto ose vlerë të dallohet nga kostoja ose vlera e sistemit mbartës në fjalë.

KREU 6

Dokumentet që duhen paraqitur

Neni 80

Kur është e nevojshme të përcaktohet vlera doganore në zbatim të neneve 27, dhe 33 deri në 40 të Kodit, deklaruesi duhet të paraqesë pranë autoriteteve doganore një kopje të faturës, në bazë të së cilës bëhet deklarimi i vlerës së mallrave të importuara. Kur vlera doganore deklarohet me shkrim kjo kopje duhet të mbahet nga autoritetet doganore.

Neni 81

1. Autoritetet doganore nuk duhet të përcaktojnë vlerën doganore të mallrave të importuara mbi bazën e metodës së vlerës së transaktuar, në qoftë se në përputhje me procedurat e përcaktuara në paragrafin 2, ata nuk binden, mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme, se vlera e deklaruar përfaqëson shumën totale realisht të paguar ose që duhet paguar sipas nenit 34 të Kodit.

2. Kur autoritetet doganore kanë dyshimet e përmendura në paragrafin 1, ata mund të kërkojnë informacion shtesë në përputhje me paragrafin 3. Nëse përsëri ka dyshime, autoritetet doganore, përpara se të marrin një vendim përfundimtar, duhet të lajmërojnë personin e interesuar, me shkrim në qoftë se ai e kërkon një gjë të tillë, për arsyet që çojnë në dyshime dhe t'i japin atij mundësinë reale për t'u përgjigjur. Vendimi përfundimtar dhe arsyet për marrjen e një vendimi të tillë i komunikohen me shkrim personit në fjalë.

3. Lidhur me përcaktimin e vlerës doganore deklaruesi është i detyruar që, me kërkesë të autoriteteve doganore, të japë informacion dhe

⁵ Shiko nenin 2(4). Ky tekst është rishikuar këtu për lehtësi përdorimi të termave të përkufizuar.

dokumente shitesë lidhur me:

- a) vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura;

- b) informacion ose dokumente shitesë të nevojshme për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave.

TITULLI VII

DISPOZITA QË ZBATOHEN PËR MALLRAT QË HYJNË NË TERRITORIN DOGANOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DERI SA T'U CAKTOHET NJË DESTINACION DOGANOR

Neni 82

Në përputhje me nenin 41 të Kodit, ky Kre përcakton rregullat për mallrat që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 83

Të gjitha mjetet e transportit mbeten nën mbikqyrjen doganore:

- për aq kohë sa ato transportojnë mallra që janë nën mbikqyrjen doganore;
- nga çasti kur hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë pa transportuar mallra, deri sa ato të kryejnë të gjitha procedurat doganore;
- nga çasti kur njoftojnë Autoritetet Doganore për largimin e tyre deri sa ato largohen nga ky territor.

Neni 84

Kapitenët ose shoferët në mjetet e transportit nën mbikqyrjen doganore janë të detyruar të ndjekin itinerarin e përcaktuar nga Autoritetet Doganore, të mbajnë me vete të gjitha dokumentet doganore për mjetin e transportit dhe ngarkesën e tij si dhe të ndalojnë kur një gjë e tillë u kërkohet nga Autoritetet Doganore. Kapitenët dhe shoferët në mjetet e transportit që nuk janë nën mbikqyrjen doganore dhe personat e tjerë janë gjithashtu të detyruar të ndalojnë. Një kërkesë e tillë mund të bëhet kur ka dyshime se nuk janë përmbushur të gjitha dispozitat në lidhje me legjislacionin doganor.

Neni 85

1. Personi përgjegjës për çdo lloj mjeti transporti, me mbërritjen ose largimin nga territori i Republikës së Shqipërisë, është i detyruar të njoftojë dhe të informojë Autoritetet Doganore për mjetin e transportit dhe të gjithë mallrat e transportuara. Mjetet e transportit nën mbikqyrjen doganore nuk lejohen të hyjnë ose të largohen nga vende të tjera përveç zonave doganore. Mbi bazën e një kërkesë me shkrim Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të lejojë, në raste të veçanta, që mjetet e transportit të hyjnë ose të largohen nga vende të tjera. Në autorizim Drejtoria e Përgjithshme e Doganave shpreh kushtet sipas të cilave lëshohet autorizimi.

2. Para se të lëshohet autorizimi duhet të paguhet një shumë prej 20.000 lekë për secilin autorizim.

Neni 86

1. Në përputhje me nenin 65 të Kodit, automjetet që transportojnë mallra që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të paraqiten pranë

autoriteteve doganore. Kjo paraqitje bëhet në formularin "deklarata e automjetit" e miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Megjithatë, deklarata e automjetit nuk nevojitet në qoftë se të gjitha mallrat në një automjet transportohen nën një Carnet TIR ose ATA.

2. "Deklarata e automjetit" duhet të përmbajë informacion të përgjithshëm për të gjitha mallrat e transportuara nga automjeti, emrin e shoferit, numrin e regjistrimit të automjetit dhe firmën e shoferit që shpreh vërtetësinë dhe saktësinë e deklaratës.

Neni 87

Për të verifikuar nëse informacioni i dhënë është i saktë dhe nëse deklarata është plotësuar plotësisht në përputhje me Kodin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Autoritetet Doganore mund të kontrollojnë:

- mjetet e transportit, duke përfshirë kontenierët, kutitë dhe hapësirat e tjera ku mund të depozitohen mallrat;
- ambjentet për magazinimin e përkohshëm, magazinat, zonat e lira, magazinat e lira dhe magazinat për sendet ushqimore për përdorim në bordin e mjeteve të transportit, aeroportet, stacionet hekurudhore dhe portet, ku depoziton mallrat nën mbikqyrjen doganore, si edhe të gjitha ambjentet brenda këtyre zonave; dhe
- bagazhet si valixhet dhe çantat e dokumenteve, çantat e dorës dhe artikuj të ngjashëm që mbarten nga udhëtarët që hyjnë ose dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ose nga persona që hyjnë ose dalin me çdo lloj mjeti transporti që është nën mbikqyrjen doganore.

Neni 88

Për kontrollet e parashikuara në nenin 6 personi, deklarata e të cilit do të verifikohet, duhet të vërë në dispozicion të autoriteteve doganore si mjetet e transportit ashtu edhe mallrat. Gjithashtu, ai duhet të vërë në dispozicion të gjitha ambjentet dhe vendet e tjera të përdorura për transport, magazinim dhe veprimtari të ngjashme që lidhen me verifikimin.

Neni 89

Për qëllime kontrolli dhe duke mos shkaktuar pengesa për trafikun normal, Autoritetet Doganore, në rast se nevojitet një gjë e tillë, mund të mbyllin përkohësisht zona ngarkim-shkarkimi ose zonat ku pasagjerët hyjnë ose zbresin nga një mjet transporti. Kjo zbatohet gjithashtu edhe në zona të

tjera në afërsi të mjeteve të transportit si per shembull hyrjet dhe daljet e ambjentëve të magazinimit të përkohshëm, magazinat, portet, zonat e lira dhe aeroportet.

Neni 90

Autoritetet Doganore mund të kyçin, vulosin ose të vendosin shenja në mjetet e transportit, kontenierët dhe mallrat e tjera që janë nën mbikqyrjen doganore. Kur është e nevojshme, Autoritetet Doganore mund të mbajnë përkohësisht dokumentet e regjistrimit ose dokumente të ngjashme për çdo mjet transporti për të parandaluar largimin e tij.

Neni 91

Shoqëritë e transportit që transportojnë udhëtarë nga jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë duhet, pa ndonjë shpenzim, t'u sigurojnë Autoriteteve Doganore ambjentet e nevojshme për zhdoganimin e automjeteve dhe pasagjerëve të transportuar prej tyre. Këto ambjente duhet të jenë sipas standarteve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Neni 92

Dispozitat e parashikuara në Kod dhe në këtë akt në lidhje me mallrat jo shqiptare zbatohen *mutatis mutandis* gjithashtu edhe për mallrat shqiptare për të cilat janë bërë subvencione, rimbursime, shuarje të detyrimeve doganore ose masa të tjera ekonomike si pasojë e eksportimit të tyre nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

KREU 2

Trafiku ajror

Neni 93

Asnjë person nuk lejohet të hyjë ose të largohet nga një mjet ajror nën mbikqyrjen e Autoriteteve Doganore që mbërrin nga vende jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë pa u autorizuar paraprakisht nga autoritetet doganore, me përjashtim të përfaqësuesve të autoriteteve të tjera publike që veprojnë në aeroport dhe të kapitenit që kryen detyra zyrtare.

Neni 94

Pa rënë ndesh me nenin 45 të Kodit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në raste të veçanta, mund të autorizojë një mjet ajror të hyjë ose të largohet nga vende të tjera që nuk janë aeroporte ndërkombëtare. Në këto raste zbatohet neni 85.

KREU 3

Trafiku detar dhe ujor

Neni 95

Çdo mjet lundrues nën mbikqyrjen doganore që mbërrin nga vende jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë nuk lejohet të bëjë ndalesa të tjera në territorin doganor përveç ndalesave që janë të nevojshme për arsye sigurie ose që janë miratuar nga autoritetet doganore, ose si pasojë e kërkesës së ndonjë autoriteti publik në

përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 96

Asnjë person nuk lejohet të hyjë ose të largohet nga një mjet lundrues nën mbikqyrjen doganore që mbërrin nga vende jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë pa u autorizuar paraprakisht nga autoritetet doganore me përjashtim të pilotëve, agjentëve të lundrimit, të përfaqësuesve të autoriteteve të tjera publike që veprojnë në aeroport dhe të kapitenit që kryen detyra zyrtare.

Neni 97

Pa rënë ndesh me nenin 85, mjetet lundruese që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nuk lejohen të shkojnë në vende të tjera përveç një zone doganore të miratuar.

Neni 98

Mjetet lundruese që kryejnë linja të rregullta me vende të tjera, që transportojnë pasagjerë ose mallra brenda kamionëve dhe rimorkiove, që kërkojnë zhdoganim të menjëhershëm me mbërritjen e tyre nuk lejohen të hyjnë në vende të tjera përveç se në vende dhe në kohën e miratuar nga autoritetet doganore kompetente. Miratimi mund të jetë i herëpashershëm ose i përgjithshëm.

Neni 99

1. Është detyra e drejtuesit të mjetit lundrues të njoftojë Autoritetet Doganore kompetente të paktën 24 orë para mbërritjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Lajmërimi duhet të përmbajë informacionin për kohën e parashikuar të mbërritjes, tipin e mjetit lundrues, kombësinë, kapacitetin, sinjalin e komunikimit me radio, portin e nisjes, dhe portet ku ka ndaluar gjatë udhëtimit dhe një përshkrim të përgjithshëm të ngarkesës dhe pasagjerëve. Megjithatë, Autoritetet Doganore mund të autorizojnë që koha e lajmërimit të jetë më pak se 24 orë para mbërritjes për mjetet lundruese që kryejnë linja të rregullta që njihen paraprakisht nga Autoritetet Doganore. Në këto raste njoftimi mund të bëhet jo më vonë se 1 orë para mbërritjes.

2. Në qoftë se koha e mbërritjes ndryshon, kapiteni duhet të informojë menjëherë autoritetet doganore por në asnjë rast jo më vonë se 1 orë para mbërritjes.

3. Kapiteni ka të drejtë të përdorë një përfaqësues për të përmbushur detyrat e tij që përcaktohen në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 100

Kur kapiteni bën deklarinë e anijes në përputhje me nenin 53 të Kodit, së bashku me manifestin ai duhet të dorëzojë deklaratën e anijes, listën e ekuipazhit, deklaratën e ngarkesës, deklaratën për furnizimet në anije, deklaratën e ekuipazhit, listën e pasagjerëve, sipas formularëve të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Neni 101

Mjetet lundruese që largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë që transportojnë mallra ose pasagjerë nën mbikqyrjen doganore nuk lejohen të bëjnë ndalesa të tjera në territorin doganor me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e nevojshme për arsye sigurie ose kur miratohet nga autoritetet doganore ose si pasojë e një kërkesë nga ndonjë autoritet publik në përputhje me legjislacionin doganor.

Neni 102

Mjetet lundruese që kryejnë linja të rregullta me vende të tjera, që transportojnë pasagjerë ose mallra me kamionë ose rimorkio, që kërkojnë zhdoganim të menjëhershëm në çastin e nisjes nuk lejohen të largohen në orare dhe vende të ndryshme nga ato të miratuara nga autoritetet doganore. Miratimi mund të jetë i herëpashershëm ose i përgjithshëm.

Neni 103

Mjetet lundruese që largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë nuk mund të fillojnë të ngarkojnë pa lejen e autoriteteve doganore kompetente. Pasi ka filluar ngarkimi, nuk lejohet të shkarkohet pa lejen paraprake të autoriteteve doganore.

Neni 104

1. Është detyra e drejtuesit të mjetit lundrues të njoftojë autoritetet doganore kompetente të paktën 2 orë para largimit nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë. Njoftimi duhet të përmbajë informacionin rreth kohës së parashikuar të largimit, portin e destinacionit, dhe një përshkrim të përgjithshëm të ngarkesës së tij dhe pasagjerëve, në këto raste përdoren formularët e deklarates së mjetit lundrues të përshkruara në 100. Megjithatë, autoritetet doganore mund të autorizojnë që ky njoftim mund të jepet më vonë se 2 orë para largimit për mjetet lundruese që kryejnë

linja të rregullta dhe që njihen paraprakisht nga autoritetet doganore. Në këto raste njoftimi nuk mund të jepet më vonë se 30 minuta para largimit.

2. Në qoftë se koha e nisjes ndryshon, drejtuesi i mjetit lundrues njofton menjëherë autoritetet doganore por në asnjë rast ky njoftim nuk bëhet më vonë se 30 minuta para nisjes.

3. Kapiteni ka të drejtën të përfaqësohet nga një përfaqësues për të përmbushur detyrat e tij që përcaktohen në paragrafin 1 dhe 2.

Neni 105

Asnjë person nuk lejohet të hyjë ose të largohet nga një mjet lundrues që po largohet, që mbart mallra ose persona nën mbikqyrjen doganore pa qenë paraprakisht i autorizuar nga autoritetet doganore me përjashtim të pilotëve, agentëve, përfaqësuesve nga autoritetet publike portuale dhe kapitenëve kur ata kryejnë detyra zyrtare.

Neni 106

Në qoftë se autoritetet doganore kanë vulosur hambaret ose hapësira të tjera ose mallra në një mjet lundrues që po largohet nën mbikqyrjen doganore, vula nuk duhet të hiqet pa dalë mjeti nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

Neni 107

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të vendosë që të thjeshtëzohet procedura e deklarimit për disa lloje mjete lundruese si anije qeveritare, anije shpëtimi dhe anije të tjera të ngjashme me to, mjete lundruese që përdoren për zbavitje dhe anije peshkimi.

Neni 108

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të nxjerrë udhëzime për zbatimin praktik për mallrat që hyjnë ose dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

TITULLI VIII

HYRJA E MALLRAVE NË TERRITORIN DOGANOR

KREU 1

Kontrolli i mallrave dhe marrja e mostrave nga personi i interesuar.

Neni 109

1. Leja për të kryer kontrollin e mallrave sipas nenit 67 të Kodit, në bazë të një kërkesë me shkrim, i jepet personit që ka të drejtën t'u caktojë mallrave një destinacion doganor, me përjashtim të rastit kur duke pasur parasysh rrethanat, autoritetet doganore konsiderojnë të mjaftueshme një kërkesë gojore. Marrja e mostrave mund të autorizohet vetëm me kërkesë me shkrim të personit të interesuar.

2. Kërkesa me shkrim e përmendur në paragrafin 1, nënshkruhet nga personi i interesuar dhe paraqitet pranë autoriteteve doganore përkatëse. Ajo duhet të përfshijë të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin dhe adresën e kërkuarit;
- b) vendodhjen e mallrave;
- c) numrin e deklarates përmbledhëse, në rast se kjo është paraqitur, duke përjashtuar rastet kur zyra doganore merr përsipër të japë vetë një informacion të tillë, ose të shënojë procedurën e mëparshme doganore ose të dhënat për identifikimin e mjetit të transportit në të cilin gjenden mallrat;

- d) të gjitha të dhënat e tjera të nevojshme për identifikimin e mallrave.

3. Autoritetet doganore shkruajnë mbi kërkesën me shkrim të paraqitur nga personi i interesuar miratimin e saj. Kur kërkesa ka për objekt marrjen e mostrave, autoritetet në fjalë përcaktojnë sasinë e mallrave që duhet të merren.

4. Bashkë me deklaratën përmbledhëse mbahet një kopje e këtij autorizimi.

5. Kontrolli paraprak i mallrave dhe marrja e mostrave kryhet nën mbikqyrjen e autoriteteve doganore, të cilat caktojnë procedurat që duhen ndjekur rast pas rasti. Rreziqet dhe shpenzimet për shpaketimin, peshimin, dhe më pas ripaketimin, si dhe çdo veprim tjetër me mallrat janë në ngarkim të personit të interesuar. Po kështu edhe çdo shpenzim në lidhje me kryerjen e analizave është në ngarkim të këtij të fundit.

6. Mostrat e marra i nënshtrohen formaliteteve që lidhen me caktimin e një destinacioni doganor. Kur kontrolli i mallrave ka si pasojë shkatërrimin e tyre ose humbje të parikthyeshme, gjykohet se nuk ka lindur borxh doganor. Për mbeturinat dhe hedhurinat zbatohet neni 197 (5) i Kodit.

KREU 2

Deklarata Përmbledhëse

Neni 110

1. Deklarata përmbledhëse nënshkruhet nga personi i cili bën këtë deklaratë.

2. Deklarata përmbledhëse pranohet, nënshkruhet, dhe vuloset nga autoritetet doganore dhe mbahet prej tyre për të kontrolluar nëse mallrat të cilave ajo u referohet, kanë marrë një destinacion doganor brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 74 të Kodit.

3. Deklarata përmbledhëse, për mallrat të cilat përpara paraqitjes në zyrën doganore kanë lëvizur nën regjim tranziti, përbëhet nga një kopje e dokumentit të tranzitit që hartohet për zyrën e doganës së destinacionit.

4. Autoritetet doganore mund të lejojnë që deklarata përmbledhëse të bëhet në mënyrë të informatizuar. Në këtë rast, zbatohen respektivisht rregullat që parashikohen në paragrafin 2.

5. Deklarata përmbledhëse bëhet me anë të depozitimit të manifestit të ngarkesës së mjetit lundrues, mjetit ajror, mjetit hekurudhor, deklaratës së tranzitit, dokumentit të transportit rrugor (CMR) ose në çdo formë tjetër që pranohet nga zyra doganore përkatëse. Deklarata përmbledhëse nuk nevojitet për mallra që hyjnë në rrugë postare ose mbarten prej vetë udhëtarit.

6. Deklarata përmbledhëse duhet të përmbajë të paktën informacion për:

- a) numrin e kolive, llojin e tyre, si dhe markat dhe numrat që ato mbajnë;

- b) llojin e mallit;

- c) peshën bruto të mallit.

7. Kur një deklaratë doganore është depozituar në zyrën doganore kompetente ajo duhet të regjistrohet në regjistrin përkatës dhe numri i regjistrimit duhet të shënohet në deklaratën përmbledhëse. Numri i regjistrimit të deklaratës përmbledhëse duhet të shënohet gjithashtu në kutinë 40 të çdo deklarate doganore të bërë në lidhje me mallrat të cilave u referohet deklarata përmbledhëse në fjalë.

Neni 111

1. Mallrat që janë deklaruar në mënyrë të përmbledhur dhe të cilat nuk janë shkarkuar nga mjeti i transportit ku janë ngarkuar drejtpërsëdrejti, duhet të riparaqiten të paprekura dhe me kërkesën më të parë të autoriteteve doganore nga personi i përmendur në nenin 110 (1), deri sa atyre nuk u është caktuar një destinacion doganor.

2. Personi i cili bëhet mbajtës i mallrave pas shkarkimit me qëllim që t'i lëvizë ose t'i magazinon ato, është i detyruar të riparaqesë të paprekura të gjitha mallrat me kërkesën më të parë nga autoritetet doganore.

KREU 3

Magazinimi i përkohshëm

Neni 112

1. Kur vendet e përmendura në nenin 76 (1) të Kodit, janë miratuar në mënyrë të përhershme për vendosjen e mallrave në magazinim të përkohshëm, këto vende quhen "ambiente për magazinim të përkohshëm".

2. Për të siguruar zbatimin e legjislacionit doganor autoritetet doganore mund, në rast se nuk i administrojnë vetë ambientet e magazinimit të përkohshëm, të kërkojnë që:

- a) ambientet e magazinimit të përkohshëm të mbyllen me dy dryna, dhe çelësi i njërës të mbahet nga autoritetet doganore;
- b) personi i cili administron ambientet e magazinimit të përkohshëm duhet të bëjë regjistrimin e mallit të magazinuar, për të mundësuar ndjekjen e lëvizjes së mallrave.

Neni 113

1. Autorizimi për ambiente të magazinimit të përkohshëm lëshohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Ky nen nuk zbatohet për ambiente të magazinimit të përkohshëm të cilat administrohen nga autoritetet doganore.

2. Për të marrë një autorizim për ambiente të magazinimit të përkohshëm duhet të jepet një garanci. Shuma e garancisë që duhet të depozitohet, në asnjë rast nuk duhet të jetë më e vogël sesa 4 milionë Lekë. Bën përjashtim vetëm rasti kur ambientet e magazinimit të përkohshëm

administrohen nga ente publike ose shtetërore, të cilat nuk është e nevojshme të depozitojnë një garanci të tillë. Garancia duhet të depozitohet përpara se të lëshohet autorizimi. Në këto raste zbatohet neni 207(2) i Kodit.

3. Kërkesa me shkrim për autorizim sipas paragrafit 1, duhet të nënshkruhet nga personat e interesuar dhe të depozitohet në zyrën doganore kompetente për vendin ku ndodhet ambienti i magazinimit të përkohshëm. Kjo zyrë brenda 2 javësh, duhet t'ia kalojë kërkesën Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave së bashku me mendimin e tyre me shkrim përpara i përket dhënies së autorizimit.

Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin dhe adresën e kërkuarit;
- b) informacion lidhur me aktivitetin kryesor të biznesit të kërkuarit;
- c) numrin e parashikuar të dërgesave për një vit;
- d) numrin e të punësuarve;
- e) përshkrimin e regjistrave të magazinës;
- f) kopje të vërtetuara të dokumentave të regjistrimit të shoqërisë;
- g) hartë, skicë, ose tregues të ngjashëm të vendodhjes së ambientit dhe kufijve.

4. Autorizimi lëshohet për një afat kohor prej 1 viti për çdo herë dhe me kushtet e parashikuara në autorizim.

5. Administruesi i ambienteve të magazinimit të përkohshëm duhet të përmbushë gjithë kushtet dhe rregullat e parashikuara në autorizim në lidhje me kontrollin doganor, çlirimin e mallrave, regjistrat e magazinës dhe rregulla të tjera. Nëse administruesi i ambienteve të magazinimit të përkohshëm nuk përmbush gjithë kushtet e parashikuara në autorizim, atij i shfuqizohet menjëherë autorizimi dhe gjithë mallrave të ruajtura u caktohet menjëherë një destinacion doganor.

6. Një prej kushteve që duhet të plotësojë mbajtësi

është krijimi i kushteve të punës për autoritetet doganore kur ata vijnë për kontroll, pa asnjë shpenzim nga këto të fundit. Këto ambiente, duhet të plotësojnë standardet e përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

7. Për çdo autorizim paguhet një tarifë, në shumën 400.000 Lekë për çdo periudhë 1 vjeçare, në mënyrë që të mbulojë shpenzimet administrative për autoritetet doganore.

Neni 114

Mallrat vendosen në ambientet e magazinimit të përkohshëm në bazë të deklaratës përmbledhëse. Megjithatë, autoritetet doganore mund të kërkojnë paraqitjen e një deklarate të veçantë, hartuar në një formë e cila korrespondon me modelin që ata kanë përcaktuar.

Neni 115

Administruesi i ambienteve të magazinimit të përkohshëm duhet të kryejë inventar të rregullt për gjithë mallrat e ruajtura atje. Inventaret duhet të bëhen të paktën një herë në çdo 3 muaj. Autoritetet doganore duhet të jenë të pranishme ndërsa bëhet inventari. Rezultati me shkrim duhet t'i dërgohet zyrës kompetente doganore brenda 3 ditësh pas inventarit. Ky nen zbatohet *mutatis mutandis* në ambiente të magazinimit të përkohshëm të administruara nga autoritetet doganore.

Neni 116

Pa rënë ndesh me nenin 81 të Kodit, ose me dispozitat që zbatohen për shitjen e mallrave nga autoritetet doganore, personi i cili ka bërë deklaratën përmbledhëse, ose në rastet kur një deklaratë e tillë nuk është paraqitur ende, personi i përmendur në nenin 69 (2) të Kodit, është përgjegjës për zbatimin e masave të marra nga autoritetet doganore në përputhje me nenin 78 (1) të Kodit dhe për mbulimin e shpenzimeve lidhur me këto masa.

Neni 117

Shitja e mallrave nga autoritetet doganore në rastet e parashikuara në përputhje me nenin 78 të Kodit kryhet në bazë të dispozitave në fuqi.

TITULLI IX

MALLRAT E FALSIFIKUARA DHE MALLRAT PIRATE

KREU 1

Kërkesa për veprim nga Autoritetet Doganore

Për qëllim të nenit 118 deri 120⁶:

- a) "Mallra të falsifikuara" do të thotë:
 - i) mallrat, duke përfshirë edhe ambalazhin e tyre, mbi të cilat është vendosur pa

autorizim një markë tregtare, identike me atë që është regjistruar rregullisht për të njëjtat lloje mallrash, ose që në thelb është e padallueshme nga kjo markë tregtare, dhe gjë që, në bazë të legjislacionit në fuqi, përbën shkelje të të drejtave të mbajtësit të markës në fjalë,

- ii) çfarëdo shenje tjetër identifikuese (stemë, etiketë, etiketa vetëngjitëse, fletëpalosje, fletë ilustruese, dokument garancie), edhe nëse paraqiten veçmas, dhe që janë në të njëjtën gjëndje me mallrat e përmendura në nënparagrafin (i),

⁶ Shiko nenin 2(5). Ky tekst është rishikuar këtu për lehtësi përdorimi të termave të përkufizuar.

iii) ambalazhet mbi të cilët janë shënuar markat e mallrave të falsifikuara të paraqitura veçmas, që janë në të njëjtën gjendje me mallrat e përmendura në (i);

- b) "*Mallra pirate*" do të thotë: mallra që janë ose përmbajnë kopje të bëra pa pëlqimin e mbajtësit të së drejtës së autorit apo të ndonjë të drejtë të ngjashme me të, ose të mbajtësit të së drejtës së modelimit, nëse këto janë regjistruar ose jo sipas legjislacionit kombëtar, ose të një personi të autorizuar në mënyrën e duhur nga mbajtësi i së drejtës në vendin e prodhimit, nëse berja e këtyre kopjeve përbën shkelje të së drejtës në fjalë, në bazë të legjislacionit shqiptar që rregullon fushën përkatëse;
- c) "*Mbajtësi i së drejtës*" do të thotë: mbajtësi i një marke tregtare që përmendet në paragrafin (a), dhe/ose të njëjës prej të drejtave që përmenden në paragrafin (b), ose dhe çdo person tjetër i autorizuar të përdorë markën tregtare dhe/ose të drejtat, ose përfaqesimin e mbajtësit;
- d) "*Deklaratë për vendosje në qarkullim të lirë, eksport ose riekспорт*" do të thotë: deklaratat e bëra në përputhje me neni 86 të Kodit;

Quhen mallra të falsifikuara ose pirate, sipas rastit, edhe çdo stampë ose matricë e projektuar posaçërisht ose e përshtatur për fabrikimin e një marke të falsifikuar ose të një malli që mban këtë markë ose për fabrikimin e një malli pirat në rastet kur përdorimi i këtyre stampave ose matricave përbën shkelje të së drejtës të mbajtësit të së drejtës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 118

Ky Kre përcakton dispozitat për zbatimin e nenit 82 (4) të Kodit.

Neni 119

1. Mbajtësi i së drejtës mund të paraqesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave një kërkesë me shkrim, mbi bazën e së cilës autoritetet doganore mund të ndërhyjnë, kur mallrat e falsifikuar ose pirate, ndodhen në një nga situatat e mëposhtme:

- janë vendosur në qarkullim të lirë, janë eksportuar ose riekспортuar;
- janë vendosur në regjimin e tranzitit doganor ose në një regjim doganor ekonomik.

2. Kërkesa e përmendur në paragrafin 1 përmban:

- një përshkrim të mjaftueshëm të mallrave, në atë masë që t'u mundësojë autoriteteve doganore të bëjnë identifikimin;
- periudhën kur kërkohet ndërhyrja e autoriteteve doganore;
- çdo informacion tjetër të dobishëm për identifikimin e eksportuesit ose importuesit.

Kërkesa duhet të shoqërohet edhe nga dokumentacioni në të cilin vërtetohet që kërkesi është mbajtësi i të drejtës për mallrat në fjalë, si dhe gjithë të dhënat e nevojshme për identifikimin e këtyre mallrave.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave pasi të ketë shqyrtuar kërkesën, merr një vendim, i cili i njoftohet kërkesit brenda 5 ditësh, në përputhje me nenin 18 të Kodit. Kundër këtij vendimi, kërkesi mund të paraqesë ankesë sipas procedurave të përcaktuara në nenin 19(4) dhe 20(5) të Kodit. Në rastet kur kërkesa pranohet, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave fikson kohën brenda të cilës autoritetet doganore mund të ndërhyjnë. Afati i mësipërm mund të shtyhet mbi bazën e kërkesës së shprehur të mbajtësit të së drejtës. Vendimi për pranimin e kërkesës së mbajtësit të së drejtës, i njoftohet menjëherë gjithë zyrtarëve doganore.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të vendosë që, me pranimin e kërkesës, kërkesi të parapaguajë një shumë për të mbuluar çdo shpenzim administrativ që do të kryhet gjatë përmbushjes së shërbimit nga administrata doganore, shumë e cila është objekt rishqyrtimi.

5. Mbajtësi i së drejtës duhet të njoftojë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në çdo rast që të drejtat e tij mbi mallin pushojnë së qeni të vlefshme ose kjo e drejtë nuk është më e regjistruar rregullisht, apo skadon.

KREU 3

Procedura e kontrollit

Neni 120

1. Kur autoritetet doganore vërtetojnë, pas këshillimit me kërkesin, nëse një gjë e tillë është e nevojshme, se mallrat, ose një pjesë e tyre, të përmendura në paragrafët 1(a) dhe (b) të nenit 119, i korrespondojnë përshkrimit të mallrave të falsifikuar ose pirate, që përmbahet në vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ata duhet të pezullojnë çlirimin e mallrave, ose t'i sekuestrojnë mallrat në varësi të situatës.

2. Autoritetet doganore duhet të informojnë menjëherë kërkesin për veprimet e ndërmarra. Në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e sekretit profesional, tregtar dhe industrial, autoritetet doganore njoftojnë mbajtësin e së drejtës edhe për emrin dhe adresën e deklaruesit, dhe kur dihet, edhe emrin e marrësit të mallrave, me qëllim që t'i mundësojë kërkesit të ndërmarrë procedurën ligjore të parashikuar nga ligji për këtë fushë. Autoritetet doganore i japin mundësi kërkesit që të kontrollojë mallrat e sekuestruara ose çlirimi i të cilave është pezulluar.

3. Nëse brenda 20 ditësh nga dita e njoftimit për sekuestrimin e mallrave, ose vendimin për pezullimin e çlirimit të mallrave, autoritetet doganore nuk marrin një kopje të apelimit të bërë pranë autoriteteve kompetente të paraqitur nga mbajtësi i të drejtës, autoritetet doganore

shfuqizojnë vendimin për pezullimin e çlirimit ose sekuestrimin të mallrave dhe i çlirojnë ato.

4. Kërkuuesi është përgjegjës për çdo dëm të

mundshëm që mund t'i shkaktohet importuesit ose një pale të tretë. Ai duhet gjithashtu të parapaguajë edhe të gjitha shpenzimet e mundshme lidhur me magazinimin e mallrave.

TITULLI X

DEKLARATA DOGANORE

KREU 1

Deklarata Doganore me shkrim

Seksioni 1

Dispozita të përgjithshme

Neni 121

1. Në rastet kur deklarimi në doganë bëhet për më shumë se një artikull, të dhënat e veçanta lidhur me secilin artikull përbëjnë një deklaratë me vete.

2. Mallrat të cilat klasifikohen nën të njëjtin pozicion tarifor, kanë origjinën nga i njëjti vend dhe importohen në të njëjtat kushte përsa i përket trajtimit tarifor preferencial dhe kufizimeve, duhet të vendosen së bashku si një artikull i vetëm.

3. Pjesët përbërëse të komplekseve industriale që klasifikohen në një kod të vetëm të nomenklaturës së kombinuar, do të konsiderohen se formojnë një artikull të vetëm.

Neni 122

Pa rënë ndesh me zbatimin e mundshëm të dispozitave penale, depozitimi pranë një zyre doganore i një deklarate të firmosur nga deklaruesi ose përfaqësuesi i tij e bën atë përgjegjës në përputhje me normat në fuqi, sidomos për:

- a) saktësinë e informacionit të paraqitur në deklaratë;
- b) vërtetësinë e dokumentave që i bashkëngjiten deklaratës; dhe
- c) përmbushjen e të gjithë detyrimeve që lidhen me vendosjen e mallrave në fjalë nën regjimin përkatës.

Neni 123

Dokumentet shoqëruese të deklaratës doganore mbahen nga autoritetet doganore përveç rasteve kur prej vetë këtyre autoriteteve parashikohet ndryshe.

Neni 124

1. Deklarata depozitohet në zyrën doganore në të cilën paraqiten mallrat. Ajo mund të depozitohet sapo kryhet paraqitja sipas nenit 12 të Kodit.

2. Autoritetet doganore mund të autorizojnë që deklarata të depozitohet para se deklaruesi të jetë në gjendje të paraqesë mallrat. Në këtë rast, duke patur parasysh rrethanat, autoritetet doganore

mund të vendosin një kufi kohor për paraqitjen e mallrave. Në rast se mallrat nuk paraqiten brenda këtij kufiri kohor, deklarata konsiderohet si e pa depozituar.

3. Në rastet kur deklarata është depozituar përpara se mallrat të cilëve u referohet të kenë mbërritur në zyrën doganore ose në ndonjë vend tjetër të caktuar nga autoritetet doganore, ajo pranohet vetëm pasi mallrat në fjalë të jenë paraqitur në doganë.

Neni 125

1 Deklarata depozitohet pranë zyrës doganore kompetente gjatë ditëve dhe orëve në të cilat kjo zyrë është e hapur. Megjithatë, autoritetet doganore, me kërkesën dhe shpenzimet e deklaruesit, mund të autorizojnë depozitimin e deklaratës në ditë dhe orë të ndryshme nga ato në të cilat zyra është e hapur.

2. Paraqitja e deklaratës doganore pranë punonjësve të të njëjtës zyre doganore në një vend tjetër të caktuar për këtë qëllim është e barazvlefshme me depozitimin e deklaratës doganore në këtë zyrë doganore, kur një gjë e tillë parashikohet me marrëveshje midis autoriteteve doganore dhe personit të interesuar.

Neni 126

1. Data e pranimit të deklaratës shënohet në deklaratë.

2. Data e pranimit të deklaratës për një deklaratë me mjete informatike është data në të cilën deklarata i është transferuar në një formë të lexueshme sistemit të informatizuar të autoriteteve doganore.

Neni 127

1. Autoritetet doganore mund të lejojnë ose të kërkojnë që korrigjimet e përmendura në nenin 90 të Kodit të bëhen nëpërmjet depozitimit të një deklarate të re që zëvendëson deklaratën fillestare. Në këtë rast, data që merret në konsideratë për përcaktimin e çdo detyrimi që duhet paguar ose për zbatimin e çdo dispozite që rregullon regjimin doganor në fjalë është data e pranimit të deklaratës fillestare.

2. Në rast se autoritetet doganore pranojnë depozitimin e një deklarate të re, të gjitha kopjet e deklaratës së vjetër duhet të mbahen në të njëjtin fashikull bashkë me deklaratën e re. Në deklaratën e re duhet të shënohet qartë arsyeja për të cilën

është shfuqizuar deklarata e mëparshme. Këto shënime duhet të përmbajnë edhe vendimin e autoriteteve doganore për të shfuqizuar deklaratën.

Neni 128

Pa rënë ndesh me zbatimin e ndonjë dispozite penale, në rast se deklaruesi ose përfaqësuesi i tij konstaton se të dhënat e pasqyruara në një deklaratë doganore mbi një import ose eksport mallrash janë të pasakta ose të paplota, ai duhet të njoftojë pa vonesë autoritetet kompetente doganore përkatëse. Në këto raste zbatohet neni 90 i Kodit.

Neni 129

Duke anashkaluar nenin 91 (2) të Kodit, një deklaratë doganore mund të zhvleftësohet edhe pasi mallrat të jenë çliruar, me kusht që:

1. Kur vërtetohet se mallrat kanë qenë deklaruar gabim në vend të mallrave të tjerë për një regjim doganor për të cilin duhen paguar detyrime importi, Autoritetet doganore do ta zhvleftësojnë deklaraten nëse kërkesa për një gjë të tillë është bërë brenda tre muajve nga data e pranimit të deklarates me kusht që:

a) mallrat që fillimisht janë deklaruar:

i) nuk kanë qenë përdorur përveçse në gjendjen e tyre fillestare dhe të autorizuar; dhe

ii) janë rikthyer në gjendjen e tyre fillestare; dhe që

b) mallrat të cilat duhej të ishin deklaruar për regjimin doganor që synohej fillimisht:

i) mund, kur deklarata doganore fillestare është depozituar, të kenë qenë paraqitur në të njëjtën zyrë doganore, dhe

ii) të kenë qenë deklaruar për të njëjtin regjim doganor që synohej fillimisht.

Autoritetet doganore mund të lejojnë që afati i parashikuar më sipër të shtyhet vetëm në raste përjashtimore dhe të motivuara në mënyrën e duhur.

2. Kur mallrat janë deklaruar për eksport ose për regjimin e përpunimit pasiv, deklarata zhvleftësohet me kusht që zyra doganore eksportuese ka marrë informacion në përputhje me nenin 437 se mallrat e deklaruar nuk janë larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë me kusht që:

(i) deklaruesi vë në dispozicion të zyrës doganore provat se mallrat nuk janë larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

(ii) deklaruesi kthen në zyrën në fjalë të gjitha kopjet e deklarates doganore, së bashku me çdo dokument që i është lëshuar atij me pranimin e deklarates,

(iii) deklaruesi, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përmbush çdo detyrim të

përcaktuar nga zyra doganore eksportuese për të rregulluar situatën e mallrave.

Zhvleftësimi i deklarates do sjellë anulimin e çdo rregullimi të bërë në një licensë eksporti ose certifikatë rregulluese-paraprake që prezantohet në mbështetje të deklarates. Kur mallrat e deklaruar për eksport kërkohen të largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë brenda një kufiri kohor të përcaktuar, mos respektimi i këtij afati kohor do të sjellë zhvleftësimin e deklarates përkatëse.

3. Për sa i përket rieksporimit të mallrave që kërkon depozitimin e një deklarate, paragrafi 1 më sipër do të zbatohet *mutatis mutandis*.

Seksioni 2

Formularët që përdoren

Neni 130

1. Modeli zyrtar që do të përdoret për deklaratat doganore me shkrim, për vendosjen e mallrave në një regjim doganor ose për rieksporimin e tyre në përputhje me nenin 197(3) të Kodit, është Dokumenti Administrativ i Vetëm (DAV).

2. Për të njëjtin qëllim mund të përdoren formularë të tjerë, në rastet kur dispozitat e regjimit doganor në fjalë lejojnë një gjë të tillë.

3. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk përjashtojnë:

a) mos bërjen e një deklarate me shkrim, përshkruar nga neni 150 deri 161 për vendosjen në qarkullim të lire, eksport, ose lejim të përkohshëm;

b) mos përdorimin e formularit të përmendur në paragrafin 1, në bazë të dispozitave në fuqi, kur zbatohen dispozita të veçanta të përcaktuara në nenin 60(1) dhe 61 të Kodit mbi dërgimin e letrave dhe pakove postare;

c) përdorimin e formularëve të veçantë për të lehtësuar deklarimin në raste të caktuara, kur e lejon Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

d) mos përdorimi i formularit të parashikuar në paragrafin 1, në rastet e marrëveshjeve ekzistuese ose të marrëveshjeve që mund të bëhen në të ardhmen, ose të marrëveshjeve të arritura mes Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera, për të thjeshtëzuar më tej plotësisht ose pjesërisht formalitetet tregtare mes dy vendeve;

e) përdorimin nga të interesuarit të listës së ngarkesës për kryerjen e formaliteteve në fuqi mbi tranzitin, në rastet e dërgesave të përbëra nga më shumë se një lloj malli;

f) shtypjen e deklarave të eksportit, tranzitit ose importit dhe dokumentave të cilat verifikojnë statusin shqiptar të mallrave, të cilat nuk qarkullojnë nën regjimin e tranzitit, me anë të sistemeve të informatizuara private apo zyrtare, në kushtet e përcaktuara nga

dispozitat në fuqi, në rast se është e nevojshme edhe në letër të bardhë;

- g) parashikimin e një rregulli të veçantë, që kur përdoret një deklaratë e përpunuar në formë të informatizuar, deklarata në kuptimin e paragrafit 1, të mund të zëvendësohet nga Dokumenti Administrativ i Vetëm, i përfutur gjithashtu në formë të informatizuar.

4. Në çdo rast që formalitetet përmbushen duke përdorur kompjutera publikë ose privatë, të cilët shtypin gjithashtu edhe deklarata, autoritetet doganore mund të parashikojnë që:

- a) nënshkrimi i tyre me dorë të zëvendësohet me një teknikë identifikimi tjetër, e cila mund të bazohet në përdorimin e kodeve dhe që ka të njëjtën vlerë ligjore me nënshkrimin me dorë. Kjo lehtësi jepet vetëm në rast se përmbushen kushtet administrative dhe teknike të përcaktuara nga autoritetet kompetente;
- b) në vend të vendosjes mekanike ose me dorë të vulës së zyrës doganore dhe nënshkrimit nga personi zyrtar kompetent, deklaratat e prodhuara në këtë mënyrë mund të vërtetohen drejtpërdrejtë nga këto sisteme.

5. Në rast se legjislacioni në fuqi, i referohet një deklaratë eksporti, rieksperti, ose importi, ose një deklaratë për vendosjen e mallrave nën një regjim tjetër doganor, autoritetet doganore mund të kërkojnë vetëm dokumentet administrative të cilët:

- a) krijohen ose parashikohen shprehimisht prej legjislacionit shqiptar;
- b) kërkojnë në kuadrin e konventave ndërkombëtare;
- c) kërkojnë nga operatorët për t'i lejuar të cilësohen, në bazë të kërkesës së tyre, për një përfitim ose lehtësi të caktuar;
- d) kërkojnë, në kuadrin e dispozitave të caktuara, të cilat nuk mund të zbatohen vetëm nëpërmjet përdorimit të dokumentit të përmendur në paragrafin 1.

Neni 131

Pa rënë ndesh me nenin 130(3), administrata doganore me qëllim plotësimin e formaliteteve të eksportit ose importit, mund të mos kërkojë paraqitjen e një ose më shumë kopjeve të dokumentit administrativ të vetëm, hartuar për përdorim nga autoritetet publike, me kusht që ky informacion të jetë i gjendshëm edhe në burime të tjera.

Neni 132

1. Dokumenti Administrativ i Vetëm paraqitet në fashikuj që përmbajnë gjithë kopjet e parashikuara për përmbushjen e formaliteteve të regjimit doganor nën të cilin do të vendosen mallrat.

2. Kur regjimi i tranzitit paraprihet ose ndiqet nga një regjim tjetër doganor, mund të paraqitet një

fashikull që përmban edhe kopjet e parashikuara për përmbushjen e formaliteteve që lidhen me regjimin e tranzitit dhe me regjimin paraprirës ose vijues të tij.

3. Fashikujt e përmendur në paragrafin 1 dhe 2 merren nga një bashkësi prej tetë kopjesh, në përputhje me modelin që përshkruhet në Aneksin 9

4. Pa rënë ndesh me nenin 130(3), 147 deri 149 formularët e deklaratave, kur është rasti, mund të plotësohen me një ose më shumë formularë plotësues të paraqitur në fashikuj, të cilët përmbajnë kopjet e deklaratës të parashikuara për përmbushjen e formaliteteve për regjimin doganor nën të cilin do të vendosen mallrat. Këtyre kopjeve, kur është rasti, mund t'i bashkëngjiten kopjet e parashikuara për përmbushjen e formaliteteve lidhur me regjimet doganore paraprirës ose vijuese.

Këto fashikuj merren nga një bashkësi e plotë prej tetë kopjesh, sipas modelit që përshkruhet në Aneksin 10

Formularët plotësues janë pjesë përbërëse e dokumentit administrativ të vetëm, të cilit i referohen.

5. Duke anashkuar paragrafin 4, në rastet kur është përdorur një sistem informatik për plotësimin e deklaratave, autoritetet doganore mund të vendosin që formularët plotësues të mos përdoren.

Neni 133

1. Në rastet kur zbatohet neni 132(2), secila prej palëve pjesëmarrëse ka përgjegjësi vetëm për sa i përket të dhënave lidhur me regjimin që ajo ka kërkuar me cilësinë e deklaruesit, e përgjegjësit kryesor, ose të përfaqësuesit të njëres apo tjetres palë.

2. Për qëllim të paragrafit 1, në rastet kur deklaruesi përdor një dokument administrativ të vetëm, të lëshuar gjatë regjimit doganor paraprirës, atij duhet t'i kërkojë, përpara se të depozitojë deklaratën doganore të verifikojë saktësinë e të dhënave ekzistuese në kutitë për të cilat ai është përgjegjës dhe përdorimin e tyre për mallrat në fjalë dhe për regjimin e kërkuar, dhe t'i plotësojë ato nëse është e nevojshme. Në rastet e përmendura në fjalë e mësipërme, deklaruesi duhet të informojë menjëherë zyrën doganore në të cilën është depozituar deklarata, kur vëren se ka ndryshime ndërmjet mallrave në fjalë dhe të dhënave ekzistuese në dokument. Në këtë rast, deklaruesi duhet ta përpilojë deklaratën në kopjet e reja të Dokumentit Administrativ të Vetëm.

Neni 134

Në rastet kur Dokumenti Administrativ i Vetëm bëhet për disa regjime doganore të njëpasnjëshme, Autoritetet Doganore duhet të sigurohen mbi përputhshmërinë e të dhënave të veçanta të reguara në deklaratat përkatëse të regjimeve të ndryshme në fjalë.

Neni 135

1. Deklarata hartohet në gjuhën shqipe, me përjashtim të rastit kur deklarata bëhet në kuadrin e konventave ndërkombëtare.

2. Në rastet e deklaratave në kuadrin e konventave ndërkombëtare, autoritetet doganore shqiptare mund t'i kërkojnë deklaruesit ose përfaqësuesit të tij një përkthim të deklaratës në shqip.

Neni 136

1. Dokumenti Administrativ i Vetëm duhet të plotësohet në përputhje me shënimet shpjeguese në Aneksin 12.

2. Autoritetet doganore marrin të gjitha masat për të siguruar që përdoruesit të kenë mundësi njohjeje me shënimet shpjeguese të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 137

Për të plotësuar formularin e përmendur në nenin 130(1), përdoren kodet e pasqyruara në Aneksin 13.

Neni 138

1. Në rastet kur rregullat kërkojnë përdorimin e kopjeve shtesë të formularëve të përmendur në nenin 130(1), deklaruesi për këtë qëllim mund të përdorë fletë shtesë ose fotokopje të formularit në fjalë.

2. Këto kopje shtesë dhe fotokopje duhet të nënshkruhen nga deklaruesi, t'i paraqiten autoriteteve doganore dhe të pranohen, firmosen dhe vulosen nga këto të fundit në të njëjtat kushte që zbatohen edhe për Dokumentin Administrativ të Vetëm. Ato pranohen nga autoritetet doganore sikur të ishin origjinale, me kusht që cilësia dhe lexueshmëria të konsiderohen të kënaqshme nga autoritetet në fjalë.

Neni 139

1. Formularët e përmendur në nenin 130(1) shtypen në letër vetkopjuese me peshë të paktën 40 g/m². Letra duhet të jetë e patejdukshme në masën që informacioni i shkruar në njërin anë të mos çënojë lexueshmërinë e anës tjetër dhe të jetë e qëndrueshme në masën që të rrudhoset ose të mos griset lehtë.

2. Letra duhet të jetë në ngjyrë të bardhë për të gjitha kopjet. Megjithatë, në kopjet e përdorura për tranzit (1, 4, 5 dhe 7) kutia 1 (nëndarja e parë dhe e tretë), 2, 3, 4, 5, 6, 8, 15, 17, 18, 19, 21, 25, 27, 31, 32, 33 (nëndarja e parë në të majtë), 35, 38, 40, 44, 50, 51, 52, 53, 55 dhe 56 duhet të jenë në fushë të gjelbër.

3. Formulari duhet të shtypet në ngjyrë të gjelbër.

4. Kutitë bazohen në një njësi matëse që i korrespondon 1/10 inch horizontalisht dhe 1/5 inch vertikalisht. Nëndarjet bazohen në njësi matëse prej 1/10 inch horizontalisht.

5. Në formularët sipas modelit të treguar në Aneksin 9 dhe 10 do të vendoset një shenjë dalluese me ngjyrë për secilën nga kopjet e ndryshme që përdoren, si vijon::

- a) kopjet 1, 2, 3 dhe 5 do të kenë në anën e djathtë një shirit të pa ndërprerë, përkatësisht të ngjyrosur me të kuqe, të gjelbër, të verdhë dhe blu,
- b) kopjet 4, 6, 7 dhe 8 duhet të kenë në anën e djathtë një shirit të ndërprerë, të ngjyrosur përkatësisht me blu, të kuqe, të gjelbër dhe të verdhë;

6. Gjerësia e këtyre shiritave duhet të jetë afërsisht 3 mm. Shiriti i ndërprerë do të përbëhet prej një varg katrorësh me brinjë 3mm dhe me një largësi nga njëri-tjetri prej 3 mm.

7. Në Aneksin 11 tregohen kopjet, në të cilat të dhënat që përmbahen në formularët e treguar në Aneksin 9 dhe 10 duhet të vetkopjohen.

8. Formularët duhet të kenë përmasat 210 x 297 mm. Tolerancat duhet të jetë të tilla që përmasat të mos shkurtohen më shumë se 5 mm dhe të mos zgjaten më shumë se 8 mm.

9. Formulari duhet të tregojë emrin dhe adresën e shtypësit ose një markë që e bën atë të identifikueshëm. Shtypja e Dokumentit Administrativ të Vetëm bëhet duke iu nënshtruar paraprakisht miratimit teknik të formularëve nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Seksioni 3

Të dhënat e veçanta që nevojiten sipas regjimit doganor të parashikuar

Neni 140

Lista e kutive që duhet të mbushen për një deklaratë për vendosjen e mallrave në një regjim të caktuar doganor në rastet e përdorimit të dokumentit të vetëm administrativ pasqyrohet në Aneksin 12.

Neni 141

Të dhënat e veçanta që nevojiten kur përdoret njëri prej formularëve të cilëve i referohet nenit 81(2) pasqyrohen po aty dhe plotësohen, sipas rastit, në përputhje me dispozitat lidhur me regjimin doganor në fjalë.

Seksioni 4

Dokumentet që shoqërojnë deklaratën doganore

Neni 142

1. Dokumentet që i bashkëngjiten deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë janë si vijon:

- a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, e cila duhet të paraqitet sipas nenit 80;

- b) dokumentet e nevojshme për zbatimin e regjimit tarifor preferencial ose çdo masë tjetër për të cilën nuk zbatohen rregullat normative të zbatueshme për mallrat e deklaruarat;
- c) gjithë dokumentet e tjera të nevojshme për zbatimin e dispozitave që rregullojnë vendosjen në qarkullim të lirë të mallrave të deklaruarat.

2. Autoritetet doganore në momentin e depozitimit të deklarates mund të kërkojnë paraqitjen e dokumenteve të transportit ose kur është rasti, paraqitjen e dokumenteve që lidhen me regjimin doganor të mëparshëm.

3. Kur një artikull i vetëm paraqitet në dy ose më shumë koli, autoritetet doganore mund të kërkojnë edhe paraqitjen e një liste paketimi ose të një dokumenti të barazvlefshëm që tregon përmbajtjen e secilës prej kolive.

4. Megjithatë, mund të mos kërkojnë dokumentet e përshkruara në paragrafin 1(c) të këtij neni, kur bëhet fjalë për mallra që kualifikohen për detyrimet doganore sipas nenit 104 të Kodit.

5. Gjithashtu, kur bëhet fjalë për mallra që përjashtohen nga detyrimi doganor i importit, dokumentet e përmendura në paragrafin 1(a) dhe (c) nuk duhet të kërkojnë përveç rasteve kur autoritetet doganore e konsiderojnë të panevojshme të kërkojnë këto dokumente për qëllim të zbatimit të dispozitave që rregullojnë vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë.

Neni 143

1. Për ta pasur të plotë informacionin e kërkuar në një deklaratë doganore, fatura e kërkuar sipas nenit 142(1)(a), me përjashtim të rasteve kur Autoritetet Doganore duke pasur parasysh rrethanat nuk e kërkojnë atë, duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin dhe adresën e shitësit;
- b) emrin dhe adresën e blerësit;
- c) datën e lëshimit;
- d) numrin e kolive, natyrën e tyre dhe shenjat numrat që ato mbajnë;
- e) peshën bruto;
- f) llojin e mallrave dhe sasinë e çmimit për çdo lloj malli;
- g) zbritje të mundshme dhe llojin e zbritjes, si dhe kushtet e lëvrimit.

2. Në rast se të dhënat mbi kolitë nuk pasqyrohen në faturë, faturës i bashkëngjitet një listë paketimi.

3. Autoritetet doganore, nëse është e nevojshme, mund të kërkojnë që informacioni i paraqitur në faturë të përkthehet me shkrim në gjuhën shqipe.

Neni 144

1. Deklarata e tranzitit shoqërohet nga dokumenti i transportit. Autoritetet doganore të zyrës së nisjes mund të mos kërkojnë paraqitjen e këtij dokumenti në çastin e përmbushjes së formaliteteve. Megjithatë, gjatë transportit, dokumenti përkatës i transportit duhet t'u paraqitet me kërkesë të zyrës doganore, ose të çdo autoriteti tjetër kompetent.

2. Pa rënë ndesh me masa thjeshtëzuese që mund të zbatohen, dokumenti doganor i eksportit/dërgimit ose i rieksporit të mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ose çdo dokument me efekt të barazvlefshëm për sa më sipër, duhet të paraqitet në zyrën e nisjes bashkë me deklaratën përkatëse të tranzitit.

3. Kur është rasti, autoritetet doganore mund të kërkojnë paraqitjen e dokumentit që lidhet me regjimin doganor të mëparshëm.

Neni 145

1. Dokumentet që i bashkëngjiten deklaratës për vendosjen nën një regjim doganor ekonomik, me përjashtim të regjimit të përpunimit pasiv, janë si vijon:

- a) dokumentet e përshkruara në nenin 142;
- b) autorizimi për regjimin doganor në fjalë ose një kopje të kërkesës përkatëse kur zbatohet paragrafi 2 i nenit 278(1), me përjashtim të rasteve të vendosjes nën regjimin e magazinimit doganor ose kur zbatohet nenet 284(3) ose 366(3);

2. Dokumentet që shoqërojnë deklaratën për vendosjen nën regjimin e përpunimit pasiv janë si vijon:

- a) dokumentet e përshkruara në nenin 146;
- b) autorizimi për regjimin ose një kopje të kërkesës përkatëse ku zbatohet nënparagrafi 2 i nenit 406(3), me përjashtim të rasteve kur zbatohet neni 414(2).

3. Për deklaratat për vendosjen nën një regjim doganor ekonomik zbatohet neni 142(2).

4. Autoritetet doganore mund të lejojnë që ndonjë prej dokumenteve të përmendura në paragrafin 1(b) dhe 2(b) të mos shoqërojnë deklaratën doganore por të ruhen nga personi i interesuar për t'i vënë në dispozicion të autoriteteve doganore sa herë që këto të fundit e kërkojnë një gjë të tillë.

Neni 146

1. Deklaratës së eksportit ose rieksporit duhet t'i bashkëngjiten të gjitha dokumentet e nevojshme për zbatimin e saktë të detyrimeve të eksportit dhe të dispozitave që rregullojnë eksportin e mallrave në fjalë.

2. Për deklaratat e eksportit ose rieksporit duhet të zbatohet neni 142(2).

KREU 2*Deklaratat doganore me mjete informatike**Neni 147*

1. Autoritetet doganore mund të autorizojnë deklaruesin që në përputhje me nenin 86(b) të Kodit, të zëvendësojë tërësisht ose pjesërisht të dhënat e deklaratës me shkrim të parashikuara në Aneksin 12 me dërgimin në zyrën doganore të caktuar për këtë qëllim të të dhënave të kodifikuara ose të paraqitura në çdo formë tjetër të caktuar nga këto autoritete dhe që përputhen me të dhënat e kërkuara për deklaratat me shkrim, për t'u përpunuar me mjete informatike.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përcakton kushtet në të cilat duhet të dërgohen të dhënat e përmendura në paragrafin 1 më sipër.

Neni 148

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të autorizojë përdorimin e mjeteve informatike, ndër të tjera (*inter alia*) edhe në mënyrat që vijojnë:

- a) të kërkojnë që të dhënat e nevojshme për kryerjen e formaliteteve në fjalë të futen në sistemet e tyre informatike të përpunimit të deklaratave, pa kërkuar deklarata me shkrim;
- b) të parashikojnë që deklarata në kuadrin e nenit 130(1), të përbëhet nga futja e të dhënave në sistemin e përpunimit, kur nuk është paraqitur ndonjë dokument që i korrespondon deklaratës.

Neni 149

1. Kur formalitetet kryen me sisteme informatike publike ose private, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i autorizon të interesuarit, mbi bazën e kërkesës së tyre, të zëvendësojnë nënshkrimin me dorë me një mjet identifikimi krahasues, i cili mund të bazohet në përdorimin e kodeve dhe që ka të njëjën vlerë ligjore me nënshkrimin me dorë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të autorizojë personat e interesuar të përpilojnë dhe dërgojnë me mjete informatike të gjitha ose një pjesë të dokumenteve mbështetëse të përmendura në nenin 142 deri 146.

3. Lehtësitë e përmendura në paragrafin 1 dhe 2 jepen vetëm kur plotësohen kushtet teknike dhe administrative të parashikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

KREU 3*Deklaratat doganore gojore ose me anë të ndonjë mënyre tjetër***Seksioni 1***Deklaratat gojore**Neni 150*

Deklaratat doganore për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë, mund të bëhen gojarisht për mallrat e mëposhtme:

a) mallra të natyrës jo tregtare:

- i) që ndodhen në bagazhet personale të udhëtarëve, ose
- ii) që i dërgohen personave privatë, ose
- iii) në raste të tjera, kur vlera e dërgesës është më e vogël se 5000 Lekë dhe mallrat lejohen të hyjnë pa kufizime, kur një gjë e tillë autorizohet nga autoritetet doganore.

b) mallra të natyrës tregtare me kusht që:

- i) vlera totale për çdo dërgesë dhe për çdo deklarues të mos kalojë 2000 Lekë,
- ii) dërgesa nuk është pjesë e një serie dërgesash të ngjashme, dhe
- iii) mallrat nuk transportohen nga një transportues i pavarur si pjesë përbërëse e një lëvizjeje më të gjerë mallrash;

c) mallrat e përmendura në nenin 145, në rastet kur ato plotësojnë kushtet për përjashtim nga detyrimet doganore si mallra të rikthyera;

d) mallrat e përmendura në nenin 155(b) dhe (c).

Neni 151

Deklaratat doganore mund të bëhen gojarisht për eksportimin e:

a) mallrave të natyrës jo tregtare :

- i) që ndodhen në bagazhet personale të udhëtarëve, ose
- ii) që i dërgohen personave privatë;

b) mallrave të përmendura në nenin 150(b);

c) mallrave të përmendura në nenin 156(b) dhe (c);

d) mallrave të tjera, në rastet me rëndësi ekonomike të papërfillshme, kur një gjë e tillë autorizohet nga autoritetet doganore.

Neni 152

1. Nenet 150 dhe 151 nuk zbatohen për rastet kur personi i cili kryen formalitetet doganore për mallrat, vepron për llogari të një personi tjetër në cilësinë e agjentit doganor.

2. Në rast se autoritetet doganore kanë dyshime përse i përket saktësisë së të dhënave të deklaruara ose nëse ato janë të plota ose jo, ato kërkojnë një deklarata me shkrim.

Neni 153

Në rastet kur mallrat e deklaruara gojarisht në përputhje me nenin 150 dhe 151 u nënshtrohen detyrimeve të importit ose të eksportit, autoritetet doganore i lëshojnë personit të interesuar një vërtetim kundrejt pagesës së detyrimeve përkatëse.

Neni 154

1. Deklaratat doganore mund të bëhen gojarisht

edhe për lejimin e përkohshëm të mallrave si më poshtë, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave:

a) i) kafshë dhe pajisje të paraqitura në listën e nenit 356,

ii) ambalazhet e paraqitura në listën e nenit 349,

iii) aparatura radio-televizive dhe pajisje transmetimi e automjete të përshtatura për përdorim për qëllimet e mësipërme dhe pajisjet e tyre të importuara nga organizata publike ose private, të vendosura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të miratuara nga autoritetet doganore nëpërmjet dhënies së një autorizimi për procedurën për të importuar të tilla pajisje dhe automjete,

iv) instrumente dhe pajisje që u nevojiten mjekëve për të dhënë ndihmën për pacientët në pritje për transplantim organesh, në përputhje me nenin 342 (2)(c).

b) mallrat e përmendura në nenin 157;

c) mallra të tjera, kur një gjë e tillë autorizohet nga autoritetet doganore.

2. Mallrat e përmendura në paragrafin 1 mund të jenë objekt i një deklarate gojore për riekспортim në mbyllje të regjimit të lejimit të përkohshëm.

Seksioni 2

Deklarata doganore e bërë me veprime të tjera

Neni 155

Kur nuk është thënë shprehimisht se duhet të deklarohen në doganë, konsiderohet se janë deklaruar për çlirim për qarkullim të lirë me anë të veprimit të cilit i referohet neni 158, mallrat e mëposhtëm:

a) mallrat e natyrës jo tregtare që ndodhen në bagazhet personale të udhëtarëve, të cilat përjashtohen nga detyrimet ose si mallra të rikthyera;

b) mjetet e transportit që përfitojnë përjashtim nga detyrimet si mallra të rikthyera;

c) mallrat e importuara në kuadrin e një shkëmbimi me vlerë ekonomike të papërfillshme dhe që përjashtohen nga detyrimi për t'u dërguar në një zyrë doganore sipas nenit 42 (3) të Kodit, me kusht që të mos i nënshtrohen detyrimit doganor të importit.

Neni 156

Kur nuk janë objekt i një deklarate të posaçme në doganë, konsiderohen të deklaruar për eksport nëpërmjet veprimit të përmendur në nenin 158(b) mallrat e mëposhtëm:

a) mallrat të natyrës jo tregtare që ndodhen në

bagazhet personale të udhëtarëve dhe që nuk i nënshtrohen detyrimit doganor të eksportit;

b) mjetet e transportit të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe të destinuara të riimportohen;

c) mallra të tjera, me rëndësi ekonomike të papërfillshme, kur një gjë e tillë autorizohet nga autoritetet doganore.

Neni 157

1. Kur nuk janë objekt i një deklarate doganore me shkrim ose me gojë, konsiderohen të deklaruar për lejim të përkohshëm nëpërmjet aktit të përmendur në nenin 158, në përputhje me nenet 368 dhe 394 mallrat e mëposhtëm:

a) sendet personale të udhëtarëve dhe mallrat e importuara për qëllime sportive të paraqitura në listën e nenit 354;

b) mjetet e transportit të paraqitura në listën e neneve 383 deri 390.

2. Kur nuk janë objekt i një deklarate me shkrim ose me gojë, mallrat e përmendura në paragrafin 1 konsiderohen të deklaruar për riekспортim, duke mbyllur regjimin e lejimit të përkohshëm nëpërmjet aktit të përmendur në nenin 106.

Neni 158

Për qëllim të zbatimit të neneve 155-157, veprimi që konsiderohet deklarate doganore mund të kryhet në format e mëposhtme:

a) në rastet kur mallrat dërgohen në një zyrë doganore ose në një vend tjetër të caktuar apo të miratuar në përputhje me nenin 42 (1) të Kodit:

i) duke përshkuar korsinë jeshile ose me shënimin "asgjë për të deklaruar", në zyrën doganore ku funksionon sistemi i korsive dyshe,

ii) duke kaluar nga një zyrë doganore, ku nuk funksionon sistemi i korsive dyshe pa bërë spontanisht një deklarate në doganë;

b) në rastet e përjashtimit nga detyrimi për të dërguar mallrat në doganë në përputhje me dispozitat e miratuara në zbatim të nenit 42(3) të Kodit, në rastin e eksportimit në përputhje me nenin 106 dhe në rastin e riekспортimit në përputhje me nenin 107(2), vetë veprimi i kalimit të kufirit të territorit doganor të Shqipërisë.

Neni 159

1. Kur përmbushen kushtet e përmendura në nenet 155-157, mallrat në fjalë konsiderohen se kanë qenë paraqitur në doganë në kuptimin e nenit 88 të Kodit, se deklarata përkatëse ka qenë pranuar dhe se është leja për çlirimin e mallrave, në kohën kur është kryer akti të cilit i referohet neni 158.

2. Në qoftë se nga një kontroll i kryer do të

rezultonte se është kryer akti i përmendur në nenin 158, por mallrat e importuara ose të nxjerra jashtë nuk përmbushin kushtet e neneve 155-157, këto mallra do të konsiderohen se janë importuar ose eksportuar në mënyrë të paligjshme.

Seksioni 3

Dispozita të përbashkëta për Seksionet 1 dhe 2

Neni 160

Nenet nga 150 deri në 157 nuk zbatohen për mallrat, për të cilat kërkohet rikthimi i pagesave ose i shumave të tjera ose rimbursimi i detyrimeve, ose të cilat i nënshtrohen masave ndaluese ose kufizuese apo ndonjë formaliteti tjetër të veçantë.

Neni 161

Për qëllim të seksioneve 1 dhe 2, "udhëtar" do të thotë personi i përmendur në nenin 63 të Kodit.

P J E S A II

DESTINACIONET DOGANORE

TITULLI I

VENDOSJA NË QARKULLIM TË LIRË

KREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 162

1. Vendosja në qarkullim të lirë e mallrave shqiptare të eksportuara përkohësisht me *Carnet ATA*, mund të kryhet në bazë të *Carnet ATA*.

2. Në këtë rast, zyra në të cilën mallrat çlirohen për t'u vendosur në qarkullim të lirë kryen formalitetet e mëposhtme:

- verifikon informacionin e dhënë në kutitë A deri G dhe fletën e ri-importimit;
- plotëson kondraletën dhe kutinë H të fletës së ri-importimit;
- mban fletën e ri-importimit.

KREU 2

Trajtimi tarifor favorizues për arsye të llojit të mallrave dhe për arsye të përdorimit të tyre të veçantë

Seksioni 1

Dispozita të përgjithshme

Neni 163

Në përputhje me pjesën II, kreu 1, neni 28 të Kodit, ky kre përcakton dispozitat për zbatimin e procedurave për trajtimin tarifor favorizues.

Seksioni 2

Trajtimi tarifor favorizues për arsye të natyrës së mallrave

Nëseksioni 1

Mallrat që i nënshtrohen kushtit të denatyrimit

Neni 164

Klasifikimi në nënkrerët tariforë të renditur në

kolonën 2 të tabelës së Aneksit 14, të mallrave të renditur përkrah çdo nënkreu në kolonën 3, i nënshtrohen kushtit të denatyrimit në mënyrë që mallrat të jenë të papërshtatshëm për konsum njerëzor, duke përdorur një nga denatyruesit e përmendur në kolonën 4, të cilët duhet të përdoren në sasi të përcaktuara në kolonën 5.

Neni 165

Denatyrimi kryhet në një mënyrë të tillë që të sigurojë se produkti që do të denatyrohet dhe lënda denatyruese janë përzier në mënyrë njëtrajtshme dhe nuk mund të ndahen përsëri në një mënyrë ekonomikisht të vlefshme.

Nëseksioni 2

Kushte për klasifikimin tarifor për disa tipe farërash

Neni 166

Klasifikimi, në nënkrerët tariforë të renditur në kolonën 2 të Aneksit 15, i mallrave të renditura përkrah çdo nënkreu në kolonën 3 i nënshtrohen kushteve të përcaktuara në nenin 167.

Neni 167

Farërat e patateve, misrit të ëmbël, misrit hibrid, orizit, melakuqit hibrid, farërat e tjera vajore dhe frutat me përmbajtje vajore nuk do të futen në nënkrerët e treguar në nenin 166 përveç rasteve kur personi i interesuar i provon autoriteteve doganore kompetente të Republikës së Shqipërisë se ato do të përdoren realisht për mbjellje.

Nëseksioni 3

Kushte për klasifikimin tarifor të roleteve me pëlhurë siç vijnë nga tezgjahu.

Neni 168

Klasifikimi tarifor i roleteve me pëlhurë siç vijnë nga tezgjahu, që klasifikohen sipas Nomenklaturës së Kombinuar në Kodin CN 59112000, do t'i nënshtrohen kushtit që në to të vendosen shenja si më poshtë. Përgjatë të dy anëve të copës, pa e

kaluar bordurën anësore të saj, duhet të vendoset në intervale të rregullta, një shenjë që konsiston në një drejtkëndësh bashkë me diagonalet e tij, në mënyrë të tillë që largësia ndërmjet dy shenjave të njëpasnjëshme matur ndërmjet dy brinjëve të brendshme të mos jetë më shumë se një metër dhe që shenjat e njërës anë të jenë vendosur në mënyrë të tillë që qendra e çdo shenje të jetë e barazlarguar nga qendrat e dy shenjave më të afërta të anës tjetër. Çdo shenjë duhet të vendoset në mënyrë të tillë që bazat e drejtkëndësive duhet të jenë paralele me anët e copës. (shiko ilustrimin në Aneksin 16). Trashësia e vijave që formojnë brinjët e drejtkëndëshit duhet të jetë 5 mm, dhe ajo e diagonaleve 7 mm. Përmasat e drejtkëndësive duhet të jenë të paktën 8 cm gjatësi dhe 5 cm gjerësi. Shenjat duhet të jenë të njëjtën ngjyrë e cila të bëjë kontrast me ngjyrën e copës dhe duhet të jenë të pafshishme.

Seksioni 3

Lejimi i mallrave me trajtim tarifar favorizues për arsye të përdorimit të tyre të veçantë

Neni 169

1. Vendosja e mallrave në qarkullim të lirë me trajtim tarifar favorizues për arsye të përdorimit të tyre të veçantë është objekt i lëshimit të një autorizimi me shkrim për personin që importon mallrat ose që i ka importuar ato për qarkullim të lirë. Në këto raste zbatohen *mutatis mutandis* nenet 109 dhe 110 të Kodit.

2. Autorizimi në fjalë lëshohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me kërkesë të personit të interesuar.

3. Kërkesa duhet të përmbajë, ndër të tjera, informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe adresën e kërkuarit;
- b) një përshkrim përmbledhës të impianteve që do të përdoren për kryerjen e trajtimeve të propozuara;
- c) llojin e trajtimit të propozuar;
- d) llojin dhe sasinë e mallrave që do të përdoren; dhe
- e) kur është rasti, llojin, sasinë dhe përshkrimin tarifar të mallrave të përfutuara. Personi i interesuar mundëson autoritetet doganore të identifikojnë mallrat në ambientin ose ambientet e tij gjatë gjithë procesit të përpunimit të tyre.

Neni 170

1. Autoritetet doganore mund të kufizojnë periudhën e vlefshmërisë së autorizimit të përmendur në nenin 169.

2. Kur autorizimi shfuqizohet, mbajtësi i autorizimit paguan menjëherë detyrimet e importit, të përcaktuara në përputhje me nenin 223 të Kodit, për ato mallra që nuk u është përcaktuar ende një

përdorim i veçantë.

Neni 171

Mbajtësi i autorizimit është i detyruar:

- a) t'i përdorë mallrat për qëllimin e caktuar;
- b) të mbajë regjistra për t'u mundësuar autoritetet doganore kryerjen e çdo kontrolli që ata konsiderojnë të nevojshëm, për të siguruar se mallrat janë vendosur në përdorimin e veçantë të përcaktuar dhe t'i ruajë këta regjistra.

Neni 172

1. Të gjitha mallrave duhet të përdoren për qëllimin e veçantë të caktuar brenda një viti nga data në të cilën është pranuar nga autoritetet doganore deklarata për qarkullim të lirë.

2. Afati kohor i përcaktuar në paragrafin 1 mund të zgjatet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në qoftë se mallrave nuk u është caktuar një përdorim i veçantë i përcaktuar si rrjedhojë e rrethanave të paparashikuara ose forcave madhore ose kërkesave të domosdoshme që lindin gjatë punimit ose përpunimit të mallrave.

Neni 173

1. Mallrat konsiderohen se janë përdorur në mënyrën e veçantë në fjalë:

- a) në rastet kur mallrat mund të përdoren vetëm një herë, kur të gjithë mallrat janë përdorur në mënyrën e veçantë brenda kufirit kohor të vendosur;
- b) në rastet kur mallrat mund të vendosen në përdorim që përsëritet, dy vjet pasi atyre u është caktuar fillimisht përdorimi i veçantë; kjo datë duhet të shënohet në regjistrat e përmendur në nenin 171(b)

2. Mbetjet dhe hedhurinat që dalin nga punimi ose përpunimi i mallrave dhe frot si pasojë e humbjeve natyrore konsiderohen si mallra të cilëve u është caktuar një përdorim i veçantë.

Neni 174

Në rast nevojë, kur mbajtësi i autorizimit jep prova, autoritetet doganore mund të lejojnë që mallrat e përmendura në këtë seksion të depozitohen së bashku me mallrat e të njëjtit lloj dhe cilësi dhe me të njëjtat karakteristika teknike dhe fizike. Kur mallrat depozitohen në këtë mënyrë, ky seksion do të zbatohet për një sasi mallrash të barazvlefshme me sasinë e vendosur në qarkullim të lirë sipas këtij Seksioni.

Neni 175

1. Autoritetet doganore nuk miratojnë përdorimin e mallrave në një mënyrë të ndryshme nga ajo që është parashikuar për trajtimin preferencial tarifar përmendur në nenin 169, për aq kohë sa mbajtësi i autorizimit t'u argumentojë në mënyrë bindëse autoriteteve doganore se ka qenë e

pamundur, për arsye që lidhen me situatën e tij ose të vetë mallrave, që t'i vendosë ato në përdorimin e veçantë të përcaktuar.

2. Miratimi i përmendur në paragrafet paraardhës e kushtëzon mbajtësin e autorizimit të paguajë shumën e detyrimeve të importit që përcaktohet në nenin 223 të Kodit.

Neni 176

Autoritetet doganore nuk do të lejojnë eksportimin e mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë ose shkatërrimin e mallrave nën mbikqyrjen doganore për aq kohë sa mbajtësi i autorizimit nuk u ka argumentuar në mënyrë bindëse autoriteteve doganore se ka qenë e pamundur, për arsye që lidhen me situatën e tij ose të vetë mallrave, që t'i vendosë ato në përdorimin e veçantë të përcaktuar. Kur miratohet eksportimi i mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, mallrat konsiderohen si mallra jo shqiptare nga momenti i pranimit të deklaratës së eksportit.

Seksioni 4

Dispozita të Përgjithshme

Neni 177

Kur detyrimi i importit që zbatohet në kuadër të trajtimit tarifor favorizues për arsye të llojit të mallrave ose të përdorimit të tyre të veçantë, nuk është më i ulët se ai që do të zbatohet për këto mallra në raste të tjera, mallrat në fjalë duhet të klasifikohen në kodin e Nomenklaturës së Kombinuar që i referohet përdorimit të veçantë dhe në këto raste ky Kre nuk do të zbatohet.

Neni 178

Trajtimi tarifor favorizues për arsye të llojit të mallrave dhe për arsye të përdorimit të tyre të veçantë për mallra të tjera të ndryshme nga ato të përmendura në këtë Kre, mund të përcaktohet me Dispozitat e nxjerra nga Ministri i Financave.

Neni 179

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të nxjerrë udhëzime për zbatimin praktik të procedurave të trajtimit tarifor favorizues.

KREU 3

Administrimi i masave tarifore

Administrimi i kuotave tarifore të përcaktuara për përdorim sipas rendit kronologjik të të dhënave të deklarave doganore

Neni 180

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, kur kuotat tarifore janë të hapura nga legjislacioni shqiptar, këto kuota tarifore duhet të administrohen në bazë të rendit kronologjik të datave të pranimit të deklarave për vënien në qarkullim të lirë.

2. Në rastin kur pranohet një deklaratë për vendosjen në qarkullim të lirë që përfshin një kërkesë të vlefshme nga deklaruesi për përfitim nga kuota tarifore, autoritetet doganore kompetente duhet të zbresin nga kuota tarifore, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, një sasi që përkon me nevojat e tyre.

3. Autoritetet doganore nuk duhet të paraqesin asnjë kërkesë për tërheqje derisa atyre nuk u janë paraqitur të gjitha dokumentet me të cilat kushtëzohet dhënia e nivelit të reduktuar ose zero.

4. Me përjashtim të rasteve të përmendura në paragrafin 8, shpërndarja e sasive bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bazë të datës së pranimit të deklaratës përkatëse për vendosjen në qarkullim të lirë, dhe deri në atë shkallë që gjendja aktuale e kuotave tarifore përkatëse e lejon këtë. Dhënia e përparësive duhet të përcaktohet në bazë të rendit kronologjik të këtyre datave.

5. Autoritetet doganore duhet t'i komunikojnë pa vonesë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të gjitha kërkesat e vlefshme për tërheqje. Këto komunikime duhet të përfshijnë datën e përmendur në paragrafin 4 si dhe shumën e saktë të zbatuar për deklaratën doganore përkatëse.

6. Për qëllim të paragrafeve 4 dhe 5, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të përcaktojë radhën e numrave kur ato nuk përcaktohen nga legjislacioni shqiptar që ka hapur kuotën tarifore.

7. Në qoftë se sasi të kërkuara për tërheqje nga kuota tarifore janë më të mëdha se gjendja aktuale e disponueshme, shpërndarja do të bëhet në përpjestim me sasi të kërkuara.

8. Për qëllim të këtij neni, pranimi i deklaratës nga autoritetet doganore në datat 1, 2, ose 3 Janar, do të konsiderohet si pranim në datën 3 Janar. Megjithatë, në qoftë se njëra nga këto ditë është e shtunë ose e dielë, një pranim i tillë konsiderohet të jetë bërë në datën 4 Janar.

9. Kur hapet një kuotë e re tarifore tërheqja nuk do të jepet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave para ditës së 11-të të punës në vijim të botimit të legjislacionit që ka krijuar këtë kuotë tarifore.

10. Autoritetet doganore i kthejnë menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave sasi të tërhequra që nuk janë përdorur prej tyre. Megjithatë, kur një tërheqje e gabuar, që përfaqëson një borxh doganor jo më shumë se 2000 lekë, zbulohet pas muajit të parë që vjen menjëherë pas periudhës së vlefshmërisë së kuotave tarifore përkatëse, nuk është e nevojshme që autoritetet doganore ta kthejnë këtë tërheqje.

11. Nëse autoritetet doganore bëjnë të pavlefshme një deklaratë për vendosjen në qarkullim të lirë për mallra që janë objekt i një kërkesë për të përfituar një kuotë tarifore, e gjithë kërkesa për këto mallra anulohet. Autoritetet doganore përkatëse i kthejnë menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave çdo sasi të tërhequr nga kuota tarifore, në lidhje me

këto mallra.

Neni 181

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të bëjë një shpërndarje çdo të dite pune, përveç:

- ditëve që janë pushim për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, ose
- në rrethana të veçanta, çdo dite tjetër, me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të

TITULLI II

TRANZITI

Për qëllim të nenit 182 deri 233⁷:

- a) "Mjet transporti" do të thotë: mjete, në veçanti:
 - i) çdo mjet rrugor, rimorkio ose gjysëm-rimorkio, çdo vagon treni ose vagon mallrash,
 - ii) çdo varkë ose anije,
 - iii) çdo mjet fluturimi
 - iv) çdo kontenier në kuptim të nenit 2(9)(g);
- b) "Zyrë nisje" do të thotë: zyra doganore ku fillon operacioni i tranzitit;
- c) "Zyrë destinacioni" do të thotë: zyra doganore ku mallrat e vëna nën regjimin e tranzitit duhet të paraqiten për të përfunduar operacionin e tranzitit;
- d) "Zyra e garancisë" do të thotë: zyra doganore ku është dhënë garancia globale.

Neni 182

Në përputhje me pjesën IV, kreu 2, seksioni 3B të Kodit, ky kre përcakton dispozitat për zbatimin e regjimit të tranzitit.

Neni 183

1. Në përputhje me nenin 114 (1) (b) të Kodit, mallrat shqiptare lëvizin nën regjimin e tranzitit në rastet e mëposhtme:

- a) kur rimbursimi ose shuarja e detyrimeve doganore kushtëzohet nga rieksporimi i tyre nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë ose nga vendosja në magazinim doganor, zonë të lirë ose magazinë doganore të lirë ose nën një regjim doganor të ndryshëm nga vendosja në qarkullim të lirë; ose
- b) kur ato janë vendosur në qarkullim të lirë nën regjimin e përpunimit aktiv me rimbursim, me synim që të eksportohen më

Doganave.

2. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 180(8), çdo shpërndarje duhet të marrë në konsideratë të gjitha kërkesat të cilave nuk u është dhënë përgjigje dhe që kanë lidhje me deklaratat për vendosje në qarkullim të lirë të pranuar jo më vonë se dy ditë më parë, dhe të cilat i janë komunikuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

tej në trajtën e produkteve kompensuese dhe për të cilat, në përputhje me nenin 149 të Kodit, mund të paraqitet një kërkesë për rimbursim dhe personi i interesuar synon të depozitojë një kërkesë të tillë.

2. Mallrat e referuara në paragrafin 1. të cilat nuk kanë dalë nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, trajtohen si mallra shqiptare, me kusht që të dëshmohet që deklaratat e eksportit dhe formalitetet e tjera doganore të nevojshme në mënyrë që mallrat të largohen nga territori në fjalë, dhe çdo efekt i këtyre formaliteteve është anuluar.

Neni 184

1. Gjithë mallrat të cilat duhet të lëvizin nën regjimin e tranzitit janë objekt i një deklarate T1, që bëhet në përputhje me këtë Seksion. Deklarata T1 nënkupton një deklaratë në një formular që i korrespondon modeleve të pasqyruara në Aneks 9 dhe 10 dhe të përdorur sipas shënimeve të parashikuara në Aneks 12 dhe 13.

2. Listë ngarkesat, të cilat bazohen në modelet e Aneksit 17, mund të përdoren në përputhje me këto dispozita zbatuese si pjesa përshkruese e deklaratës së tranzitit. Ky përdorim nuk ndikon mbi detyrimet lidhur me formalitetet përkatëse të një regjimi dërgimi/eksporti, ose lidhur me formularët e përdorur për këto formalitete.

Neni 185

Listë ngarkesa përmban:

- a) titullin: "Listë ngarkese";
- b) një kuti me përmasa 70 x 55 mm, të ndarë në një pjesë të sipërme me përmasa 70 x 15 mm ku shënohet simboli "T", i ndjekur nga një prej shënimeve "T1" ose "T1 bis" dhe një pjesë të poshtme me përmasa 70 x 40 mm për përdorim zyrtar;
- c) kolonat, të renditura dhe të titulluara si vijon:
 - i) numri rendor,
 - ii) marka, numra, sasia e lloji i kolive, përshkrimi i mallrave,
 - iii) vendi i dërgimit/eksportimit,

⁷ Shiko nenin 2(6). Ky tekst është rishikuar këtu për lehtësi përdorimi të termave të përkufizuar.

- iv) pesha bruto (në kg),
 - v) vetëm për përdorim zyrtar.
- d) Gjerësia e kolonave përshtatet sipas nevojës. Megjithatë, gjerësia e kolonës së titulluar “Vetëm për përdorim zyrtar” nuk duhet të jetë më e vogël se 30 mm. Mund të përdoren gjithashtu edhe hapësira të tjera prej atyre të cilave i referohet (a), (b) dhe (c) më sipër.

Neni 186

1. Si listë ngarkesë mund të përdoret vetëm faqja balllore e fletës.
2. Çdo element i pasqyruar në listë ngarkesë duhet të paraprihet nga numri rendor.
3. Çdo element ndiqet, kur është rasti, nga referime specifike të cilat parashikohen nga legjislacioni në fuqi, dokumentat e paraqitura dhe çertifikatat apo autorizimet.
4. Pas shënimit të fundit vendoset një vijë horizontale dhe hapësirat e papërdorura që mbeten mund të kryqëzohen në mënyrë që të mos lihet mundësi për shtesa të mëtejshme.

Neni 187

1. Autoritetet doganore mund të lejojnë edhe përdorimin e listë ngarkesave të cilat nuk përmbushin të gjitha kërkesat. Megjithatë, përmasat dhe hapësira e përdorur për përdorim nga autoritetet doganore nuk duhet të ndryshojë.

Përdorimi i kësaj liste lejohe vetëm atëherë kur ato:

- b) përgatiten nga shoqëri, regjistrat e të cilave bazohen në një sistem të integruar elektronik ose automatik të përpunimit të të dhënave;
- c) janë përgatitur dhe plotësuar në mënyrë të tillë që mund të përdoren pa vështirësi nga autoritetet doganore;
- d) për çdo artikull përmbajnë sasinë, llojin, markat dhe numrat e kolive, përshkrimin e mallrave, vendin e dërgimit/eksportit dhe peshën bruto në kg.

2. Autoritetet doganore mund të lejojnë shoqëritë, regjistrat e të cilave bazohen në një sistem përpunimi të dhënash elektronik ose automatik, dhe të cilat lejohen sipas paragrafeve 1 dhe 2 të përdorin listë ngarkesa të një lloji të veçantë, të përdorin këto lista për operacione tranziti që përfshijnë vetëm një lloj malli kur një lehtësi e tillë bëhet e nevojshme nga programet kompjuterike të shoqërisë në fjalë.

Neni 188

1. Kur përgjegjësi kryesor përdor listë ngarkesa për një dërgesë që përmban dy ose më shumë lloje mallrash, kutitë 15 “vendi i dërgimit/eksportit”, 33 “Kodi tarifor i mallrave”, 35 “Pesha bruto (kg)”, 38 “Pesha neto (kg)” dhe kur është e nevojshme, 44 “Dokumente plotësuese, dokumente të lëshuara,

çertifikata dhe autorizime” të formularit u vihet kryq dhe kutia 31 “Kolitë dhe përshkrimi i mallrave” e atij formulari nuk përdoret për të treguar markat dhe numrat, numrin dhe llojin e kolive dhe përshkrimin e mallrave. Kur përdoren listë ngarkesat, nuk përdoren formularë plotësues.

2. Listë ngarkesa lëshohet në të njëjtin numër kopjesh si edhe deklarata T1 me të cilën ajo ka të bëjë.

3. Kur regjistrohet deklarata, listë ngarkesa duhet të mbajë të njëjtin numër regjistrimi si edhe deklarata T1 me të cilën ajo ka të bëjë. Numri shkruhet ose nëpërmjet një vule që përmban në vetvete emrin e zyrës nisëse, ose me dorë. Në rastin e fundit duhet të shoqërohet nga vula zyrtare e zyrës nisëse. Nënshkrimi i një zyrtari të kësaj zyre është fakultativ.

4. Kur një deklaratë e vetme T1 shoqërohet nga dy ose më shumë listë ngarkesa, çdo numër duhet të ketë edhe numrin rendor të vendosur nga përgjegjësi kryesor. Numri i listë ngarkesës duhet të tregohet në kutinë 4 të deklaratës T1 të titulluar “Listë ngarkesat”.

5. Një deklaratë e bërë në një formular të Dokumentit Administrativ të Vetëm që mban shenjën T1 në nëndarjen e djathtë të kutisë 1 dhe që shoqërohet nga një ose më shumë listë ngarkesa duhet të trajtohet si një deklaratë tranziti.

Neni 189

1. Kur mallrat qarkullojnë nën një regjim tranziti, përgjegjësi kryesor shënon simbolin “T1” në nëndarjen e djathtë të kutisë 1 të formularit të përdorur. Kur përdoren formularë plotësues, përgjegjësi kryesor duhet të shënojë simbolin “T1 bis” në nëndarjen e djathtë të kutisë së parë të formularit të përdorur.

2. Deklarata T1 duhet të nënshkruhet nga përgjegjësi kryesor dhe kopjet 1, 4, 5 dhe 7 të saj duhet paraqitet në zyrën nisëse.

3. Kur regjimi i tranzitit ndjek një regjim tjetër doganor, ky regjim duhet të përmendet në deklaratën T1, ose në dokumentat doganore përkatëse.

Neni 190

1. I njëjti mjet transporti mund të përdoret si për ngarkimin e mallrave pranë më shumë se një zyre nisëse, ashtu edhe për shkarkimin e mallrave në më shumë se një zyrë destinacioni.

2. Çdo deklaratë T1 përfshin vetëm mallrat e ngarkuar apo për t'u ngarkuar në një mjet transporti të vetëm për transportim nga një zyrë nisëse në një zyrë destinacioni. Për qëllim të fjalisë së parë, mjetet e mëposhtme do të merren si pjesë përbërëse të një mjeti transporti të vetëm, me kusht që të transportojnë mallra të cilat përbëjnë një dërgesë të vetme:

- a) një automjet rrugor i shoqëruar nga rimorkioja/rimorkiot ose gjysmë

- rimorkioja/rimorkiot e tij;
- b) një varg vagonash hekurudhorë;
 - c) mjete lundruar që formojnë një karvan të vetëm;
 - d) kontenierë ngarkuar në një mjet transporti në kuptim të këtij neni.

Neni 191

1. Zyra nisëse pranon dhe regjistron deklaratën T1, cakton afatin brenda të cilit mallrat duhet të paraqiten në zyrën e destinacionit dhe merr masat e nevojshme për identifikim nëse e konsideron të nevojshme një gjë të tillë.

2. Zyra nisëse shënon hollësitat e nevojshme në deklaratën T1, mban kopjen 1 të saj dhe i kthen përgjegjësit kryesor ose përfaqësuesit të tij kopjet e tjera.

3. Mjetet e transportit nën regjimin e tranzitit nuk lejohen të largohen nga zyra doganore nisëse pa autorizim nga autoritetet doganore.

4. Në rastet kur mallrat për t'u tranzituar paraqesin rrezik të lartë për mashtime, apo në çdo rast kur autoritetet doganore e konsiderojnë të nevojshme, zyra nisëse mund të caktojë një itinerar për dërgesën. Itinerari, me kërkesë të përgjegjësit kryesor, mund të ndryshohet vetëm nga autoritetet doganore të zyrës nisëse dhe kjo kërkesë duhet të depozitohet brenda afatit kohor të caktuar për këtë qëllim. Autoritetet doganore marrin masat e nevojshme për trajtimin e çdo shkeljeje apo parregullsie dhe vendosjen e gjobave të duhura në përputhje me nenin 260 të Kodit.

5. Në rastet e forcave madhore, mjeti i transportit mund të devijojë nga itinerari i përcaktuar. Dërgesa dhe dokumenti T1 paraqiten pranë autoriteteve doganore më të afërta pa vonesë. Autoritetet doganore informojnë menjëherë zyrën nisëse përse i përket devijimit dhe regjistron hollësitat përkatëse në dokumentin T1.

Neni 192

1. Si rregull i përgjithshëm, identifikimi i mallrave sigurohet nëpërmjet plumbosjes.

2. Mund të plumboset:

- a) hapësira që përmban mallrat, kur mjeti i transportit në bazë të rregullave të tjera, përveç legjislacionit doganor miratohet apo njihet nga zyra nisëse si i përshtatshëm për plumbosje;
- b) çdo koli e veçantë, në raste të tjera.

3. Mjetet e transportit konsiderohen të përshtatshme për plumbosje nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) mund të plumbosen thjesht dhe me efikasitet;
- b) janë ndërtuar në mënyrë të tillë që përjashtohet mundësia e zhvendosjes ose

vendosjes së mallrave pa lënë shenja të qarta të manipulimit apo pa thyer plumbin;

- c) nuk përmbajnë hapësira ku mund të fshihen mallrat; dhe
- d) në hapësirat e rezervuara për vendosjen e ngarkesës autoritetet doganore mund të hyjnë lehtësisht për kontroll.

4. Zyra nisëse mund të mos kryejë plumbosjen në rast se, duke pasur parasysh masa të tjera të mundshme identifikimi, përshkrimi i mallrave në dokumentin T1 ose në dokumentet plotësuese i bën ata lehtësisht të identifikueshëm.

Neni 193

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të vendosë që tranziti me kamionë, rimorkio ose kontenierë të lejohet vetëm në qoftë se këto mjete janë miratuar për transport ndërkombëtar të mallrave të plumbosura nga dogana, dhe që janë në kushte të mira.

Neni 194

1. Mallrat transportohen të shoqëruara nga kopjet 4, 5 dhe 7 e dokumentit T1 të cilat i janë dhënë përgjegjësit kryesor ose përfaqësuesit të tij nga zyra nisëse pas formaliteteve të kryera aty.

2. Drejtuesi i mjetit të transportit nën regjimin e tranzitit duhet të mbajë me vete kopjet e dokumentit T1 dhe t'i paraqesë ato kundrejt kërkesës së autoriteteve doganore apo ndonjë autoriteti tjetër publik kur kjo parashikohet nga legjislacionin në fuqi.

Neni 195

Në rastet kur mallrat ngarkohen apo shkarkohen në prani të autoriteteve doganore të ndërmjetme kopjet e dokumentit T1 paraqiten pranë këtyre autoriteteve.

Neni 196

Mallrat e përshkruara në dokumentin T1 mund të transbordohen në një mjet tjetër transporti nën mbikqyrjen e autoriteteve doganore që veprojnë në territorin ku bëhet ky transbordim pa qenë nevoja të bëhet një deklaratë e re. Në këtë rast, autoritetet kompetente regjistrojnë hollësitat e nevojshme në dokumentin T1.

Neni 197

1. Në rast se gjatë transportimit për arsye që nuk varen nga transportuesi, thyhet plumbosja, ky i fundit pa vonesë duhet të kërkojë mbajtjen e një proces verbal nga ana e autoritetit doganor më të afërt, pa rënë ndesh me nenin 280 të Kodit lidhur me procedurat e ndjekjes penale. Autoriteti doganor kompetent vendos në rast se është e mundur, vula të reja.

2. Në rast aksidenti që kërkon transbordimin e mallit në një mjet tjetër transporti, ky veprim duhet të bëhet nën mbikqyrjen e autoriteteve doganore të cilat janë kompetente në territorin ku do të bëhet

transbordimi.

3. Në rast rreziku të menjëhershëm dhe real i cili kërkon shkarkimin në çast të të gjithë apo një pjese të ngarkesës, transportuesi mund të veprojë me iniciativën e tij. Këtë rrethanë, ai duhet ta regjistrojë në dokumentin T1. Në të tilla raste zbatohet paragrafi 1 i këtij neni.

4. Në rast se, si rrjedhojë e aksidenteve apo incidenteve të tjera të cilat lindin gjatë transportit, transportuesi nuk mund të respektojë afatin kohor të caktuar brenda të cilit mallrat duhet të paraqiten në zyrën e destinacionit, ai duhet të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur autoritetet doganore të cilave i referohet paragrafi 1. Këto autoritete më pas regjistrojnë hollësisht përkatëse në dokumentin T1.

Neni 198

1. Mallrat dhe dokumenti T1 paraqiten në zyrën doganore të destinacionit.

2. Drejtuesit e mjeteve të transportit nën regjimin e tranzitit duhet të paraqesin pa vonesë deklaratën e tranzitit së bashku me mallrat pranë zyrës doganore të destinacionit. Atyre nuk u lejohej të bëjnë ndalesa gjatë tranzitimit, me përjashtim të atyre që janë të nevojshme për arsye sigurie apo të miratuara nga autoritetet doganore apo ndalesave që kryhen për t'iu përgjigjur kërkesës së ndonjë autoriteti publik në bazë të legjislacionit në fuqi.

3. Zyra e destinacionit në kopjen 4 dhe 5 të dokumentit T1 duhet të regjistrojë detajet e kontrollit të kryer dhe brenda 10 ditëve i dërgon zyrës nisëse kopjen 5, duke mbajtur kopjen tjetër.

4. Sa herë që autoritetet doganore e konsiderojnë të nevojshme, zyra e destinacionit mund të ndryshohet me kërkesën e përgjegjës kryesor, vetëm nga zyra nisëse. Autoritetet doganore në të tilla raste regjistrojnë detajet e nevojshme në të gjitha kopjet e dokumentit T1.

5. Afati kohor që zyra nisëse përcakton për paraqitjen e mallrave pranë zyrës së destinacionit, nuk lejohet të ndryshohet nga zyra e destinacionit.

6. Kur mallrat paraqiten pranë zyrës së destinacionit pasi ka përfunduar afati kohor i përcaktuar nga zyra nisëse dhe ky afat nuk është zbatuar për shkak të rrethanave që i arsyetohen bindshëm zyrës së destinacionit dhe nuk janë për shkak të transportuesit ose përgjegjës kryesor, konsiderohet se këta të fundit e kanë respektuar afatin kohor të caktuar.

Neni 199

1. Personi që paraqet një dokument tranziti pranë zyrës së destinacionit së bashku me dërgesën të cilës i referohet ky dokument, ka të drejtë të marrë një vërtetim, në qoftë se ai e kërkon një gjë të tillë.

2. Formulari i vërtetimit i cili lëshohet për të dëshmuar faktin që një dokument tranziti dhe dërgesa përkatëse janë paraqitur pranë zyrës së destinacionit, duhet të përputhet me modelin në

Aneksin 18. Megjithatë, vërtetimi lidhur me dokumentin e tranzitit mund të bëhet sipas modelit të treguar në faqen e pasme të kopjes 5 të deklaratës T1.

3. Vërtetimi plotësohet paraprakisht nga personi i interesuar. Ai mund të përfshijë detaje të tjera që lidhen me ngarkesën, përjashtuar hapësirën e rezervuar për zyrën e destinacionit, por konfirmimi nga zyra e destinacionit është i vlefshëm vetëm për sa i përket detajeve të përfshira në atë hapësirë.

Neni 200

1. Garancia të cilës i referohet neni 117 (1) i Kodit është e vlefshme në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

2. Garancia mund të jetë globale, që mbulon disa operacine tranziti ose individuale që mbulon një operacion të vetëm tranziti.

3. Garancia mund të jepet individualisht ose solidarisht nga persona të tretë fizikë ose juridikë që plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 210 të Kodit, ose mund të depozitohet në të holla në një zyrë dërguese. Zyra dërguese mund të lejojë që depozitimi në të holla të bëhet edhe në ndonjë zyrë tjetër doganore kur rrethanat e kërkojnë një gjë të tillë.

4. Dokumenti i garancisë do të jetë në përputhje me modelet e dhëna në :

- a) Aneksin 19 për rastet e garancisë globale,
- b) Aneksin 20 për rastet e garancisë individuale.

5. Kur dispozitat e përcaktuara në legjislacionin shqiptar, rregulloret ose veprimet administrative, ose praktika të zakonshme e kërkojnë një gjë të tillë, autoritetet doganore mund të lejojnë që garancia të jetë në një model tjetër, me kusht që ajo të ketë të njëjtat efekte ligjore si modelet e përmendura në paragrafin 4.

Neni 201

1. Përdorimi i një garancie globale i jepet vetëm personave:

- a) të cilët janë të vendosur në Republikën e Shqipërisë;
- b) të cilët janë përdorues të rregullt, si përgjegjës kryesor, për një periudhë 6 muajore ose për të cilët autoritetet doganore kanë bindjen se gëzojnë një gjendje të mirë financiare, e cila i lejon të përmbushin detyrimet e tyre; dhe
- c) të cilët nuk kanë kryer shkelje serioze ose të përsëritura të legjislacionit doganor ose tatimor.

2. Garancia globale duhet të depozitohet në një zyrë garancie.

3. Zyrë garancie është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

4. Zyra e garancisë përcakton shumën e garancisë, pranon marrjen përsipër nga garantuesi dhe lëshon një autorizim i cili lejon përdoruesin kryesor të kryejë, brenda kufijve të shumave të garantuara, çfarëdo operacioni tranziti pavarësisht nga zyra nisëse.

5. Çdo person që ka marrë një autorizim, bashkë me këtë të fundit merr edhe një ose disa dokumenta garancie të përpiluara sipas formularit të modelin të paraqitur në Aneksin 21.

6. Çdo dokument T1 i referohet dokumentit të garancisë.

7. Zyra e garancisë shfuqizon autorizimin për përdorimin e një garancie globale në cdo rast kur nuk plotësohen më kushtet e parashikuara në paragrafin 1.

Neni 202

1. Shuma e garancisë globale caktohet në 100% të detyrimeve dhe të gjithë pagesave të tjera, me një minimum prej 1 500 000 Lekë, sipas paragrafit 4, me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 2.

2. Autoritetet doganore mund të caktojnë shumën e garancisë globale në të paktën 30% të detyrimeve dhe pagesave të tjera, me një minimum prej 1 500 000 Lekë, sipas dispozitave të paragrafit 4 me kusht që:

- operatori brenda një periudhë dy vjecare rregullisht ka kryer operacione tranziti sipas sistemit të garancisë globale;
- operatori nuk ka kryer asnjë shkelje serioze të detyrimeve të veta gjatë kësaj periudhe;
- garancia e reduktuar mbulon të paktën shumën e detyrimeve doganore;
- mallrat nuk janë listuar në Aneksin 22 dhe nuk përjashtohen nga garancia globale.

3. Përjashtimi i parashikuar në paragrafin 2 nuk zbatohet nëse kushtet e përshkruara po aty, pushojnë së ekzistuari.

4. Zyra e garancisë kryen vlerësime cdo javë për:

- dërgesat e kryra;
- detyrimet dhe pagesat e tjera për t'u paguar duke marrë parasysh nivelin me të lartë të taksimit të zbatueshëm. Ky vlerësim duhet të bëhet në bazë të dokumentacionit tregtar dhe kontabël të personit në fjalë, lidhur me mallrat e transportuara gjatë vitit të mëparshëm, shuma që merret më pas pjesëtohet në 52. Në rastet e kërkuesve për garanci globale, zyra e garancisë në bashkëpunim me personin e interesuar bën vlerësimin e sasisë, vlerës dhe detyrimeve që zbatohen mbi mallrat e transportuara në një periudhë të caktuar, bazuar në të dhëna të disponuara. Zyra e garancisë me extrapolim përcakton vlerën e përafërt të detyrimeve të zbatueshme për

mallrat që duhet të transportohen gjatë një jave.

5. Zyra e garancisë kryen gjithë rishikimet vjetore të shumës së garancisë globale, vecanërisht në bazë të informacionit nga zyra nisëse dhe nëse është e nevojshme rregullon shumën.

Neni 203

1. Si me iniciativë të Ministrit të Financave ashtu edhe me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm i Doganave, përdorimi i garancisë globale mund ndalohet përkohësisht, kur kjo bëhet për qëllim të mbulimit të operacioneve të tranzitit lidhur me mallrat të cilat gjykohej se paraqesin rritje të rrezikut për mashtrim.

2. Periudha maksimale gjatë së cilës ndalohet përdorimi i garancisë globale për mallrat mund të jetë 12 muaj, me përjashtim të rasteve kur Ministri i Financave vendos ta zgjasë këtë periudhë.

Neni 204

1. Me lëshimin e dokumentit të garancisë, ose në cdo kohë gjatë periudhës në të cilën është e vlefshme kjo certifikatë, përgjegjesi kryesor ne faqën e pasme të dokumentit dhe nën përgjegjesinë e tij duhet të caktojë personin ose personat e autorizuar të nenshkruajnë për llogari të tij deklaratat e tranzitit. Të dhenat e vecanta duhet të përfshijnë emrin dhe mbiemrin e cdo të autorizuari, pasuar nga nenshkrimi i ketij të fundit. Cdo emerim i një personi të autorizuar konfirmohet nga nenshkrimi i përgjegjesit kryesor. Përgjegjësi kryesor ka të drejtë që me dëshirën e tij të vendosë kryq mbi kutitë e papërdorura.

2. Përgjegjësi kryesor mund të fshijë në cdo kohë emrin e personit të autorizuar nga faqja e pasme e certifikatës.

Neni 205

Çdo person i përmendur në faqën e pasme të dokumentit të garancisë që paraqitet në një zyrë nisëse duhet të jetë përfaqësues i autorizuar prej përgjegjësit kryesor.

Neni 206

Afati i vlefshmerisë së certifikatës së garancise nuk duhet të kalojë dy vjet. Megjithatë, ky afat mund të zgjatet nga zyra e garancisë për një periudhë të mëtejshme që gjithsesi nuk i kalon 2 vjet.

Neni 207

Në qoftë se garancia është hequr, përgjegjësi kryesor është përgjegjës për kthimin në zyrën e garancisë të të gjithë certifikatave të garancisë ende të vlefshme, të leshuara në emer të tij.

Neni 208

1. Një garanci individuale e paraqitur për një operacion të vetëm tranziti depozitohet në zyrën nisëse. Zyra nisëse fikson shumën e garancisë. Shuma duhet të mbulojë gjithë detyrimet dhe pagesat e tjera që lidhen me dërgesën.

2. Garancia të cilës i referohet paragrafi 1 mund të jetë depozitë me para në dorë në zyrën nisëse. Në këtë rast, shumat e derdhur kthehet kur dokumenti T1 mbyllet në zyrën nisëse.

Neni 209

1. Garantuesi clirohet nga detyrimet e tij të parashikuara në nenin 214(1) të Kodit dhe gjithashtu clirohet edhe nga detyrimet lidhur me afatin e skadimit prej 12 muajsh nga data e regjistrimit të deklarates T1, kur zyra doganore nisëse nuk e ka njoftuar mbi faktin që dokumenti T1 nuk është mbyllur. Kur brenda afatit të parashikuar në fjalë e mësipërme, garantuesi është njoftuar nga autoritetet doganore mbi mos mbylljen e dokumentit T1, më tej ai njoftohet mbi faktin se atij do t'i kërkohet ose mund t'i kërkohet të paguaje shumat për të cilat detyrohet për këtë operacion tranziti. Ky njoftim duhet t'i shkojë garantuesit jo më vonë se 3 vjet pas datës së regjistrimit të deklarates T1. Kur nuk është bërë një njoftim i tillë përpara datës së skadimit të afatit kohor, garantuesi clirohet nga detyrimet e tij.

2. Garancia që mbulon operacionet e tranzitit nuk shkarkohet deri në fund të periudhës tre vjeçare të përmendur më sipër ose deri në shlyerjen e detyrimeve dhe pagesave të tjera të zbatueshme. Autoritetet doganore marrin të gjitha masat e nevojshme lidhur me shkeljet ose parregullsitë dhe vendosin sanksionet e duhura në përputhje me Kodin.

Neni 210

1. Për qëllim të lejimit të mosdhënies së garancisë për operacionet e tranzitit, detyrimi që merr përsipër personi i interesuar në përputhje me nenin 118(2)(e) të Kodit, hartohet sipas modelit të përshkruar në Aneksin 23.

2. Kur legjislacioni shqiptar në fuqi ose praktika të zakonshme e lejojnë një gjë të tillë, autoritetet doganore mund të pranojnë që detyrimet e marra përsipër nga personi i interesuar të permbushen në një mënyrë të ndryshme, me kusht që të ketë fuqi të njëjtë detyruese me detyrimet e marra përsipër sic tregohet në modelin në fjalë.

Neni 211

1. Në përputhje me nenin 118(3) të Kodit, mosdhënia e garancisë nuk zbatohet për mallrat:

- a) vlera totale e të cilave i kalon 1 000 000 Lekë për dergesë; ose
- b) të cilat janë renditur në Aneksin 22 si mallra që sjellin rrezik të lartë.

2. Mosdhënia e cdo lloj garancie nuk zbatohet për rastet në të cilat nuk lejohet përdorimi i garancisë globale.

Neni 212

1. Kur nuk është dhënë garanci, ky fakt tregohet në deklaraten T1 të tranzitit.

2. Çertifika që lejon mosdhënien e garancisë duhet të jete në përputhje me modelin në Aneksin 24.

3. Sapo lëshohet çertifikata për mosdhënien e garancisë ose në cdo kohë tjetër gjatë së cilës ky dokument është i vlefshëm, përgjegjësi kryesor nën përgjegjësinë e tij në faqën e pasme të çertifikatës duhet të caktojë personin ose personat e autorizuar të nënshkruajnë deklaratën e tranzitit për llogari të tij. Të dhënat e veçanta duhet të përfshijnë emrin dhe mbiemrin e cdo personi të autorizuar, pasuar nga nënshkrimi i këtij të fundit. Cdo caktim i një personi të autorizuar duhet të konfirmohet nga nënshkrimi i përgjegjësit kryesor. Përgjegjësi kryesor ka të drejtë që me dëshirën e tij të vendosë kryq mbi kutitë e papërdorura. Po kështu, ky i fundit mund të fshijë emrin e ndonjë personi të autorizuar që është shënuar në faqën e pasme të dokumentit.

4. Cdo person i përmendur në faqën e pasme të një çertifikate që lejon mosdhënien e garancisë i paraqitur në një zyrë nisëse do të konsiderohet përfaqësues i autorizuar i përgjegjësit kryesor.

5. Afati gjatë të cilit është i vlefshëm një çertifikatë që lejon mosdhënien e garancisë nuk duhet të kalojë 2 vjet. Megjithatë, ky afat mund të zgjatet nga vetë autoritetet që vendosin mosdhënien e garancisë për një periudhë të mëtejshme që nuk i kalon 2 vjet.

6. Në qoftë se çertifikata për lejimin e mosdhënies së garancisë shfuqizohet, përgjegjësi kryesor është përgjegjës për kthimin menjëherë tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të të gjitha çertifikatave për lejimin e mosdhënies së garancisë të cilat i janë lëshuar atij dhe që janë ende të vlefshme.

Neni 213

1. Kur një dërgesë nuk është paraqitur ende në zyrën e destinacionit, zyra nisëse duhet të lajmërojë menjëherë përgjegjësin kryesor brenda 5 javëve që prej datës së regjistrimit të deklarates së tranzitit. Megjithatë, e drejta për të bërë lajmërim parashkruhet pas 11 muajsh nga data e regjistrimit të deklarates së tranzitit.

2. Lajmërimi të cilit i referohet paragrafi 1, duhet të tregojë vecanërisht kufirin kohor brenda të cilit duhet të paraqiten prova të mjaftueshme për autoritetet doganore mbi rregullsinë e operacioneve të tranzitit në zyrën nisëse. Ky kufi kohor nuk duhet të jetë më i gjatë se një muaj nga data e lajmërimit të cilit i referohet paragrafi 1. Në qoftë se nuk është paraqitur kjo provë deri në fund të kësaj periudhe, autoritetet doganore kompetente duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbledhur detyrimet doganore dhe gjithë pagesat e tjera përkatëse.

Neni 214

Provat mbi rregullsinë e një operacioni tranziti paraqiten për aq sa konsiderohen të mjaftueshme për autoritetet doganore nëpërmjet:

- a) paraqitjes së një dokumenti doganor ose tregtar të vërtetuar nga autoritetet doganore, i cili dëshmon që mallrat në fjalë janë paraqitur në zyrën e destinacionit. Ky dokument duhet të përmbajë informacionin e mjaftueshëm për t'u dhënë mundësinë mallrave në fjalë të identifikohen; ose
- b) paraqitjes së një dokumenti doganor që i vendos mallrat nën një regjim doganor në një vend tjetër ose me anën e një kopjeje apo fotokopjeje të tij; kjo kopje ose fotokopje të vërtetohet si origjinale nga autoritetet e vetë vendit tjetër i interesuar. Dokumenti duhet të përmbajë informacion të mjaftueshëm për të dhënë mundësi të identifikohen mallrat në fjalë.

Neni 215

Deklarata e tranzitit dhe dokumentat hartohen në gjuhën shqipe.

Neni 216

1. Letra e përdorur për listën e ngarkesës dhe për formularët e vërtetimit duhet të jetë e përshtatshme për qëllime shkrimi dhe duhet të peshojë të paktën 40 g/m²; fortësia e saj duhet të jetë e tillë që në përdorim normal nuk griset ose rrudhohet lehtë.

2. Letra e formularëve të përdorur për certifikatën e garancisë dhe certifikata për lejimin e mosdhënies së garancisë duhet të mos kenë brum mekanik druri dhe të peshojë të paktën 100 g/m². Duhet të ketë një fushë me motive arabeskash në të dy faqet në mënyrë që të tregojë ndonjë falsifikim të mundshëm mekanik ose kimik. Kjo fushë duhet të jetë:

- a) e gjelbër për certifikatat e garancisë;
- b) bojëqielli për certifikatat e lejimit të mosdhënies së garancisë.

3. Letra e përmendur në paragrafet 1 dhe 2 duhet të jetë e bardhë, me përjashtim të listë ngarkesës, për të cilën zgjedhja e ngjyrës i lihet personit të interesuar.

Neni 217

Formularët duhet të kenë përmasat:

- a) 210 x 297 mm për listë ngarkesën. Tolerancat duhet të jetë të tilla që përmasat të mos shkurtohen më shumë se 5 mm dhe të mos zgjaten më shumë se 8 mm;
- b) 210 x 148 mm për dokumentin e garancisë dhe certifikatën për mosdhënie garancie.

Neni 218

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është përgjegjëse për shtypjen ose për të marrë masat për shtypjen e certifikatës së garancisë dhe e certifikatave të lejimit të mosdhënies së garancisë. Çdo certifikatë duhet të mbajë një numër rendor për qëllim identifikimi.

2. Formularët për certifikatat e garancisë dhe certifikatat e lejimit të mosdhënies së garancisë duhet të plotësohen me makinë shkrimi ose procese të tjera të ngjashme mekanografike.

3. Listë ngarkesat dhe vërtetimet mund të plotësohen duke përdorur makinë shkrimi ose procese të tjera të ngjashme mekanografike, ose me shkrim dore të lexueshëm; në rastin e fundit ato duhet të plotësohen në shkronja të mëdha shtypi dhe me bojë.

4. Formularët nuk duhet të përmbajnë fshirje të tjera ose ndryshime. Korrigjimet duhet të bëhen duke vënë një kryq mbi fjalët e shkruara gabimisht dhe duke shtuar hollësisht e nevojshme. Korrigjimet duhet të firmosen nga personi që i kryen ato dhe të vërtetohen shprehimisht nga autoritetet doganore.

Neni 219

Regjimi i tranzitit nuk është i detyrueshëm për ato mallra jo shqiptare të cilat të transportuara në rrugë ajrore, ngarkohen ose ringarkohen në një aeroport në Republikën e Shqipërisë dhe destinacioni i tyre është një aeroport tjetër në Republikën e Shqipërisë.

Neni 220

Regjimi i tranzitit nuk është i detyrueshëm për mallra jo shqiptare të transportuara në rrugë detare, vetëm nëse ato janë ngarkuar ose transborduar në një port të Republikës së Shqipërisë dhe destinacioni i tyre është në një port tjetër i Republikës së Shqipërisë.

Neni 221

Regjimi i tranzitit nuk zbatohet kur mallrat të cilave u referohet neni 114(1) i Kodit, janë ngarkuar në një mjet lundrues në një port të vendosur në Republikën e Shqipërisë për t'u eksportuar drejt një vendi tjetër pa u shkarkuar ose transportuar më parë në një port tjetër të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 222

Për qëllim të përdorimit të *Carnet ATA* si dokument tranziti, "tranzit" do të thotë transporti i mallrave nga një zyrë doganore e vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në një zyrë doganore të vendosur brenda të njëjtit territor.

Neni 223

Kur gjatë transportit nga një pikë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në një tjetër, mallrat kalojnë nëpër territorin e një vendi të tretë, kontrollat dhe formalitetet që shoqërojnë procedurën TIR ose ATA kryhen në pikat ku mallrat largohen përkohësisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dhe ku ato hyjnë sërish në këtë territor.

Neni 224

Mallrat e transportuara nën *Carnet TIR* ose *ATA* brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, konsiderohen mallra jo shqiptare,

përvec rasteve kur statusi i tyre shqiptar është caktuar në mënyrën e duhur.

Neni 225

1. Ky nën zbatohet pa rënë ndesh me dispozitat e veçanta të Konventave TIR dhe ATA lidhur me përgjegjësinë e shoqatave të garancive kur përdoret një *Carnet* TIR ose ATA.

2. Kur vërtetohet se gjatë ose në lidhje me një operacion transporti të kryer në kuadrin e *Carnet* TIR ose një operacioni tranziti të kryer në kuadrin e një *Carneti* ATA, kryhet një shkelje apo ndodh një parregullsi brenda Republikës së Shqipërisë, vjelja e detyrimeve doganore dhe pagesave të tjera që duhen paguar, bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pavarësisht nga fillimi i çështjes penale.

3. Kur nuk është e mundur të përcaktohet në cilin territor është kryer shkelja apo parregullsia, kjo shkelje apo parregullsi konsiderohet të jetë kryer në Republikën e Shqipërisë, në rast se është zbuluar atje, përvec rasteve kur brenda afatit të përcaktuar në konventat TIR dhe ATA, paraqiten prova të mjaftueshme për autoritetet doganore mbi rregullsinë e operacionit, ose prova mbi vendin ku është kryer ne fakt shkelja ose parregullsia. Kur nuk paraqiten prova të tilla dhe shkelja ose parregullsia në fjalë konsiderohet të jetë kryer në Republikën e Shqipërisë, detyrimet ose pagesat e tjera lidhur me mallrat objekt shqyrtimi, vilen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në përputhje me Kodin dhe aktet e tij nënligjore. Autoritetet doganore marrin të gjitha masat e nevojshme për të ndjekur shkeljet ose parregullsitë e rastit dhe të vendosin ndëshkime e dhura, në bazë të Kodit.

Neni 226

1. Kur gjendet se është kryer një shkelje ose parregullsi gjate ose në lidhje me një operacion transporti të kryer nën një *Carnet* TIR ose një operacion tranziti kryer nën një *Carneti* ATA, autoritetet doganore lajmërojnë mbajtësin e *Carneti* TIR ose ATA dhe shoqatën garantuese brenda afatit të parashikuar në nenin 11(1) të Konventës TIR ose nenin 6(4) të Konventës ATA, sipas rastit.

2. Provat mbi rregullsinë e operacionit të kryer në kuadrin e *Carneti* TIR ose një *Carnet* ATA duhet të paraqiten brenda periudhës së parashikuar në nenin 11(2) të Konventës TIR ose nenit 7(1) dhe (2) të Konventës ATA, sipas rastit.

3. Provat e permendura në paragrafin 2 paraqiten në përputhje me kërkesat e autoriteteve doganore:

- a) nëpërmjet një dokument doganor ose fletë *Carneti* të vertetuar nga autoritetet doganore që deshmton se mallrat në fjale janë paraqitur në zyren e destinacionit. Ky dokument duhet të përshijë informacion për të mundësuar identifikimin e mallrave; ose
- b) nëpërmjet një dokumenti doganor që tregon vendosjen nën një regjim doganor në një vend tjetër, ose një fotokopje apo kopje të tij; kopja ose fotokopja duhet të vërtetohet si origjinale

sipër organit që ka pranuar, nëshkruar dhe vulosur dokumentin origjinal, ashtu edhe prej autoriteteve të vendit tjetër në fjalë. Ky dokument duhet të përmbajë informacion që mundëson identifikimin e mallrave në fjalë; ose

- c) për qëllim të Konventës ATA, nepermjet provave të pershkruara në nenin 8 të asaj Konvente.

Neni 227

Për qëllim të nenit 1(h) të Konventës TIR, "zyrë doganore në rrugë" do të thotë çdo zyrë doganore nepermjet të ciles një mjet rrugor, bashkësi mjeteve ose konteiner sic perkufizohet në Konventën TIR, importohet ose eksportohet prej territorit doganor të Republikës së Shqipërisë gjate kohes së veprimt të një operacioni TIR.

Neni 228

Për qëllim të nenit 8 (4) të Konventës TIR, kur një dergese hyn në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë ose nisët nga një zyrë doganore e vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, shoqata garantuese është ose bëhet përgjegjëse ndaj autoriteteve doganore deri në pikën në të cilën dergesa largohet nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë ose deri në zyren doganore të destinacionit në këtë territor.

Neni 229

Kur Drejtori i Përgjithshëm i Doganave vendos të përjashtojë një person prej procedurës TIR sipas nenit 38 të Konventës TIR, ky vendim zbatohet në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Ky vendim zbatohet për gjithë *Carneti* TIR të paraqitura në një zyrë doganore për praninë.

Neni 230

1. Kur një operacion TIR ka të bëjë me mallra që paraqesin rrezik të lartë për mashttrim, ose kur autoritetet doganore e konsiderojnë të nevojshme, zyra nisëse/e hyrjes mund të caktojë një itinerar për dërgesat. Itinerari ndryshohet me kërkesë të mbajtësit të *Carneti* TIR, vetëm prej autoriteteve doganore të nisjes/të hyrjes. Autoritetet doganore regjistrojnë gjithë hollësitë përkatëse në *Carnet* TIR. Autoritetet doganore marrin të gjitha masat e nevojshme për të ndjekur shkeljet ose parregullsitë e rastit dhe për të vendosur ndëshkimet e dhura sic parashikohet në Kod.

2. Në rastet e forcave madhore, transportuesi mund të mos ndjekë itinerarin e përcaktuar. Dërgesa dhe *Carnet* TIR duhet të paraqiten pa vonesë në zyren më të afërt doganore. Autoritetet doganore duhet të informojnë zyren nisëse/të hyrjes pa vonesë dhe të regjistrojnë të gjithë hollësitë përkatëse në *Carneti* TIR.

Neni 231

Kur autoritetet doganore të Republikës së Shqipërisë konstatojnë se ka lindur një borxh doganor, dërgohet një kërkesë në adresë të shoqatës garantuese sa më shpejt që të jetë e

mundur. Kur borxhi lind për shkak të faktit se mallrat e mbuluara nga *Carnet ATA* nuk janë rieksportuar ose nuk u është caktuar një destinacion doganor brenda afatit të përcaktuar nga Konventa ATA, kjo kërkesë dërgohet duke filluar prej 3 muaj pas dates së skadimit të *Carnetit*.

Neni 232

1. Shuma e detyrimeve doganore dhe detyrimeve që lindin për shkak të mos mbylljes së një *Carneti ATA*, përllëgaritet nëpërmjet formularit të detyrimeve modeli i të cilit pasqyrohet në Aneksin 25, e të plotësuar në përputhje me udhëzimet

bashkëngjitur. Formulari i detyrimeve mund të dërgohet më vonë sesa vetë padia, por jo më shumë se 3 muaj më pas dhe sidoqoftë jo më shumë se 6 muaj nga data në të cilën autoritetet doganore fillojnë procedurën e vjeljes.

2. Formulari i detyrimeve plotësohet në dy ose në 3 kopje, sipas nevojës. Kopja e parë bëhet për shoqatën garantuese përkatëse. Kopja e dytë mbahet në zyrën doganore lëshuese.

Neni 233

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të nxjerrë udhëzime për zbatimin praktik të regjimit të tranzitit.

TITULLI III

REGJIMET DOGANORE EKONOMIKE

KREU 1

Dispozita të përgjithshme

Për qëllim të nenit 234 deri 427⁸:

- a) "*Zyrë doganore mbikqyrëse*" do të thotë: zyra doganore e autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për mbikqyrjen e regjimit, siç përcaktohet në autorizim;
- b) "*Zyrë e vënies nën regjim*" do të thotë: zyra apo zyrat doganore të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për pranimin e deklarave që venë mallrat nën regjimin që përcaktohet në autorizim;
- c) "*Zyrë e mbylljes së regjimit*" do të thotë: zyra apo zyrat doganore të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për të pranuar, siç është treguar në autorizim, deklaratat për t'u caktuar mallrave një destinacionin doganor, pasi ato kanë qenë të vendosura në një regjim doganor ekonomik.

Neni 234

1. Në përputhje me nenin 108 të Kodit dhe pa rënë ndesh me përdorimin e procedurës së thjeshtuar për autorizimet, kërkesa për autorizim për përdorimin e një regjimi doganor ekonomik, këtu e në vijim quajtur "*kërkesa*", bëhet me shkrim. Kërkuesi duhet të përfshijë në kërkesë gjithë informacionin e kërkuar, sic tregohet në Aneksin nga 26 deri 30, përfshirë shënime. Teksti i shënimeve megjithatë nuk rishkruhet në kërkesë. Kjo e fundit nënshkruhet dhe i vendoset data përkatëse. Në rastet kur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave konsideron se informacioni i dhënë në kërkesë është i pamjaftueshëm, ajo i kërkon kërkuesit të japë informacion shtesë, ose hollësira të tjera të cilat nevojiten për kërkesën.

2. Kërkesa i referohet dhe shoqërohet nga origjinali apo kopje të origjinalit të të gjithë provave mbështetëse apo dokumenteve që kanë lidhje me hollësitë e dhëna në kërkesë, paraqitja e të cilave

nevojitet për vlerësimin e kërkesës. Ajo mund të shoqërohet nga flete shtese në të cilat jepet informacion më i zgjeruar. Të gjithë këto dokumente, prova apo flete shtese janë pjesë perberese e kërkesës që ato shoqërojnë. Në kërkesë shenohet edhe numri i anekseve.

3. Të gjitha kërkesat për persona juridike shoqërohen nga një kopje e noterizuar e dokumentave të regjistrimit të tyre.

4. Pa rënë ndesh me procedurat e thjeshtuara për kërkesën, një kërkesë që nuk përmbush kushtet e përshkruara në këtë nen dhe që nuk paraqitet në përputhje me aktet nënligjore, konsiderohet e papranueshme.

Neni 235

Depozitimi i një kërkesë të nënshkruar nga kërkuesi tregon se personi i interesuar dëshiron të përdorë regjimin doganor të kërkuar dhe, pa rënë ndesh me zbatimin e mundshëm të dispozitave penale, ai është përgjegjes sipas legjislacionit në fuqi, për:

- a) saktësinë e informacionit të dhënë në kërkesë;
- b) vërtetësinë e dokumenteve që shoqërojnë atë; dhe
- c) përmbushjen e të gjitha detyrimeve në lidhje me regjimin doganor për të cilin ka bërë kërkesë.

Neni 236

1. Përpara lëshimit të autorizimit, autoritetet doganore kompetente për dhënien e tij duhet të sigurohen se të gjithë kushtet për dhënien e autorizimit janë përmbushur.

2. Nuk jepet autorizim nëse kërkesa është e papranueshme.

Neni 237

1. Pa rënë ndesh me procedurat e thjeshtuara për autorizimin, autorizimi për përdorimin e një regjimi doganor ekonomik, në përputhje me nenin

⁸ Shiko nenin 2(7). Ky tekst është rishikuar këtu për lehtësi përdorimi të termave të përkufizuar.

108 të Kodit, bëhet në një model që është sipas dispozitave përkatëse të Anekseve nga 31 deri 35. Ai nënshkruhet dhe në të shënohet data përkatëse.

2. Kërkuesi njoftohet që autorizimi i kërkuar është lëshuar.

3. Autorizimi hyn në fuqi në datën e lëshimit. Megjithatë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në raste të vecanta, mund të lëshojë autorizim me fuqi paravepruese.

4. Autorizimet mund të mbulojnë edhe më shumë se një ze për regjimin e përkatës.

Neni 238

1. Në rastet kur nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet për lëshimin e autorizimit, kërkesa refuzohet.

2. Vendimi për refuzimin e kërkesës bëhet me shkrim dhe i njoftohet kërkuesit sipas nenit 18 (3) të Kodit.

Neni 239

1. Autoritetet doganore ruajnë kërkesat dhe anekset përkatëse, së bashku me cdo autorizim të lëshuar.

2. Në rastet kur është lëshuar një autorizim, kërkesa, anekset dhe autorizimi mbahen nga autoritetet doganore për të paktën tre vjet nga mbarimi i vitit kalendarik në të cilin autorizimi skadon ose, kur është fjala për autorizimet për administrimin e një magazine doganore ose përdorimin e regjimit të magazinimit doganor, për të paktën tre vjet nga mbarimi i vitit kalendarik në të cilin autorizimi është anuluar ose shfuqizuar.

3. Në rastet kur refuzohet një kërkesë apo kur anulohet ose shfuqizohet autorizimi, kërkesa dhe vendimi që refuzon kërkesën apo autorizimin, sipas rastit, dhe të gjithë anekset mbahen nga autoritetet doganore për të paktën tre vjet nga mbarimi i vitit kalendarik në të cilin është refuzuar kërkesa apo është anuluar ose shfuqizuar autorizimi.

KREU 2

Magazinimi Doganor

Neni 240

Në përputhje me Titullin IV, Kreu 2, Seksioni 3C të Kodit, ky Kre përcakton dispozitat për zbatimin e regjimit të magazinimit doganor.

Neni 241

Magazinat doganore në të cilat mallrat vendosen nën regjimin e magazinimit doganor klasifikohen si më poshtë:

- a) *tipi A*: magazina publike për përdorim nga cdo person, me qëllim magazinimin e mallrave nën përgjegjesinë e administratorit të magazinës;
- b) *tipi B*: magazina publike për përdorim nga

cdo person për magazinimin e mallrave nën përgjegjesinë e cdo depozituesi, sipas nenit 125 (1) të Kodit, duke patur parasysh nenin 128 (2) të Kodit;

c) *tipi C*: magazina private të destinuara vetëm për magazinimin e mallrave nga administratori i magazinës, kur ky i fundit dhe depozituesi janë i njëjti person, por jo domosdoshmërisht pronari i mallrave;

d) *tipi E*: magazina private, të destinuara vetëm për magazinimin e mallrave nga administratori i magazinës, kur ky i fundit dhe depozituesi janë i njëjti person por jo domosdoshmërisht pronar i mallrave, sipas një sistemi që lejon magazinimin e mallrave në ambientet e magazinimit që i përkasin mbajtësit të autorizimit, por ku mallrat mund të vendosen nën regjimin e magazinimit doganor pa u ruajtur në një magazinë doganore;

e) *tipi F*: magazina publike për përdorim nga cdo person për magazinimin e mallrave, dhe që administrohet nga autoritetet doganore.

Një ambient nuk mund të jetë më shumë se një lloj magazine doganore në të njëjtën kohë.

Neni 242

1. Me përjashtim të magazinave të tipit E dhe tipit F, magazina doganore duhet të përbëhet nga ambiente të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

2. Në rastet kur autoritetet doganore vendosin të administrojnë një magazinë të tipit F, ato caktojnë ambientet apo vendin që përbën magazinën. Vendimi botohet në formën e zakonshme që perdoret nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për botimin e akteve nënligjore ose administrative të saj.

3. Një ambient i miratuar nga autoritetet doganore si "ambient magazinimi i përkohshëm" ose që administrohet nga autoritetet doganore mund të miratohet gjithashtu si magazinë e tipit A, tipit B ose tipit C ose mund të administrohet si magazinë e tipit F.

Neni 243

Magazinat e tipit C mund të miratohen edhe magazinat për sendet ushqimore për përdorim në bordin e mjeteve të transportit ose *duty free shops*.

Neni 244

Në rastet kur legjislacioni në fuqi parashikon zbatimin e masave të politikave tregtare për:

- a) vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë, këto masa nuk zbatohen për mallrat e vendosura nën regjimin e magazinimit doganor, për sa kohë mallrat mbeten nën këtë regjim;
- b) hyrjen e mallrave në territorin doganor të

Republikës së Shqipërisë, këto masa zbatohen vetëm kur mallrat jo-shqiptare janë vendosur nën regjimin e magazinimit doganor;

- c) eksportimin e mallrave, këto masa zbatohen kur mallrat shqiptare eksportohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë pasi janë vënë nën regjimin e magazinimit doganor.

Neni 245

Dispozitat që lidhen me autorizimin zbatohen për të gjitha tipet e magazinave, përjashtuar tipin F.

Neni 246

Kërkesa për autorizim, në përputhje me Aneksin 26, dorëzohet pranë zyrës doganore që ka kompetencë në territorin ku ndodhen ambientet ose, në rastin e një magazine të tipit E, pranë zyrës doganore që ka kompetencë në territorin ku mbahen librat kontabël themelorë të administratorit të magazinës. Këto autoritete, brenda dy javëve nga data në të cilën është dorëzuar kërkesa, e dërgojnë atë në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, së bashku me mendimin e tyre me shkrim lidhur me lëshimin e autorizimit.

Neni 247

1. Autorizimi mund të lëshohet vetëm nëse kërkuuesi tregon se ekziston një nevojë e reale ekonomike për magazinim dhe nëse magazina në fjalë kërkohet kryesisht për magazinim mallrash; megjithatë, mallrat mund t'u nenshtrohen formave të zakonshme të perpunimit, perpunimit aktiv ose perpunimit nën kontroll doganor në kushtet e pershkruara në nenin 129 dhe 132 të Kodit, me kusht që të tilla perpunime të mos mbizoterojnë mbi magazinimin e mallrave.

2. Pa rënë ndesh me miratimin e magazinave të tipit C, magazinë furnizimi ose *duty free shops*, nuk lejohet shitja me pakice në ambientet e magazines, në mjediset e ruajtjes ose në ndonjë vend tjetër të përcaktuar si magazinë doganore.

Neni 248

1. Autorizimet lëshohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me përjashtim të *duty free shops* të cilët miratohen nga Ministri i Financave në përputhje me nenin 199 të kodit. Autorizimet hyjnë në fuqi në datën e lëshimit ose në një datë të mëvonshme kur autorizimi lejon një gjë të tilla. Autorizimet duhet të behen në formën e pershkruar në Aneksin 31.

2. Për marrjen e një autorizimi për një magazinë doganore kerkohet dhënia e një garancie. Shuma e garancise që depozitohet në asnjë rast nuk duhet të jete me e vogel se 4 milion Leke. Nuk kerkohet dhënia e garancise, kur magazinat doganore janë të tipit F ose kur administrohen nga vetë shteti shqiptar apo autoritete publike shqiptare. Garancia duhet të depozitohet perpara se të jepet autorizimi. Në këtë rast zbatohet neni 207(2) i Kodit.

3. Administratori i magazines duhet të permbushë të gjitha kushtet dhe rregullat e percaktuara në autorizim në lidhje me kontrollin doganor, clirimin e mallrave, regjistrat e magazinimit të mallrave, dhe dispozita të tjera. Në rast se administratori i magazinës nuk përmbush të gjitha këto kushte, kjo gjë sjell heqjen e menjeherëshme të autorizimit dhe të gjithë mallrave të ruajtura në këtë magazinë duhet t'u caktohet menjëherë një destinacion doganor.

4. Një nga kushtet që duhet të përmbushë administratori i magazinës do të jetë siguri për autoritetet doganore i zyrës së nevojshme për punë pa ndonjë shpenzim për ta. Këto lehtesira duhet të perputhen me një standard të caktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

5. Për çdo autorizim paguhet një shumë shërbimi prej 200.000 Leke për çdo periudhë 12 mujore, për të mbuluar shpenzimet administrative të autoriteteve doganore.

6. Pa rënë ndesh me rregullat mbi anulimin, revokimin dhe ndryshimin e autorizimeve, ato janë të vlefshme për një afat kohor të pakufizuar.

7. Autorizimi duhet të percaktojë zyrën doganore përgjegjëse për mbikqyrjen e magazines doganore. Në rastet e magazinave private, autorizimi mund të percaktojë gjithashtu kategorinë e mallrave të cilat lejohen të hyjnë në këtë magazinë.

8. Në rastet kur personi i interesuar kërkon leje për të paraqitur mallra ose i deklaron ato për regjim pranë një zyre të ndryshme nga zyra mbikqyrese, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të autorizojë një ose me shumë zyra për të vepruar si zyre(a) për vendosjen nën regjimin doganor.

Neni 249

1. Konsiderohet se kriteri ekonomik i nevojshëm ka pushuar se ekzistuar, kur personi i interesuar kërkon me shkrim revokimin e autorizimit.

2. Gjithashtu, autorizimi mund të revokohet kur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave gjykon se magazina doganore nuk perdoret në masën e mjaftueshme për të justifikuar egzistencën e saj.

Neni 250

Për qëllim të nenit 251 deri 255, "furnizime" do të thotë mallrat e marra në bordin e anijeve dhe mjeteve ajrore për përdorim në bord apo për shitje udhëtarëve dhe ekuipazhit në bordin e këtyre mjeteve.

Neni 251

1. *Magazinë furnizimi* do të thotë një magazinë e tipit C, e përdorur për magazinimin e furnizimeve për anijet dhe mjete ajrore.

2. Magazina e furnizimit shërben vetëm për magazinimin e mallrave jo-shqiptare dhe mallrave shqiptare të patakshueshëm që përdoren për:

- a) furnizim ose pajisje të anijeve dhe mjeteve

- ajrore në trafik nderkombetar;
- b) shitje në *duty free shops*;
- c) shitje të mallrave jo-shqiptare personave të cilët gëzojnë të drejta, privilegje dhe imunitete siç parashikohet nga Konventa e Vjenës e vitit 1961 për Marrëdhëniet Diplomatike, Konventa e Vjenës e 24 Prill 1963 për Marrëdhëniet Konsullore, apo Konventa e New York e 16 Dhjetorit 1969 për Misionet e Veçanta;

Neni 252

Lejohet magazinimi në një magazinë furnizimi i:

- a) mallrave jo-shqiptare të llojeve si vijon:
 - i) furnizime, përfshi pijet alkoolike e të tjera,
 - ii) duhan dhe produkte të duhanit,
 - iii) cokollata dhe embelsira të tjera,
 - iv) parfume, produkte kozmetike dhe kolonja,
 - v) pajisje për përdorim personal të llojit që normalisht mbahet me vete, p.sh kollare, shall, ore, bizhuteri, lapsa dhe çakmak,
 - vi) mallra që përdoren për pajisjen e anijeve dhe mjeteve ajrore;
- b) mallra shqiptare të pataksueshem të llojeve të mëposhtem:
 - i) furnizime, përfshi pijet alkoolike e të tjera,
 - ii) duhan dhe produkte të duhanit,
 - iii) cokollata dhe embelsira të tjera,
 - iv) parfume, produkte kozmetike dhe kolonja,
 - v) pajisje për përdorim personal të llojit që normalisht mbahet me vete, p.sh kollare, shall, ore, bizhuteri, lapsa dhe çakmak,
 - vi) mallra që përdoren për pajisjen e anijeve dhe mjeteve ajrore.

Neni 253

'Duty free shop' do të thotë një magazinë doganore të tipit C, të përdorur për magazinimin e furnizimeve për t'u shitur mallra udhëtarëve që largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

Neni 254

Lejohet te magazinohen në një *duty free shop*:

- a) mallra jo-shqiptare të llojit të mëposhtem:
 - i) pije alkoolike, vere dhe birra,
 - ii) duhan dhe produkte të duhanit,
 - iii) cokollata dhe embelsira të tjera,

- iv) parfume, prodhime kozmetike dhe kolonje,
- v) pajisje për përdorim personal të llojit që normalisht mbahet me vete, p.sh kollare, shall, ore, bizhuteri, lapsa dhe çakmak,
- vi) punime artizanale dhe suvenire.
- b) mallra shqiptare të pataksueshem të llojit të mëposhtem:
 - i) pije alkoolike, verë dhe birra,
 - ii) duhan dhe produkte të duhanit,
 - iii) cokollata dhe embelsira të tjera,
 - iv) parfume, prodhime kozmetike dhe kolonje,
 - v) pajisje për përdorim personal të llojit që normalisht mbahet me vete, p.sh kollare, shall, ore, bizhuteri, lapsa dhe çakmak,
 - vi) punime artizanale dhe suvenire.

Neni 255

1. *Duty free shops* mund t'u shesin mallra vetëm udhetarëve që largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë. Pijet alkoolike, vera dhe birra mund t'u shitet vetëm personave mbi 18 vjeç. Cigaret mund t'u shiten vetëm personave mbi 15 vjeç.

2. Në përputhje me nenet 156 dhe 158 nuk paraqitet asnjë deklaratë eksporti për mallrat që largohen nga *duty free shops*.

Neni 256

1. Mallrat që duhet të vendosen nën regjimin e magazinimit doganor dhe deklarata përkatëse për vendosjen e mallrave nën këtë regjim, paraqiten pranë zyres mbikqyrese.

2. Për mallrat shqiptare që hyjnë në një *duty free shop* duhet të paraqitet një deklaratë në përputhje me nenet nga 121 deri 161. Deklara duhet të paraqitet në zyrën mbikqyrese.

3. Kur hyrja e mallrave shqiptare në një *duty free shop* ka nevojë të vërtetohet, autoritetet doganore mbikqyrese të *duty free shop* mund të firmosin dhe vulosin faturën e mallrave nëse një gjë e tillë i kërkohet nga personi i interesuar.

Neni 257

Deklarata për vendosjen nën regjimin e magazinimit doganor bëhet në përputhje me nenet 121 deri 161.

Neni 258

Deklarata duhet të zbatohet gjithashtu edhe për transferimin e mallrave nga një vend që është njëkohesisht ambient magazinimi i perkohshëm dhe magazinë doganore.

Neni 259

1. Në magazinat e tipit A, tipit C dhe tipit E, autoritetet doganore autorizojnë administratorin e magazinës të mbajë regjistrat e magazinimit të cilave i referohet neni 128 i Kodit. Regjistrat e magazinimit vihen në dispozicion të zyrës doganore mbikqyrese për të mundësuar kryejn e kontrolleve prej saj.

2. Për magazinat e tipit B, zyra mbikqyrese ruan deklaratat e vendosjes nën regjim, në mënyrë që të mbikqyrë mbylljen e tij. Në këto magazina nuk mbahen regjistra magazinimi. Në rastet kur brenda afatit kufi mallrave të treguara në deklarate nuk u është caktuar një destinacion doganor, zyra mbikqyrese kërkon që mallrave t'u caktohet ky destinacion doganor ose deklarata fillestare për vendosjen e mallrave nën një regjim doganor të zëvendësohet me një deklarate të re duke riprodhuar të gjitha hollësitë e deklaratës së vjetër.

3. Në magazinat e tipit F, gjithë informacioni mbi mallrat mbahet në regjistrat e doganore. Këto regjistra zëvendësojnë regjistrat e magazinimit të mallit sipas nenit 128 të Kodit.

Neni 260

Me përjashtim të magazinave të tipit F, zyra mbikqyrese nuk mban regjistra magazinimi të mallit. Megjithatë, për qëllime administrative ajo mund të mbajë një regjistër të të gjithë deklaratave të pranuar.

Neni 261

Regjistrat e magazinimit të permendura në nenin 105 të Kodit duhet të përmbajnë gjithë hollësitë që nevojiten për zbatimin e duhur dhe mbikqyrjen regjimit. Ato duhet të përmbajnë:

- a) të dhenat e përfshira në kutitë 1, 31, 37 dhe 38 të deklaratës për venien e mallrave në regjim;
- b) referencat e deklaratave nepermjet të cilave mallrave u është caktuar një destinacion doganor duke mbyllur regjimin e magazinimit doganor;
- c) datën dhe referencat e dokumenteve të tjera doganore dhe cdo dokumenti tjetër që ka lidhje me vendosjen në regjim dhe mbylljen e tij;
- d) të dhenat që mundësojnë mbikqyrjen e mallrave, përfshi vendodhjen e tyre dhe hollësira mbi ndonjë transferim mallrash mes magazinave doganore;
- e) të dhenat lidhur me magazinimin e perbashket të mallrave shqiptare dhe jo-shqiptare;
- f) ndonjë detaj tjetër që mund të nevojitet për identifikimin e mallrave;
- g) të dhenat lidhur me format e zakonshme të trajtimit të cilit mallrat mund t'i nënshtrohen;
- h) të dhëna lidhur me zhvendosjen e perkohshme të mallrave nga ambientet e magazinës doganore.

2. Regjistrat e magazinimit duhet të pasqyrojnë në cdo kohë gjendjen e vertete të mallrave që ndodhen ende nën regjimin e magazinimit doganor. Brenda afatit të vendosur nga autoritetet doganore, administratori i magazinës duhet të depozitojë në zyrën mbikqyrese një listë të gjendjes së mallrave të magazinuara.

3. Në rastet kur zbatohet neni 135 (2) i Kodit në regjistrin e magazinimit duhet të shënohet vlera doganore e mallrave para trajtimit.

Neni 262

1. Mallrat e vendosura nën regjimin e magazinimit doganor në magazina të tipit A ose tipit C, shenohen në regjistrat e magazines në përputhje me nenin 130 të Kodit, në kohën që ato fizikisht futen në magazinën doganore, mbi bazën e të dhenave të njohura apo pranuar nga zyra mbikqyrese.

2. Kur mallrat janë vendosur nën regjim në një magazinë të tipit E, regjistrimi në magazinë i permendur në paragrafin 1 bëhet në kohën kur ato mberrijnë pranë ambienteve të magazinimit.

3. Kur magazina doganore shërben gjithashtu si ambient për magazinim të perkohshëm, regjistrimi në regjistrin e magazinës i permendur në paragrafin 1 bëhet në kohën kur mallrat clirohen në vijim të depozitimit të deklaratës për vendosjen e mallrave nën regjimin e magazinimit doganor.

4. Të dhenat e vecanta që lidhen me mbylljen e regjimit duhet të regjistrohen në regjistrin e magazinës në kohën kur mallrat janë cliruar në vijim të paraqitjes së deklaratës që i cakton atyre një destinacion doganor.

Neni 263

Format e zakonshme të trajtimit permendur në nenin 132 (2) të Kodit përshkruhen në Aneksin 36.

Neni 264

1. Personi i interesuar duhet t'i kerkoje rast-pas-rasti zyres mbikqyrese me shkrim autorizim për kryerjen e formave të zakonshme të trajtimit përpara kryerjes së tij.

2. Kërkesa e autorizimit për kryerjen e formave të zakonshme të përpunimit duhet të japë gjithë hollësitë e nevojshme. Kur kërkesa miratohet, zyra mbikqyrese jep autorizimin me anë të nëshkrimit dhe vulosjes së kërkesës. Kërkesat, anekset dhe autorizimi mbahen për të pakten tre vjet nga mbarimi i vitit në të cilin është pranuar kërkesa.

3. Autorizimi për administrimin e një magazine doganore përcakton format e zakonshme të trajtimit të cilat priten të kryhen nën regjimin doganor. Në këtë rast, kërkesa zëvendësohet me njoftimin lidhur me kryerjen e përpunimit.

Neni 265

1. Me kusht që të mos cenohet funksionimi normal, zyra mbikqyrese mund të lejojë ruajtjen e mallrave shqiptare dhe jo-shqiptare në të njëjtin

ambient magazinimi. Megjithë, nuk lejohet që të magazinohen së bashku me mallrat jo shqiptare mallarat shqiptare të mëposhtëme:

- a) pije alkoolike, verë dhe birra;
- b) duhan dhe produkte duhani,

me përjashtim të magazinave të furzimit dhe *duty free shop*.

2. Kur magazinimi i përbashkët i mallrave, përmendur në paragrafin 1, bën të pamundur identifikimin në çdo kohë të statusit doganor të çdo lloji malli, ky magazinim lejohet vetëm në qofte se mallrat janë të barazvlefshëm. Mallra të barazvlefshëm janë ato mallra të cilët futen në të njëjtin nen në Nomenklaturën së Kombinuar, që kanë të njëjtat cilësi tregtare dhe të njëjtat karakteristika teknike.

Neni 266

1. Përpara se të zhvendose perkohesisht mallrat nga ambientet e magazines doganore, personi i interesuar duhet të bëjë, rast pas rasti, kërkesë me shkrim prane zyres mbikqyrese për të kryer një veprim të tillë.

2. Kërkesat për autorizim për zhvendosjen e perkohshme të mallrave duhet të përmbajne të gjitha hollësitë që nevojiten për zbatimin e dispozitave që rregullojnë regjimin e magazinimit doganor. Në rast se kërkesa miratohet, zyra mbikqyrese lëshon autorizimin duke konfirmuar pranimin e kërkesës duke e nënshkruar dhe vulosur atë. Kërkesat, anekset dhe autorizimi mbahen të paktën tre vjet nga mbarimi i vitit në të cilin është dhënë autorizimi.

3. Autorizimi për administrimin e një magazine doganore mund të përcaktojë që mallrat mund të zhvendosen perkohesisht. Në këtë rast, kërkesa zevendesohet me njoftimin e zyrës mbikqyrese për zhvendosjen e perkohshme të mallrave.

Neni 267

1. Për të transferuar mallra midis magazinave doganore pa ndërprerë regjimin e magazinimit doganor, dokumenti DAV, përdoret sipas procedurës së përshkruar në Aneksin 37.

2. Për mallrat e transferuara mes magazinave, pergjegjesia i kalon administratorit të magazines doganore në të cilën do të vendosen mallrat, në rastin kur merr në dorezim mallrat dhe i shenon ato në regjistrin e magazines.

3. Kur mallrat për t'u transferuar kanë kaluar neper format e zakonshme të trajtimit dhe kur zbatohet neni 135 (2) i Kodit, dokumenti DAV për vendosjen në magazine përfshin llojin, vlerën doganore dhe sasinë e mallrave të transferuar.

4. Nuk lejohet transferimi i mallrave pa kryer me parë mbylljen e regjimit në rast se njëra nga magazinat e përfshira është magazinë e tipit B.

Neni 268

1. Administratori i magazines duhet të bëjë inventare të rregullta të të gjithë mallit të ruajtur në magazinë. Inventaret duhet të kryhen të paktën një herë në tre muaj. Zyra mbikqyrese duhet të jetë e pranishme gjatë kryerjes së inventarit. Rezultatet i dërgohen me shkrim zyrës mbikqyrese brenda tre ditëve pas kryerjes së inventarit. Ky nën zbatohet *mutatis mutandis* për magazinat të tipit F të administruara nga autoritetet doganore.

2. Procedura e përshkruar në paragrafin 1 zbatohet gjithashtu edhe për magazinat e furnizimit dhe *duty free shops*, me të vetmin përjashtim që inventarët duhet të kryhen një herë në muaj.

Neni 269

1. Kur magazinohen bashkarisht mallra të barazvlefshëm, mallrat e deklaruar për një destinacion doganor mund të konsiderohen ose mallra shqiptare ose jo-shqiptare, në varësi të zgjedhjes së personit të interesuar. Zbatimi i rregullit mësipërm, në asnjë rast nuk duhet të sjellë si pasojë dënimin e një statusi doganor të caktuar një sasi mallrash me të madhe se sasia që ka në fakt këtë status, e cila ruhet në magazinën doganore kur mallrat e deklaruar për një destinacion doganor zhvendosen.

2. Në rastet e shkatërrimit të plote apo humbjes së pakthyeshme të mallrave, pjesa e mallrave që vendosen nën regjim dhe që është shkatërruar apo ka humbur përcaktohet në përpjestim me sasinë e mallrave të të njëjtit lloj që ndodhen nën regjim në ambientet e magazines doganore në kohën kur ka ndodhur shkatërrimi apo humbja, përveç kur administratori i magazines është në gjendje të paraqesë prova mbi sasinë e vërtetë të mallrave nën regjim që u shkatërruan apo humben.

Neni 270

1. Në rastet kur autoritetet doganore kërkojnë që mallrat shqiptare të cilat ruhen në ambientet e një magazine doganore të shënohen në regjistrin e magazines, ky veprim duhet të qartësojë statusin e tyre doganor.

2. Pa rënë ndesh me mallrat e barazvlefshëm, zyra mbikqyrese mund të përcaktojë metoda të vecanta për identifikimin e mallrave shqiptare, kryesisht me qëllim dallimin e tyre nga mallrat jo-shqiptare që janë vënë nën regjimin e magazinimit doganor në të njëjtat ambiente.

3. Mallrat e përmendur në paragrafin 1 mund të përdoren për forma të zakonshme trajtimi, përpunim aktiv apo përpunim nën kontrollin doganor.

Neni 271

Drejtoria e Përgjithshme e doganave mund të përcaktojë udhëzime për zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor.

KREU 3

Përpunimi aktiv

Seksioni 1

Dispozita të përgjithshme

Për qëllim të nenit 272 deri 325⁹:

- a) "Produkte kompensuese kryesore" do të thotë: produktet kompensuese për përfutimin e të cilave është dhënë autorizim për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv;
- b) "Produkte kompensuese dytësore" do të thotë: produkte kompensuese, të ndryshme nga ato kryesore, të cilët përftohen domosdoshmërisht si produkt shoqërues gjatë operacioneve të përpunimit;
- c) "Humbje(/firo)" do të thotë: pjesa e mallrave të importuara të cilat shkatërrohen dhe humbasin gjatë përpunimit, veçanërisht për shkak të avullimit, tharjes, çlirimit në trajtë gazi ose nga shplarja;
- d) "Metoda e matjes sasiore" do të thotë: llogaritja e asaj pjese të mallrave të importuara të trupëzuara në produkte të ndryshme kompensuese në raport me sasinë e mallrave të importuara;
- e) "Metoda e matjes mbi bazën e vlerës" do të thotë: përllogaritja e asaj pjese të mallrave të importuara të trupëzuara në produktet të ndryshme kompensuese në raport me vlerën e këtyre të fundit;
- f) "Operator" do të thotë: personi që kryen të gjithë ose një pjesë të operacioneve të përpunimit;
- g) "Afati i ri eksportimit" do të thotë: afati brenda të cilit produkteve duhet t'u caktohet një destinacion doganor siç përkrahëhet në nenin 112 të Kodit;

Neni 272

Në përputhje me pjesën IV, kreu 2, seksioni 3D të Kodit, ky kre përcakton dispozitat për zbatimin e regjimit të përpunimit aktiv.

Neni 273

Mallrat e referuara në nenin 136 (2)(c) të Kodit, të cilat mund të përdoren si produkte shtesë renditen në Aneksin 38.

Seksioni 2

Dhënia e autorizimit

Neni 274

1. Autorizimi për sistemin me pezullim jepet vetëm kur kërkuesi ka synimin të rieksporitoje

⁹ Shiko nenin 2(8). Ky tekst është rishikuar këtu për lehtësi përdorimi të termave të përkufizuar.

produktet kompensuese parësore nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë. Në keto raste, përdorimi i sistemit me pezullim mund të autorizohet për të gjitha mallrat që do të përpunohen.

2. Autorizimi për të përdorur sistemin e rimbursimit jepet vetëm në rastet të cilave u referohet neni 145 i Kodit, kur ekzistojnë mundësitë për të eksportuar jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë produktet kompensuese parësore.

3. Kur plotësohen kushtet për përdorimin e të dy sistemeve, kërkuesi mund të kërkojë që autorizimi të jetë parashikuar si sistemin me pezullim ashtu edhe për atë me rimbursim.

4. Për qëllim të nenit 138 (b) të Kodit, autoritetet doganore duhet të caktojnë mënyrat e identifikimit të mallrave të importit në produktet kompensuese. Autoritetet doganore duhet të përdorin kryesisht mënyrat e mëposhtme, sipas rastit:

- a) tregimin ose përshkrimin e markave të vecanta ose numrave të fabrikimit;
- b) vendosjen e plumbcit, vulave, shenjave lidhëse;
- c) marrje mostrash, ilustrime, ose përshkrime teknike;
- d) kryerje analizash;
- e) shqyrtimin e regjistrave të magazinimit ose dokumente të tjerë mbështetës lidhur me transaksionin në fjalë, të cilët tregojnë qartë që produktet kompensuese janë prodhuar nga mallrat e importit.

Neni 275

1. Kushtet ekonomike të përshkruara në nenin 138 (b) të Kodit gjykohen të plotësuar mes të tjerash kur:

- a) përpunimi konsiston në njërin prej veprimeve të mëposhtme me kodet perkatese:
 - i) veprime të kryera në kuadrin e punimit në bazë të një kontratë porosie, kontraktuar me një person i cili është i vendosur në një vend tjetër. "Kontrate porosie" do të thotë çdo përpunim kryer në bazë të udhëzimeve dhe për llogari të një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, zakonisht vetëm kundrejt pagesës së shpenzimeve të transformimit të mallrave të importuara drejtpërdrejt ose tërthorazi të vendosura në dispozicion të mbajtësit të autorizimit (kodi 6201);
 - ii) operacione lidhur me mallra me natyrë jo tregtare (kodi 6202);
 - iii) riparime, përfshi këtu edhe kontrolle dhe riparime kapitale (kodi 6301);

- iv) forma të zakonshme trajtimi me synim ruajtjen e mallrave, përmirësimin e paraqitjes ose cilësisë të tregtimit ose përgatitjen e tyre për shpërndarje ose rishitje (kodi 6302) ,
 - v) operacione lidhur me mallra, vlera e të cilave në bazë të Kodit 8 shifror të nomeklaturës së kombinuar, nuk kalon shumë 50 000 000 Lekë për çdo kërkues e për çdo vit kalendarik, pavarësisht nga numri i operatorëve që kryejnë veprime përpunimi. Kjo vlerë është vlera doganore e mallrave e përcaktuar në bazë të dhënash të njohura dhe dokumentave të paraqitura në kohën kur depozitohet kërkesa. Kjo pikë mund të moszbatohet për mallra importi, të caktuara me urdhër të Ministrit të Financave (6400),
 - vi) operacione përpunimi të kryera në zona të lira ose në magazina të lira ;
- b) kur në Republikën e Shqipërisë nuk prodhohen mallra të krahasueshme; “mallra të krahasueshme” do të thotë mallra që klasifikohen në të njëjtin kod 8 shifror të Nomenklaturës së Kombinuar, që paraqesin të njëjtat cilësi tregtare dhe kanë të njëjtat karakteristika teknike, në krahasim me produktet kompensuese (kodi 6101);
- c) kur mallra të krahasueshme të perkufizuara në shkronjën (b) me sipër nuk prodhohen në Republikën e Shqipërisë në sasi të mjaftueshme (kodi 6102);
- d) kur mallra të krahasueshme të perkufizuara në shkronjën (b) me sipër nuk mund të vihen në dispozicion të kërkuesit nga prodhuesi të vendosur në Republikën e Shqipërisë brenda afatesh të pershtatshme. Keto mallra quhet se nuk janë paraqitur brenda “afatesh të pershtatshme” në rast se prodhuesi të vendosur në Republikën e Shqipërisë nuk mund t’i vënë mallrat e krahasueshme në dispozicion të operatorit në afatin e duhur për kryerjen e operacionit tregtar, megjithatë kërkesa perkatese është bërë në kohën e duhur (6103);
- e) kur mallra të krahasueshme, të perkufizuara në shkronjën (b) me sipër nuk prodhohen në Republikën e Shqipërisë, por që nuk mund të përdoren për arsye se:
- i) çmimi i tyre e ben ekonomikisht të pamundur veprimin tregtar të parashikuar, duke patur parasysh (6104):
 - nga njëra anë, përpara kryerjes së formaliteteve doganore, çmimin perkates të mallrave të destinuar t’i nënshtrohen përpunimit aktiv dhe çmimin e mallrave të krahasueshme të prodhuara në Republikën e Shqipërisë me detyrimet e brendshme të rimbursuara ose për t’u rimbursuar me rastin e eksportimit të mallrave. Për krahasimin e çmimeve të mesipërme mbahen parasysh edhe kushtet e shitjes së mallit, në vecanti kushtet e pagesës dhe të dorezimit të parashikuara për mallra shqiptare,
 - nga ana tjetër, çmimin që mund të merret për produktet kompensuese në tregun e një vendi të trete, ose
 - ii) nuk kanë cilësitë ose karakteristikat e nevojshme për të mundësuar operatorin të prodhojë produktet kompensuese të kërkuara (6105),
 - iii) nuk përputhen me kërkesat e shprehura nga blerësi i produkteve kompensuese (6106);
 - iv) produktet kompensuese duhet të përfitohen prej mallrave të importit në mënyrë që të respektohen dispozitat lidhur me mbrojtjen e të drejtave të pronësive industriale (6107);
- f) kur për një lloj të vecantë malli për t’u vendosur nën regjim brenda një afati të caktuar, kërkuesi i autorizimit:
- i) përpiqet të parandalojë probleme furnizimi për atë lloj malli, të cilat duhet të provohen bindshëm autoriteteve doganore, dhe nëse pjesa e furnizimit të mallit të prodhuar në Republikën e Shqipërisë është 80% me e ulët sesa nevojat e tij (7002);
 - ii) provon përpara autoriteteve doganore që ka marrë masat e nevojshme për të marrë furnizim me mallrat për t’u përpunuar brenda Republikës së Shqipërisë, por nuk ka marrë asnjë përgjigje nga prodhuesit shqiptarë (7002);
2. Kërkuesi duhet të tregojë në kërkesë arsyet për të cilat në kuptimin e paragrafit 1, kushtet ekonomike janë përmbushur.
- Neni 276
1. Në rrethanat të jashtëzakonshme, kur kërkuesi gjykon që janë përmbushur kushtet ekonomike për arsye të ndryshme nga ato të përmendura më sipër, ai duhet të paraqesë keto arsye në kërkesën perkatese (kodi 8000).
2. Kur autoritetet doganore gjykojnë që kushtet ekonomike janë përmbushur në raste të tjera prej atyre të përmendura më sipër, autorizimi jepet për një periudhë të kufizuar, jo më të gjatë se 9 muaj. Autoritetet doganore, me kërkesë të mbajtesit të autorizimit, mund të zgjasin periudhën e vlefshmerisë.

Neni 277

1. Pa rënë ndesh me procedurën e thjeshtëzuar, kërkesa të cilës i referohet neni 276 bëhet në përputhje me nenin 234 dhe sipas modelit të pasqyruar në Aneksin 27 dhe paraqitet nga personi të cilit i jepet autorizimi.

2. Kërkesa i paraqitet Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

3. Për qëllim të fjalise se dyte të nenit 138 (a) të Kodit, "*importe te natyres jo tregtare*" do të thotë importi i mallrave sipas nenit 1(5).

Neni 278

1. Pa rënë ndesh me procedurën e thjeshtëzuar për autorizimin, autorizimi lëshohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe përpilohet sipas modelit të pasqyruar në Aneksin 32. Ai nënshkruhet dhe i vendoset data. Autorizimet hyjne në fuqi në datën e lëshimit. Megjithatë, në rastet jashtëzakonshme, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të lëshojë autorizime me fuqi prapavepruese. Sidoqoftë, efekti prapaveprues i një autorizimi të tillë nuk mund të kapërcejë ditën kur është depozituar kërkesa. Autorizimet mund të mbulojnë edhe me shume se një vendosje mallrash në regjimin e kerkuar.

2. Cdo autorizim duhet të shoqërohet nga një formular i quajtur Regjister Importi për Përpunimin Aktiv që është pjesë përbërëse e cdo autorizimi, modeli i së cilës paraqitet në Aneksin 32. Çdo vendosje e mallrave në regjim duhet të regjistrohet në këtë formular në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

3. (a) për të siguruar zbatimin e sakte të dispozitave që rregullojnë regjimin, autoritetet doganore mund t'i kërkojnë mbajtësit të autorizimit të mbaje ose të sigurojë mbajtjen e regjistrave të magazinimit të mallit, që tani e në vijim do të quhen shkurt "*regjistra të perpunimit aktiv*", të cilat tregojnë sasinë e mallrave të importuara të vendosura në regjim dhe sasinë e produkteve kompensuese të perfutuara, si dhe gjithë hollësitë e nevojshme për kontrollin e operacioneve dhe përlogaritjen e sakte të detyrimeve doganore të importit të cilat duhet të paguhet;

(b) "regjistrat e perpunimit aktiv" duhet të vihen në dispozicion të zyres doganore mbikqyrese në mënyrë që kjo e fundit të mund të kryejë kontrollet e nevojshme për të siguruar zbatimin e duhur të regjimit. Kur operacionet e perpunimit kryhen në më shumë se një ndermarrje, regjistrat e magazinimit të mallit duhet të tregojnë në cdo kohë informacionin që lidhet me zbatimin e regjimit në cdo ndermarrje.

Neni 279

Periudha e vlefshmerise se autorizimit vendoset nga

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bazë të kushteve ekonomike dhe nevojave të vecanta të kerkuesit. Kur periudha gjatë së cilës është i vlefshëm autorizimi është me e gjatë se tre vjet, kushtet në bazë të të cilave është lëshuar autorizimi rishikohen periodikisht në intervalet e caktuara në autorizim.

Neni 280

1. Kur lëshon një autorizim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave percakton edhe afatin brenda të cilit produktet kompensuese duhet të rieksporthen në përputhje me nenin 139 të Kodit, duke marrë parasysh kohën e nevojshme për të kryer operacionet e perpunimit sic tregohet në autorizim për një sasi të caktuar mallrash, sasinë e autorizuar të mallrave të importuara në regjim, si dhe kohën brenda të cilës produkteve kompensuese u duhet caktuar një destinacion doganor.

2. Kur mbajtësi i autorizimit ben një kerkese të arsyetuar për zgjatje afati, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të zgjase afatin e caktuar për rieksportim.

Neni 281

Afati brenda të cilit produktet kompensuese duhet të rieksporthen fillon nga data e pranimit të deklarates për vendosjen e mallrave në regjim, ose në sistemin me rimbursim, nga dita e pranimit të deklarates për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë.

Neni 282

1. Koeficienti i shfrytëzimit sic është perkufizuar në nenin 136(2)(e) të Kodit ose menyra e percaktimit të koeficientit të permendur në nenin 140 të Kodit vendoset për atë sa është e mundur në bazë të të dhënave të prodhimit dhe duhet të jetë i identifikueshëm në regjistrat që mbahen nga operatori.

2. Koeficienti ose menyra e percaktimit të tij caktohet në bazë të paragrafit 1 dhe i nënshtrohet verifikimit të mëvonshëm nga autoritetet doganore.

Neni 283

1. Koeficientet standarte të shfrytëzimit të cilave u referohet paragrafi 2 zbatohen vetëm për mallrat e importit cilesitë e të cilave janë në përputhje me standardet e cilësisë të percaktuara nga lrgjislacioni shqiptar përkatës.

2. Kur kryhen operacione të perpunimit aktiv mbi mallrat e importuara që renditen në kolonën 1 të Aneksit 39, që japin si rezultat produkte kompensuese të renditura në kolonat 3 dhe 4, atëherë si koeficient standart të shfrytëzimit do të merren ato të pasqyruara në kolonën 5 të këtij Aneksi.

Neni 284

1. Një procedurë e thjeshtëzuar autorizimi mund të ndiqet për rastet e mëposhtme:

- a) operacione që përfshijnë mallra të natyrës jo tregtare;
 - b) riparime, përfshirë kontrolle të përgjithshme dhe riparime;
 - c) operacione përpunimi të kryera në zonë të lirë ose në magazina të lira.
2. Në këto raste cdo zyre doganore e autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për të dhene autorizime duke përdorur procedurën e thjeshtuar, lejon depozitimin e një deklarate për vendosje nën regjim, në kuadrin e sistemit me pezullim, ose depozitimin e deklaratës për vendosjen në qarkullim të lire me sistemin me rimbursim që në këtë rast do të luaje rolin e kërkesës për autorizim. Në raste të tilla, pranimi i deklaratës përbën dhënien e autorizimit.
3. Deklaratat e paraqitura sipas paragrafit 2, me përjashtim të rasteve kur këto të dhëna mund të shënohen në kutinë 44 të formularit të përdorur për vetë deklaratën, shoqërohen nga një dokument i paraqitur nga vetë deklaruesi e që përmban të dhënat e mëposhtme:
- a) emrin ose emrin e shoqërisë dhe adresën e kërkuarit, kur personi që ben kërkesë për të përdorur një regjim nuk është vetë deklaruesi;
 - b) emrin e shoqërisë dhe emrin ose adresën e operatorit kur operatori nuk është vetë kërkuar ose deklaruesi;
 - c) natyrën e veprimeve të përpunimit;
 - d) përshkrimin tregtar dhe/ose teknik të produkteve kompensuese;
 - e) koeficientin e shfrytëzimit të parashikuar dhe kur është rasti, mënyra me të cilën ky koeficient duhet të përllogaritet;
 - f) koha e parashikuar për rieksporim;
 - g) vendi ku mendohet të kryhen veprimet e përpunimit.
4. Depozitimi i deklaratës në kuadrin të procedurave të thjeshtuara për kërkesat e nënshkruar nga kërkuar duhet të tregojë që personi i interesuari dëshëron të përdorë regjimin doganor të kërkuar dhe pa rënë ndesh me zbatimin e mundshëm të legjislacionit penal, sipas ligjeve në fuqi personi është përgjegjës për:
- a) saktësinë e të dhënave në deklaratë;
 - b) vërtetësinë e dokumentave që e shoqërojnë deklaratën; dhe
 - c) përmbushjen e gjithë detyrimeve lidhur me regjimin doganor për të cilin është bërë kërkesë.
5. Autoritetet doganore, nëse është rasti mbajnë deklaratën me anekset përkatëse, bashkë me autorizimet e lëshuara,

6. Kur jepet një autorizim, kërkesa, anekset dhe autorizimi mbahen nga autoritetet doganore për të paktën 3 vjet nga fundi i vitit kalendarik në të cilin skadon autorizimi.

7. Kur refuzohet një kërkesë, ose autorizimi anulohet ose shfuqizohet, kërkesa dhe ose vendimi refuzues ose autorizimi, sipas rastit, dhe gjithë anekset mbahen nga autoritetet doganore për të paktën 3 vjet nga mbarimi i vitit kalendarik në të cilin u refuzua kërkesa ose u anulua apo revokua autorizimi.

Seksioni 3

Dispozita lidhur me sistemin me pezullim

Neni 285

1. Deklarata për vendosjen e mallrave për përpunim aktiv (sistemi me pezullim) depozitohet në njërin nga zyrat doganore të vendosjes nën regjim sic tregohet në autorizim.

2. Kur përdoret procedura e thjeshtuar, deklarata e përmendur në paragrafin 1 duhet të depozitohet në zyrën doganore të autorizuar për këtë qëllim.

Neni 286

1. Deklarata për vendosjen e mallrave nën regjimin e përpunimit aktiv (sistemi me pezullim) bëhet në përputhje me nenin 121 deri 161.

2. Pa rënë ndesh me procedurën e thjeshtuar për kërkesat, përshkrimi i mallrave në deklaratën e përmendur në paragrafin 1 duhet të përputhet me specifikimet e dhëna në autorizim.

3. Çdo deklaratë importi duhet të përmbajë kodin IM 5 në kutinë 1 të deklaratës dhe numrin e datën e autorizimit për përpunim aktiv në kutinë 44. Formulari Regjistri i Eksportimit për Përpunim Aktiv siç është përshkruar në Aneksin 32 duhet të lëshohet për çdo deklaratë që vendos mallrat në regjim dhe është pjesë përbërëse e kopjes së deklaratës që mbahet nga autoritetet doganore. Të gjitha eksportet duhet të regjistrohen në këtë formular në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Kopja e deklaratës së importit që mban dogana së bashku me të gjithë dokumentat që i bashkëngjiten, do të mbahen pas çlirimit të dërgesës në një dosje të vecantë për çdo shoqëri të autorizuar të përdorë regjimin e përpunimit aktiv.

4. Për qëllim të nenit 87 (2) të Kodit, dokumentet që shoqërojnë deklaratën janë ato që parashikohen në nenin 145.

Neni 287

1. Në vijim të nenit 112 të Kodit, regjimi i përpunimit aktiv (sistemi me pezullim) mbyllet kur produktet kompensuese ose mallrat në gjendje të pandryshuar janë deklaruar për një destinacion të ri doganor dhe janë respektuar gjithë kushtet e tjera për përdorimin e regjimit.

2. Ne funksion të mbylljes së regjimit të përpunimit aktiv (sistemi me pezullim), quhet eksport nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dërgimi i produkteve kompensuese personave që përfitojnë përjashtime nga detyrimi doganor, në bazë të Konventës së Vjenës datë 18 prill 1961 mbi Marrëdhëniet Diplomatike, Konventës së Vjenës të datës 24 prill 1963 për Marrëdhëniet Konsullore dhe konventa të tjera me përmbajtje konsullore, ose Konventa e New York e datës 16 dhjetor 1969 mbi Misionet Speciale.

3. Mbyllja e regjimit kryhet ose mbi bazën e sasisë së mallrave të importit të cilave u korrespondojnë produktet kompensuese të cilave u është caktuar njëri nga destinacionet doganore të përmendura në paragrafin 1 ose 2, ose mbi bazën e sasisë së mallrave në gjendje të pandryshuar, të cilave u është caktuar njëri prej destinacioneve në fjalë.

4. Deklarata për vendosjen e produkteve kompensuese ose mallrave në gjendje të pandryshuar në njërin prej destinacioneve doganore përmban gjithë hollësitat që nevojiten për mbylljen e procedurës.

Neni 288

1. Kur për shkak rrethanash të paparashikueshme ose force madhore, natyra dhe /ose karakteristikat teknike të mallrave të importit pesojnë ndryshime për shkak të cilave nuk mund të përfitohen produktet kompensuese për të cilat është leshuar një autorizim përpunimi aktiv (sistemi me pezullim), mbajtësi i autorizimit duhet të njoftojë menjëherë zyrën doganore mbikqyrese për sa ka ndodhur.

2. Në rastet kur ndryshimi në fjalë mund të cenojë mbajtjen e autorizimit ose thelbin e tij, paragrafi 1 përdoret vetëm nëse nuk bie ndesh me nenet 20 dhe 110 (2) të Kodit.

3. Ky nen zbatohet *mutatis mutandis* edhe për produktet kompensuese.

Neni 289

1. Pa rënë ndesh me masat e politikës tregtare që zbatohen për mallrat e importit, vendosja në qarkullim të lirë e mallrave në gjendje të pandryshuar ose produkteve kompensuese parësore lejohet vetëm kur personi i interesuar nuk është në gjendje t'u caktojë këtyre mallrave ose produkteve një destinacion doganor i cili lejon të mos paguhen detyrime doganore importi. Në këtë rast vendosja në qarkullim të lirë sjell si pasoje që mallrat i nënshtrohen pageses së interesit kompensues.

2. "Interes kompensues" do të thotë interesi të cilit i referohet nenin 229 (3) i Kodit, i përllogaritur në përputhje me nenin 293.

Neni 290

1. Produktet kompensuese ose mallrat në gjendjen të pandryshuar, të cilëve duhet t'u caktohet një destinacion doganor, paraqiten në

zyrën e mbylljes së regjimit, në mënyrë që t'i nënshtrohen formaliteteve doganore të destinacionit doganor në fjalë sipas dispozitave të përgjithshme të zbatueshme për rastin.

2. Deklarata për mbylljen e një regjimi të përpunimit aktiv (sistemi me pezullim) depozitohet në zyrën doganore mbikqyrese të caktuar në autorizim.

Neni 291

1. Deklarata për mbylljen e regjimit të përpunimit aktiv (sistemi me pezullim) përpilohet në përputhje me dispozitat që rregullojnë destinacionin doganor përkatës.

2. Përshkrimi i produkteve kompensuese ose mallrave në gjendje të pandryshuar në deklaratën e mbylljes së regjimit duhet të përputhet me veçantitë e autorizimit.

3. Për qëllim të nenit 87 (2) të Kodit, dokumentet që shoqërojnë deklaratat mbyllëse, janë ato dokumenta, paraqitja e të cilave nevojitet për të vendosur mallrat nën regjimin e kërkuar.

Neni 292

1. Detyrimet e importit që duhet të paguhen sipas nenit 141 (1) të Kodit mbi mallrat e importit, në kuadër të një trajtimi tarifor favorizues për arsye të përdorimit të tyre veçantë, do të përllogariten, edhe pse nuk është kërkuar ndonjë autorizim për trajtim të veçantë, me tarifën që i korrespondojnë këtij trajtimi në kohën kur deklarata për vendosje në regjim ka qënë pranuar, me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kërkesat në lidhje me dhënien.

2. Paragrafi 1 zbatohet vetëm kur mallrat kanë qënë vendosur në përdorimin e vecantë që i cilëson ato për trajtim tarifor favorizues përpara përfundimit të afatit kohor të vendosur për këtë qëllim nga dispozitat që rregullojnë kushtet në të cilat këtyre mallrave mund t'u jepet trajtimi në fjalë. Afati kohor fillon nga casti i pranimit të deklaratës për vendosje në regjim. Ai mund të zgjatet nga autoritetet doganore, kur mallrat nuk kanë qënë vendosur dot në përdorimin e vecantë në fjalë për shkak të rrethanave të paparashikuara, forcave madhore, ose kërkesave të pashmangshme teknike të operacioneve përpunuese.

Neni 293

Në përputhje me nenin 143 të Kodit, kur produktet kompensuese vendosen në qarkullim të lirë, dhe borxhi doganor përllogaritet në baze të elementeve perkates të taksimit të mallrave të importit, kutitë 15, 16, 34 dhe 41 të deklarates duhet t'i referohen mallrave të importit.

Neni 294

Shkatërrimi i produkteve kompensuese nën kontrollin doganor trajtohet si eksport prej territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 295

1. Kur lind një borxh doganor lidhur me produkte kompensuese ose mallra në gjendjen e tyre të pandryshueshme, interesi kompensues duhet të paguhet në bazë të detyrimit doganor të importit që zbatohet në rastin konkret.

2. Paragrafi 1 nuk zbatohet kur:

- a) borxhi doganor lind si rezultat i zbatimit të një trajtimi tarifor preferencial, në kuadër të një marreveshjeje midis Republikës së Shqipërisë dhe një vendi tjetër, lidhur me importet për në atë vend;
- b) hedhurinat dhe mbetjet të cilat dalin prej shkatërrimit në kuadrin e nenit 197 të Kodit, janë vendosur në qarkullim të lirë;
- c) interesi kompensues që përlllogaritet sipas paragrafit 4 nuk kapërcen 2 000 Lekë për deklaratë për vendosje në qarkullim të lirë;
- d) mbajtësi i autorizimit kërkon vendosje në qarkullim të lirë dhe paraqet prova që rrethana të caktuara, të cilat nuk janë pasojë e ndonjë neglizhence ose hileje nga ana e tij, e bëjnë të pamundur ose joekonomike kryerjen e veprimeve të eksportit në kushtet që ai kishte planifikuar kur kishte paraqitur kërkesë për autorizim;
- e) lind një borxh doganor, si rezultat i një kërkesë për vendosje në qarkullim të lirë sipas nenit 149 të Kodit, për sa kohë që detyrimet doganore të importit të produkteve në fjalë nuk janë rimbursuar ose shuar.

3. (a) Niveli i interesit vjetor përcaktohet nga Ministri i Financave në bazë mesatare aritmetike të niveleve afat shkurtër përfaqësuese të të njëjtit 6 mujor të vitit të mëparshëm. Ato zbatohen për gjithë borxhin doganor të lindur gjatë një periudhe 6 mujore. Niveli i interesit duhet të botohet të paktën një muaj përpara se të bëhet i zbatueshëm.

(b) Interesat zbatohen në baze mujore dhe për periudhën që fillon nga dita se pare e muajit që ndjek muajin në të cilin është pranuar deklarata e importit deri në ditën e fundit të muajit në të cilin ka lindur borxhi doganor. Kur sipas nenit 149 (4) të Kodit është kërkuar vendosje në qarkullim të lirë, periudha që merret në konsideratë është ajo që fillon nga dita e parë e muajit që ndjek muajin në të cilin u rimbursuan ose u shuan detyrimet doganore përkatëse deri në ditën e fundit të muajit në të cilin lindi borxhi doganor;

(c) Shuma e interesit përlllogaritet në baze të detyrimeve të importit, në baze të nivelit të interesit të referuar në sipër ne paragrafin (a), dhe në baze të periudhës të referuar më sipër ne paragrafin (b).

4. Në rast të veçanta, me vendim të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, mund të përdoren metoda të thjeshtuara me kërkesën e personit të interesuar për llogaritjen dhe kontabilizimin e interesave kompensuese.

Neni 296

1. Kur është nevoja që të përcaktohen detyrimet doganore të importit që duhen paguar, ato llogariten sipas pjesës së mallrave të importit të trupëzuara në produktet kompensuese. Kjo përlllogaritje nuk kryhet, veçanërisht kur, mes të tjerash, shuma e detyrimit doganor përcaktohet vetëm në bazë të nenit 143 të Kodit.

2. Përlllogaritjet kryhen në përputhje ose me metodën sasiore, ose me metodën e llogaritjes sipas vlerës, ose me mënyra të tjera që japin të njëjtin rezultat në bazë të shembujve të pasqyruar në Aneksin 40.

Neni 297

Metoda e matjes sasiore (produkte kompensuese) përdoret kur nga operacionet e perpunimit aktiv del një lloj i vetëm produktesh kompensuese. Në këtë rast, sasia e mallrave të importit që i korrespondon sasisë së produkteve kompensuese për të cilat ka lindur një borxh doganor, përlllogaritet duke zbatuar për sasinë totale të mallrave në fjalë, një koeficient i cili i korrespondon raportit mes sasisë të produkteve kompensuese për të cilat ka lindur një borxh doganor, dhe sasisë totale të produkteve kompensuese.

Neni 298

1. Metoda e matjes sasiore (mallra importi) do të zbatohet kur të gjithë elementët e mallrave të importuara gjenden në secilin prej produkteve kompensuese.

2. Për të vendosur nëse zbatohet kjo metodë, nuk merren parasysh firot.

3. Sasia e mallrave të importit, të përdorura në prodhimin e çdo produkti kompensues, përcaktohet duke zbatuar në mënyrë të njëpasnjëshme mbi sasinë të mallrave të importuara një koeficient, që i korrespondon raportit të sasisë së mallrave në fjalë që gjenden në secilin lloj të produkteve kompensuese me sasisë totale të këtyre mallrave të gjendura në produktet kompensuese në tërësi.

4. Sasia e mallrave të importit të cilat i korrespondojnë sasisë së produkteve kompensuese lidhur me të cilat lind një borxh doganor, përcaktohet duke zbatuar koeficientin që i korrespondon raportit të sasisë së produkteve kompensuese, në lidhje me të cilët lind një borxh doganor, me sasinë e mallrave të importuara të përdorura në fabrikimin e produkteve në fjalë përlllogaritur në përputhje me paragrafin e tretë më sipër.

Neni 299

1. Kur nuk zbatohet metoda e matjes sasiore, për

gjithë rastet zbatohet metoda e matjes në baze vlerë.

2. Në mënyrë që të përcaktohet sasia e mallrave të importit të përdorura në fabrikimin e çdo lloji produkti kompensues, koeficientët e njëpasnjëshëm që i korrespondojnë raportit mes vlerës së çdo produkti kompensues, dhe vlerës totale të këtyre produkteve, përlogaritur në përputhje me paragrafin 3, do të zbatohen për sasinë totale të mallrave të importit.

3. Vlera e secilit prej produkteve kompensuese për t'u përdorur për zbatimin e metodës së matjes mbi bazën e vlerës është:

- a) cmimi i fundit i shitjes së produkteve të ngjashme ose identike në Republikën e Shqipërisë, me kusht që ky cmim të mos jetë ndikuar nga marrëdhënia mes blerësit dhe shitësit, ose,
- b) kur një cmim i tillë nuk njihet,
- c) cmimi i fundit *ex æorks* në Republikën e Shqipërisë, me kusht që ky cmim të mos jetë ndikuar nga marrëdhënia mes blerësit dhe shitësit.

Kur vlera nuk mund të përcaktohet duke zbatuar metodat e mësipërme, ajo përcaktohet nga zyra doganore mbikqyrese duke përdorur një metodë të arsyeshme.

4. Sasia e mallrave të importuara që i korrespondon sasisë së produkteve kompensuese në lidhje me të cilat ka lindur një borxh doganor do të llogaritet duke zbatuar koeficientin që gjendet nga përdorimi i metodës së matjes sasiore për produktet kompensuese, mbi sasinë e mallrave të importuara që janë përdorur në fabrikimin e produkteve në fjalë, përlogaritur në përputhje me paragrafin 2.

Neni 300

1. Mbajtësi i autorizimit duhet të paraqesë zyrën doganore mbikqyrese dokumentin e mbylljes së regjimit.

2. Dokumenti i mbylljes së regjimit mes të tjerash duhet të përmbajë:

- a) referencat e autorizimit;
- b) sasinë e çdo lloji malli importi dhe referencat e deklaratave për vendosjen e tyre në regjim;
- c) kodin e nomenklaturës së kombinuar të mallrave të importit;
- d) vlerën doganore të mallrave të importit dhe nivelin e detyrimeve doganore të importit për mallrat në fjalë;
- e) koeficientin e caktuar të shfrytëzimit;
- f) natyrën dhe sasinë si dhe destinacionin doganor që iu është dhënë produkteve kompensuese, bashkë me referencat e

deklaratave në baze të cilave produkteve kompensuese iu është dhënë një destinacion përkatës doganor;

- g) vlerën e produkteve kompensuese, nëse për mbylljen e regjimit përdoret metoda e matjes në baze të vlerës;

3. Dokumenti i mbylljes së regjimit i dërgohet zyres mbikqyrese brenda 30 ditësh nga mbarimi i afatit të caktuar për rieksportimin.

4. Zyra doganore mbikqyrese mund të bjere dakord që dokumenti i mbylljes së regjimit të behet me sisteme informatike ose në çdo formë tjetër që pranon zyra përkatëse.

Neni 301

Zyra mbikqyrese bën shenimet përkatëse në dokumentin e mbylljes së regjimit mbi bazën e verifikimit të kryer, duke informuar, nëse është e nevojshme, mbajtësin e autorizimit për rezultatin e verifikimit, dhe ruan dokumentin e mbylljes së regjimit dhe dokumentet që lidhen me të për të paktën 3 vjet kalendarike nga data në të cilën është hartuar dokumenti.

Neni 302

1. Kur mallrave të importit iu është caktuar një regjim nepermjet të njëjtit autorizim, por me anë disa deklaratave, produktet kompensuese ose mallrat në gjendjen e tyre të pandryshuar, të cilave u është dhënë një destinacion doganor, konsiderohen të përfuara nga mallrat e importit të vendosura nën regjim në baze të deklaratës më të parë.

2. Paragrafi 1 nuk zbatohet kur mbajtësi i autorizimit është në gjendje të tregojë mallrat e importit nga të cilat janë përfuqar produktet kompensuese ose mallrat në gjendje të pandryshuar, të përmendura në paragrafin 1.

Neni 303

Kur kërkesa për autorizim ka për objekt mallra të cilat u nënshtrohen masave të politikës tregtare, nuk është e nevojshme të paraqitet ndonjë licencë, autorizim ose dokument tjetër i ngjashëm në kohën kur depozitohet kërkesa.

Neni 304

1. Kur legjislacioni shqiptar parashikon masa të vecanta të politikës tregtare për:

- a) vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë, masat në fjalë nuk do të zbatohen për vendosjen e mallrave në regjimin e perpunimit aktiv, për atë kohë sa mallrat mbeten nën atë regjim;
- b) mallrat e sjella në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, masat në fjalë zbatohen kur mallrat e importit vendosen nën regjimin e perpunimit aktiv.

2. Kur zbatohet paragrafi 1(a), nuk është e nevojshme paraqitja e një licence, autorizimi ose

dokumenti tjetër perkatës në kohen e vendosjes nën regjim.

3. Pa rënë ndesh me masat e politikës tregtare që zbatohen për eksportimin e mallrave që kanë origjinë në Republikën e Shqipërisë, rieksporimi i mallrave jo shqiptare të vendosura nën regjim nuk sjell zbatimin e masave të politikës tregtare lidhur me eksportin e mallrave në gjendjen të pandryshuar ose produkteve kompensuese.

Neni 305

Vendosja në qarkullim të lirë e mallrave të importit, si në trajtën e mallrave në gjendjen e tyre të pandryshuar, ashtu edhe në trajtën e produkteve kompensuese i nënshtrohet zbatimit, nga ana e autoriteteve doganore, të çdo mase mase të politikës tregtare në fuqi për mallrat e importit në kohen kur u pranua deklarata për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë.

Neni 306

1. Kur produktet kompensuese ose mallrat në gjendjen e tyre të pandryshuar vendosen në një zonë të lirë ose magazine të lirë, duke mundësuar mbylljen e regjimit të perpunimit aktiv, kutia 31 e dokumentit administrativ të vetëm, përveç të dhenave të shënuara lidhur me regjimin perkatës, duhet të përmbajë edhe shënimin: "*Mallra për perpunim aktiv - me pezullim*", shkruar me bojë të kuqe.

2. Kur mallrat e importit të vendosura nën regjim duke përdorur sistemin me pezullim u nënshtrohen masave të politikës tregtare dhe masa të tilla vazhdojnë të zbatohen në kohen kur mallrat, në gjendjen e tyre të pandryshuar ose në trajtën e produkteve kompensuese, janë vendosur nën një regjim doganor ose në një zonë të lirë apo magazine të lirë, shënimin të cilit i referohet paragrafi 1 duhet të ndiqet nga shënimin: "*Politike tregtare*", shkruar me bojë të kuqe.

3. Zyra doganore e mbylljes duhet të bindet që shënimet të cilëve i referohen paragrafët 1 dhe 2 janë janë bërë sic duhet në secilin nga dokumentet e leshuara për të zëvendësuar ose mbyllur dokumentet të cilave u referohen keto paragrafe.

Neni 307

1. Autoritetet doganore lejojnë që produktet kompensuese ose mallrat në gjendje të pandryshuar të transferohen nga mbajtësi i një autorizimi tek mbajtësi i një autorizimi tjetër, me kusht që transferimi të regjistrohet në librat e perpunimit aktiv të mbajtësit të parë.

2. Përgjegjësia për mallrat ose produktet e transferuara i kalon mbajtësit të autorizimit të dytë në kohën në të cilën ai merr në dorëzim mallrat ose produktet në fjalë, dhe i regjistron ato në regjistrat e perpunimit aktiv.

3. Keto shënime në regjistrat e perpunimit aktiv kanë efekt të njëjte me vendosjen e mallrave ose produkteve serish nën regjim në emër të mbajtësit të autorizimit të dytë.

Neni 308

Mbajtësi i autorizimit është përgjegjës për t'u dërguar paraprakisht autoriteteve doganore njoftimin mbi transferimin që do të kryhet, në formën dhe në mënyrat e përcaktuara nga autoritetet doganore.

Seksioni 4

Dispozita të zbatueshme për sistemin me rimbursim

Neni 309

Deklarata për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë në kuadër të sistemit me rimbursim depozitohet në një nga zyrat e specifikuar në autorizim për vendosjen e mallrave në regjimin e perpunimit aktiv.

Neni 310

1. Deklarata për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë në kuadër të sistemit me rimbursim behet në përputhje me nenet nga 121 deri 161.

2. Pa rënë ndesh me procedurën e thjeshtuar për kërkesat, përshkrimi i mallrave, që është dhënë në deklaratën që i referohet paragrafit 1, duhet t'i korrespondojë sqarimeve të autorizimit.

3. Për qëllim të nenit 87 (2) të Kodit, dokumentat që shoqërojnë deklaratën janë ato që parashikohen në nenin 145.

4. Çdo deklaratë importi duhet të përmbajë kodin IM 5 në kutinë 1 të deklaratës si dhe numrin dhe datën e autorizimit për perpunim aktiv në kutinë 44. Formulari Regjistër i Përpunimit Aktiv për Eksportin, modeli i të cilit është paraqitur në Aneksin 32, duhet të lëshohet për çdo deklaratë që vendos mallrat në regjim dhe formon një pjesë përbërëse të kopjes së deklaratës që mbahet nga autoritetet doganore. Të gjitha eksportet duhet të regjistrohen në këtë formular në përputhje me udhëzimet që do të nxjerrë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Deklarata e importit sëbashku me të gjitha dokumentet që i bashkangjiten duhet që, pas çlirimit të dërgesës, të ruhen në një dosje të veçantë për secilën nga shoqëritë e autorizuar për të përdorur regjimin e perpunimit aktiv.

Neni 311

Për qëllim të mbylljes së regjimit të perpunimit aktiv (sistemi me rimbursim), trajtohet si eksport i produkteve kompensuese nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dërgimi i produkteve kompensuese personave që përfitojnë përjashtime nga detyrimi doganor, në bazë të Konventës së Vjenës datë 18 prill 1961 për Marrëdhëniet Diplomatike, Konventës së Vjenës të datës 24 prill 1963 për Marrëdhëniet Konsullore ose konventa të tjera me përmbajtje konsullore, ose Konventa e New York e datës 16 dhjetor 1969 për Misionet Speciale.

Neni 312

1. Deklarata ose kërkesa për t'u caktuar

produkteve kompensuese ose nese është rasti mallrave ne gjendje të pandryshuar një destinacion doganor sic referohet ne nenin 149 të Kodit, duhet të permbajë gjithë hollesirat e nevojshme per të mbështetur kerkesen per rimbursim.

2. Çdo deklaratë për mbylljen e regjimit të përpunimit aktiv duhet të përmbajë në kutinë 44 numrin dhe datën e autorizimit të përpunimit aktiv.

Neni 313

Çdo produkt kompensues dhe nese është rasti, mallrat ne gjendje të pandryshuar të cilave duhet t'u caktohet një nga destinacionet doganore të cilave u referohet neni 149 i Kodit, duhet të paraqiten ne zyren doganore të mbylljes se regjimit dhe i nenshtrohen formaliteteve doganore perkatëse të destinacionit doganor ne fjale ne perputhje me dispozitat e pergjithshme që zbatohen.

Neni 314

1. Deklarata per dhenien e produkteve kompensuese dhe nese është rasti, mallrave ne gjendje të pandryshuar, njërin nga destinacionet doganore të referuara ne nenin 149 të Kodit, depozitohet ne zyren doganore të mbylljes se regjimit sic tregohet ne autorizim.

2. Deklarata per dhenien e produkteve kompensuese ose mallrave ne gjendjen e tyre të pandryshuar një destinacion doganor, behet ne perputhje me dispozitat e percaktuara per destinacionin doganor perkatës.

3. Pershkrimi i produkteve kompensuese ose mallrave ne gjendjen e tyre të pandryshuar ne deklaraten e mbylljes se regjimit duhet të perputhet me hollesirat e dhëna ne autorizim.

4. Për qëllim të nenit 87(2) të Kodit, dokumentat që shoqërojnë deklaraten e mbylljes, duhet të jenë ato dokumente paraqitja e të cilave nevojitet per vendosjen e mallrave ne regjimin e kerkuar.

Neni 315

1. Kur është nevoja të përcaktohen detyrimet e importit që duhet të rimbursohen ose shuhet, përlogaritet ajo pjesë e mallrave të importit të trupezuara ne produktet kompensuese. Nuk kryhet një përlogaritje e tillë kur të gjithë produkteve kompensuese u caktohet njëri nga destinacionet doganore të cileve u referohet nenin 149 i Kodit.

2. Përlogaritja kryhet ne perputhje me metoden e matjes sasiore ose metoden mbi bazën e vlerës ose me cdo menyre tjetër që jep të njëjtat perfundime, ne baze të shembujve të pasqyruar ne Aneksin 40.

Neni 316

Metoda e matjes sasiore (produktet kompensuese) perdoret kur prej operacioneve të përpunimit aktiv perftohet vetëm një lloj produkti kompensues. Ne këtë rast, sasia e mallrave të importit që i korrespondon produkteve kompensuese per të cilat mund të kerkohet rimbursim ose shuarje e detyrimeve doganore, llogaritet duke zbatuar mbi të gjithë sasine e mallrave në fjalë, një koeficient që i

korrespondon raportit të sasise se produkteve kompensuese, per të cilat mund të kerkohet rimbursimi ose shuarja e detyrimeve doganore, me sasinë totale të produkteve kompensuese.

Neni 317

1. Metoda e matjes sasiore (mallrat e importit) perdoret kur të gjithë elementet e mallrave që vendosen ne qarkullim të lire, gjenden ne secilin prej produkteve kompensuese.

2. Per të vendosur nese do të zbatohet kjo metode, nuk merren parasysh firot.

3. Sasia e mallrave të importuara në kuadër të sistemit me rimbursim, që perdoren ne procesin e fabrikimit të cdo produkti kompensues, percaktohet duke zbatuar në mënyrë të njëpasnjëshme, per të gjithë sasine e mallrave të importit, një koeficient i cili i korrespondon raportit të sasise se mallrave ne fjale, që gjenden ne secilin prej produkteve kompensues me sasinë totale të mallrave të tilla që gjenden në produktet kompensues ne tëresi.

4. Sasia e mallrave të importuara në kuadër të sistemit me rimbursim, që i korrespondon sasise se produkteve kompensuese per të cilat mund të kerkohet rimbursimi ose shuarja e detyrimeve doganore, percaktohet duke zbatuar koeficientin që i korrespondon raportit të sasise së produkteve kompensues për të cilat është kërkuar rimbursimi ose shuarja, me sasinë totale të produkteve kompensuese ndaj sasise së mallrave të importit të përdorura në fabrikimin e produkteve në fjalë, përlogaritur në perputhje me paragrafin e tretë.

Neni 318

1. Kur nuk mund të zbatohet metoda e matjes sasiore, perdoret metoda mbi baze e vlerës.

2. Per të percaktuar sasine e mallrave të importit të përdorura ne fabrikimin e secilit lloj produkti kompensues, koeficientët e njëpasnjëshëm që i korrespondojnë raportit ndërmjet vlerave të krahasueshme për cdo produkt kompensues, të përlogaritur në perputhje me paragrafin 3, do të zbatohen për të gjithë sasinë e mallrave të importit.

3. Per të përdorur metoden me baze vlere, vlere e cdo produkti kompensues perbehet nga:

- a) cmimi i shitjes me të fundit ne Republikën e Shqipërisë i produkteve identike ose të ngjashme, me kusht që ky cmim nuk është ndikuar nga marrëdhënia mes bleresit dhe shitësit, ose, kur ky nuk është i njohur,
- b) cmimi më i fundit ex works ne Republikën e Shqipërisë, me kusht që të mos jetë ndikuar nga marrëdhënia mes bleresit dhe shitësit.

Kur vlere nuk mund të përcaktohet duke përdorur një nga metodat e mesiperme, percaktohet nga zyra doganore mbikqyrese me ane të cdo metode tjetër të arsyeshme.

4. Sasia e mallrave të importit e cila i

korrespondon sasise se produkteve kompensuese per të cilat kerkohet rimbursim ose shuarje e detyrimit doganor, perlogaritjet duke zbatuar koeficientin e gjetur me anë të metodës së matjes sasiore (produkte kompensuese) ndaj sasise se mallrave të importit të perdorura ne prodhimin e produkteve ne fjale, të perlogaritura ne perputhje me paragrafin 2.

Neni 319

Rimbursimi ose shuarja e detyrimeve doganore i nenshtrohet depozitimit, nga ana e mbajtësit të autorizimit, ne zyren doganore mbikqyrese, të një kerkese që këtu e në vijim do të quhet "Kerkese rimbursimi/Perpunimi aktiv".

Neni 320

1. Afati i permendur ne nenin 149(3) të Kodit, brenda të cilit duhet të depozitohet kerkesa per rimbursim/Perpunimi aktiv është maksimumi 6 muaj nga data ne të cilen produkteve kompensuese u është caktuar njëri prej destinacioneve doganore të cilave u referohet neni 149(1) i Kodit.

2. Kur e kerkojne rrethana të jashtëzakonshme, Drejtoria e Pergjithshme e Doganave mund të zgjase afatin e permendur ne paragrafin 1, edhe pasi ky afat ka mbaruar.

Neni 321

1. Kerkesa per rimbursim/ Perpunimi aktiv mes të tjerash duhet të permbaje të dhenat e meposhtme:

- a) referencat e autorizimit;
- b) sasia e cdo lloj mallrash të importit per të cilat kerkohet rimbursim ose shuarje e detyrimeve doganore;
- c) kodin e mallrave të importit në Nomenklaturën e Kombinuar;
- d) vleren doganore mallrave të importit dhe nivelin e detyrimeve doganore të importit të cilat duhet të paguhet per mallrat në datën e pranimit të deklaratës për vendosjen e mallrave ne qarkullim të lire në kuadër të sistemit me rimbursim, të verifikuara këto nga autoriteteve doganore;
- e) datën e vendosjes ne qarkullim të lire të mallrave të importit në kuadër të sistemit me rimbursim;
- f) referencat e deklaratës sipas se ciles mallrat u vendosen ne qarkullim të lire në kuadër të sistemit me rimbursim;
- g) llojin dhe sasine e produkteve kompensuese dhe destinacionin doganor që iu është caktuar ose ne të cilin ato duhet të caktohen;
- h) vlere e produkteve kompensuese, nese per qëllim të mbylljes së regjimit është përdorur metoda mbi baze vlere;
- i) koeficienti i shfrytëzimit të perdorur;
- j) referencat e deklaratës sipas se ciles produktet kompensuese ose nese është rasti, mallrat ne gjendjen e tyre të pandryshuar u vendosen ne njërin nga destinacionet doganore të cilave u

referohet neni 149 i Kodit;

- k) shumen e detyrimeve të importit që duhet të rimbursohen ose të shuhet dhe cdo interes kompensues të vjele, duke marre parasysh mes të tjerash detyrimet e importit per produkte të tjera kompensuese.

Neni 322

1. Zyra doganore mbikqyrese mund të lejoje që kerkesa të mos permbaje ndonjë të dhene të vecantë, nese kjo nuk ndikon mbi perlogaritjen e shumes per t'u rimbursuar ose shuar.

2. Zyra doganore mbikqyrese mund të lejoje që Kerkesa e rimbursimit/Perpunimi pasiv të behet ne kompjuter ose ne cfaredo forme tjetër që vendos zyra ne fjale.

Neni 323

Zyra mbikqyrese bën shënimet përkatëse në kerkesen per rimbursim/Perpunimi aktiv ne baze të verifikimit të kryer dhe duhet të informojë mbajtësin e autorizimit mbi perfundimin e verifikimit; kjo zyre duhet ta ruajë kerkesen dhe dokumentat perkatëse per të paktën 3 vjet kalendarike nga fundi i vitit ne të cilin mori vendimin per kerkesen.

Neni 324

1. Kur produktet kompensuese në sistemin me rimbursim vendosen ne njërin prej destinacioneve doganore të cilave u referohet paragrafi i dytë i nenit 149 (1) i Kodit, duke lejuar ne këtë menyre rimbursimin, kutia e rezervuar per pershkrimin e mallrave ne dokumentat e perdorura per vendosjen e këtyre mallrave në regjim, në një zonë të lirë ose në një magazinë të lirë, duhet të përmbajë shënimin: "Perpunimi aktiv/Mallra të rimbursuara" me bojë të kuqe.

2. Zyra doganore e mbylljes se regjimit duhet të bindet që shenimet, të cilave i referohet paragrafi 1, janë bërë jë secilin prej dokumenteve të leshuar per të zevendesuar ose të mbyllur dokumentet të cilave u referohet ai paragraf.

Neni 325

Drejtoria e Pergjithshme e Doganave mund të nxjerre udhëzime për zbatimin praktik të regjimit të perpunimit aktiv.

KREU 4

Perpunimi nën kontrollin e doganës

Neni 326

Ne perputhje me pjesen IV, kreu 2, seksioni 3E të Kodit, ky kre percakton dizpozitat per zbatimin e regjimit të perpunimit nen kontrollin doganor.

Neni 327

Ne zbatim të nenit 151 të Kodit, regjimi i perpunimit nen kontroll doganor mund të perdoret vetëm per mallrat e treguara në kolonen 1 të listës se Aneksit 41, të cilat mund ti nënshtrohen vetëm perpunimeve e treguara ne kolonen 2.

Neni 328

1. Kërkesa behet ne perputhje me nenin 234 dhe ne perputhje me modelin e Aneksit 28 dhe duhet të paraqitet nga personi, të cilit mund t'i jepet autorizimi sipas neneve 109, 152, 153 të Kodit.

2. Kërkesa i paraqitet Drejtorise se Pergjithshme se Doganave.

Neni 329

1. Autorizimi leshohet nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave dhe behet sipas modelit të Aneksit 33.

2. Çdo autorizim duhet të shoqërohet nga një formular i quajtur Regjistër i përpunimit nën kontrollin doganor që do të jetë pjese përbërëse e çdo autorizimi. Modeli i Regjistrit të përpunimit nën kontrollin doganor në import është përshkruar në Aneksin 33. Të gjitha vendosjet në regjim duhet të regjistrohen në këtë formular në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

3. Per të siguruar zbatimin e rregullt të dispozitave që rregullojnë regjimin, autoritetet doganore mund t'i kërkojnë mbajtësit të autorizimit të mbaje regjistra magazinimi, ne të cilat tregohet sasia e mallrave të importit të vendosura nën regjim dhe sasia e produkteve të perpunuara të perfutuara, si dhe gjithë hollesirat e nevojshme per ndjekjen e operacioneve nga dhe perlogaritjen e saktë të detyrimeve doganore të importit që ligjërisht mund të paguhen. "Regjistrat e përpunimit nën kontrollin doganor" vihen ne dispozicion të zyres mbikqyrese per të mundësuar këtë të fundit të kryejë gjithë kontrollet e nevojshme per zbatimin e duhur të regjimit.

Neni 330

Afati i vlefshmerise se autorizimit vendoset rast pas rasti nga autoritetet doganore, duke patur parasysh nevojat e vecanta të kerkuesit. Kur ky afat është me i gjate se 2 vjet, kushtet ne te cilat ishte leshuar autorizimi rishikohen periodikisht ne intervalet e percaktuara ne autorizim.

Neni 331

1. Kur leshon një autorizim, Drejtoria e Pergjithshme e Doganave duhet të caktojë edhe afatin brenda të cilit produkteve të perpunuara duhet t'u jepet një destinacion doganor ne perputhje me nenin 154 të Kodit, duke marre parasysh kohen që nevojitet per të kryer operacionet e perpunimit dhe kohen që nevojitet per t'u caktuar produkteve të perpunuara një destinacion doganor.

2. Kur mbajtësi i autorizimit depoziton një kerkese të arsyetuar per zgjatje afati, afat i caktuar per rieksportimin mund të zgjatet nga Drejtori i Pergjithshem i Doganave.

Neni 332

1. Koeficienti i shfrytëzimit, ose menyra e

percaktimit të tij, referuar ne nenin 154 të Kodit, per sa është e mundur percaktohet ne baze të të dhenave të prodhimit dhe duhet të jetë i identifikueshëm ne regjistrat e mbajtësit të autorizimit.

2. Koeficienti ose menyra e percaktimit të tij vendosen ne perputhje me paragrafin 1, duke qënë objekt i verifikimeve *a posteriori* nga autoritetet doganore.

Neni 333

1. Deklarata per vendosjen e mallrave per perpunim nën kontrollin doganor duhet të depozitohet ne njëren prej zyrave të treguara ne autorizimin që lejon vendosjen e mallrave nën regjim.

2. Deklarata të ciles i referohet paragrafi 1 duhet të kryhet ne perputhje me nenet nga 121 deri 161.

3. Përshkrimi i mallrave i dhene ne deklaraten e referuar ne paragrafin 2, duhet t'i korrespondoje specifikimeve të bëra ne autorizim.

4. Për qëllim të të nenit 87(2) të Kodit, dokumentat shoqëruese të deklaratës jane ato të parashikuara ne nenin 145.

5. Çdo deklarate importi duhet të përmbajë kodin IM9 në kutinë 1 të deklaratës si dhe numrin dhe datën e autorizimit për regjimin e përpunimit nën kontrollin doganor në kutinë 44. Formulari Regjistër importi i përpunimit nën kontrollin doganor, i përshkruar në Aneksin 33 duhet të lëshohet për çdo deklarate që vendos mallrat në regjim dhe do formojë një pjese përbërëse e kopjes së deklaratës që mbahet nga organet doganore. Të gjitha exits duhet të regjistrohen në këtë formular në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Deklarata e importit sëbashku me të gjitha dokumentet që i bashkangjiten, pas clirimit të mallrave, duhet të mbahet në një dosje të veçantë për secilën prej shoqërive që janë autorizuar të përdorin regjimin e përpunimit nën kontrollin doganor.

Neni 334

1. Mbyllja e regjimit bazohet ose ne sasine e mallrave të importit, të ciles i korrespondojne produktet e perpunuara, duke zbatuar koeficientin e shfrytëzimit, ose ne sasine e mallrave ne gjendje të pandryshuar të ciles i është dhene një destinacion doganor.

2. Kur është nevoja, ne perputhje me nenin 155 të Kodit, për llogaritjen e pjesës që i perket mallrave të importit të trapezuar ne produktet e perpunuara, zbatohet *mutatis mutandis* metoda e matjes sasiore ose metoda ne baze vlere.

Neni 335

Deklarata per mbylljen e regjimit të përpunimit të mallrave nën kontrollin doganor duhet të depozitohet ne njëren prej zyrave doganore per mbylljen e regjimit, të treguara ne autorizim.

Neni 336

1. Deklarata per mbylljen e regjimit të perpunimit nen kontroll doganor perpilohet sipas dispozitave që rregullojne destinacionin doganor perkatës.
2. Pershkrimi i produkteve të perpunuara ose mallrave të importit ne deklaratën, e të ciles i referohet paragrafi 1, duhet t'i korrespondoje specifikimeve të dhena ne autorizim.
3. Për qëllim të të nenit 87(2) të Kodit, dokumentat shoqëruese të deklaratës per mbylljen e regjimit jane ato dokumenta të cilat nevojiten per vendosjen e mallrave nen regjimin e kerkuar.
4. Çdo deklarate për mbylljen e regjimit të perpunimit nën kontrollin doganor duhet të përmbajë në lutinë 44 numrin dhe datën e autorizimit për regjimin nën kontrollin doganor.

Neni 337

1. Mbajtësi i autorizimit, brenda 30 ditësh nga dita e skadimit të afatit kohor per mbylljen e regjimit, duhet ti paraqesë zyres doganore mbikqyrese dokumentin per mbylljen e regjimit perkatës.
2. Dokumenti i mbylljes se regjimit permban mes të tjerash të dhenat e meposhtme:
 - a) referencat e autorizimit;
 - b) sasine per cdo lloj nga mallrat e importit dhe referencat e deklaratës per vendosjen e tyre nen regjim;
 - c) kodin e mallrave të importit në nomenklaturën e kombinuar;
 - d) vleren doganore të mallrave të importit;
 - e) koeficientin e shfrytëzimit që është caktuar;
 - f) natyren dhe sasise e produkteve të perpunuara dhe destinacionin doganor ne të cilin ato jane vendosur, bashke me referencat e deklaratës që i vendos keto produkte nen një destinacion doganor;
 - g) shpenzimet e perpunimit, kur vlera doganore duhet të permbaje ato;
 - h) kodin e produkteve të perpunuara në nomenklaturën e kombinuar.

Neni 338

1. Zyra doganore mbikqyrese mund të bjere dakord që:
 - a) dokumenti i mbylljes se regjimit të behet me sisteme informatike ose ne cdo forme tjetër ne të cilen zyra ne fjale bie dokort;
 - b) dokumenti i mbylljes se regjimit të behet nepermjet deklaratës per vendosjen e

mallrave nen regjim.

2. Zyra mbikqyrese plotëson dokumentin e mbylljes se regjimit ne baze të verifikimit të kryer, duke informuar mbajtësin e autorizimit, nese është nevoja, mbi rezultatet e verifikimit, duke ruajtur dokumentin e mbylljes se regjimit dhe dokumentat perkatëse per të paktën 3 vjet kalendarikë nga fundi i vitit ne të cilin u krijua dokumenti.

Neni 339

Ne kuadrin e nenit 40(1) të Kodit, kur produktet e perpunuara vendosen ne qarkullim të lire, ne baze të zgjedhjes se vetë personit të interesuar ne datën e pranimi të deklaratës per vendosje ne qarkullim të lire të produkteve në fjale, vlera doganore e tyre, do të jetë njëra prej vlerave të treguara me poshtë:

- a) vlera doganore, e percaktuar ne ose ne pothuaj të njëjtën kohe me prodhimin e mallrave identike ose të ngjashme ne ndonjë vend tjetër;
- b) cmimi i shitjes, me kusht që ky të mos jetë ndikuar nga ndonjë marredhenie mes bleresit dhe shitësit ;
- c) cmimi i shitjes ne Republikën e Shqipërisë per mallra identike ose të ngjashme, me kusht që ky të mos jetë ndikuar nga ndonjë marredhenie mes bleresit dhe shitësit;
- d) vlera doganore e mallrave të importit duke i shtuar edhe shpenzimet e perpunimit.

Neni 340

Kur në kohen e pranimi të deklaratës per vendosjen ne qarkullim të lire të mallrave të importit, për këto mallra është ne fuqi ndonjë masë e politikës tregtare, ajo nuk do të zbatohet per produktet e perpunuara, pervec kur ajo masë është ne fuqi edhe për produkte identike me produktet e perpunuara. Ne keto raste, masat e politikës tregtare zbatohen mbi sasine e mallrave të importit të perdorura faktikisht ne fabrikimin e produkteve të perpunuara të vendosura ne qarkullim të lire.

Neni 341

Drejtoria e Pergjithshme e Doganave mund të nxjerrë udhezime per zbatimin praktik të regjimit të perpunimit nen kontrollin doganor.

KREU 5

Regjimi i lejimit të perkohshem

Seksioni 1

Dispozita të pergjithshme

Për qëllim të nenit 342 deri 402¹⁰:

- a) "Zyrë doganore e hyrjes" do të thotë: zyra doganore nëpërmjet të cilës mallrat e shoqëruara nga një Carnet ATA, hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

¹⁰ Shiko nenin 2(9). Ky tekst është rishikuar këtu për lehtësi përdorimi të termave të përkufizuar.

- b) *"Zyrë doganore e daljes"* do të thotë: zyra doganore nëpërmjet të cilës mallrat e shoqëruara nga një *Carnet ATA*, dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;
- c) *"Mjete transporti"* do të thotë: çdo mjet i përdorur për transportin e personave ose të mallrave. Termi i mësipërm përfshin edhe pjesët e këmbimit, aksesoret dhe pajisjet e zakonshme, duke përfshirë këtu edhe pajisjet që nevojiten për të stivuar, fiksuar ose siguruar mallrat kur materiale të tilla importohen së bashku me mjetet e transportit;
- d) *"Person i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë"* do të thotë: një person fizik i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ose një person juridik i cili ka selinë tregtare të regjistruar jashtë këtij territori;
- e) *"Përdorim tregtar"* do të thotë: përdorimi i një mjeti transporti për transportimin e personave për qëllime përfitim, ose transportimin industrial apo tregtar të mallrave për qëllime përfitim ose jo;
- f) *"Përdorim privat"* do të thotë: përdorim nga ana e një personi e një mjeti transporti vetëm për përdorim vetiak, duke përjashtuar përdorimin tregtar;
- g) *"Konteiner"* do të thotë: një lloj pajisje transporti që:
- përbën një ndarje të mbyllur plotësisht ose pjesërisht për të mbajtur mallra;
 - ka karakter të përhershëm dhe njëkohësisht është rezistent në atë masë që të mund të përdoret në mënyrë të përsëritur,
 - është projektuar në mënyrë të tillë që lehtëson transportin e mallrave, nëpërmjet një ose disa mënyrash transporti, pa pasur nevojë për ngarkim-shkarkime të ndërmjetme,
 - është projektuar për t'u manovruar lehtësisht, sidomos gjatë transbordimit nga një lloj transporti në një tjetër,
 - është projektuar në mënyrë të tillë që mbushtet dhe zbrazet lehtësisht, me një vëllim të brendshëm prej 1 m³ e më shumë.
- Edhe platformat e sheshta trajtohen si konteinerë. Termi *"konteiner"* përfshin aksesore dhe pajisje të konteinerit, të përshtatshme për llojin në fjalë, me kusht që të transportohen bashkë me konteinerin. Ky term nuk përfshin automjetet, aksesoret ose pjesë këmbimi të tyre, ambalazhe dhe paleta. Duke anashkaluar nënparagrafin g(v), termi *"konteiner"* zbatohet edhe për konteineret e përdorur në transportin ajror me vëllim të brendshëm më të vogël se 1 m³;
- h) *"Transport nën plumbosjen doganore"* do të thotë: përdorimin e konteinerëve për transportin e mallrave, identifikimi i të cilave sigurohet me anën e plumbosjes së konteinerit;
- i) *"Karrocieri e levizshme"* do të thotë: një ndarje për ngarkim, e cila nuk ka mjete të pavarura lëvizjeje dhe është e projektuar posaçërisht për t'u transportuar mbi mjetet rrugore në të cilat shasia dhe platforma e të cilave është projektuar për këtë qëllim. Ky përkufizim përfshin kasat e levizshme të cilat formojnë ndarje për ngarkesë të projektuara posaçërisht për transport të kombinuar;
- j) *"Konteinerë pjesërisht të mbyllur"* do të thotë: një strukturë e cila në përgjithësi përbëhet nga një platformë e vetme dhe nga katër mbajtëse vertikale që kufizojnë një hapësirë ngarkimi të barazvlefshme me atë të një konteineri të mbyllur; superstruktura përbëhet zakonisht nga elementë metalikë që formojnë kornizën e një konteineri; konteinerë të këtij karakteri mund të përbëhen edhe një ose disa parete anësore ose ballore; në raste të caktuara ka vetëm një tavan të lidhur me katin me anën e katër elementëve të superstrukturës vertikale. Konteinerë të këtij lloji përdoren zakonisht për transportimin e mallrave me vëllim të madh (p.sh. automjete);
- k) *"Platforma të sheshta"* do të thotë: platforma të lëvizshme ngarkimi, të sheshta, pa struktura të ndërtuara mbi to, ose me struktura të pjesshme, me gjatësi dhe gjerësi të njëjtë me konteinerët dhe që ka kënde të sipërme dhe të poshtme të vendosura në qoshet e konteinerëve për të mundësuar vendosjen e pajisjeve të stivosjes dhe ngritjes që përdoren për konteineret;
- l) *"Aksesore dhe pajisje të konteinerit"* do të thotë: veçanërisht pajisjet e mëposhtme, të lëvizshme ose jo:
- pajisje për kontrollin, ndryshimin dhe ruajtjen e temperaturës brenda konteinerëve;
 - pajisje të vogla si regjistruet të temperaturës, ose të goditjeve, të projektuara në mënyrë të tillë që të tregojnë ndryshimet në kushtet mjedisore dhe goditjet;
 - ndarës të brendshëm, paleta, rafte, mbështetës, çengela, dhe pajisje të tjera për stivimin e mallrave;
- m) *"Paleta"* do të thotë: një pajisje në sipërfaqe të të cilës mund të vendosen së bashku një sasi mallrash duke formuar një njësi ngarkese për qëllime transporti, lëvizjeje ose ruajtje apo stivim të mallit, duke përdorur aparaturo të tjera mekanike. Pajisja në fjalë përbëhet nga dy kate që lidhen me njëri tjetrin me anë të traversave ose nga një kat i vetëm i mbështetur mbi këmbë, ose nga një kat i

veçantë që përdoret për transportin ajror; lartësia e saj e përgjithshme duhet të jetë aq sa të bëjë të mundur lëvizjen me vinça pirun ose karrelet e paletave. Paletat mund të kenë edhe superstrukturë të ngritur mbi to;

- n) "Përdorues të një konteineri ose palete" do të thotë: personi i cili, është ose jo pronari i konteinerit, kontrollon faktikisht lëvizjet e tyre;
- o) "Përdorues i një konteineri ose palete" do të thotë: përdoruesi i konteinerit ose paletës, ose përfaqësuesi i tij;
- p) "Trafik i brendshëm" do të thotë: transporti i personave ose mallrave që kanë hipur ose janë ngarkuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për të zbritur ose për t'u shkarkuar në një vend tjetër brenda këtij territori.

Neni 342

Ne perputhje me Pjesen IV, Kreu 2, Seksioni 3F të Kodit, ky kreu përcakton dispozitat për zbatimin e regjimit të lejimit të perkohshëm.

Seksioni 2

Lejimi i perkohshëm i mallrave që nuk janë mjete transporti

Neni 343

1. Regjimi i lejimit të perkohshëm me perjashtim të plotë nga detyrimet e importit jepet për materialet profesionale.

2. *Pajisje profesionale* do të thotë:

- a) pajisje për shtyp ose transmetim radiofonik apo televiziv, që i nevojiten përfaqësuesve të shtypit ose të transmetimeve radiofonike apo televizive të vendosura jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që vizitojnë Shqipërinë për qëllime reportazhi ose për të transmetuar apo regjistruar materiale për programe të caktuara;
- b) pajisje kinematografike që i nevojitet një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që viziton Shqipërinë për të xhiruar një ose disa filma të caktuar;
- c) cdo pajisje tjetër të nevojshme për ushtrimin e zanatit, tregtisë ose profesionit nga një person i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që viziton Shqipërinë për të kryer një detyrë të caktuar. Nuk përfshin megjithatë, kjo kategori, pajisjet të cilat do të përdoren për prodhimin industrial ose paketimin e mallrave ose (me perjashtim të veglave të dorës) për shfrytëzimin e rezervave natyrore, për ndërtimin, riparimin ose mirëmbajtjen e ndërtesave, për gjermimin dhe zhvendosjen e dherave si dhe pune të tjera të ngjashme;
- d) aparatura ndihmëse për pajisjet e përmendura

ne nenparagrafet (a), (b) dhe (c) me siper dhe aksesoret përkatës. Lista e mallrave që quhen materiale profesionale pasqyrohet në Aneksin 42.

3. Regjimi i lejimit të perkohshëm përmendur në paragrafin 1, jepet me kusht që pajisjet profesionale:

- a) t'i perkasin një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;
- b) të importohen nga një person i vendosur jashtë këtij territori;
- c) të përdoren vetëm ose nën mbikqyrjen personale të personit që viziton këtë territor. Megjithatë, kushtet e këtij paragrafi nuk zbatohen për pajisjet kinematografike që importohen për prodhim filmash, programesh televizive ose vepra audio-vizive, sipas një kontratë bashkeprodhimi të kryer me një person të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Në rastet e prodhimeve të përbashkëta të programeve radiotelevevizive, pajisjet profesionale mund të jenë objekt i një kontratë qiraje ose ndonjë marrëveshje të ngjashme në të cilën personi i vendosur në Republikën e Shqipërisë, është palë

Neni 344

Pjesët e kembimit që herë pas herë importohen për riparimin e pajisjeve profesionale të cilat janë importuar perkohësisht, gezojnë lehtësirat e regjimit të lejimit të perkohshëm në kushte të njëjta me vetë pajisjet.

Neni 345

1. Regjimi i lejimit të perkohshëm me perjashtim të plotë nga detyrimet e importit jepet për:

- a) mallrat që importohen me qëllimin për t'u ekspozuar ose shfaqur në ndonjë aktivitet të veçantë;
- b) mallrat që importohen me qëllimin për të realizuar ekspozimin ose shfaqjen në ngjarjen përkatëse të mallrave të importuara, duke përfshirë:
 - i) mallra që nevojiten për të demonstruar makineritë e importuara ose aparaturat që realizojnë paraqitjen,
 - ii) konstruksione dhe materiale zbulimi, përfshirë pajisje elektrike për stenda të perkohshme të personave të vendosur jashtë Republikës së Shqipërisë,
 - iii) materiale reklame dhe demonstrimi dhe pajisje të tjera siç është materiali reklamues për mallrat e ekspozuara, apo të tilla si regjistrime zanore ose pamore, filma dhe diapozitiva, sëbashku me aparaturat e nevojshme për përdorimin e tyre;

- c) pajisje, duke përfshirë pajisje perkthimi, aparatura regjistrimi të zërit ose figurës si dhe filma me karakter edukativ, shkencor dhe kulturor, me qëllim përdorimi në takime ndërkombetare, konferenca dhe kongrese;
 - d) kafshe të gjalla për t'u ekspozuar ose për të marrë pjesë në ndonjë ngjarje të veçantë;
 - e) produktet që mund të përftoheshin gjatë ngjarjes përkatëse prej mallrave, makinerive, aparateve ose kafsheve të importuara me lejim të perkohshëm.
2. *Ngjarje* do të thotë kuptojmë:
- a) ekspozita, panaire, dhe shfaqje të ngjashme me karakter tregtar, industrial, bujqësor ose artizanal;
 - b) ekspozitat ose takime e organizuara kryesisht me qëllime bamiresie;
 - c) ekspozitat ose takime e organizuara kryesisht për qëllime shkencore, teknike, artizanale, artistike, edukative ose kulturore, sportive, fetare dhe kulturi, sindikale, turistike ose, me qëllim nxitjen e marrëdhëniet të miqësisë mes vendeve të ndryshme;
 - d) takime të përfaqësuesve të organizatave ose shoqatave ndërkombetare;
 - e) ceremoni dhe manifestime me karakter zyrtar ose perkujtimor, me përjashtim të ekspozitave të organizuara për qëllime private në dyqane ose ambiente të tjera tregtare në synim shitjen e mallrave të importit.

Neni 346

1. Regjimi i lejimit të perkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimet e importit jepet edhe për:

- a) materiale pedagogjike dhe pajisjet shkencore;
- b) pjesë kembimi dhe aksesore për keto materiale ose pajisje;
- c) vegla për mirëmbajtjen, kontrollin, kalibrimin ose riparimin e një materiali ose pajisjeje të tillë.

2. *Materiale pedagogjike* do të thotë: çdo material që nevojitet për qëllimin e vetëm të mesimdhënieve ose kualifikimit profesional, vecanërisht modele, instrumente, aparate dhe makina. Lista e mallrave që quhen materiale pedagogjike pasqyrohet në Aneksin 43. Një listë ilustruese e mallrave që importohen në lidhje me aktivitetet edukative, shkencore ose kulturore është dhënë në Aneksin 44.

3. *Pajisje shkencore* do të thotë: pajisje për t'u përdorur vetëm për kërkime shkencore ose mesimdhënie, dhe vecanërisht modele, instrumente, aparate dhe makina.

4. Regjimi i lejimit të perkohshëm i referuar në paragrafin 1, jepet me kusht që materialet

pedagogjike ose pajisjet shkencore, pjesët e kembimit, aksesoret dhe veglat:

- a) të importohen nga ente të miraturara dhe përdoren nën kontrollin dhe përgjegjësinë e ketyre të fundit;
- b) të përdoren për qëllime jo tregtare;
- c) të importohen në sasi të arsyeshme, duke patur parasysh destinacionin e tyre;
- d) të mbeten, gjatë gjithë qëndrimit të tyre në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, prane e një personi të vendosur jashtë këtij territori;

5. Materiale të tilla pedagogjike ose pajisje shkencore mund të qëndrojnë nën regjimin e lejimit të perkohshëm për një periudhë 12 muaj.

6. Për qëllim të paragrafit 4(a), *ente të miratuara* do të thotë, në rastin e materialeve pedagogjike, ente mesimdhënieje ose trainimi profesional, publike ose private, të cilat në thelb nuk kanë përfitimin ekonomik dhe janë miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si marrëse të materialit pedagogjik nën regjimin e lejimit të perkohshëm.

7. Për qëllim të paragrafit 4(a), *ente të miratuara* do të thotë, në rastin e pajisjeve shkencore, ente shkencore ose masimdhënëse, publike ose private, të cilat në thelb nuk kanë përfitimin ekonomik dhe janë miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si marrëse të pajisjeve shkencore nën regjimin e lejimit të perkohshëm.

Neni 347

1. Regjimi i lejimit të perkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimet e importit jepet edhe për pajisje mjeksore, laboratorike, kirurgjikale që nevojiten për spitalet dhe institucionet e tjera mjeksore.

2. Regjimi i lejimit të perkohshëm i referuar në paragrafin 1 jepet me kusht që pajisjet në fjale:

- a) të jenë objekt dergesash rastësore dhe të dhëna hua pa pagesë;
- b) importohen për qëllime diagnostikimi ose terapeutike.

3. *Pajisje të derguara në baze rastësore* do të thotë çdo pajisje mjeksore, kirurgjikale ose laboratorike që i dërgohet, kundrejt kërkesës, një spitali ose qëndre shëndetsore, që është duke u ballafaquar me rrethana të jashtëzakonshme dhe ka nevojë urgjente për keto pajisje për të përballuar mungesat që ato kanë në pajisje të tilla.

Neni 348

1. Regjimi i lejimit të perkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimet e importit jepet edhe për materiale të cilat përdoren në kuadrin e masave për të menjanuar pasojat e katastrofave që ndodhin në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Regjimi i lejimit të perkohshem që jepet sipas paragrafit 1, i nenshtrohet kushtit që materialet ne fjale:

- a) të importohen ne forme huadhenieje pa pagese;
- b) të perdoren nga Institucione shtetërore ose nga organizma të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Neni 349

1. Regjimi i lejimit të perkohshem me perjashtim të plotë nga detyrimet e importit jepet edhe per ambalazhet.

2. Ambalazhe do të thotë:

- a) mbajtësit e perdorur, ose që do të perdoren ne gjendjen ne të cilen jane importuar, per ambalazhimin e jashtëm ose të brendshem të mallrave;
- b) materialet ndihmëse në të cilat mallrat janë, ose do të jenë, mbështjell, palosur ose fiksuar, me perjashtim të materialeve abalazhuere si kashta, letra, leshi i xhamit, tallash, të importuar rifuxho.

3. Regjimi i lejimit të perkohshem i referuar ne paragrafin 1, jepet me kusht që amabalazhet.

- a) e importuar të mbushur, të deklarohen se do të rieksporthen të zbrazur ose të mbushur;
- b) e importuar të bosh, të deklarohen se do të rieksporthen të mbushur.

4. Ambalazhet e vendosur nen regjimin e lejimit të perkohshem nuk mund të perdoren, qoftë edhe rastësisht, ne trafikun e brendshem, me perjashtim të rastit kur synohet të eksportohen mallrat nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë. Ne rastin e ambalazheve të importuara të mbushura, ky kufizim zbatohet vetëm duke filluar nga casti ne të cilin zbrazet nga permbajtja e tyre.

5. Ambalazhet mund të qëndrojnë nen regjimin e lejimit të perkohshem per një periudhe prej 6 muajsh.

Neni 350

1. Regjimi i lejimit të perkohshem me perjashtim të plotë nga detyrimet e importit jepet edhe per mallrat që vijojne:

- a) stampa, matrica, presforma, klishe, dizeno, projekte, dhe objekte të tjera të ngjashme, të cilat i dergohen një personi të vendosur ne territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, kur të paktën 75% e prodhimit që del prej perdorimit të tyre eksportohet nga ky territori;
- b) instrumente matëse, kontrolli, verifikimi ose objekte të tjera të ngjashme të cilat destinohen per një person të vendosur ne territorin doganor të Republikës së

Shqipërisë, per perdorim ne prodhimin e mallrave, kur të paktën 75% e prodhimit që del nga perdorimi i tyre eksportohet nga ky territor;

- c) vegla dhe instrumenta të cilat i vihen ne dispozicion një personi të vendosur ne territorin doganor të Republikës së Shqipërisë per perdorim ne fabrikimin e mallrave të cilat eksportohen plotësisht, me kusht që të tilla vegla dhe instrumente të mbeten prone e personit të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;
- d) mallra të cdo lloji, të cilat i nenshtrohen provave, eksperimentave, ose demonstrimeve, duke perfshire eksperimentet e nevojshme per proceduren e homologimit, me perjashtim të provave, eksperimenteve dhe demonstrimeve që perbejne aktivitetet me qëllim fitimi;
- e) mallra të cdo lloji, që duhet të perdoren per kryerje e provave, eksperimenteve ose demonstrimeve, me perjashtim të provave, eksperimentave dhe demonstrimeve që perbejne aktivitetet me qëllim fitimi;
- f) mostra, p.sh. artikuj që perfaqësojne një kategori të caktuar mallrash, të prodhuara ose që jane shembuj mallrash, të cilat duhet të prodhohen, perjashtuar artikuj identike të sjelle nga i njëjti individ, ose derguar një marresi të vetëm, ne masen që e marre ne tëresi, sipas perdorimit të zakonshem tregtar nuk perbejne me mostra.

2. Per të perfituar regjimin e lejimit të perkohshem, sipas paragrafit 1:

- a) mallrat e permendura ne nenparagrafin (a), (b), (c) dhe (f) me siper duhet të jene prone e një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;
- b) mostrat e permendura ne ne piken (f) të paragrafit ne fjale, duhet të importohen vetëm per t'u ekspozuar ose demonstruar ne territorin doganor të Republikës së Shqipërisë per porosi per mallra të ngjashme që të importohen ne këtë territor. Keto mostra nuk duhet të shiten ose të vendosen ne perdorimin e zakonshem ose të perdoren ne cdo menyre tjetër gjatë kohes që jane ne territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, perjashtuar rastet e demonstrimit.

Neni 351

1. Regjimi i lejimit të perkohshem me perjashtim të plotë nga detyrimet e importit jepet edhe per mjetet zevendesuese të prodhimit.

2. Mjetet zevendesuese të prodhimit mund të qëndrojnë nen regjimin e lejimit të perkohshem per një periudhe prej 6 muajsh.

3. Mjete zevendesuese të prodhimit do të thotë:

instrumenta, aparatura, ose makina të cilat i vihen ne dispozicion klienteve nga furnizuesi ose riparuesi, falas dhe perkohesisht, gjatë kohës që pritet dorezimi ose riparimi i mallrave të ngjashme.

Neni 352

1. Regjimi i lejimit të perkohshem me perjashtim të plotë të detyrimeve të importit, jepet edhe për:

- a) mallrat e dorës së dytë, për t'u shitur në ankand;
- b) mallra të importuara në kuadrin e një kontratë shitjeje që duhet të nënshtrohet provave të mjaftueshme;
- c) vepra arti, artikuj koleksioni dhe antikuare, të importuara për t'u ekspozuar, me synim shitjen e tyre të mundshme;
- d) dergesat me provë të artikujve të peliçeve, gureve të çmuar, qilimave dhe artikujve të bizhuterisë, me kusht që të kenë karakteristika të caktuara që nuk lejojnë të importohen si mostra.

2. Periudha kohore gjatë së cilës mallrat e referuara në paragrafin 1, mund të qëndrojnë në regjimin e lejimit të perkohshëm do të jetë 6 muaj në rastet e (a) dhe (c), 3 muaj në rastet e (b) dhe 1 muaj në rastet e (d).

3. Për qëllim të këtij neni :

- a) *mallra të dorës së dytë*: do të thotë mallrat të ndryshme nga mallrat sapoproduhuara ose të përdorura;
- b) *vepra arti, artikuj koleksioni dhe antikuare*: do të thotë mallra të përcaktuara si në Aneksin 45;
- c) *dergim për provë*: do të thotë dergimin e mallrave që derguesi kërkon të shesë dhe që marrësi mund t'i blejë, pas provës së tyre.

Neni 353

Regjimi i lejimit të perkohshem me perjashtim të plotë nga detyrimet e importit jepet edhe për:

- a) pozitive filmash kinematografike, të zhvilluar dhe stampuar dhe pajisje të tjera mbajtëse të pamjes të regjistruara dhe të destinuara për t'u parë përpara përdorimit të tyre tregtar;
- b) filma, shiritat dhe disqe magnetike dhe pajisje të tjera mbajtëse të zërit dhe të figures që importohen për t'u pajisur me kolone zanore, për tu dubluar, ose riprodhuar;
- c) filma që tregojnë natyrën ose funksionimin e produkteve ose materialeve të huaja, me kusht që të mos kenë për qëllim shfaqjet publike kundrejt pagesës;
- d) pajisje mbajtëse informacioni, të regjistruara, të derguara falas dhe me qëllim përdorimin e tyre në përpunimin automatik të të dhënave;

Neni 354

1. Regjimi i lejimit të perkohshem me perjashtim të plotë nga detyrimet doganore jepet edhe për sende vetiake dhe mallra të importuara për qëllime sportive.

2. Për këtë qëllim:

- a) *udhetar* do të thotë personi i përmendur në nenin 63 të Kodit;
- b) *sende vetiake* do të thotë gjithë sendet e reja ose të përdorura të cilat i nevojiten normalisht një udhetari gjatë udhëtimit, për përdorimin e tij vetiak, duke patur parasysh të gjithë rrethanat e udhëtimit, por duke përjashtuar mallrat e importuara për qëllime tregtare;
- c) *mallra të importuara për qëllim sportive*: artikuj sportive dhe materiale të tjera për t'u përdorur nga udhetari gjatë konkurrenive ose shfaqjeve sportive ose me qëllim stërvitjeje që do të kryhet në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

3. Sendet vetiake duhet të rieksporthen jo më vonë se në castin kur personi që i importoi largohet nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë. Mallrat e importuara për qëllim sportive mund të qëndrojnë nën regjimin e lejimit të perkohshem për një periudhë prej 12 muajsh.

4. Lista ilustruese e mallrave të ketilla pasqyrohet në Aneksin 46.

Neni 355

1. Regjimi i lejimit të perkohshem me perjashtim të plotë nga detyrimet e importit jepet edhe për materiale që shërbejnë për publicitetin turistik.

2. *Materiale publiciteti turistik* do të thotë mallrat qëllimi thelbësor i të cilave është të nxirë publikun të vizitojë vende të huaja, vecanerisht kur behet për ndjekjen e aktiviteteve kulturore, fetare, turistike, mbledhje profesionale ose sportive ose ngjarjet që zhvillohen në këto vende.

3. Lista ilustruese e këtyre mallrave pasqyrohet në Aneksin 47.

Neni 356

1. Regjimi i lejimit të perkohshem me perjashtim të plotë nga detyrimet e importit jepet edhe për pajisje dhe kafshë të çdo lloji të importuara për qëllimet e përmendura në Aneksin 48.

2. Regjimi i lejimit të perkohshem të cilit i referohet paragrafi 1 jepet me kusht që:

- a) kafshet janë prone e një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;
- b) pajisjet janë prone e një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë por në një zonë kufitare fqinje;

- c) kafshet e punes dhe pajisjet jane importuar nga një personi i vendosur ne një zone kufitare fqinjë me territori doganor të Republikës së Shqipërisë per të punuar token që ndodhet brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, pune që perfshin kryerjen e punimeve bujqësore ose pylltarise, perfshire edhe shkarkimin ose transportin e drurit, ose peshkimit;

3. *Zone kufitare* do të thotë, pa rene ndesh me konventat ne fuqi per këtë fushe, ne zone e cila, ne vije ajrore, nuk shtrihet më tej se 15 km nga kufiri. Ndarja administrative territori i të ciles shtrihet brenda kesaj zone, quhet pjese e kesaj zone kufitare, pa perjashtuar edhe ndonjë anashkalim të rastit.

Neni 357

1. Regjimi i lejimit të perkohshem me perjashtim të plotë nga detyrimet e importit jepet edhe per materialet e furnizimit, derguar per detaret.

2. Për këtë qëllim:

- a) *material furnizimi* do të thotë materiale që sherbejne per aktivitetet kulturore, sportive, arsimore, shlodhese, ose fetare nga detaret;
- b) *detar* do të thotë gjithë personat e transportuar ne bordin e një mjeti lundrues dhe që kryejne detyra që kane per objekt funksionimin ose sherbimin detar të mjetit lundrues në det.

3. Lista e mallrave që quhen si materiale furnizimi per detaret jepet ne Aneksin 49.

4. Regjimi i lejimit të perkohshem per mallrat e permendura ne paragrafin 1, jepet me kusht që materiali të jetë:

- a) shkarkuar nga një mjet lundrues që merret me trafikun nderkombetar ujqor, per t'u perdorur perkohesisht ne breg nga ekuipazhi per një periudhe kohe jo me të gjatë se koha e qëndrimit ne port;
- b) importuar per perdorim të perkohshem ne qëndrat kulturore ose sociale per një periudhe 6 mujore. *Qendra kulturore dhe sociale* do të thotë vendi i grumbullimit, klubi dhe lokalet e shlodhjes per detaret, të drejtuara nga organizma zyrtare ose fetare ose organizma të tjere jofitimprures, dhe vendet e kultit ku festohen rregullisht sherbimet fetare per detaret.

Neni 358

Regjimi i lejimit të perkohshem me perjashtim të plotë nga detyrimet e importit jepet edhe per materiale të ndryshme të perdorura nen mbikqyrjen dhe pergjegjesine e autoriteteve publike per ndertimin, riparimin ose mirmbajtjen e infrastrukturave me rëndësi të karakterit të pergjithshem ne zonen kufitare.

Neni 359

1. Regjimi i lejimit të perkohshem me perjashtim të plotë nga detyrimet e importit jepet per mallrat e importuara perkohesisht ne territorin doganor të Republikës së Shqipërisë per situata të vecanta që nuk kane ndikim ekonomik.

2. Lejimi i perkohshem i mallrave të importuara ne baze rastesore per të qëndruar ne territorin doganor të Republikës së Shqipërisë per një periudhe jo me të gjatë se 3 muaj, vlera e të cilave është me pak se 150.000 Leke, quhet situatë e vecantë pa ndikim ekonomik.

Neni 360

1. Drejtoria e Pergjithshme e Doganave mund të vendose të jape perjashtim të plotë nga detyrimet e importit në vend të përjashtimit të pjesshëm, të cilit i referohet neni 162 të Kodit per mallrat e importuara ne territorin e vet ne baze rastësore per një periudhe jo me të gjatë se 3 muaj.

2. Me kalimin e afatit brenda të cilit mallrat mund të qëndrojnë nen regjimin e vendosur e sipas ketij neni, mallrave iu caktohet një destinacion i ri doganor ose vendosen nen regjimin e lejimit të perkohshem me perjashtim të pjesshem nga detyrimet doganore. Nëse bëhet e nevojshme të përcaktohen detyrimet doganore sipas regjimit të përjashtimit të pjesshëm, merret parasysh data në të cilën mallrat u vendosën nën regjimin e lejimit të perkohshëm sipas paragrafit 1.

Neni 361

Në përputhje me nenin 162 (1) të Kodit, Drejtoria e Pergjithshme e Doganave mund të vendosë të japë regjimin e lejimit të perkohshem me përjashtim të pjesshëm të detyrimeve të importit. Lista e mallrave për të cilat mund të jepet regjimi i lejimit të perkohshem me përjashtim të pjesshëm të detyrimeve doganore pasqyrohet në Aneksin 50.

Neni 362

1. Kërkesa bëhet në përputhje me nenin 234 dhe sipas modelit të Aneksit 29 dhe paraqitet nga personi të cilit mund t'i jepet autorizimi sipas neneve 109 dhe 158 të Kodit.

2. Pa rënë ndesh me procedurat e thjeshtuara për kërkesat, kjo e fundit depozitohet në Drejtorinë e Pergjithshme të Doganave.

Neni 363

1. Pa rënë ndesh me proceduren e thjeshtuar për autorizimet, autorizimi lëshohet nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave dhe përpilohet sipas modelit të Aneksit 34.

2. Çdo autorizim duhet të shoqërohet nga një formular i quajtur Regjistër i importit me lejim të perkohshëm që do të jetë pjesë përbërëse e çdo autorizimi. Modeli i Regjistrit të lejimit të perkohshëm është dhënë në Aneksin 34. Të gjithë vendosjet në regjim duhet të regjistrohen në këtë formular në bazë të udhëzimeve që do të nxjerrë Drejtoria e Pergjithshme e Doganave.

Neni 364

Afati i vlefshmërisë së autorizimit caktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave rast pas rasti, duke patur parasysh nevojat përkatëse të kërkuarit.

Neni 365

1. Kur lëshon një autorizim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të caktojë edhe afatin brenda të cilit mallrave të importuara përkohësisht duhet t'u caktohet një destinacion doganor, duke marrë parasysh afatet specifike të përcaktuara në Kod dhe në aktet nënligjore dhe kohen që nevojitet për të arritur objektivin e për të cilin është kërkuar lejimi i përkohshëm.

2. Zgjatja e afatit të dhënë në tejkallim të afatit të parashikuar duhet të caktohet në mënyrë të tillë që të marre parasysh rrethanat që kanë penguar mbajtësin e autorizimit të plotësojë detyrimin për të rieksportuar mallrat brenda afatit fillestar.

Neni 366

1. Ky nen zbatohet kur nuk kërkohet zbatimi i nenit 162 (1) të Kodit.

2. Zyra doganore e autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për të dhene autorizime duke përdorur procedurën e thjeshtuar lejon që një deklaratë për vendosjen nën regjim të jetë njëkohësisht edhe kërkesë për autorizim. Në këtë rast, pranimi i deklaratës është edhe dhenia e autorizimit, me kusht që ky pranim t'i nënshtrohet sidoqoftë rregullave që lidhen me dhenien e autorizimit, duke përfshirë edhe vendimin e zyrës doganore të kontrollit, treguar në kutinë 44 të formularit.

3. Deklarata e paraqitur sipas paragrafit 2, duhet të shoqërohet nga një dokument i perpiluar nga deklaruesi ku përmban të dhënat e mëposhtme, të cilat janë të nevojshme por nuk mund të shenohen dot në kutinë 44 të formularit të përdorur për vetë deklaratën:

- kur personi që kërkon të perdore regjimin nuk është i njëjti person me deklaruesin, duhet të jepet emri ose titulli i aktivitetit dhe adresa e kërkuarit, dhe kur është rasti, edhe e pronarit të mallrave;
- kur perdoruesi nuk është i njëjti person me kërkuarin ose deklaruesin, duhet të jepet emri i aktivitetit dhe adresa e perdoruesit të mallrave;
- nenin sipas se cilit behet kërkesa;
- afatin gjatë të cilit pritët që mallrat të qëndrojnë nën regjim;
- vendin ku do të perdoren mallrat.

4. Depozitimi i një deklaratë duke përdorur procedurën e thjeshtuar për kërkesat, e nënshkruar nga deklaruesi, duhet të tregojë që personi i interesuar kërkon të perdore regjimin doganor të kërkuar dhe ai, pa rënë ndesh me

zbatimin e mundshëm të dispozitave penale, sipas dispozitave në fuqi, është përgjegjës për:

- saktësinë e të dhënave në deklaratë;
- vërtetësinë e dokumentave që e shoqërojnë atë; dhe
- përbushjen e të gjithë detyrimeve që lidhen me regjimin e kërkuar.

5. Autoritetet doganore mbajnë deklaratën me anekset përkatëse, bashkë me cdo autorizim që është lëshuar.

6. Kur jepet një autorizim, kërkesa, anekset dhe vetë autorizimi ruhen nga autoritetet doganore për të paktën 3 vjet nga fundi i vitit kalendarik në të cilin skadon autorizimi.

7. Kur nuk pranohet kërkesa ose anulohet apo revokohet autorizimi, kërkesa dhe vendimi i mospranimit të kërkesës ose autorizimi, sipas rastit, dhe gjithë anekset mbahen nga autoritetet doganore për të paktën 3 vjet nga fundi i vitit kalendarik në të cilin kërkesa nuk u pranua ose autorizimi u anulua ose revokua.

Neni 367

1. Paraqitja e *Carnet* ATA, në zyrën doganore të autorizuar në mënyrën e duhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për të përdorur regjimin e lejimit të përkohshëm, është e barazvlefshme me paraqitjen e kërkesës për autorizim, dhe pranimi i *Carnet*it (fleta lejimit të përkohshëm), është e barazvlefshme me dhënien e autorizimit për të përdorur regjimin.

2. Mallrat që mund të importohen perkohësisht në perputhje me regjimin e përmendur në paragrafin 1, renditen në Aneksin 51.

3. *Carnet*et ATA do të pranohen nga zyrat doganore vetëm nëse janë:

- lëshuar në një vend i cili është palë nënshkruese e konventës ATA dhe e firmosur dhe vulosur dhe e garantuar nga një shoqatë që është pjesë e një zinxhiri ndërkombëtar garantimi; dhe
- vërtetuar nga autoritetet doganore në seksionin përkatës të kopertinës; dhe
- të vlefshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 368

1. Sendet vetiake të udhetarëve dhe mallrat e importuara për qëllime sportive sipas Aneksit 46 do të vendosen nën regjimin e lejimit të perkohshëm pa kërkesë me shkrim apo me gojë dhe pa autorizim.

2. Kur është fjala për një shumë të madhe detyrimesh importi dhe pagesash të tjera, nuk zbatohet paragrafi 1 përse i përket sendeve vetiake dhe mallrave të importuara për qëllime sportive. Në këtë rast, zbatohet *mutatis mutandis* procedura e thjeshtuar për kërkesat.

Neni 369

1. Deklarata për vendosjen e mallrave nën regjimin e lejimit të përkohshëm depozitohet në njërin nga zyrat doganore të treguara në autorizim për vendosjen nën regjim.

2. Kur zbatohet procedura e thjeshtuar për autorizimet, deklarata për vendosjen e mallrave nën regjimin e lejimit të përkohshëm, depozitohet në zyrën doganore të autorizuar në mënyrën e duhur.

3. Kur importimi i përkohshëm kryhet nëpërmjet *Carnet ATA*, ky i fundit, për t'i vendosur mallrat të vendosen nën regjimin e lejimit të përkohshëm, duhet të paraqitet në cdo zyrë doganore të autorizuar në mënyrën e duhur. Megjithatë, kjo zyre lejon që mallrat të mbarten në zyrën e destinacionit që është në gjendje të kryejë keto kontrolle nën *Carnet ATA* të përdorur si dokument tranziti kur:

- a) zyra doganore e autorizuar në mënyrën e duhur nuk është në gjendje të kontrollojë plotësimin e gjithë kushteve të cilave u nënshtrohet regjimi i lejimit të përkohshëm, ose
- b) zyra doganore ku mallrat hyjnë në territorin doganor nuk është e autorizuar të veprojë si zyre vendosjeje nën regjim.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lëshon autorizimet për të lejuar zyrat doganore të veprojnë si zyra për vendosjen nën regjim.

Neni 370

1. Për qëllim të nenit 111 të Kodit, vendosja nën regjimin e lejimit të përkohshëm i nënshtrohet depozitimit të një garancie.

2. Duke anashkaluar paragrafin 1, në Aneksin 52 renditen rastet në të cilat nuk nevojitet garanci për vendosjen e mallrave nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

Neni 371

1. Garancia duhet të depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, në mënyrë që të sigurohet pagesa e cdo borxhi doganor dhe cdo pagese tjetër që mund të lindë lidhur me mallrat.

2. Garancia duhet të zhblokohet nga zyra që lëshon autorizimin me njëherë sapo kjo e fundit merr të konfirmuar nga zyra e mbylljes së regjimit :

- a) kopjen 3 të deklarates së rieksporimit, ose
- b) një kopje të dokumentit të vendosjes nën regjim të mallrave për në destinacion të ri doganor, ose prova të mjaftueshme për autoritetet doganore që mallrave iu është caktuar një destinacion tjetër doganor.

Neni 372

1. Deklarata për vendosjen e mallrave nën regjimin e lejimit të përkohshëm përpilohet sipas neneve 121 deri 161.

2. Pa rënë ndesh me procedurën e thjeshtuar për kërkesat, përshkrimi i mallrave në deklaraten e përmendur në paragrafin 1 duhet të përputhet me specifikimet e bëra në autorizim.

3. Cdo deklarate importi duhet të përmbajë kodin IM5 në kutinë 1 të deklarates si dhe numrin dhe datën e autorizimit të lejimit të përkohshëm në kutinë 44. Formulari Regjistër i eksportit për lejimin e përkohshëm, sic është treguar në Aneksin 34, duhet të lëshohet për cdo deklarate që i vendos mallrat nën regjim dhe formon pjesë përbërëse të kopjes së deklarates që mbahet nga autoritetet doganore. Të gjitha daljet (eksportet) duhet të regjistrohen në këtë formular në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Deklarata e importit, së bashku me të gjithë dokumentat që i bashkëngjiten, duhet që pas cilitrimit të dërgesës, të ruhet në një dosje të vecantë për cdo shoqëri të autorizuar për të përdorur regjimin e lejimit të përkohshëm.

4. Kur regjimi i lejimit të përkohshëm behet nën *Carnet ATA*, zyra doganore e vendosjes nën regjim duhet të kryejë veprimet e mëposhtme:

- a) të verifikojë informacionin e dhënë në kutitë nga A deri në G të fletës së importimit;
- b) të plotësojë kundrafletën dhe kutinë H të fletës së importimit; data përfundimtare për rieksporimin e mallrave që shënohet në kutinë H (b), nuk duhet të jetë me vone se data në të cilën skadon afati i *Carnetit*, pa rënë ndesh me afatet e vecanta të përmendura në nenin 160 të Kodit;
- c) të shkruajë emrin dhe adresën e zyrës së vendosjes nën regjim në kutinë H (e) të fletës së rieksporimit; dhe
- d) të mbajë fletën e importimit.

Neni 373

Dhënia e një destinacioni doganor mallrave nën regjimin e lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm i nënshtrohet ndonjë detyrimi që pagohet sipas nenit 163 të Kodit.

Neni 374

1. Deklarata për mbylljen e regjimit të lejimit të përkohshëm depozitohet në njërin nga zyrat doganore të treguara në autorizim për mbylljen e regjimit, duke përjashtuar zbatimin e procedurave të thjeshtuara për kërkesat.

2. Kur zbatohet procedura e thjeshtuar për kërkesat, deklarata të cilës i referohet paragrafi 1, depozitohet në zyrën doganore ka lëshuar autorizimin.

3. Kur regjimi i lejimit të përkohshëm kryhet nëpërmjet *Carnet ATA*, ky i fundit paraqitet në zyrën doganore të autorizuar për mbylljen e regjimit.

4. Cdo deklarate për mbylljen e regjimit të lejimit të përkohshëm duhet të përmbajë në kutinë 44

numrin dhe datën e autorizimit për lëjimin e përkohshëm.

Neni 375

1. Deklarata për mbylljen e regjimit të lejimit të përkohshëm bëhet në përputhje me dispozitat e percaktuara për destinacionin doganor përkatës.

2. Përshkrimi i mallrave të importit në deklaratën e referuar në paragrafin 1, duhet të përputhet me specifikimet e bëra në autorizim.

3. Kur regjimi i lejimit të përkohshëm kryhet nëpërmjet *Carnet ATA*, zyra doganore e mbylljes së regjimit duhet të:

- a) plotësojë kundërletën dhe kutinë H të fletës të rieksporimit;
- b) mbajë formularin e rieksporimit dhe pa vonesë t'ia kthejë zyrës së përmendur në kutinë H (e).

Neni 376

Në përputhje me nenin 164 (1) të Kodit, në rastin e mallrave për t'u ekspozuar ose për t'u përdorur në ekspozita, panaire, mbledhje ose ngjarje të këtij karakteri, ose mallra të dorës së dytë të cilat janë importuar për t'u shitur në ankand ose veprat e artit, artikujt e koleksionit dhe antikuaret e importuara për ekspozim, ose dërgesat me prove të artikujve të pelicerise, gurëve e çmuar, qilimave dhe artikujve të bizhuterisë, koha e caktuar për qëllim të përcaktimit të borxhit doganor është koha e pranimit të deklaratës për vendosje në qarkullim të lirë.

Neni 377

1. Kur lind një borxh doganor lidhur me mallrat e vendosura paraprakisht nën regjimin e lejimit të përkohshëm, paguhet interes kompensues për shumën totale të detyrimeve të importit që zbatohen në rastin në fjalë.

2. Nuk zbatohet paragrafi 1:

- a) kur lind një borxh doganor në përputhje me nenin 216 (1) (b) të Kodit;
- b) kur lind një borxh doganor dhe është depozituar një garanci nepermjet një depozite me para në dorë, të barabartë me njëren prej shumave të borxhit doganor të percaktuara në nenin 207 (1) të Kodit;
- c) kur lind një borxh doganor për shkak të vendosjes në qarkullim të lirë të mallrave të cilat ishin vendosur nën regjimin e lejimit të përkohshëm për ekspozim ose përdorim në ekspozita, panaire, mbledhje ose ngjarje të këtij karakteri, ose mallra të dorës së dytë të cilat janë importuar për t'u shitur në ankand ose veprat e artit, artikujt e koleksionit dhe antikuaret e importuara për ekspozim, ose dërgesat me prove të artikujve të pelicerisë, gurëve të çmuar, qilimave dhe artikujve dhe bizhuterisë;

d) kur interesi kompensues, i përlogaritur në përputhje me paragrafin 3, nuk kapërcen 1 000 Lekë për çdo borxh doganor të lindur;

e) kur mbajtësi i autorizimit kërkon vendosjen në qarkullim të lirë dhe paraqet prova që për rrethana të veçanta, që nuk janë shkaktuar prej neglizhencës ose mashtrimit e bëjnë të pamundur ose jo të volitshme ekonomikisht kryerjen e operacioneve të rieksporimit sipas kushteve që ai kishte parashikuar dhe arsyetuar në kohën kur bëri kërkesë për autorizim;

f) kur neni 293 zbatohet *mutatis mutandis*.

3. a) niveli vjetor i interesit është ai nivel që është në fuqi në kohën kur lind borxhi doganor.

b) interesi zbatohet në bazë mujore për periudhën që fillon nga dita e parë e muajit që ndjek muajin në të cilin mallrat e importit kanë qënë vendosur në regjim dhe mbaron ditën e fundit të muajit në të cilin lindi borxhi doganor. Periudha kohore minimale për të cilën mund të kërkohe interes kompensues është një muaj.

c) shumat e interesit përlogaritet në bazë të detyrimeve të importit të zbatueshme, nivelit të interesit të referuar në nënparagrafin (a) dhe periudhën e referuar në nënparagrafin (b).

Neni 378

Në rastet ku kryhet një shkelje ose një parregullsi gjatë zbatimit ose lidhur me një operacion lejimi të përkohshëm sipas *Carnet ATA*, për të vjele detyrimet e importit për t'u paguar, zbatohen *mutatis mutandis* dispozitat lidhur me përdorimin e *Carnet ATA* si dokument tranziti.

Neni 379

Kur mallrat e importit janë vendosur në një zonë të lirë ose magazinë të lirë, ose janë vendosur për ndonjë nga regjimet e mundshme me përjashtim të kushtëzuar nga detyrimet e importit, që mundëson mbylljen e regjimit të lejimit të përkohshëm, kutia e caktuar për përshkrimin e mallrave në dokumentin që lidhet me destinacionin doganor në fjalë, përveç të dhënave të paraqitura për regjimin në fjalë, duhet të përmbajë edhe shënimin: "*Mallra me lejim i përkohshëm*" me bojë të kuqe.

Neni 380

Kur zbatohet neni 113 i Kodit, autoritetet kompetente që miratojnë një transferim të tillë, duhet ta shënojnë këtë fakt në autorizim. Një transferim i tillë përfundon regjimin për mbajtësin e mëparshëm.

Neni 381

1. Kur parashikohet që operacionet e lejimit të përkohshëm mund të tejkalojnë periudhën e

vlefshmërisë së *Carnetit* ATA për shkak se mbajtësi nuk është në gjendje të rieksportojë mallrat, shoqata që lëshon *Carnetin* mund të lëshojë një *Carnet* zëvendësues. Mbajtësi duhet t'ia kthejë *Carnetin* original shoqatës që e lëshoi atë.

2. *Carneti* zëvendësues depozitohet pranë zyrës doganore kompetente për vendin ku ndodhen mallrat, e cila kryen formalitetet e mëposhtme:

- a) mbyll *Carnetin* fillestar duke përdorur fletën e rieksporimit të cilën duhet ta kthejë pa vonesë në zyrën doganore fillestare për lejimin e përkohshëm;
- b) merr *Carnetin* zëvendësues dhe mban fletën e importimit, së pari duke shënuar në këtë fletë datën e fundit për rieksporimin siç tregohet në *Carnetin* fillestar, duke shtuar ndonjë zgjatje afati dhe numrin e *Carnetit* original.

3. Kur mbyllet regjimi i lejimit të përkohshëm, zyra e rieksporimit:

- a) plotëson kundërfletën dhe kutinë H të fletës së rieksporimit;
- b) mban fletën e rieksporimit dhe pa vonesë ia kthen zyrës doganore të referuar në kutinë H (e),

duke përdorur fletën e *Carnetit* zëvendësues, e cila i kthehet pa vonesë zyrës doganore që pranon *Carnetin* zëvendësues.

4. Lëshimi i një *Carneti* zëvendësues është përgjegjësi e shoqatës që e lëshon. Nëse *Carneti* ATA skadon dhe mbajtësi i regjimit nuk është në gjendje të rieksportojë mallrat, dhe shoqata që lëshoi *Carnetin* refuzon të lëshojë një *Carnet* zëvendësues, autoritetet doganore kërkojnë plotësimin e një kërkesë të re, qoftë për importimin e përkohshëm pa detyrim doganor, qoftë për caktimin e një destinacioni tjetër doganor të përshtatshëm për mallrat në fjalë.

Seksioni 3

Lejimi i përkohshëm i mjeteve të transportit

Neni 382

Pa rënë ndesh me dispozitat të mëposhtme, të këtij seksioni, që parashikojnë shprehimisht kryerjen e veprimeve me mjetet e transportit, këto të fundit nuk lejohet të jepen hua, me qira, të vendosen peng, të transferohen, ose të vendosen në dispozicion të një personi të vendosur në Republikën e Shqipërisë.

Neni 383

1. Regjimi i lejimit të përkohshëm zbatohet edhe për automjete rrugore për përdorim tregtar.

2. Për qëllim të këtij neni, 'automjete' do të thotë gjithë automjetet rrugore, përfshi rimorkiot që mund t'i bashkëngjiten këtyre automjeteve.

3. Pa rënë ndesh me paragrafin 4, regjimi i

lejimit të përkohshëm i parashikuar në paragrafin 1, jepet me kusht që automjetet të jenë:

- a) importuar nga një person i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, ose për llogari të këtij personi;
- b) përdorur për qëllime tregtare nga një person i tillë ose për llogari të tij;
- c) regjistruar jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në emër të një personi të vendosur jashtë këtij territori. Megjithatë, nese automjetet nuk janë regjistruar, quhen të plotesuara kushtet e mësipërme kur automjetet në fjale i përkasin një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;
- d) përdorur ekskluzivisht për transport që fillon ose mbaron jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

4. Kur një automjeti të regjistruar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë i bashkëngjitet një rimorkio, regjimi i lejimit të përkohshëm mund të jepet edhe nëse nuk janë plotësuar kushtet e parashikuara në nënparagrafet 3(a) dhe (b).

5. Automjetet rrugore për përdorim tregtar mund të qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në kushtet e paragrafit 3, gjatë gjithë kohës që nevojitet për kryerjen e operacioneve për të cilat është kërkuar regjimi i lejimit të përkohshëm, p.sh. transportimi, hipja dhe zbritja e udhëtarëve ngarkimi, dhe shkarkimi i mallrave, transporti dhe mirëmbajtja.

6. Për qëllim të nënparagrafeve 3(a) dhe (b), personat që veprojnë për llogari të një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë duhet të jenë autorizuar në mënyrën e duhur nga personi i interesuar.

7. Duke anashkaluar nga paragrafi 3:

- b) automjetet për përdorim tregtar mund të drejtohen, në kushtet e parashikuara në paragrafin 6, nga persona fizike të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;
- c) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund:
 - i) të lejojë në raste të jashtëzakonshme, që një person i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të importojë dhe perdore automjete për qëllim tregtar të vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm, për një periudhë kohore që caktohet nga vete këto autoritete rast pas rasti, duke marrë parasysh rrethanat përkatëse;
 - ii) të lejojë që një person fizik i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe i punësuar nga një person i vendosur jashtë këtij territori doganor, të importojë dhe të përdorë në këtë territor për qëllime tregtare, një automjet që i

përket këtij të fundit. Automjeti i importuar nën regjimin e lejimit të përkohshëm mund të përdoret edhe për qëllime private, me kusht që të jetë përdorim rastësor dhe dytësor në raport me përdorimin tregtar dhe të jetë parashikuar në kushtet e kontratës së punës.

Neni 384

1. Regjimi i lejimit të përkohshëm zbatohet edhe për automjetet rrugore për përdorim privat.

2. Për qëllim të këtij neni, "automjete" do të thotë gjithë automjetet rrugore duke përfshirë edhe *roulettes* e rimorkiot të cilat mund t'i bashkëngjiten një automjeti.

3. Regjimi i lejimit të përkohshëm për automjetet për përdorim privat i nënshtrohet kushteve që automjetet të jenë:

- b) importuar nga persona te vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;
- c) përdorur për qëllime private nga këta persona; dhe
- d) regjistruar jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në emër të një personi te vendosur jashtë këtij territori. Megjithatë, nëse automjetet nuk janë regjistruar, kushti i mesiperm quhet se është permbyllur, kur automjetet në fjalë i perkasin një personi te vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

4. Regjimi i lejimit të përkohshëm zbatohet edhe në rastet e mëposhtme:

- b) kur një automjet privat i regjistruar në vendin e qëndrimit normal të përdoruesit, përdoret rregullisht në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për udhëtim nga vendi i qëndrimit të tij në vendin e punës dhe anasjelltas. Autorizimi për të përdorur këtë regjim nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi kohor;
- c) kur një student përdor një automjet privat të regjistruar në vendin e tij të zakonshëm të qëndrimit, në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, ku studenti qëndron vetëm për të vazhduar studimet.

5. Pa rënë ndesh me paragrafin 4, automjetet rrugore për përdorim privat mund të qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për:

- b) një periudhë deri në 6 muaj, të vazhdueshme ose jo, matur gjatë një periudhe 12 mujore;
- c) periudhën gjatë së cilës studenti qëndron në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në rastet e parashikuara në paragrafin 4 (b).

6. Paragrafet 4 (b) dhe 5 (b) zbatohen *mutatis mutandis* edhe për personat e ngarkuar me detyra me kohëzgjatje të përcaktuar, mes të tjerash, shkencetarë dhe mjekë.

7. Për qëllim të zbatimit të nënparagrafeve 3 (a) dhe (b), automjetet për përdorim privat nuk duhet të jepen me qira, në huadhenie ose të vendosen në dispozicion të dikujt pas importimit dhe, nëse në castin e importimit ishin dhene me qira, hua, ose ishin vënë në dispozicion të dikujt, nuk duhet të ri jepen me qira ose nënqira, ose hua ose të ri vendosen në dispozicion të një personi tjetër në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për qëllime të ndryshme nga rieksporimi i menjëhershëm.

8. Në bazë të paragrafit 7, automjetet për përdorim privat që i përkasin një shoqërie qiradhënëse automjetesh, selia e të cilës ndodhet jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, mund t'u ri jepen me qira përsëri personave fizike të vendosur jashtë këtij territori me synim që të rieksporthen brenda një afati që caktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëse ndodhen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë gjatë kohëzgjatjes së një kontratë e qiraje.

9. Pavarësisht nga sa parashikohet në paragrafin 7:

- a) bashkeshortja/bashkeshorti dhe pasardhësit dhe paraardhësit në vijë të drejte, të një personi fizik te vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë të cilet janë te vendosur normalisht jashtë këtij territori, mund të përdorin një automjet privat te vendosur tashme nën regjimin e lejimit të përkohshëm;
- b) një automjet për përdorim privat, i cili është vendosur nën regjimin e lejimit të përkohshëm, mund të përdoret në mënyrë rastësore nga një person fizik i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë kur një person i tillë vepron për llogarë të, dhe sipas udhëzimeve të përdoruesit të regjimit, i cili ndodhet vetë në këtë territor.

10. Duke anashkaluar nenin 381:

a) regjimi i lejimit të përkohshëm i parashikuar në paragrafin 8, duhet t'u jepet edhe personave fizike te vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) automjetet mund të nxirren jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë nga një i punësuar i shoqërisë qiradhënëse të automjeteve, e vendosur në këtë territor.

11. Për qëllim të zbatimit të paragrafit 5 (a), për të nderprerë afatin e qëndrimit të një automjeti të importuar nën regjimin e lejimit të përkohshëm në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, përdoruesi i regjimit të lejimit të përkohshëm duhet

të njoftojë për këtë qëllim autoritetet doganore dhe duhet të respektojë të gjitha masat që gjykohen të pershtatshme nga keto autoritete për të parandaluar perdorimin e perkohshëm të automjetit.

Neni 385

1. Neni 384, me përjashtim të paragrafit 11, zbatohet *mutatis mutandis* edhe për kafshët e shalës dhe të punes dhe për mjetet e terhequra prej tyre, të cilat hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Kafshet dhe mjetet e tërëhequra prej tyre mund të qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për një afat deri në 3 muaj.

Neni 386

1. Regjimi i lejimit të përkohshëm zbatohet edhe për mjetet e transportit hekurudhor.

2. Për qëllim të këtij neni, 'mjetet e transportit hekurudhor' do të thotë lokomotiva, vagona vetlëvizës hekurudhorë, si dhe vagonet e çdo lloji, të përdorur për transportin e personave ose mallrave.

3. Regjimi i lejimit të përkohshëm për mjetet e transportit hekurudhor i nënshtrohet kushtit që mjetet e transportit hekurudhor:

a) t'i përkasin një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) të jenë regjistruar në një rrjet hekurudhor jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

4. Mjetet e transportit hekurudhor mund të qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për një periudhë deri në 12 muaj.

5. Duke anashkaluar nenin 382, mjetet e transportit hekurudhor mund të vendosen në dispozicion të një personi të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që të jenë përdorur bashkarisht sipas një marrëveshjeje e cila parashikon që secili prej rrjeteve hekurudhore mund të përdorë mjetet e transportit hekurudhor tjetrës, sikur të ishin të vetat.

Neni 387

1. Regjimi i lejimit të perkohshëm zbatohet edhe për mjetet e transportit ajror.

2. Mjetet e transportit ajror mund të qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë gjatë kohës që nevojitet për të kryer operacionet për të cilat kërkohej lejimi i perkohshëm, mes të tjerash, transportimi, hipja dhe zbritja e udhëtarëve, ngarkimi ose shkarkimi i mallrave, transporti dhe mirmbajtja.

3. Kur mjetet e transportit ajror përdoren për transport ajror privat, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) të jenë importuar nga persona të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) të përdoren për qëllime private nga personi i interesuar;

c) të regjistrohen jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në emër të një personi të vendosur jashtë këtij territori. Megjithatë, në qoftë se mjetet e transportit ajror nuk janë regjistruar, kushti i mesipër quhet se është përmbushur kur mjetet e transportit ajror në fjalë i perkasin një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

4. Mjetet e transportit ajror të përdorur për transport ajror privat mund të qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për një periudhë deri në 6 muaj, qoftë ky qëndrim i vazhdueshëm ose jo, matur për një periudhë 12 mujore.

Neni 388

1. Regjimi i lejimit të përkohshëm zbatohet edhe për mjetet e transportit detar dhe transportit të ujërave të brendshme.

2. Mjetet detare dhe të lundrimit në ujrat e brendshme mund të qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për gjithë kohën e nevojshme për kryerjen e operacioneve për të cilat kërkohej regjimi i lejimit të përkohshëm, mes të tjerash, transportimi, hipja dhe zbritja e udhëtarëve, ngarkimi ose shkarkimi i mallrave, transporti dhe mirmbajtja.

3. Kur mjetet e transportit detar dhe ujor të brendshëm përdoren për transport detar dhe ujor të brendshëm privat, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) të jenë importuar nga persona të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) të përdoren për qëllime private nga personi i interesuar;

c) të jenë regjistruar jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në emër të një personi të vendosur jashtë këtij territori. Megjithatë, në qoftë se mjetet e transportit detar dhe ujor të brendshëm nuk janë regjistruar, kushti i mesipër gjykohet se është përmbushur kur mjetet e transportit detar dhe ujor të brendshëm në fjalë i përkasin një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

4. Mjetet e transportit të përmendur në paragrafin 3, mund të qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për një periudhë deri në 6 muaj, qoftë ky qëndrim i vazhdueshëm ose jo, matur për një periudhë 12 mujore.

5. Duke anashkaluar nenin 382, ne raste të jashtëzakonshme, kur infrastruktura e portit liqënor jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë nuk është e pershtatshme për ankorimin e mjeteve të ujërave të brendshme të transportit për përdorim privat, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të lejojë që një person fizik i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të importojë një mjet lundrues të vendosur nën regjimin e lejimit të perkohshëm, dhe përdorimin e mjetit në fjalë në atë pjesë të liqënit që i përket Republikës së Shqipërisë; kur liqëni shtrihet mes këtij territori dhe territorit të vendit ku është regjistruar vetë mjeti. I interesuari duhet të sjellë prova të panueshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për mungesën e kushteve të infrastruktures së portit liqënor.

Neni 389

1. Regjimi i lejimit të perkohshëm zbatohet edhe për paletat.
2. Paletat të cilat mund të identifikohen mund të qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për një periudhë deri në 12 muaj, periudhë e cila me kërkesën e personit të interesuar mund edhe të shkurtohet.
3. Paletat, përjashtuar ato të përmendura në paragrafin 2, mund të qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për një periudhë deri në 6 muaj, periudhë kjo e cila me kërkesën e personit të interesuar mund të shkurtohet.

Neni 390

1. Regjimi i lejimit të perkohshëm zbatohet edhe për konteinerë të miratuar për transport nën plumbosjen doganore, ose thjesht të pajisur me shenja identifikuese kur hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për llogari të pronareve të tyre, të përdoruesit ose të përfaqësuesve të secilit prej tyre.
2. Konteinerët, përveç atyre të përmendur në paragrafin 1, pranohen nën regjimin e lejimit të perkohshëm kur një gjë e tillë autorizohet nga autoritetet doganore.
3. Konteinerët e vendosur nën regjimin e lejimit të perkohshëm mund të qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për një periudhë prej 12 muajsh.
4. Konteinerët e vendosur nën regjimin e lejimit të perkohshëm, përpara se të rieksporthen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, mund të përdoren në trafikun e brendshëm. Megjithatë, konteineret mund të përdoren një here për çdo qëndrim në Republikën e Shqipërisë, për transportimin e mallrave të ngarkuara brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe synohet të shkarkohen brenda po këtij territori, kur konteineret në rast të kundërt duhet të kryenin një udhëtim të pangarkuar brenda këtij territori.
5. Pa rene ndesh me dispozitat lidhur me

regjimin e lejimit të perkohshëm të aksesoreve të pjesëve të kembimit dhe pajisjeve të zakonshme për konteinere, aksesoret e konteinereve dhe pajisjet e zakonshme për konteinere, mund të importohen ose me një konteiner për rieksportim të metejshëm vecmas, ose me një konteiner tjetër, ose vecmas për rieksport të metejshëm me një konteiner.

Neni 391

1. Neni 391 (1) zbatohet për konteinere, pavarësisht nëse ata janë miratuar ose jo për plumbosje nga dogana, të cilët mbajnë në një vend të pershtatshëm dhe të dukshëm, të dhenat e mëposhtme të shkruara në mënyrë të tillë që të jete e rezistueshme:
 - a) identitetin e pronarit ose të përdoruesit;
 - b) shenjat e identifikimit të konteinerit dhe numrat e konteinerit, të vendosura nga pronari ose përdoruesi;
 - c) pesha e tarës së konteinerit, duke përfshirë edhe atë të pajisjeve të fiksuara të tij; dhe
 - d) vendin të cilit i përket konteineri.
2. Megjithatë, të dhenat e përmendura në paragrafin 1 (c) nuk kerkohen në rastin e shenjave dalluese të kasave të levizshme, të cilat përdoren në transportin e kombinuar rrugor- hekurudhor, dhe gjithashtu të dhenat e përmendura në nenin 1 (d) nuk kerkohen në rastin e konteinereve të përdorur në transportin ajror.
3. Vendi të cilit i përket konteineri, mund të tregohet i plote ose pjesërisht, nepermjet kodit të vendit ISO alfa-2, të parashikuar në Standardin Ndërkombëtar ISO 3166, ose nepermjet siglave/shenjave dalluese që përdoren për të treguar vendin e regjistrimit të automjeteve për qarkullimin rrugor ndërkombëtar, ose kur është fjala për kasa të levizshme të përdorura në transportin e kombinuar rrugor-hekurudhor, me ane shifrash. Identiteti i pronarit ose përdoruesit mund të tregohet duke shënuar emrin e tij të plote, ose një mënyrë të tjetër të caktuar identifikimi, përjashtuar simbole të tilla si emblema ose flamurë.
4. Quhen të miratuar për transport nën plumbosjen doganore konteineret që:
 - a) në vijim të informacionit të parashikuar në paragrafin 1, mbajnë edhe detajet e mëposhtme të cilat do të vendosen në targën e miratimit sipas rregullave të parashikuara në paragrafin 5, të tilla si:
 - i) numri i serisë së prodhimit (numrin e prodhimit), dhe
 - ii) numri ose shkronjat e identifikimit të llojit, nëse ka të tilla për atë lloj,
 - b) plotësojnë kushtet teknike të cilave u referohet paragrafi 5; dhe
 - c) janë miratuar në përputhje me procedurat e parashikuara në paragrafin 5.

5. Normat teknike që zbatohen për konteineret të cilët mund të miratohen për transport nën plumbosjen nga dogana dhe procedurat lidhur me plumbosjen në fjalë, duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Pjesës I dhe Pjesës II të Aneksit 7 të Konventës TIR.

6. Kur gjenden konteinerë të miratuar të cilët nuk përputhen me normat teknike të cilave u referohet paragrafi 5, ose kur konteineri ka defekte thelbësore të tilla që nuk përputhet me standartet sipas të cilave ishte miratuar për transport nën plumbosje nga dogana, zyra doganore duhet të veprojë sipas Aneksit 53.

Neni 392

1. Regjimi i lejimit të përkohshëm jepet për pjesët e zakonshme të kembimit, aksesoret dhe materialet, përfshi edhe pajisjet e zakonshme për stivimin, fiksimin ose mbrojtjen e mallrave, të importuara bashkë ose vecas nga mjetet e transportit për të cilat duhet të përdoren.

2. Pjesët e kembimit të importuara bashkë me mjetet e transportit për të cilat ato do të përdoren ose vecmas prej këtyre mjeteve, shërbejnë vetëm për riparime të vogla ose për mirëmbajtjen e zakonshme.

3. Operacionet e zakonshme të mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve të transportit që dalin të nevojshme gjatë udhëtimit neper ose brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, nuk përbejnë ndryshim në kuptimin e nenit 157 të Kodit, dhe mund të kryhen gjatë regjimit të lejimit të përkohshëm.

Neni 393

Vendosja e mjeteve të transportit nën regjim, autorizohet pa qënë e nevojshme të bëhet kërkesë me shkrim ose të lëshohet autorizim.

Neni 394

1. Mjetet e transportit kur nuk i deklarohen me shkrim ose me gojë autoriteteve doganore, vendosen nën regjimin e lejimit të përkohshëm nëpërmjet veprimi të përshkruar në nenin 157 (1).

2. Në bazë të nenit 111 të Kodit, vendosja nën regjimin e lejimit të përkohshëm e mjeteve të transportit të cilat nuk deklarohen, nuk i nënshtrohet depozitimit të garancisë.

3. Duke anashkaluar paragrafin 1, kur zyra doganore mbikqyrëse, në castin e vendosjes nën regjim ose kur kryhen kontrole, gjykon që ka një rrezik të lartë të mospermbushjes së kushteve të rieksporimit të një mjeti transporti, regjimi i lejimit të përkohshëm zbatohet kundrejt:

- a) paraqitjes së një deklarate të perpiluar në përputhje me nenin 130 (1);
- b) deklarimit gojor, në rastin e konteinerëve, të shoqëruar nga një listë e cila duhet të përmbajë:

- i) emrin, emrin e shoqërisë dhe adresën e përdoruesit ose përfaqësuesit të tij,
- ii) mënyrat e identifikimit të konteinerëve,
- iii) numrin e konteinerëve, sasinë dhe natyrën e pjesëve të këmbimit, të aksesoreve dhe pajisjeve.

4. Pa rënë ndesh me paragrafin 2, kur zyra doganore mbikqyrëse gjykon se nuk është e sigurtë pagesa e borxhit doganor që mund të lindë, duhet të zbatohet paragrafi 3 dhe depozitimi i garancisë është i detyrueshëm.

Neni 395

1. Mjetet e transportit të vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm pas mbylljes së regjimit të perpunimit aktiv, trajtohen si mjete të transportit të cilat janë sjelle në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Data e vendosjes nën regjimin e lejimit të përkohshëm të mjeteve të transportit të cilave u referohet paragrafi 1, është data në të cilën ato janë përdorur për herë të parë nën regjim.

3. Për qëllim të perpilimit të dokumentit të mbylljes së regjimit, të parashikuar në regjimin e perpunimit aktiv, përdoruesi i regjimit të importit të përkohshëm duhet të pajisë mbajtësin e autorizimit për perpunim aktiv me një vertetim që përmban të informacionin që nevojiten për perpilimin e dokumentit për mbylljen e regjimit.

Neni 396

Pjesëve të zëvendësuar si pasojë e riparimeve ose mirëmbajtjes dhe pjesëve të reja të kembimit, të cilat janë demtuar ose me defekt, u caktohet ndonjë nga destinacionet doganore të lejuara për mallrat e importit.

Neni 397

Në rastin e mjeteve të transportit hekurudhor dhe paletave të përdorura së bashku në baze marreveshjeje, mbyllet gjithashtu regjimi kur mjetet e transportit hekurudhor të njëjtit lloj ose paletat e të njëjtit lloj ose me vlerë të barazvlefshme me ato të cilat i ishin vënë në dispozicion një personi të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, u caktohet ndonjë nga destinacionet doganore të lejuara.

Neni 398

1. Kur mjetet e transportit vendosen nën regjimin e lejimit të përkohshëm pa ndonjë deklaratë, regjimi mbyllet:

- a) në rastin e rieksporimit, në mënyrën të ciles i referohet neni 157 (2);
- b) në rastin e deklaratës për ndonjë destinacion tjetër doganor, në mënyrën e specifikuar për të deklaruar për destinacionin doganor në fjalë.

2. Kur zbatohet neni 349 (3), regjimi i lejimit të

përkohshëm lidhur me mjetet e transportit të cilave u referohet, mbyllet duke paraqitur mjetet e transportit për ndonjë nga destinacionet doganore të lejuara, bashkë me deklaratën brenda afatit kufi të përcaktuar nga autoritetet doganore kur një dokument i tillë ishte lëshuar ose ishte depozituar deklarata.

Neni 399

Autoritetet doganore mund të revokojnë autorizimin e regjimit të lejimit të perkohshëm kur, pa rënë ndesh me përjashtimet e parashikuara në këtë Kre dhe pa rënë ndesh me fillimin e cështjes penale, mes të tjerash konstaton se:

- a) mjetet e transportit rrugor për përdorim tregtar janë përdorur për trafik të brendshëm;
- b) mjetet e transportit për përdorim privat janë përdorur për qëllime tregtare në trafik të brendshëm;
- c) mjetet e transportit janë dhënë me qira, huadhënie ose vënë në dispozicion pas importimit të tyre ose nëse ishin të dhëna me qira, hua ose në dispozicion ndërkohë që u importuan, janë ridhënë me qira ose nënqira, hua ose janë në vënë në dispozicion një personi tjetër në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për çdo qëllim tjetër përveç rieksporimit të tyre të menjëhershëm.

Seksioni 4

Dispozita të veçanta lidhur me mbylljen dhe masat e politikës tregtare

Neni 400

Për qëllim të këtij Kreu, me miratimin e autoriteteve doganore, lejohet të braktisen mallrat në favor të buxhetit të shtetit, në raste thelbësisht përjashtimore.

Neni 401

1. Kur legjislacioni në fuqi parashikon masa të politikës tregtare për:

- a) vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë, masat në fjalë nuk zbatohen për vendosjen e mallrave nën regjimin e importimit të perkohshëm, për sa kohë që mallrat qëndrojnë nën këtë regjim;
- b) mallrat e sjella në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, masat në fjalë zbatohen kur mallrat vendosen nën regjimin e importimit të perkohshëm;
- c) eksportet, masat në fjalë nuk zbatohen kur mallrat jo shqiptare janë rieksportuar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë pasi janë vendosur nën regjimin e importimit të perkohshëm.

2. Vendosja e mallrave të importit për qarkullim të lirë i nënshtrohet zbatimit të masave të politikës tregtare në fuqi për këto mallra nga autoritetet

doganore, në kohën kur ishte pranur deklarata për vendosjen në qarkullim të lirë.

Neni 402

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të nxjerrë udhëzime për zbatimin praktik regjimit të lejimit të perkohshëm.

KREU 6

Përpunimi pasiv

Seksioni 1

Dispozita të përgjithshme

Për qëllim të nenit 403 deri 427¹¹:

- a) “*Produkte kompensuese kryesore*” do të thotë: produktet kompensuese për përfundimin e të cilave është lëshuar autorizim për përdorimin e regjimit të përpunimit pasiv;
- b) “*Produkte kompensuese dytësore*” do të thotë: produkte kompensuese të ndryshme nga produktet për të cilat u dha autorizimi dhe që përftohen domosdoshmërisht si produkt shoqërues nga operacionet e përpunimit pasiv;
- c) “*humbje(/firo)*” do të thotë: pjesa e mallrave të eksportuara përkohësisht të cilat humbasin gjatë përpunimit, veçanërisht për shkak të avullimit, tharjes, shkarkimit në trajtë gazi ose humbjes për shkak të shpëlarjes;
- d) “*Metoda e matjes sasiore*” do të thotë: përlllogaritja e asaj pjese të mallrave të eksportit të trupezuara në produktet kompensuese të ndryshme në funksion të sasisë së mallrave të importit;
- e) “*Metoda e matjes mbi bazën e vlerës*” do të thotë: përlllogaritja e asaj pjese të mallrave të eksportit të trupëzuara në produktet kompensuese të ndryshme në funksion të vlerës së këtyre të fundit;
- f) “*Importim paraprak*” do të thotë: sistemi i parashikuar në nenin 174 (4) të Kodit;
- g) “*Shuma për t’u zbritur*” do të thotë: shuma e detyrimeve doganore të importit të cilat do të duhej të paguheshin për mallrat e eksportit të perkohshëm, nëse keto të fundit do të importoheshin në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga ai vend në të cilin iu nënshtroan operacioneve të përpunimit ose operacioneve të fundit të përpunimit;
- h) “*Shpenzime ngarkimi, transporti, dhe sigurimi*” do të thotë: gjithë shpenzimet që janë bërë në lidhje me ngarkimin,

¹¹ Shiko nenin 2(10). Ky tekst është rishikuar këtu për lehtësi përdorimi të termave të përkufizuar.

transportin dhe sigurimin e mallrave, duke përfshirë:

- i) komisionet dhe shpenzimet e ndermjetësisë, duke përfshirë komisionet e blerjes;
- ii) kostot e mbajtësve të mallrave (shishe, flakonë, çanta, kuti, thasë, dhe mbajtës të tjerë të kësaj natyre) që nuk janë pjesë përbërëse e mallrave të eksportuara përkohësisht;
- iii) kostot e ambalazhimit, duke përfshirë materialet dhe punën e krahut;
- iv) shpenzimet e bëra për trajtimin e mallrave, lidhur me transportin e tyre.

Neni 403

Në përputhje me Pjesën IV, kreu 2, seksioni 3G të Kodit, ky Kre përcakton dispozitat për zbatimin e regjimit të përpunimit pasiv.

Seksioni 2

Dhënia e regjimit

Neni 404

1. Për qëllim të nenit 168 (b) të Kodit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të bindet që është i mundur përcaktimi i faktit që produktet kompensuese janë përftuar prej mallrave të eksportuara përkohësisht, e sidomos:

- a) tregimi ose përshkrimin i shenjave të veçanta ose të numrave të prodhimit;
- b) vendosjen e plumbceve, vulave, damkosjen, ose shenjave të tjera identifikuese;
- c) marrjen e mostrave, ilustrimet ose përshkrimet teknike;
- d) kryerjen e analizave;
- e) shqyrtimin e dokumentave mbështetës lidhur me transaksionin përkatës (si p.sh kontrata, korrespondencë, ose fatura), të cilët tregojnë qartë që produktet kompensuese duhet të fabrikohen nga mallra të eksportuara përkohësisht.

2. Kur regjimi kërkohet për riparimin e mallrave, pavarësisht nëse përdor sistemin e shkembimeve standarde ose jo, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të bindet që mallrat e eksportuara perkohësisht shkojnë për tu riparuar. Nëse Drejtoria e Përgjithshme e Doganave gjykon se ky kusht nuk është plotësuar, ajo refuzon autorizimin.

3. Kur kërkohet sistemi standard i shkëmbimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, mes të tjerash, përdor metodat e verifikimit të renditura në paragrafin 1(a), (c), (d) ose (e). Në rastin e paragrafit 1(e), nga dokumentat mbështetëse duhet të dalë qartë që riparimi i parashikuar do të kryhet duke përdorur një produkt zëvendësues, që plotëson kushtet e parashikuara në nenin 175(1) të Kodit.

4. Për qëllim të paragrafit 3, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të bindet vecanerisht që përdorimi i regjimit që duhet të kryhet nepermjet zëvendësimit të parashikuar në nenin 174(1) të Kodit nuk autorizohet për të përmirësuar aftësitë teknike të mallrave. Për këtë qëllim këto autoritete shqyrtojnë:

- a) kontratat dhe dokumenta të tjere mbështetës që i perkasin riparimit, dhe
- b) kontratat e shitjes ose qirase dhe/ose faturat e mallrave të eksportuara perkohësisht ose të mallit në të cilin janë trupezuar mallrat e eksportuara perkohësisht dhe vecanerisht, të kushteve të percaktuara në ato kontrata.

5. Kur nuk është e mundur të percaktohet nëse produktet kompensuese do të përftoheshin nga mallrat e eksportuara perkohësisht dhe autoritetet doganore u kërkohet një anashkalim nga neni 168(b) i Kodit, këto autoritete ia kalojnë kërkesën për shqyrtim Ministrit të Financave.

Neni 405

1. Kërkesa bëhet në përputhje me nenin 234 sipas modelit të Aneksit 30 dhe paraqitet nga personi të cilit mund t'i jepet autorizimi në zbatim të nenit 109, 167 dhe 168 të Kodit.

2. Kërkesa i paraqitet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Neni 406

1. Pa rënë ndesh me procedurën e thjeshtuar për kërkesat, autorizimet leshohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe hartohen sipas modelit të Aneksit 35.

2. Çdo autorizim duhet të shoqërohet nga një formular Regjistër i përpunimit pasiv për eksportin që do të jetë pjesë integrale e çdo autorizimi. Modeli i regjistrit të përpunimit pasiv për eksportin është dhënë në Aneksin 35. Të gjitha vendosjet e mallrave nën regjim duhet të regjistrohen në këtë formular në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme të Doganave.

3. Në rastet përjashtisht thelbësore e të arsyetura bindshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të leshojnë një autorizim me fuqi prapavepruese. Efekti prapaveprues i një autorizimi të tillë nuk mund të shkojë më tej se dita kur është depozituar kërkesa. Ky anashkalim nuk zbatohet për shkëmbimet standarde me importim paraprak.

Neni 407

Për riimportimin e produkteve kompensuese në vend të produkteve zëvendësuese mund të përdoret edhe autorizimi që lejon përdorimin e sistemit të shkëmbimeve standarde pa importim paraprak, me kusht që të jenë plotësuar të gjithë kushtet e parashikuara. Për këtë qëllim, personat e interesuar duhet të paraqesin një kërkesë jo me vone sesa casti kur produktet janë importuar.

Neni 408

Kohezgjatja e vlefshmërisë së autorizimit vendoset nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duke

patur parasysh kushtet ekonomike dhe nevojat specifike të kerkuesit. Kur kohezgjatja e vlefshmerise tejkalon 2 vjet, kushtet ekonomike ne baze te te cilave është leshuar autorizimi rishqyrtohen periodikisht ne intervale të specifikuara ne autorizim.

Neni 409

1. Afati brenda te cilit produktet kompensuese duhet te riimportohen ne territorin doganor te Republikës së Shqipërisë vendoset duke patur parasysh afatin e nevojshem per te kryer operacionet e perpunimit dhe per te transportuar mallrat e eksportuara perkohsisht si dhe produktet kompensuese. Ky afat perlllogaritet nga data e pranimit te deklarates se vendosjes nen regjim.

2. Sipas sistemit te shkembimit standard pa importim paraprak, afati brenda te cilit produktet zevendesuese duhet te importohen ne territorin doganor te Republikës së Shqipërisë, percaktohet duke patur parasysh afatin që nevojitet per zevendesimin e mallrave te eksportuara perkohsisht dhe per transportimin e ketyre te fundit si dhe te produkteve zevendesuese. Ky afat përlllogaritet nga data e pranimit te deklarates se pranimit te vendosjes nen regjim.

3. Riimportimi i produkteve kompensuese dhe importimi i produkteve zevendesuese gjykohet se është kryer kur produktet jane:

- a) vendosur ne qarkullim te lire; ose
- b) vendosur ne një zone te lire ose magazine te lire ose nen magazinimin doganor ose regjimin e perpunimit aktiv; ose
- c) vendosur nen regjimin e tranzitit.

4. Data që merret parasysh per zbatimin e ketij neni është data e pranimit te deklarates per vendosje ne qarkullim te lire ose deklarata per vendosjen e produkteve ne njërin nga destinacionet doganore te referuara ne paragrafin 3, ose data e vendosjes ne një zone te lire ose magazine te lire.

Neni 410

Kur për shkak të rrethanave, afati i riimportimit te produkteve kompensuese dhe riimportimit të produkteve zevendesuese, sipas sistemit te shkembimit standard pa importim paraprak, mund te zgjatet edhe ne rast se periudha fillestare ka skaduar.

Neni 411

1. Kur për shkak të rrethanave, afati te cilit i referohet neni 177 i Kodit, mund te zgjatet edhe ne qofte se ka perfunduar afati fillestar.

2. Per zbatimin e nenit 177 (1) te Kodit, vendosja e mallrave ne një zone te lire ose magazine te lire ose nen regjimin e magazinimit doganor per eksport te metejshem trajtohet si eksport.

Neni 412

Koeficienti i shfrytezimit te cilit i referohet neni 169(2) i Kodit, caktohet jo me vone se casti kur mallrat vendosen nen regjim, duke marre parasysh te dhenat teknike te operacionit ose te operacioneve që duhet te kryhen, kur ka te tilla, ose ne te kundert, nga te dhena te disponuara ne Republikën e Shqipërisë lidhur me operacione te te njëjtit lloj.

Neni 413

1. Për qëllim te nenit 167(2) te Kodit, autorizimi per perpunimin pasiv leshohet me kerkesen e personit që eksporton mallrat e eksportit te perkohshem edhe kur ai nuk është personi që kryen operacionet e perpunimit. Ky anashkalim i kerkohet autoriteteve doganore ne kerkesen që u paraqitet ketyre te fundit. Autorizimi i leshohet kerkuesit. Anashkalimi mundeson një person te ndryshem nga mbajtesi i autorizimit te deklaroje produktet kompensuese per qarkullim te lire dhe te autorizohet per perdorimin e regjimit.

2. Kerkesa duhet të shoqërohet nga të gjithë dokumentat mbështetëse që gjykohen te nevojshme per shqyrtimin e saj.

3. Kur Drejtoria e Pergjithshme e Doganave ka gjithë informacionin e nevojshem, vendos nese dhe ne cfare kushtesh mund te leshohet një autorizim, duke saktësuar vecanerisht masat e kontrollit te zbatueshme per te siguruar që perjashtimi te cilit i referohet neni 171 i Kodit, jepet vetem per produkte kompensuese ne te cilat jane trapezuar mallrat e eksportit te perkohshem.

Neni 414

1. Kur operacionet e perpunimit kane te bejne me riparim mallrash, zyra doganore e autorizuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave per te leshuar autorizime, duke perdorur procedure te thjeshtuar, lejon që depozitimi e një deklarate per vendosjen nen regjim te sherbeje si kerkese per autorizim. Ne këtë rast, pranimi i deklarates perben edhe dhenien e autorizimit dhe ky pranim i nenshtrohet kushteve që rregullojne dhenien e autorizimit.

2. Deklarates se paraqitur sipas paragrafit 1 i bashkengjitet një dokument i plotësuar nga deklaruesi dhe që permban te dhenat e meposhtme, kur ato janë te nevojshme por nuk mund të shenohen ne kutine 44 te formularit te perdorur nga vete deklaruesi:

- a) emrin ose emrin e biznesit dhe adresen e kerkuesit, kur personi që kerkon te perdore regjimin nuk është i njëjtë me deklaruesin;
- b) pershkrimin tregtar dhe/ose teknik te produkteve kompensuese;
- c) natyren e operacioneve te perpunimit;
- d) afatin që gjykohet i nevojshem per riimportimin e produkteve kompensuese;
- e) koeficientin e shfrytezimit, ose nese është rasti, menyren e percaktimit te ketij koeficienti;
- f) mjetet e identifikimit.

3. Depozitimi i një deklarate duke perdorur

proceduren e thjeshtuar për kërkesat, nënshkruar nga kërkuuesi, tregon që personi i interesuar kërkon të përdorë regjimin e përpunimit pasiv dhe, pa rënë ndesh me zbatimin e mundshëm të dispozitave penale, është përgjegjës, sipas dispozitave në fuqi në Republikën e Shqipërisë për:

- a) saktësinë e informacionit të dhënë në deklarate;
 - b) vërtetësinë e dokumentave që e shoqërojnë ato; dhe
 - c) përmbushjen e të gjithë detyrimeve që lidhen me regjimin e përpunimit pasiv.
4. Autoritetet doganore mbajnë gjithë deklaratat dhe anekset perkatese, bashkë me ndonjë autorizim të lëshuar.
5. Kur lëshohet një autorizim, kërkesa, anekset perkatese dhe autorizimi mbahen nga autoritetet doganore për të paktën 3 vjet nga fundi i vitit kalendarik në të cilin skadon autorizimi.
6. Kur refuzohet autorizimi ose anulohet apo revokohet, kërkesa dhe vendimi për refuzimin e kërkesës ose autorizimi, sipas rastit, dhe gjithë anekset mbahen nga autoritetet doganore për të paktën 3 vjet nga fundi i vitit kalendarik në të cilin u refuzua kërkesa ose u anulua apo revokua autorizimi.

Neni 415

1. Kur operacionet e përpunimit lidhen me riparime të natyrës jo tregtare, nëse kundrejt një pagese apo falas, zyra doganore e caktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me kërkesën e deklaruesit, lejon deklaratat për vendosjen në qarkullim të lirë të perbeje edhe kërkesën për autorizim. Në keto raste, pranimi i deklaratës përben dhenie autorizimi dhe një pranim i tillë i nënshtrohet kushteve të parashikuara për dhenien e autorizimit.

2. Për qëllim të paragrafit 1 me *'riparime të natyrës jo tregtare'* kuptojmë riparimin e mallrave, duke përfshirë rivendosjen e tyre në gjendjen fillestare dhe rregullime të tyre, të cilat:

- a) kryhen mbi baza rastësore; dhe
- b) kanë të bëjnë ekskluzivisht me mallra të destinuara për përdorim personal të importuesit ose familjes së tij, dhe të cilat për vetë natyrën ose sasinë e tyre nuk kanë karakter tregtar.

3. I takon kërkuarit të provojë natyrën jo tregtare të mallrave. Zyra doganore nuk jep lehtësitë e pagesës të parashikuara në paragrafin 1, përveçse kur gjithë kushtet janë përmbushur.

Seksioni 3

Funksionimi i regjimit

Neni 416

Procedurat që rregullojnë vendosjen e mallrave nën regjimin e përpunimit pasiv zbatohen për mallrat e eksportit të perkohshëm, duke përfshirë mallrat e

eksportit të perkohshëm që përdoren sipas sistemit të shkëmbimit standard, me importim paraprak ose jo.

Neni 417

1. Përveç kur zbatohet procedura e thjeshtuar e autorizimeve, deklaratat për vendosjen e mallrave të eksportit për regjimin e përpunimit pasiv (deklarate eksporti) depozitohet në njërin nga zyrat e vendosjes nën regjimin e treguar në autorizim.

2. Kur zbatohet procedura e thjeshtuar për autorizimet, deklaratat për vendosjen nën regjim depozitohet në një zyrë të caktuar.

3. Cdo deklaratë eksporti duhet të përmbajë kodin EX2 në kutinë 1 të deklaratës dhe numrin dhe datën e autorizimit për për përpunim pasiv në kutinë 44. Formulari Regjistër i përpunimit pasiv për importin që është përshkruar në Aneksin 35 duhet të lëshohet për cdo deklaratë që vendos mallrat në regjim dhe është pjesë përbërëse e kopjes së deklaratës që mbahet nga autoritetet doganore. Të gjitha importet duhet të regjistrohen në këtë formular në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Deklarata e eksportit sëbashku me të gjithë dokumentet që i bashkëngjitet, pas cilit limit të dërgesës, duhet të mbahet në një dosje të veçantë për cdo shoqëri të autorizuar për të përdorur regjimin e përpunimit pasiv.

Neni 418

1. Deklarata për vendosjen e mallrave nën regjimin e përpunimit pasiv bëhet në përputhje me dispozitat e përcaktuara për eksportin.

2. Pa rënë ndesh me zbatimin e procedurës së thjeshtuar për kërkesat lidhur me riparime të natyrës jo tregtare, përshkrimi i mallrave në deklaratën për vendosje nën regjimin e përpunimit pasiv i korrespondon hollësirave të treguara në autorizim.

3. Deklarata për vendosjen e mallrave nën regjimin e përpunimit pasiv bëhet në përputhje me nenin 121 deri 161.

4. Pa rënë ndesh me procedurën e thjeshtuar për kërkesat, përshkrimi i mallrave që është dhënë në deklaratën për vendosjen e mallrave në regjimin e përpunimit pasiv i korrespondon specifikimeve në autorizim.

5. Për qëllim të nenit 87 (2) të Kodit, dokumentat që shoqërojnë deklaratën janë ato që parashikohet në nenin 145.

Neni 419

Pa rënë ndesh me nenin 409 (përcaktimi i afatit të parashikuar në nenin 169 (1) të Kodit.), përfitimi i përjashtimit nga detyrimet doganore në kuadër të regjimit të përpunimit pasiv bëhet vetëm kundrejt depozitimit të një deklarate për vendosjen në qarkullim të lirë.

Neni 420

1. Me perjashtim te rasteve kur zbatohen autorizime te thjeshtuara, deklarata per vendosje ne qarkullim te lire depozitohet ne njeren nga zyrat e mbylljes se regjimit, qe specifikohet ne autorizim.
2. Kur zbatohet procedura e autorizimeve te thjeshtuara lidhur me riparimin e mallrave (tregtar), deklarata per vendosjen ne qarkullim te lire depozitohet ne zyren doganore qe leshoi autorizimin.
3. Kur zbatohet procedura e autorizimeve te thjeshtuara lidhur me riparimin e mallrave (jo tregtare), deklarata per vendosjen ne qarkullim te lire depozitohet ne zyren doganore e autorizuar per kete qellim nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave.
4. Deklarata per vendosjen e mallrave ne qarkullim te lire e referuara ne paragrafin 1 dhe 3 behet ne perputhje me nenet nga 121 nga 161.
5. Pa rene ndesh me zbatimin e autorizimeve te thjeshtuara per riparime te natyres jo tregtare, pershkrimi i produkteve kompensuese ose produkteve zevendesuese, ne deklaraten per vendosje ne qarkullim te lire, duhet te perputhet me specifikimet e bera ne autorizim.
6. Per qellim te nenit 87(2) te Kodit, dokumentet qe shoqerojne deklaraten jane ato qe nevojiten per vendosjen e mallrave ne qarkullim te lire, siç eshte parashikuar ne nenet nga 142 deri 146 dhe:

- a) një kopje te deklarates per vendosje nen regjim; dhe
- b) kur deklarata per vendosjen e mallrave ne qarkullim te lire depozitohet pas kalimit te afatit te caktuar ne perputhje me nenin 169(1) te Kodit, dhe zbatohet neni 409(3), cdo dokument mbështetës qe ben te mundur te verifikohet nese produkteve kompensuese ose produkteve zevendesuese u ishte caktuar një destinacion doganor brenda te njëjtit afat.

Neni 421

1. Kur zbatohet nenparagrafi i dyte i nenit 171(2) i Kodit, shpenzimet e ngarkimit, transportit dhe sigurimit per mallrat e eksportit te perkohshem deri ne vendin kur u kryen operacionet e perpunimit ose operacionet e fundit nuk perfshihet ne:
 - a) vlerën e mallrave te eksportit qe merret parasysh kur percaktohet vlera doganore e produkteve kompensuese ne perputhje me nenin 37(1)(b)(i) te Kodit;
 - b) shpenzimet e perpunimit, kur vlere e mallrave te eksportit te perkohshem nuk mund te percaktohet duke zbatuar nenin 37(1)(b)(i) te Kodit te cilit i referohet paragrafi i pare.
2. Shpenzimet e perpunimit duhet te perfshijne shpenzimet e ngarkimit, transportit dhe sigurimit per produktet kompensuese nga vendi ku u kryen

operacionet e perpunimit ose operacionet e fundit te perpunimit deri ne vendin ku mallrat hyjne ne territorin doganor te Republikës së Shqipërisë.

3. Shpenzimet e riparimit te cilave u referohet neni 173 i Kodit konsistojne ne pagesen totale qe mbajtesi i autorizimit i ben personit qe kreu riparimet dhe perfshin gjithë shpenzimet e bera ose per t'u bere si kusht i riparimit te mallrave te eksportit te perkohshem nga mbajtesi i autorizimit personit qe kryen riparimet ose nga mbajtesi i autorizimit per te plotesuar një detyrim te personit qe kryen gjithë riparimet. Kjo pagese mund të mos bëhet domosdoshmerisht trajten e një transferte parash. Pagesa mund te behet edhe nepermjet letrave te kredise ose me cdo mënyrë tjetër të rënë dakort dhe mund te behet drejtperdrejt ose terthorazi.

Neni 422

1. Pjesa e mallrave te eksportit te perkohshem qe trupezohej ne produktet kompensuese perllogaritet ose duke perdorur metoden e matjes sasiore ose metoden mbi baze vlere, kur të gjithë produktet kompensuese, te ndryshme nga produktet kompensuese dytesore si mbetje, hekurishte, hedhurina, copeza dhe pjese te mbetura nga operacionet e caktuara të perpunimit, nuk clirohen per qarkullim te lire ne te njëjen kohe.
2. Perllogaritja duke perdorur keto metoda behet ne baze te shembujve te pasqyruar ne Aneksin 54 ose me ane te cdo menyre tjetere qe jep te njëjtin rezultat.

Neni 423

1. Kur, nga perpunimi pasiv i një ose me shume lloj mallrash te eksportit te perkohshem, rezulton një lloj i vetem produkti kompensues, per te percaktuar shumen qe duhet zbritur per vendosjen vendosjen ne qarkullim te lire te produkteve kompensuese, perdoret metoda e matjes sasiore (produktet kompensuese).
2. Per qellim te paragrafit 1, sasia e cdo lloji malli eksporti te perkohshem te ciles i korrespondon sasia e produkteve kompensuese te vendosura ne qarkullim te lire qe merret parasysh per te percaktuar shumen qe do te zbritet, perllogaritet duke zbatuar per sasine totale te cdo lloji te mallrave ne fjale, një koeficient i cili i korrespondon raportit të sasise se produkteve kompensuese te vendosura ne qarkullim te lire me sasi totale te produkteve kompensuese.

Neni 424

1. Kur si rrjedhim i operacioneve te perpunimit pasiv, prej një ose disa lloj mallrash te eksportit te perkohshem rrjedhin disa lloje produktesh kompensuese dhe të gjithë elementet e mallrave ne fjale gjenden ne secilin prej llojeve te ndryshme te produkteve kompensuese, per te percaktuar shumen qe duhet te zbritet ne vendosjen ne qarkullim te lire te produkteve kompensuese perdoret metoda e matjes sasiore (mallrat e eksportit te perkohshem).

2. Per te vendosur nese zbatohet metoda e permendur ne paragrafin 1, nuk merren parasysh humbjat/firot.

3. Ne percaktimin e pjeses se mallrave te eksportit te perkohshem, produktet kompensuese dytesore te cilat perbejne mbetje, hekurishte, hedhurina, copeza te mbetura nga prerja, trajtohen si mbetje/firo.

4. Kur zbatohet paragrafi 1, sasia e cdo malli te eksportit te perkohshem, te perdorur ne fabrikimin e cdo lloj produkti kompensues, do të percaktohet duke zbatuar në mënyrë të njëpasnjëshmei, ndaj sasisë totale te cdo lloj malli eksporti te perkohshem, një koeficient i cili i korrespondon raportit te sasise se mallrave ne fjale, që gjenden ne secilin lloj malli te eksportit, kundrejt sasise totale te mallrave ne fjale, që gjendet ne produktet kompensuese ne teresi.

5. Sasia e secilit lloj nga mallrat e eksportit te perkohshem që i korrespondon sasisë së secilit lloj produkti kompensues te vendosur per qarkullim te lire, që do të merret parasysh për percaktimin e shumës që zbritet, perlogaritët duke zbatuar koeficientin, që i korrespondon raportit të sasisë së produkteve kompensues te vendosura ne qarkullim te lire me sasine totale të produkteve kompensuese, ndaj sasisë së cdo lloj malli të eksportit të përkohshëm të përdorur në fabrikimin e secilit prej produkteve në fjalë, perlogaritët ne perputhje me paragrafin 4.

Neni 425

1. Kur nuk zbatohet metoda e matjes sasiore, perdoret metoda ne baze vlere. Megjithate, me pelqimin e mbajtesit te autorizimit dhe per qëllim thjeshtimi, autoritetet doganore mund te zbatojne metoden sasiore (mallra te eksportit te perkohshem) ne vend te metodes ne baze vlere kur cilado prej tyre jep te njëjtat rezultate.

2. Per te percaktuar sasine e secilit lloj malli te eksportit te perkohshem te perdorur ne prodhimin e secilit lloj produkti kompensues, ndaj sasisë totale të mallrave të eksportit të përkohshëm, do të zbatohen koeficientët e njëpasnjëshëm që dalin si raport i vlerës doganore të secilit produkt me vlerën doganore totale të atyre produkteve.

3. Kur nuk është riimportuar një lloj i caktuar produkti kompensues, vlera e ketij produkti per

qëllim te metodes me baze vlere, është cmimi i fundit i shitjes ne Republikën e Shqipërisë te mallrave identike ose te ngjashme, me kusht që një cmim i tille nuk është ndikuar nga marredhenia mes bleresit dhe shitesit. Nuk zbatohet neni 55 per te vleresuar marredhenien mes bleresit dhe shitesit. Nese vlera nuk mund te percaktohet nga zbatimi i dispozitave te mesiperme, percaktohet nga autoritetet doganore me cdo menyre tjetër te arsyeshme.

4. Sasia e cdo lloj malli te eksportit te perkohshem që i korrespondon sasisë së secilit lloj prej produkteve kompensues te vendosur ne qarkullim te lire, që merret parasysh per te percaktuar shumën që zbritet, perlogaritët duke zbatuar ndaj sasisë së secilit lloj malli te eksportit te perkohshem te perdorur ne prodhimin e produkteve kompensuese, një koeficient i cili i korrespondon raportit të sasise se produkteve kompensues te vendosur ne qarkullim te lire me sasinë totale te produkteve kompensuese, koeficient ky i perlogaritët ne perputhje me paragrafin 2.

Neni 426

1. Masat e politikës tregtare mbi eksportet do të zbatohen në kohën kur pranohet deklarata per vendosjen e mallrave nen regjim.

2. Kur produktet kompensuese te cilave u referohet neni 165(1) i Kodit vendosen ne qarkullim te lire, masat e e vecanta te politikës tregtare, që janë ne fuqi per keto produkte ne kohën kur pranohet deklarata per vendosjen e mallrave ne qarkullim te lire, zbatohen vetem kur keto produkte nuk kane origjine shqiptare, ne kuptimin e neneve 29 dhe 30 te Kodit.

3. Nuk zbatohen masat e politikës tregtare per importet kur perdoret sistemi i shkembimeve standarde, dhe as ne rastin e riparimeve ose operacioneve te tjera perpunuese që duhet te kryhen ne perputhje me nenin 144 te Kodit.

Neni 427

Drejtoria e Pergjithshme e Doganave mund te percaktoje rregulla te metejshme per zbatimin ne praktike te regjimit te perpunimit pasiv.

TITULLI IV

DISPOZITA MBI EKSPORTIN

KREU 1

Eksportimi

Neni 428

* Në përputhje me Pjesën IV, kreu 2, seksioni 4 të Kodit, ky kre përcakton dispozitat për zbatimin e regjimit të eksportit.

Neni 429

1. Eksportuesi, në kuptimin e nenit 181(4) të Kodit, quhet personi në emrin ose për llogari të të cilit behet deklarata e eksportit dhe i cili është pronar i mallrave ose ka të drejta të ngjashme për t'i tjetërsuar ato në castin kur pranohet deklarata.

2. Kur pronësia ose një e drejte e ngjashme tjetërsimi për mallrave i përket një personi te vendosur jashtë Republikës së Shqipërisë si

rrjedhojë e një kontratë në të cilën bazohet eksporti, eksportuesi konsiderohet të jete pala kontraktuese e vendosur në Republikën e Shqipërisë.

Neni 430

Kur për arsye administrative fjalia e parë e nenit 181(4) të Kodit nuk mund të zbatohet, deklarata mund të depozitohet në cilëndo zyrë doganore kompetente për operacionet në fjalë.

Neni 431

Kur ka arsye, të justifikuar në mënyrën e duhur dhe të pranuar nga autoritetet doganore, një deklaratë eksportit mund të pranohet në një zyrë doganore të ndryshme nga ajo të cilës i referohet fjalia e parë e nenit 181(4) të Kodit.

Neni 432

Arsye të justifikuar në mënyrën e duhur do të thotë p.sh. që zyra doganore përgjegjëse për mbikqyrjen e vendit ku është vendosur eksportuesi nuk ndodhet në drejtimin e lëvizjes së mallrave dhe ndodhet me larg se 30 km nga ambientet e eksportuesit. Eksportuesi në këto raste mund të depozitojë një deklaratë eksporti në zyrën e parë doganore që ndodhet në rrugën për kufi.

Neni 433

1. Deklarata e eksportit bëhet në bazë të Dokumentit Administrativ të Vetëm duke përdorur kopjet 1, 2 dhe 3 të formularit. Zyra doganore ku është depozituar deklarata e eksportit (zyra doganore e eksportit) duhet të vulosë kutinë A dhe të plotësojë kutinë D. Pas clirimit të mallrave, kjo zyrë mban kopjen 1, dërgon kopjen 2 pranë zyrës së statistikës dhe i kthen kopjen 3 personit të interesuar.

2. Përpara clirimit të mallrave, si rregull i përgjithshëm, identifikimi i mallrave sigurohet nëpërmjet vulosjes.

3. Duhet të vulosen:

- a) hapësira e mjetit të transportit ku mbahen mallrat, kur mjeti i transportit është miratuar nëpërmjet rregullash të tjera ose njohur nga zyra doganore e eksportit si mjet i përshatshëm për tu plumbosur;
- b) secila koli, në gjithë rastet e tjera.

4. Mjetet e transportit mund të konsiderohen të përshtatshme për vulosje me kusht që:

- a) vulat të vendosen lehtësisht dhe efektivisht mbi to;
- b) janë ndërtuar në mënyrë të tillë që asnjë mall nuk mund të hiqet ose vendoset pa lënë shenja të dukshme të dëmtimit ose pa thyer vetë vulën;
- c) nuk kanë vende të fshehura kur mund të fshihen mallrat; dhe

- d) hapësira e rezervuar për ngarkesën mund të kontrollohet lehtësisht nga autoritetet doganore.

5. Zyra doganore e eksportit mund të vendose të mos përdorë vulosjen nëse, duke patur mundësi të tjera identifikimi, përshkrimi i mallrave në deklaratën e eksportit i bën mallrat lehtësisht të identifikueshme.

Neni 434

1. Kopja 3 e Dokumentit Administrativ të Vetëm dhe mallrat e cliruara për eksport duhet të paraqiten në zyrën doganore të daljes.

2. "Zyrë doganore e daljes" do të thotë:

- a) në rastin e mallrave të eksportuara në rrugë hekurudhore, postare, ajrore ose detare, zyra doganore kompetente për vendin ku mallrat merren përsipër sipas një kontrate të vetme transporti për transortim në një vend tjetër përkatësisht nga shoqëritë hekurudhore, nga autoritetet postare, nga shoqëritë ajrore ose nga shoqëritë e spedicionit;
- b) në rastin e mallrave të eksportuara nëpërmjet tubacioneve dhe në rastin e energjisë elektrike, zyra e caktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- c) në rastin e mallrave të eksportuara nga mjete të tjera ose në rrethana të pambuluara nga paragrafi (a) dhe (b), zyra doganore e fundit përpara se mallrat të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

3. Zyra doganore e daljes duhet të bindet që mallrat që u paraqitën atyre përputhen me ato të deklaruar dhe mbikqyrin daljen e mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë. Tregues normal që mallrat e paraqitura përputhen me mallrat e deklaruar është fakti që plumbçat e vendosur nuk janë prekur dhe nuk ka asnjë shenjë dëmtimi. Zyra në fjalë, vërteton daljen në fakt të mallrave nëpërmjet konfirmimit në faqën e pasme të Kopjes nr. 3 dhe ia jep këtë kopje personit i cili e paraqiti. Konfirmimi bëhet me anë të një vule që tregon emrin e zyrës dhe datën. Kopja 3 e deklaratës së eksportit, konfirmuar në përputhje me këtë paragraf, me kërkesën e autoriteteve të tjera publike, mund të përdoret për të provuar që mallrat të cilave ajo iu përket janë eksportuar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, kur zbatohet paragrafi 8, rikthimi i kopjes nr.3 personit që e paraqiti nuk kryhet përpara se të mbyllet regjimi i tranzitit.

4. Kur zyra doganore e daljes vërteton se kanë humbur mallrat, pa rënë ndesh me fillimin e çështjes penale, kjo zyrë mban shënim në kopjen e deklaratës së paraqitur dhe njofton zyrën doganore të eksportit.

5. Kur zyra doganore e daljes vërteton se mallrat janë me teprice, pa rënë ndesh me fillimin e

çështjes penale, refuzon daljen e këtyre mallrave derisa të plotësohen formalitetet doganore.

6. Kur zyra doganore e daljes vërteton mospërputhje në natyrën e mallrave, pa rënë ndesh me fillimin e çështjes penale, refuzon daljen e mallrave derisa formalitetet e eksportit të jenë plotësuar dhe gjithashtu merr masa të informoje zyrën doganore të eksportit.

7. Në rastet të cilave u referohet paragrafi 2 (a), zyra doganore e eksportit konfirmon kopjen 3 të deklaratës në përputhje me paragrafin 3. Regjimi i tranzitit duhet të perdoret nese mallrat janë shkarkuar ose transborduar në një tjetër port, aeroport ose stacion hekurudhor shqiptar.

8. Kur mallrat e eksportit dërgohen në një zyrë doganore daljeje nën një regjim tranziti, zyra e nisjes vendos vulën "Eksport" me bojë të kuqe, në të gjithë kopjet e deklaratës së tranzitit. Zyra doganore e daljes kontrollon daljen në fakt të mallrave.

9. Zyra doganore e daljes mund t'i kërkojë eksportuesit të paraqesë prova që mallrat kanë dalë nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

Neni 435

1. Mallrat që nuk i nënshtrohen masave të ndalimit ose kufizimit dhe me vlerë më të madhe se 100 000 Lekë, për çdo dergese dhe për çdo deklarues, mund të deklarohen në zyrën doganore të daljes. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur personi që bën deklaratën e eksportit vepron si agjent profesionist doganor në emër të të tjerëve.

2. Deklaratat gojore mund të bëhen vetëm në zyrën doganore të daljes.

Neni 436

Pa rënë ndesh me regjimet e eksportit të përdorura për produktet e peshkimit dhe produkte të tjera deti, kur mallrat largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë pa depozituar një deklaratë eksporti si rrjedhim i gabimeve, mungesave ose rrethanave të tjera të vecanta e të pavullnetshme, kjo deklaratë mund të depozitohet *a posteriori* nga eksportuesi në zyrën doganore kompetente për vendin ku ai është i vendosur. Pranimi i kësaj deklarate kryhet pasi eksportuesi paraqet në zyrën doganore të interesuar prova të mjaftueshme lidhur me natyrën dhe sasinë e mallrave në fjalë dhe rrethanat në të cilat ato u larguan nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë. Kjo zyrë, duhet gjithashtu të konfirmojë kopjen 3 të Dokumentit Administrativ të Vetëm. Pranimi *a posteriori* i deklaratës nuk përjashton zbatimin e sanksioneve në fuqi.

Neni 437

Kur mallrat e ciluara për eksport nuk largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, eksportuesi menjëherë duhet të informojë zyrën doganore të eksportit. Kopja 3 e deklaratës në fjalë i kthehet kësaj zyre.

KREU 2

Eksporti i produkteve të peshkimit dhe produkteve të tjera të marra nga deti prej anijeve shqiptare të peshkimit pa u paraqitur në republikën e shqipërisë

Neni 438

Në rast se produktet e peshkimit dhe produkte të tjera të marra nga deti eksportohen në Republikën e Shqipërisë pa u paraqitur aty, përdoret procedura e mëposhtme:

- a) Me kthimin në Republikën e Shqipërisë, drejtuesi i mjetit lundruar duhet të depozitojë një deklaratë eksporti. Kjo deklaratë depozitohet në zyrën doganore kompetente për vendin ku ai është vendosur. Pranimi i kësaj deklarate bëhet pasi drejtuesi i mjetit i paraqet autoriteteve të zyrës doganore të interesuar prova të mjaftueshme lidhur me natyrën dhe sasinë e mallrave në fjalë;
- b) këto prova konsistojnë prej një kopjeje të autorizuar të deklaratës doganore të depozituar në vendin e destinacionit;
- c) zyra doganore kompetente konfirmon kopjen 3 të Dokumentit Administrativ të Vetëm në përputhje me nenin 433 (3).

KREU 3

Eksportimi i përkohshëm duke përdorur Carnet ATA

Neni 439

1. Një Carnet ATA mund të perdoret për eksport kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) Carneti ATA duhet të lëshohet në Republikën e Shqipërisë dhe konfirmuar dhe garantuar nga një shoqatë e vendosur në Republikën e Shqipërisë e cila bën pjesë në një zinxhir ndërkombëtar garancie;
- b) Carneti ATA zbatohet vetëm për mallra shqiptare lidhur me të cilat nuk është bërë kërkesë për rimbursim;
- c) duhet të paraqiten dokumentat e referuara në nenin 221. Autoritetet doganore mund të kërkojnë paraqitjen e dokumentit të transportit;
- d) synohet që mallrat të riimportohen.

2. Kur mallrat e mbuluara nga një Carnet ATA paraqiten me qëllim eksportimin e përkohshëm, zyra doganore e eksportit do të kryejë të gjitha formalitetet e mëposhtme:

- a) verifikon të dhënat e përshkruara në kutitë A deri në G të fletës të eksportit që ka lidhje me mallrat e mbuluara nga Carneti;
- b) plotëson, kur është rasti, kutinë në

kopertinën e *Carnetit* të titulluar "Vërtetuar nga autoritetet doganore";

- c) plotëson kundërfletën dhe kutinë H të fletës të eksportimit;
- d) shënon emrin e vet në kutinë H (b) të fletës së riimportimit;
- e) mban formularin e eksportimit.

3. Nëse zyra doganore e eksportit nuk është zyra e daljes, zyra doganore e eksportit kryen formalitetet e referuara në paragrafin 2, por nuk plotëson kutinë 7 të kundër fletës së eksportimit, e cila duhet të plotësohet nga zyra doganore e daljes.

4. Afati kohor për riimportimin e mallrave, i caktuar nga autoritetet doganore në kutinë H (b) të

fletës së eksportimit nuk duhet të kalojë vlefshmerinë e *Carnetit*.

Neni 440

Kur për mallrat që largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë sipas *Carnetit* ATA nuk synohet më riimportimi, në zyrën doganore të eksportit paraqitet një deklarate eksporti me gjithë hollësitat të cilave u referohet Aneksi 37. Me paraqitjen e *Carnetit* në fjalë, kjo zyrë konfirmon kopjen 3 të deklaratës së eksportit dhe zhvlerëson fletën e riimportimit dhe kundërfletën.

Neni 441

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të percaktojë udhëzime për zbatimin praktik të regjimit të eksportit.

TITULLI VII

DESTINACIONE TË TJERA DOGANORE

KREU 1

Zonat e lira dhe magazinat e lira

Seksioni 1

Dispozita të përgjithshme

Për qëllim të nenit 442 deri 472: "operator" do të thotë çdo person i cili kryen një aktivitet që përfshin ruajtjen, punimin, përpunimin, shitjen ose blerjen e mallrave në një zonë të lirë ose në një magazinë të lirë.¹²

Neni 442

Në përputhje me pjesën IV, kreu 3, seksioni 1 të Kodit, ky kre përcakton dispozitat për zbatimin në praktike të procedurës që ndiqet në zonat e lira dhe magazinat e lira.

Neni 443

Kur legjislacioni në fuqi përcakton që masat e politikës tregtare zbatohen:

- a) për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë, këto masa nuk zbatohen kur mallrat vendosen në një zonë të lirë ose magazinë të lirë për sa kohë që mallrat qëndrojnë në këto vende;
- b) për hyrjen e mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, këto masa zbatohen vetëm për mallrat jo shqiptare të vendosura në një zonë të lirë ose magazinë të lirë;
- c) për eksportin e mallrave, këto masa zbatohen kur mallrat shqiptare në një zonë të lirë ose magazinë të lirë eksportohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

Në këto raste, mallrat i nënshtrohen mbikqyrjes së autoriteteve doganore.

Neni 444

1. Rrethimi i zonës së lirë dhe ambienteve të magazinave të lira duhet të jetë i tillë që të lehtësojë mbikqyrjen nga autoritetet doganore nga jashtë zones së lirë ose magazinës së lirë dhe të parandalojë çdo mundësi të daljes së parregullt të mallrave prej zonës së lirë ose magazinës së lirë. Zona fqinje jashtë rrethimit duhet të jetë e tillë që të lejojë mbikqyrjen e duhur nga autoritetet doganore. Hyrja në këto zona bëhet me miratimin e autoriteteve doganore.

2. Zhvilluesi i një zone të lirë, me shpenzimet e tij duhet të ndërtojë dhe mirembajë gardhet ose masat e tjera mbrojtëse, sic përcakton Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

3. Autoritetet doganore mund të caktojnë vendin dhe kohën kur një lloj i jo i zakonshëm trafiku mund të hyjë dhe të dalë nga zona e lirë.

4. Drejtuesit e mjeteve të transportit, kundrejt kërkesës së autoriteteve doganore, ndalojnë dhe venë në dispozicion gjithçka që ka lidhje me mjetet e transportit, për kontroll doganor.

Neni 445

Pa rene ndesh me mbikqyrjen e permendura në nenin 185 (1) të Kodit, autoritetet doganore kryejnë gjithë kontrollet sipas nenit 185 (2) dhe (4) të Kodit, vetëm mbi bazë përzgjedhjeje, ose kur kanë dyshime serioze lidhur me respektimin e legjislacionit doganor.

Neni 446

Ne rastet e veprimtarive të cilave iu referohet neni 192(1) të Kodit, njoftimi i permendur në nenin 189(1) të Kodit behet në formën e paraqitjes së një kerkese për miratimin e regjistrave të magazinës.

¹² Shiko nenin 2(11). Ky tekst është rishikuar këtu për lehtësi përdorimi të termave të përkufizuar.

Neni 447

Operatori merr gjithë masat e nevojshme për të siguruar që personat e punësuar për të kryer aktivitetin e tij, veprojnë duke respektuar legjislacionin doganor.

Neni 448

1. Përpara nisjes së veprimtarisë në një zonë të lirë ose magazine të lirë, operatori duhet të marrë miratimin e regjistrave të magazines sipas nenit 192 të Kodit nga autoritetet doganore.

2. Miratimi i regjistrave të magazines jepet vetëm për persona që paraqesin gjithë garancitë e nevojshme për zbatimin e dispozitave që rregullojnë funksionimin e zonave të lira ose magazinave të lira.

Neni 449

1. Kërkesa për miratimin e regjistrave të magazines, që tani e mëbrapa do të quhet shkurt 'kërkesa', depozitohet me shkrim në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

2. Kërkesa duhet të specifikojë cila prej veprimtarive të përmendura në nenin 192(1) të Kodit parashikohet të kryhet. Ajo duhet të përmbajë edhe një përshkrim të hollësishëm të regjistrave të magazinimit që mbahen ose që do të mbahen, natyrën dhe statusin doganor të mallrave me të cilat lidhen këto veprimtari, regjimin doganor nën të cilin këto aktivitete do të kryhen, kur është rast, dhe gjithë të dhënat e tjera që i nevojiten autoriteteve doganore për të siguruar zbatimin e duhur të dispozitave që rregullojnë zonat e lira dhe magazinat e lira.

3. Kërkesa dhe dokumentat përkatëse mbahen nga autoritetet doganore për të paktën 3 vjet nga fundi i vitit kalendarik në të cilin operatori mbyll veprimtarinë në zonën e lirë ose magazinën e lirë.

Neni 450

Miratimi i regjistrave të magazines leshohet me shkrim, i vendoset date dhe nënshkruhet. Kerkuesi njoftohet mbi miratimin. Autoritetet doganore mbajnë një kopje për të paktën 3 vjet nga fundi i vitit kalendarik në të cilin operatori mbyll veprimtarinë në zonën e lirë ose magazinën e lirë.

Neni 451

1. Autoritetet doganore ndryshojnë ose revokojnë miratimin e regjistrave të magazines, kur ato vendosin t'i ndalojnë personit i cili ka marrë miratim, kryerjen e aktivitetit në një zonë të lirë ose magazine të lirë sipas nenit 189 (2) ose (3) të Kodit.

2. Miratimi revokohet nga autoritetet doganore kur këto të fundit konstatojnë zhdukje të vazhdueshme të mallrave, që nuk mund të shpjegohen bindshëm.

3. Menjëherë pas revokimit të miratimit, nuk mund të kryhet më asnjë veprimtari nga ato për të cilat për të cilat mbahen regjistrat e magazines.

Seksioni 2

Hyrja e mallrave në një zonë të lirë ose magazine të lirë

Neni 452

Pa rene ndesh me nenet 185(4) dhe 187(2) të Kodit, kur mallrat mberrijnë në një zonë të lirë ose magazine të lirë, nuk është nevoja që ato të paraqiten në një zyrë doganore dhe as të depozitohet ndonjë deklaratë doganore. Mberritja e mallrave në vendet e caktuara për kryerjen e veprimtarisë, shenohet menjëherë në regjistrat e magazines.

Neni 453

Dokumenti i transportit i përmendur në nenin 185(4) të Kodit, do të jetë një nga dokumentet që lidhet me transportin, me kusht që këto dokumente të kenë gjithë të dhënat e nevojshme për identifikimin e mallrave.

Neni 454

1. Kur mallrat e vendosura nën një regjim doganor, duhet të paraqiten tek autoritetet doganore përgjegjëse për mbikqyrjen e një zone të lirë ose magazine të lirë në bazë të nenit 187(2)(a) të Kodit, bashkë me mallrat duhet të paraqiten edhe dokumentat përkatëse.

2. Kur mbyllet regjimi i përpunimit aktiv ose i lejimit të perkohshëm, nepermjet vendosjes së produkteve kompensuese ose mallrave të importit nën regjimin e tranzitit, duke u ndjekur nga hyrja në një zonë të lirë ose magazine të lirë, për t'u eksportuar me tej jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, autoritetet doganore duhet të kryejnë kontrolle në mënyrë perzgjedhese për t'u siguruar që i gjithë informacioni përkatës është shënuar në regjistrat e magazines. Ato duhet të binden gjithashtu që, kur mallrat janë transferuar nga një operator tek një tjetër brenda një zone të lirë, një transferim i tillë është shënuar në regjistrat e magazines të operatorit që merr këto mallra.

Neni 455

Kur një vendim për të rimbursuar ose shuar detyrimet e importit, autorizon vendosjen e mallrave në një zonë të lirë ose magazine të lirë, autoritetet doganore përgjegjëse për mbikqyrjen e zonës së lirë duhet të vërtetojë që mallrat janë vendosur në një zonë të lirë apo magazinë të lirë.

Neni 456

Hyrja në një zonë të lirë ose magazine të lirë e mallrave, për të cilat zbatohen detyrime eksporti ose dispozita të tjera mbi eksportin, dhe për të cilat kerkohet nga autoritetet doganore të sillen nën kontrollin doganor sipas nenit 187(3) të Kodit, kryhet pa pasur nevojë të paraqitet ndonjë dokument lidhur me hyrjen dhe pa ju nënshtruar kontrolleve të përgjithshme e sistematike, që zakonisht ushtrohen për mallrat që hyjnë.

Neni 457

1. Kur autoritetet doganore vertetojnë statusin shqiptar ose jo shqiptar të mallrave, në përputhje me nenin 187(4) të Kodit, ato përdorin një formular që përputhet me modelin dhe dispozitat e Aneksit 55.

2. Kur hyrja e mallrave shqiptare në një zonë të lirë ose magazinë të lirë duhet të vertetohet, autoritetet doganore që mbikëqyrin zonën e lirë, me kërkesën e vetë personit të interesuar, mund ta konfirmojnë një gjë të tillë mbi faturën e mallrave.

Seksioni 3

Funksionimi i zonave të lira dhe magazinave të lira

Neni 458

1. Operatori që mban regjistrat e miratuar të magazinimit, shënon aty gjithë të dhënat që nevojiten për të kontrolluar respektimin e legjislacionit doganor.

2. Në qoftë se operatori zbulon se mallrat janë zhdukur për shkakë jo natyralë, ai njofton autoritetet doganore.

3. Regjistrat e magazinimit duhet të përmbajne:

- a) të dhëna mbi shenjat identifikuese, numrat e identifikimit, numrin dhe llojin e kolive, sasine dhe përshkrimin e mallrave dhe, kur është rasti dhe shenjat identifikuese të kontenerit;
- b) të dhëna që mundesojnë vëzhgimin nga afër të mallrave, sidomos vendndodhjen e tyre;
- c) referencat e dokumentit të transportit të përdorur për hyrjen dhe daljen e mallrave;
- d) tregohet statusi doganor i mallrave;
- e) të dhëna mbi format e zakonshme të trajtimit;
- f) kur sjellja e mallrave në një zonë të lirë dhe magazinë të lirë mbyll një regjim të lejimit të perkohshëm, ose një regjim tranziti, i cili nga ana e vet mbyll njërin prej këtyre regjimeve, një nga shenimet e duhura dhënë me poshtë:
 - i) "Perpunim aktiv/Mallra të pezulluara", "Perpunim Aktiv/Mallra që do të rimbursohen", me bojë të kuqe, ose
 - ii) "Mallra të lejimit të perkohshëm" me bojë të kuqe,
- g) të dhëna për mallrat të cilat, në rast vendosjeje në qarkullim të lirë ose në lejim të perkohshëm, nuk i nënshtrohen detyrimeve të importit ose masave të politikës tregtare, dhe për të cilat duhet të kontrollohet përdorimi ose destinacioni.

4. Kur në kuadrin e një regjimi doganor duhet të mbahet kontabiliteti, të dhënat që figurojnë atje nuk

shënohen në regjistrat e magazinës.

Neni 459

Format e zakonshme të manipulimit të referuara në nenin 190(1) (b) janë ato që përcaktohen në Aneksin 36.

Seksioni 4

Dalja e mallrave nga një zonë e lirë ose magazinë e lirë

Neni 460

Të dhënat e vecanta të daljes së mallrave nga vendet e përdorura për veprimtarinë, shënohen menjëherë në regjistrat e magazinës.

Neni 461

Në rastet e rieksporimit të mallrave jo shqiptare, për mallrat të cilat nuk janë shkarkuar ose transborduar në kuptimin e nenit 192(2) të Kodit, nuk është i nevojshëm njoftimi të cilit i referohet neni 197(3) i Kodit.

Neni 462

Një magazinë furnizmi dhe një duty free shop mund të krijohet, brenda një zone të lirë ose magazinë të lirë, si magazinë doganore e tipit C.

Seksioni 5

Procedura të zbatueshme kur përdoret regjimi i perpunimit aktiv (sistemi me pezullim) ose regjimi i perpunimit nën kontrollin doganor, në një zonë të lirë ose magazinë të lirë.

Neni 463

Operacionet e perpunimit të kryera në një zonë të lirë ose magazinë të lirë, nën regjimin e perpunimit aktiv (sistemi me pezullim) ose nën regjimi e perpunimit nën kontrollin doganor, kryhen vetëm pasi të jepet autorizim për regjimin në fjalë. Në autorizim tregohet zona e lirë ose magazinë e lirë ku do të kryhen veprimet në fjalë.

Neni 464

Autoritetet doganore refuzojnë dhenien e autorizimit për përdorimin e regjimeve të cilave u referohet ky Seksion, në rast se nuk disponohen garancitë e nevojshme për kryerjen e rregullt të operacioneve. Autoritetet doganore mund të refuzojnë dhenien e autorizimit personave që nuk kryejnë operacione të shpeshta të perpunimit aktiv ose perpunimit nën kontrollin doganor.

Neni 465

1. Mbajtësi i autorizimit mban regjistrat e perpunimit aktiv ose regjistrat e perpunimit nën kontrollin doganor, të cilat përmbajnë edhe referencat të autorizit.

2. Për qëllim të përpilimit të dokumentit të mbylljes së regjimit, referenca në deklaratat dhe në dokumentat e mbylljes së regjimit, zëvendëson referencën në shenimet e regjistrave të përmendura në paragrafin 1.

Neni 466

Kur mallrat janë vendosur nën regjimin e perpunimit aktiv ose regjimin e perpunimit nën kontrollin doganor, në kohën kur ato sillen në një zonë të lirë ose magazinë të lirë, procedurat e zakonshme që zbatohen janë ato të përmendura në nenin 121 deri 161.

Neni 467

1. Kur mallrat që ndodhen në zonën të lirë ose magazinën të lirë vendosen nën regjimin e perpunimit aktiv ose nën regjimin për perpunimin nën kontroll doganor, zbatohet procedura e zakonshme e përmendur në nenin 121 deri 161.

2. Në regjistrat e magazinimit të zonës së lirë ose magazinës së lirë duhet të shënohen referencat regjistrimeve të bëra në regjistrat e perpunimit aktiv ose regjistrat e perpunimit nën kontrollin doganor.

Neni 468

1. Regjimi i perpunimit aktiv ose regjimi i perpunimit nën kontrollin doganor, për produkte kompensuese, produkte të perpunuara ose mallra në gjendje të pandryshuar, që ndodhen në një zonë të lirë ose magazinë të lirë, mbyllet nepermjet depozitimit të një deklarate në përputhje me procedurën normale të përcaktuar në nenin 121 deri 161 dhe duke shënuar më pas të dhenat e duhura në librin e magazinës së zonës së lirë ose magazinës së lirë. Referencat e regjistrimeve në fjalë vendosen në "regjistrat e perpunimit aktiv" ose "regjistrat e perpunimit nën kontroll doganor", sipas rastit.

2. Shenimet "Perpunim Aktiv/Mallra të pezulluara" me bojë të kuqe, shënohen në regjistrat e magazinës të zonës së lirë ose magazinës së lirë.

Neni 469

1. Kur regjimi i perpunimit aktiv, lidhur me produktet kompensuese apo mallra në gjendje të pandryshuar, ose regjimi i perpunimit nën kontrollin doganor për produkte të perpunuara ose mallra në gjendje të pandryshuar, mbyllet në kohën e daljes nga zona e lirë ose magazinë e lirë, nepermjet eksportit të këtyre mallrave ose produkteve, zbatohet procedura normale e përkrahur për këtë qëllim.

2. Kur regjimi i perpunimit aktiv, lidhur me produktet kompensuese ose mallrat në gjendje të pandryshuar, ose regjimi i perpunimit nën kontrollin doganor lidhur me produktet e perpunuara ose mallrat në gjendje të pandryshuar, mbyllet në kohën e daljes së këtyre mallrave ose produkteve nga zona e lirë ose magazinë e lirë, duke u vendosur në qarkullim të lirë, zbatohet procedura normale e parashikuar për këtë qëllim.

3. Kur regjimi i perpunimit aktiv ose regjimi i perpunimit nën kontrollin doganor mbyllet në kohën kur produktet kompensuese, produktet e perpunuara ose mallrat në gjendje të pandryshuar dalin nga zona e lirë ose magazinë e lirë për t'u

vendosur nën një regjim të ndryshëm nga vendosja në qarkullim të lirë ose eksport, zbatohet procedura normale e parashikuar për atë qëllim.

Neni 470

Statusi shqiptar i produkteve kompensuese ose produktet e perpunuara në gjendje të pandryshuar, të vendosura në qarkullim të lirë brenda ose pas daljes nga zona e lirë ose magazinë e lirë, vërtetohet nga dokumenti i referuar në Aneksin 55, që leshohet nga autoritetet doganore.

Neni 471

Regjistrimet në regjistrat e perpunimit aktiv ose regjistrat e perpunimit nën kontrollin doganor duhet të mundësojnë autoritetet doganore të verifikojnë në çdo kohë gjendjen e saktë të të gjithë mallrave ose produkteve të vendosura nën njërin nga regjimet në fjalë ose në një zonë të lirë ose magazinë të lirë.

Neni 472

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të nxjerrë udhëzime për zbatimin praktik të procedurave që ndiqen në zonat e lirë ose magazinat e lirë.

KREU 2

Rieksportimi, shkatërrimi dhe braktisja

Neni 473

Në përputhje me Pjesën IV, Kreu 3, Seksioni 2 të Kodit, ky Kre përcakton dispozitat për zbatimin e procedurave të rieksportimit, shkatërrimit, dhe braktisjes.

Neni 474

Kur rieksportimi bëhet me anë të një deklarate doganore, zbatohen dispozitat lidhur me eksportin, pa rënë ndesh me dispozita që zbatohen në rastet kur mbyllet një regjim doganor ekonomik paraardhës.

Neni 475

1. Për qëllim të nenit 197(3) të Kodit, njoftimi për shkatërrimin e mallrave njoftohet me shkrim, dhe nënshkruhet nga personi i interesuar. Në keto raste perdoret Dokumenti Administrativ i Vetëm. Lajmerimi bëhet në kohë të mjaftueshme për të lejuar autoritetet doganore të mbikqyrin shkatërrimin.

2. Kur mallrat janë objekt i një deklarate të pranuar nga autoritetet doganore, keto autoritete duhet të shenojnë shkatërrimin e mallrave në deklarate, duke e bërë deklaratën të pavlefshme, sipas nenit 91 të Kodit. Autoritetet doganore të pranishme në shkatërrimin e mallrave duhet të specifikojnë në deklarate llojin dhe sasinë e mbeturinave dhe hedhurinave që rezultojnë nga shkatërrimi, në mënyrë që të përcaktohen elementet e zbatueshëm të taksimit që merren parasysh në momentin kur këtyre mbetjeve dhe hedhurinave u caktohet një destinacion i ri

doganor.

Neni 476

3. Per mallrat e braktisura ne favor te buxhetit te shtetit zbatohen *mutatis mutandis*. paragrafi 1 dhe 2.

Drejtoria e Pergjithshme e Doganave mund te percaktoje udhezime zbatimin praktik te regjimeve te rieksporimit, shkaterrimit, dhe braktisjes.

PJESA III

PERJASHTIME NGA DETYRIMET DOGANORE

KREU I

Dispozita të përgjithshme

Për qëllim të nenit 477 deri 560¹³:

- a) "Sende personale" do të thotë: sendet që nevojiten për përdorim personal të të interesuarit ose për nevoja familjare të këtij të fundit. Përbëjnë, në veçanti, sende personale, sendet e poshtme:
 - i) sendet shtëpiake,
 - ii) biçikleta dhe motoçikleta, automjetet private dhe rimorkiot e tyre, ruletat e kampingut, mjetet ajrore për dëfrim dhe avionet private,
 - iii) furnizimet shtëpiake në masën dhe për llojin që i përshtaten përdorimit shtëpiak, manarët shtëpiake dhe kuajt e shalës. Gjithashtu përbëjnë pronë vetiake edhe instrumenta të tjerë portativë të arteve të aplikuara dhe të profesioneve të lira, që nevojiten për ushtrimin e profesionit nga i interesuari. Sendet vetiake duhet të importohen në sasi dhe të jenë të një natyre të tillë që të duket qartë se nuk po importohen për qëllime tregtare;
- b) "Sende shtëpiake" do të thotë: sendet vetiake, shtresa dhe mbulesa për përdorim shtëpiak, mobilje, dhe pajisje të tjera për përdorim personal të të interesuarit ose për të plotësuar nevojat e tij shtëpiake;
- c) "Produkte alkoolike" do të thotë: produktet (si p.sh. birrë, verë, aperitive me përmbajtje vere ose likeri, konjak, likerna, ose pije të tjera alkoolike, etj), që përfshihen në kërret nga 2203 deri 2208 të Nomenklaturës së Kombinuar.

Neni 477

Ne baze te nenit 199 te Kodit, ky Kre percakton dispozitat perkatese per rastet ne te cilat per shkak rrethanash te vecanta, jepet perjashtim nga detyrimet e importit ose eksportit ne castin e vendosjes se mallrave ne qarkullim te lire ne territorin doganor te Republikës së Shqipërisë.

¹³ Shiko nenin 2(12). Ky tekst është rishikuar këtu për lehtësi përdorimi të termave të përkufizuar.

Perjashtimi nga detyrimet e importit zbatohet si per mallrat e deklaruar per qarkullim te lire që vijne drejtperdrejt nga vend te tjera, ashtu edhe per mallrat e deklaruar per qarkullim te lire pasi kane qëne nen një regjim tjetër doganor.

Neni 479

Kur jepet perjashtim nga detyrimet e importit, i cili kushtezohen nga vendosja e mallrave ne një perdorim te vecante nga marresi, një perjashtim i tille mund te jepet vetem nga autoritetet kompetente doganore te Republikës së Shqipërisë.

Neni 480

Autoritetet kompetente doganore te Republikës së Shqipërisë marrin gjithë masat e nevojshme per te siguruar që mallrat e vendosura ne qarkullim te lire, kur perjashtimi nga detyrimet e importit është dhënë me kusht te vendosjen e mallrave ne një perdorim te vecante nga marresi, të mos perdoren per qëllime te tjera pa kryer me pare pagesen e detyrimeve perkatese te importit, pervecse kur një perdorim i ndryshëm perputhet me kushtet e percaktuara ne këtë dispozite.

Neni 481

Kur i njëjti person ne te njëjten kohe ploteson kushtet e percaktuara per dhenien e perjashtimit nga detyrimet e importit, ne baze te me shume se një dispozite te ketij akti, keto te fundit zbatohen njëkohesisht.

Neni 482

Ne rastet kur kjo dispozite parashikon që perjashtimit perfitohet kundrejt plotesimit te kushteve te caktuara, i interesuari duhet te paraqese prova te mjaftueshme autoriteteve doganore mbi plotesimin e ketyre kushteve.

Neni 483

Ne rastet kur lejohet importimi me perjashtim nga detyrimet brenda kufirit te një shume te percaktuar ne Leke, shuma e arritur rrumbullakoset me shumen menjëhere me te larte.

Neni 484

1. Dispozitat e ketij akti nuk paragjykojne dhenien nga ana e Republikës së Shqipërisë te:

- a) perjashtimeve ne baze te Konventes se Vjenes

"Per marrëdhëniet diplomatike" e dates 18 prill 1961, Konventes se Vjenes "Per marrëdhëniet konsullore" e dates 24 prill 1963 ose te Konventave te tjera konsullore, ose te Konventes se New York "Per misionet speciale" e dates 16 dhjetor 1969;

- b) perjashtimeve që bejne pjese ne privilegjet e zakonshme te dhena ne baze te marreveshjeve nderkombetare, duke perfshire perjashtimin e dhene me rastin e konferencave nderkombetare;
- c) perjashtimeve që bejne pjese ne privilegjet e zakonshme te dhena prej te drejtes nderkombetare dhe imunitetet e njohura ne kuadrin e marreveshjeve nderkombetare te nenshkruara per krijimin e një institucioni ose organizmi te te drejtes nderkombetare me karakter kulturor dhe shkencor;
- d) perjashtimeve ne baze te privilegjeve dhe imuniteteve te dhena ne kuadrin e marreveshjeve te bashkepunimit kulturor dhe shkencor apo teknik te nenshkruara vende te tjere;
- e) perjashtimeve te vecanta te dhena ne kuadrin e marreveshjeve te nenshkruara me vende te trete që parashikojne masa te perbashketa per mbrojtjen e personave dhe ambientit;
- f) perjashtimeve te vecanta te dhena ne kuadrin e marreveshjeve që nenshkruhen me vendet fqinje, per shkak te natyres se trafikut dhe tregtise kufitare me vendet ne fjale;
- g) perjashtimeve ne kuadrin e marreveshjeve ne te cilat është aderuar per shkak te parimit te reciprocitetit me vendet e tjera anetare ne konventen mbi aviacionin civil (Chicago 1944), për qëllim te zbatimit te praktikës se rekomanduar ne Aneksin 9, pikat 4.42 dhe 4.44, te Konventes.

KREU 2

Rrethana te vecanta per te cilat jepet perjashtim nga detyrimet doganore

Seksioni 1

Sende vetiake që i perkasin personave fizike që transferohen nga një vend tjetër qëndrimi ne Republikën e Shqipërisë

Neni 485

Pa rene ndesh me nenin nga 486 deri 492, prona personale e importuar nga persona fizike që transferojne vendbanimin e tyre tij nga një vend tjetër për ne territorin doganor te Republikës së Shqipërisë, importohen duke u perjashtuar nga detyrimet e importit. Në këto raste do të përdoret Formulari i sigurimit të përjashtimit nga detyrimet e importit për pronën personale të emigrantëve i përcaktuar si në Aneksin 56.

Neni 486

Perjashtimi kufizohet vetem per sendet vetiake te cilat:

- a) perjashtuar rastet e vecanta te justifikuara nga rrethanat, kane qene ne posedim te te interesuarit, dhe kur është fjala per mallra te pakonsumueshme, jane perdorur prej tij ne vendin e meparshem te qëndrimit per te pakten 6 muaj perpara dates ne te cilen i interesuari pushon së qëni banor i vendit prej nga është nisur;
- b) synohet te perdoren per te njëjtat qëllime ne vendin e ri te qëndrimit;
- c) automjete, ruleta, mjete lundruese dhe mjete ajrore, te cilat permbushin kushtet e meposhtme:
 - i) i interesuari ka qene pronari i regjistruar per automjetin, ruleten, mjetin lundrues ose mjetin ajror, ne vendet ku zbatohet një regjistrim mjetes, per te pakten 12 muaj perpara transferimit te tij ne Republikën e Shqipërisë,
 - ii) ka qene prone e te interesuarit per te pakten 12 muaj perpara se te sillej ne territorin doganor te Republikës së Shqipërisë,
 - iii) ka qene përdorur nga i interesuari në një vend tjetër normalisht për të pakten 12 muaj përpara se të sillej në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë,
 - iv) pasi të importohet duke u përjashtuar nga detyrimet e importit, nuk mund të tjetërsohet deri në dy vjet pas kryerjes se formaliteve doganore, përvese kur paguan detyrimet e importit dhe gjithë taksat e tjera prej të cilave ishte përjashtuar.
 - v) përjashtimi nga detyrimet e importit i nënshtrohet depozitimit të një garancie. Forma dhe shuma e garancisë përcaktohen nga autoritetet doganore kompetente. Garancia shkarkohet pas kalimit të dy vjetëve nga momenti i depozitimit të saj në zyrën ku është bërë clirimi i mallrave mbi bazën e paraqitjes së provave bindëse që personi i interesuar është dhe ka qene gjatë gjithë kësaj periudhe kohe pronari i regjistruar i automjetit, ruletës, mjetit të lundrimit, ose mjetit të fluturimit për të cilin është dhënë përjashtimi.

Neni 487

Përfitojnë përjashtim vetëm personat të cilët kanë patur vendbanim të zakonshëm, për të paktën 12 muaj në mënyrë të vazhdueshme, jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, autoritetet doganore kompetente mund të lejojnë anashkalim nga rregulli i përcaktuar në fjalinë e

parë me kusht që synimi i të interesuarit të ketë qënë qartësisht qëndrimi jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë për një periudhë prej të paktën 12 muaj, por që e transferojnë në vendin e zakonshëm të qëndrimit nga një vend tjetër në Republikën e Shqipërisë për shkak rrethanash politike të jashtëzakonshme.

Neni 488

Nuk jepet përjashtim për:

- a) produktet alkoolike;
- b) duhanin dhe produktet e duhanit;
- c) mjetet tregtare të transportit; dhe
- d) artikuj për përdorim në ushtrimin e një tregtie ose profesioni, të ndryshëm nga instrumentat e mbartshëm të arteve të aplikuara ose të lira.

Neni 489

Përvec rasteve të vecanta, përjashtimi jepet vetëm për pasuri personale të vendosura në qarkullim të lirë, brenda 12 muajsh nga data në të cilën i interesuari është vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Pasuria personale mund të vendoset në qarkullim të lirë, pjesë pjesë, brenda afatit të përmendur në fjalinë e mësipërme.

Neni 490

1. Per një periudhë prej 12 muajsh nga data në të cilën është pranuar deklarata për vendosjen në qarkullim të lirë, pasuria personale që është lejuar me përjashtim nga detyrimet e importit, nuk mund të jepet hua, vendoset si garanci, jepet me qira ose transferohet, si kundrejt pageses, ashtu edhe falas, pa njoftuar paraprakisht autoritetet kompetente doganore për këtë qëllim.

2. Huadhenia, lenia si garanci, qiradhënia apo tjetërsimi përpara përfundimit të afatit të përmendur në paragrafin 1, sjell si pasoje zbatimin e detyrimeve të importit përkatëse për pasurinë në fjalë, sipas nivelit të detyrimeve të importit në fuqi në datën në të cilën kryhet huadhenia, dhenia si garanci, qiradhënia apo tjetërsimi, dhe në bazë të llojit të mallrave si dhe të vlerës doganore të verifikuar apo të pranuar në po atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Neni 491

1. Pavarësisht nga sa parashikohet në nenin 14, mund të jepet përjashtim për pasurinë personale të vendosur në qarkullim të lirë, përpara se i interesuari të caktojë vendin e tij të zakonshëm të banimit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që ai merr përsipër të caktojë vendbanimin e zakonshëm në këtë vend, brenda një afati 6 mujor. Marrja përsiper e këtij detyrimi shoqërohet nga dhënia e një garancie, forma dhe shuma e të cilës përcaktohet nga autoritetet doganore kompetente.

2. Kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1,

periudha e përcaktuar në nenin 486 (a) përlogaritet nga data në të cilën pasuria personale është sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 492

Autoritetet kompetente doganore mund të anashkalojnë nenin 486 (a) dhe (b), 488 (c) dhe (d) dhe 490, kur një person duhet të transferojë vendbanimin e tij të zakonshëm nga një vend tjetër në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, si rezultat i rrethanave politike të jashtëzakonshme.

Seksioni 2

Mallra të importuara në rast martesë

Neni 493

1. Pa rënë ndesh me nenin 494 deri 497, veshjet martesore dhe sendet shtëpiake, qofshin të reja ose jo, që i përkasin një personi që transferon vendbanimin e tij të zakonshëm nga një vend tjetër, në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë me rastin e martesës së tij/saj, importohen duke u përjashtuar nga detyrimet importit.

2. Pa rënë ndesh me të njëjtat kushte, lejohen gjithashtu duke përfituar përjashtim nga detyrimet e importit, paja dhe dhuratat që jepen zakonisht në rast martesë, të cilat i adresohen një personi që përmbush kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 nga persona të cilët kanë vendbanim të zakonshëm në një vend tjetër. Vlera e çdo dhurate të lejuar pa pagesë, megjithatë, nuk duhet të jetë më e madhe sesa 50 000 Lekë.

Neni 494

Përjashtimi i referuar në nenin 493 mund të jepet vetëm për persona:

- a) vendbanimi i zakonshëm i të cilëve ka qënë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë për të paktën 12 muaj të vazhdueshme. Megjithatë, lejohen përjashtime nga ky rregull mund të jepen, me kusht që i interesuari të provojë qartë se synonte të qëndronte jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë për një periudhë kohe prej të paktën 12 muajdh dhe transferon vendbanimin e tij të zakonshëm nga një vend tjetër në Republikën e Shqipërisë si rezultat i rrethanave politike të jashtëzakonshme;

- b) që paraqesin prova të martesës së tyre.

Neni 495

Asnjë përjashtim nuk duhet të jepet për produktet alkoolike, për duhanin dhe produktet e duhanit.

Neni 496

1. Me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, përjashtimi jepet vetëm për mallrat e vendosura në qarkullim të lirë:

- a) jo më herët se 2 muaj përpara datës së caktuar për martesë (në këtë rast përjashtim

jepet vetëm kundrejt depozitimit të garancisë përkatëse, forma dhe shuma e të cilës caktohet nga autoritetet kompetente doganore); dhe

b) jo me vonë se 4 muaj pas datës së martesës.

2. Mallrat e përmendura në nenin 493, mund të vendosen në qarkullim të lirë në disa dërgesa të vecanta, brenda afatit të përmendur në paragrafin 1.

Neni 497

1. Për një periudhë prej 12 muajsh, nga data e pranimit të deklaratës për vendosjen në qarkullim të lirë, mallrat e lejuara duke përfutur përjashtim detyrimet e importit sipas nenit 493, nuk lejohet të jepen hua, të vendosen si garanci, të jepen me qira ose të tjetërsohen, si kjo kundrejt pagesës ashtu edhe falas, pa njoftuar paraprakisht autoritetet doganore kompetente.

2. Huadhënia, dhënia si garanci, qiradhënia ose tjetërsimi përpara përfundimit të periudhës 12 mujore bëhet vetëm kundrejt pageses së detyrimeve përkatëse të importit për mallrat në fjale, duke zbatuar nivelin e detyrimeve të importit në fuqi në datën në të cilën kryhet huadhënia, lënia si garanci, qiradhënia ose tjetërsimi, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të tyre, të verifikuar apo të pranuar në po atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Seksioni 3

Pasuri personale të fituara nëpërmjet trashëgimisë

Neni 498

1. Pa rënë ndesh me nenet nga 499 deri 501, pasuria personale e fituar nëpërmjet trashëgimisë, nga një person fizik më vendbanim të zakonshëm në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, lejohet të importohet me përjashtim nga detyrimet e importit.

2. Për qëllim të paragrafit 1, "pasuri personale" do të thotë gjithë pasuria e përmendur në nenin 2 (12)(a), që përbëjnë pasurinë e trashëgimlënësit.

Neni 499

Nuk jepet përjashtim për:

- a) produktet alkoolike;
- b) duhanin dhe produktet e duhanit;
- c) mjetet e transportit tregtar;
- d) artikuj të përdorur gjatë ushtrimit të një tregtie apo profesioni, të ndryshme nga instrumentat e arteve të aplikuara ose të lira, të cilat i nevojiteshin trashëgimlënësit për ushtrimin e tregtisë ose të profesionit;
- e) stoqet e lëndëve të para dhe produkteve ose gjysëm produkteve;

f) stoqet e produkte bujqësore dhe blegtorale, përfshi bagëtitë, që kalojnë sasi të përshtatshme për nevoja të përdorimit familjar.

Neni 500

1. Përjashtimi lejohet vetëm për pasurinë personale të vendosur në qarkullim të lirë jo me vonë se dy vjet pas datës në të cilën i interesuari fiton të drejtën e pronësisë mbi këto sende (ndarja përfundimtare e trashëgimisë). Megjithatë, për raste të vecanta, kjo periudhë mund të zgjatet nga autoritetet doganore kompetente.

2. Pasuria personale mund të importohet në disa dërgesa të vecanta brenda afatit të përmendur në paragrafin 1.

Neni 501

Nenet nga 498 deri 500 zbatohen *mutatis mutandis* për pasurinë personale të fituar me trashëgimi nga personat juridikë që merren me aktivitet me qëllim jo fitimprurës, të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Seksioni 4

Veshje shkollore, materiale shkollore dhe sende të tjera për përdorim shkollor

Neni 502

1. Përjashtohen nga detyrimet e importit veshjet, materialet shkollore dhe sendet e tjera shtëpiake që përbëjnë në vetvete materiale të zakonshme për dhomat studentore dhe që i përkasin nxenesve ose studenteve të huaj që do të qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për qëllime studimi dhe u nevojiten atyre për përdorim vetiak gjatë kohës së studimeve.

2. Për qëllim të paragrafit 1:

- a) 'nxenës ose student': do të thotë cdo person i regjistruar në një institucion edukimi për të ndjekur me shkeputje nga puna mësimet e ofruara në këtë institucion;
- b) 'veshjet, materialet shkollore dhe sendet e tjera shtëpiake': do të thotë:
 - i) eshje personale për të gjitha stinët, të reja ose të përdorura;
 - ii) shtesje personale audiovizive për studim dhe kompjuterin (përfshi këtu edhe makina llogaritëse, kompjuter ose ordinator);
 - iii) obilje dhe pajisje shtëpiake të përdorura të përshtatshme për të mobiluar një dhomë studentit.

Neni 503

Përjashtimi jepet jo më shumë se një herë për cdo vit shkollor.

Seksioni 5

Dërgesa me vlerë të papërfillshme

Neni 504

1. Pa rënë ndesh me nenin 505, cdo dergese e përbere nga mallra me vlerë të papërfillshme, të dërguara drejtpërsëdrejti nga një vend tjetër tek një marrës në Republikën e Shqipërisë, përjashtohen nga detyrimet e importit.
2. 'Mallra me vlerë të papërfillshme' do të thotë: mallra, vlera përmbledhëse e të cileve nuk e kalon 10 mijë Lekë për cdo dërgesë.

Neni 505

Përjashtimi nuk zbatohet për mallrat e mëposhtme:

- a) produktet alkoolike;
- b) parfumet dhe kolonjat;
- c) duhanet dhe produktet e duhanit;

Seksioni 6

Mallra të ndodhura në bagazhin personal të udhëtarëve

Neni 506

1. Pa rënë ndesh me nenin nga 507 deri 510, mallrat e ndodhura në bagazhin personal të udhëtarëve që vijnë nga një vend tjetër, lejohen duke përfutur përjashtim nga detyrimet e importit, me kusht që këto importe të mos kenë natyrë tregtare.

2. Për qëllim të paragrafit 1:

- a) 'Bagazh personal' do të thotë tërësia e bagazhit që udhëtarit i paraqet autoriteteve doganore me mbërritjen e tij në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, si dhe cdo bagazh që i paraqitet këtyre autoriteteve në një datë të mëvonshme, me kusht që të paraqiten prova që ishte regjistruar, ditën e largimit të udhëtarit, si bagazh të shoqëruara, në momentin e nisjes, pranë shoqëruesit që ka siguruar transportin për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga vendi i nisjes. Pa rënë ndesh me nenin 549(1) (b), mbajtës portativë të mbushur me karburant nuk përbëjnë bagazh personal;

- b) 'Importe me natyrë jo tregtare' do të thotë importe, të cilat:

- i) kanë natyrë rastësore, dhe
- ii) përbëhen ekskluzivisht prej mallrash për përdorim vetiak të udhëtarëve ose familjeve të tyre ose mallrat e destinuara për dhurata, me kusht që lloji dhe sasia e këtyre mallrave të mos jete e tille që të tregojë synim përdorimi tregtar.

Neni 507

1. Përjashtimi i referuar në nenin 506(1) për mallrat e renditura më poshtë, zbatohet mbi bazën

e kufizimeve sasiore për cdo udhëtar:

a) produkte duhani:

- 200 cigare, ose
- 100 cigarillo (cigare me peshë maksimale prej 3 gramë secila) ose
- 50 puro, ose
- 250 gramë duhan, ose përzgjedhje në përpjestim të drejtë i këtyre produkteve të ndryshme;

b) alkooli dhe pijet alkoolike:

- i) 1 liter pije të distiluara dhe alkoole me fortësi alkoolike ndaj volumit më të lartë se 22%, ose alkool etilik i pa denaturuar me forcë alkoolike ndaj volumit 80% dhe më shumë,
- ii) 2 litra: pije të distiluara dhe alkoole dhe aperitivë me bazë vere ose alkooli, tafia, sake, ose pije të ngjashme me fortësi alkoolike ndaj volumit që nuk e kalon 22%, ose verëra të gazuara, likere, ose një përzgjedhje në përpjesetim të drejtë e këtyre produkteve të ndryshme, dhe

iii) 2 litra verëra të zakonshme;

c) 50 gramë parfume ose 0,25 litra kolonjë;

d) produkte mjeksore në sasi të nevojshme për të plotësuar nevojat personale të udhëtarit.

2. Nuk jepet përjashtim për mallrat e përmendura në paragrafin 1(a), për udhëtarët nën moshën 15 vjeç.

3. Nuk jepet përjashtim për mallrat e përmendura në paragrafin 1(b), për udhëtarët nën moshën 18 vjeç.

Neni 508

Përjashtim i përmendur në nenin 506 jepet edhe për një shumë prej 30 000 Lekë për cdo udhëtar për mallra të ndryshme nga ato të renditura në nenin 507. Për udhëtarët nën 15 vjeç, kjo shumë reduktohet në 15 000 Lekë.

Neni 509

Kur vlera e përgjithshme, për cdo udhëtar e dy ose më shumë mallrave, kalon shumë kufi të treguara në nenin 508, jepet përjashtim deri në ato shuma dhe për këto artikuj, të cilëve sikur të ishin importuar veçmas, do të ishte dhënë përjashtim, me kusht që vlera e një artikulli të vecantë nuk mund të ndahet.

Neni 510

1. Ministri i Financave mund të reduktojë vlerën dhe/ose sasinë e mallrave të lejuara të hyjnë me përjashtim nga detyrimet e importit, në rast se ato importohen nga:

- a) persona banues në zonë kufitare;
- b) punonjës kufitarë;
- c) ekuipazhin e mjeteve të transportit që përdoren për transport mes vendeve të tjera dhe Republikës së Shqipërisë;

2. Këto kufizime zbatohen vetëm për personat që kanë vendbanim në një zonë kufitare të vendit fqinjë. Po kështu, kufizimet në fjalë zbatohen edhe për punonjësit kufitarë dhe ekuipazhin e mjeteve të transportit që udhëtojnë midis vendeve të tjerë dhe Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ata importojnë mallra gjatë udhëtimeve të kryera në kuadrin e punës.

3. Për qëllim të zbatimit të dispozitave të paragrafit 1:

- a) 'zonë kufitare' do të thotë: pa rënë ndesh me konventat ekzistuese në këtë fushë, një zonë, shtrirja e së cilës në vije të drejtë ajrore, nuk i kalon 10 km nga kufiri.
- b) 'punonjës kufitar' do të thotë: personat, aktiviteti i zakonshëm që ata kryejnë, u kërkon të shkojë në anën tjetër të kufirit në ditët e punës.

Seksioni 7

Kafshe laboratorit dhe substanca kimike ose biologjike që nevojiten për kërkime

Neni 511

1. Përjashtimi nga detyrimet e importi jepet për kafshet për përdorim laboratorik.

2. Përjashtimi i referuar në paragrafin 1 kufizohet vetëm për kafshët që janë caktuar për:

- a) institucione publike që merren kryesisht me arsimim ose kërkime shkencore dhe ato departamente ose institucione publike të cilat merren kryesisht me arsimim ose kërkime shkencore; ose
- b) institucione private që merren kryesisht me arsimim ose kërkime shkencore dhe të autorizuar nga autoritetet kompetente doganore të Republikës së Shqipërisë të marrin artikuj të tillë me përjashtim nga detyrimet e importit.

Seksioni 8

Substanca terapeutike me origjinë njerëzore dhe reagentë për analizat e gjakut dhe të indeve; organe njerëzore për transplantim

Neni 512

1. Pa rënë ndesh me nenin 513, përjashtohen nga detyrimet e importit mallrat e mëposhtme:

- a) substanca terapeutike me origjinë njerëzore;
- b) reagentë për përcaktimin e grupit të gjakut;
- c) reagentë për përcaktimin e përbërjes së

indeve;

d) organe njerëzore për transplantim.

2. Për qëllim të paragrafit 1:

- a) 'substanca terapeutike me origjinë njerëzore' do të thotë gjaku i njeriut dhe derivativet e tij (gjak integral, plazmën e tharë, albuminë, dhe solucione të qëndrueshme të proteinave plazmike, imunoglobulinë dhe fibrinogen);
- b) 'reagentë për përcaktimin e grupit të gjakut' do të thotë: gjithë reagentet, qofshin këta me origjinë njerëzore, shtazore, bimore ose origjinë tjetër të përdorur për përcaktimin e grupit dhe papajtueshmërisë së gjakut;
- c) 'reagentë për përcaktimin e përbërjes së indeve' gjithë reagentet, qofshin këta me origjinë njerëzore, shtazore, bimore ose të tjera, përdorur për përcaktimin e përbërjes së indeve.

Neni 513

Përjashtimi bëhet vetëm për substancat me karakter terapeutike me origjinë njerëzore dhe reagentet për analizat e gjakut dhe të indeve, të cilat:

- a) destinohen për institucione ose laboratorë të njohur nga autoritetet doganore kompetente për t'u përdorur ekskluzivisht për qëllime mjeksore ose shkencore jo tregtare;
- b) shoqërohen me një vertetim konformiteti, lëshuar nga një institucion i autorizuar për këtë qëllim në vendin e nisjes;
- c) ndodhen në ambalazhe të pajisur me etiketë të veçante identifikuese.

Neni 514

Përjashtimi jepet vetëm për organet njerëzore për transplantim të cilat:

- a) destinohen për spitale dhe institucione të tjera shëndetsore, për përdorim ekskluziv për qëllime transplantimi;
- b) shoqërohen nga një certifikatë e lëshuar nga një organ i autorizuar zyrtarisht për këtë qëllim në vendin e nisjes;
- c) ndodhen në ambalazhe që mbajnë etiketa të vecanta identifikuese.

Neni 515

Përjashtimi përfshin edhe ambalazhet esenciale, që nevojiten për transportimin e substancave terapeutike me origjinë njerëzore, të reagentëve të analizave të gjakut dhe indeve ose organeve njerëzore, si dhe cdo tretës apo mjete të tjera ndihmëse për përdorimin e tyre të cilat mund të jenë përfshirë në dërgesë si të importuara së bashku ashtu edhe veçmas.

Seksioni 9

Substanca për kontrollin e cilësisë së produkteve mjeksore

Neni 516

Dërgesat të cilat përmbajnë kampione të substancave të miratuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë për kontrollin cilësor të materialeve të përdorura në prodhimin e produkteve mjeksore dhe të cilat i adresohen pritësve të autorizuar nga autoritetet doganore kompetente të Republikës së Shqipërisë për të marrë të tilla dërgesa, përjashtohen nga detyrimet e importit.

Seksioni 10

Produkte farmaceutike të përdorura në aktivitete sportive

Neni 517

Produktet farmaceutike për përdorim mjeksor njërëzor apo veterinar nga persona ose kafshë që vijnë nga vende të tjera për të marrë pjesë në aktivitete ndërkombëtare sportive të organizuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, brenda kufijve të arsyeshëm për të plotësuar kërkesat gjatë gjithë qëndrimit në këtë territor, përjashtohen nga detyrimet e importit.

Seksioni 11

Mallrat për organizata bamirëse, organizma filantropie ose për qëllime ndihme për ente bamirëse, institucione fetare, ente publike, si dhe ente shtetërore buxhetore

Neni 518

1. Pa rënë ndesh me nenet 520 dhe 521, importohen me përjashtim nga detyrimet e importit, për as sa të mos krijojnë mundësi për abuzime ose shtrembërime të konkurrencës, sa më poshtë:

- a) mallra te nevojave bazë te importuara nga organizata bamirësie, filantropizmi ose fetare, ente publike si dhe ente shtetërore buxhetore, të miratuara nga autoritetet doganore kompetente për tua shpërndarë falas personave që kanë nevojë;
- b) materiale dhe pajisje zyre të derguara falas, nga një person ose një organizatë e vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe pa qëllime tregtare nga ana e dërguesit, për organizata bamirëse, filantropike apo fetare, ente publike dhe institucione buxhetore shtetërore të miratuara nga autoritetet doganore kompetente, mallra këto për tu përdorur vetëm për të plotësuar nevojat e ushtrimit të aktivitetit të tyre bamirës apo filantropik.

2. Për qëllim të paragrafit 1(a), 'nevoja bazë' do të thotë mallrat te cilat nevojiten për të plotësuar nevojat elementare të qenieve njërëzore, si p.sh. ushqim, barna, veshje dhe shtresa apo mbulesa.

Neni 519

Nuk jepet përjashtim për:

- a) produktet e alkoolit;
- b) duhani dhe produktet e duhanit;
- c) kafe dhe çaj;
- d) automjetet që nuk janë ambulanca dhe automjete të tjera emergjence.

Neni 520

Përjashtim përfitojnë vetëm organizatat, të cilat kanë procedurë kontabiliteti, të cilat i lejojnë autoritetet doganore kompetente të mbikqyrin veprimtarinë e tyre dhe të cilat nga ana tjetër, paraqesin të gjitha garancitë që gjykohen të nevojshme.

Neni 521

1. Organizatat që përfitojnë nga përjashtimi, nuk mund të të japin hua, me qira, të tjetërsojnë, falas apo kundrejt pageses, mallrat apo pajisjet e përmendura në nenin 529, për qëllime të ndryshme nga ato të përmendura në paragrafin 1(a) dhe (b) të atij neni, pa njoftuar me parë për këtë qëllim autoritetet doganore kompetente.

2. Në rast se mallrat dhe pajisjet e përmendura me sipër i jepen hua, me qira apo i tjetërsohen një organizatë që ka të drejtë të përfitojë përjashtim sipas neneve 518 dhe 520, përjashtimi jepet me kusht që organizata e fundit të përdorë mallrat dhe pajisjet për qëllime që perputhen me arsyen e dhënies së përjashtimit. Në rast të kundërt, huadhënia, qiradhenia apo tjetërsimi behet vetëm pas pageses të detyrimeve të importit sipas nivelit të zbatueshëm në datën e dhënies hua, dhënies me qira apo tjetërsimit, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të verifikuar ose të pranuar nga autoritetet doganore kompetente në atë datë.

Neni 522

1. Organizatat e përmendura në nenin 518, të cilat nuk përmbushin me kushtet që i kanë dhene të drejtën për të përfituar përjashtim, ose të cilat propozojnë përdorimin e mallrave dhe pajisjeve të përjashtuara nga detyrimet e importit, për qëllime të ndryshme nga ato të pershkrjuara në nenin 518, duhet të njoftojnë për këtë qëllim autoritetet doganore kompetente.

2. Mallrat dhe pajisjet që mbeten në posedim të organizatave të cilat nuk përmbushin me kushtet për të cilat iu dha e drejta për të përfituar përjashtim, janë objekt i pageses së detyrimeve të importit perkatese, sipas nivelit të zbatueshëm në datën në të cilën kushtet pushuan së egzistuari, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të verifikuar ose pranuar nga autoritetet kompetente doganore në atë datë.

3. Mallrat dhe pajisjet e përdorura nga organizatat që përfitojnë nga përjashtimi për qëllime të ndryshme nga ato të përmendura në nenin 518, i nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit sipas nivelit të zbatueshëm në datën në të cilën ato janë vendosur në një përdorim tjetër, mbi bazën e llojit të mallrave dhe pajisjeve si dhe të vlerës doganore të verifikuar ose pranuar në datën në fjalë nga

autoritetet doganore kompetente.

Neni 523

Pa rënë ndesh me nenet nga 524 deri 528, mallrat e importuara nga organizata bamirëse, filantropike ose fetare, entet publike si dhe institucionet buxhetore shtetërore të miratuara prej autoriteteve doganore për këtë qëllim, përjashtohen nga detyrimet e importit kur destinohen:

- a) për shpërndarje falas, viktimave të fatkeqësive që godasin territorin doganor të Republikës së Shqipërisë; ose
- b) për t'ua vënë në dispozicion falas viktimave të fatkeqësive të tilla, ndonëse mbeten pronë e organizatave në fjalë.

Neni 524

Nuk përfitojnë përjashtim për materialet dhe pajisjet që nevojiten për të rindertuar zonat e goditura nga forca madhore.

Neni 525

Përjashtim përfitojnë vetëm organizatat të cilat përdorin procedura kontabilizimi të cilat lejojnë autoritetet doganore kompetente të mbikqyrin veprimtarinë e tyre dhe të cilat nga ana tjetër, paraqesin te gjithë garancite që gjykojnë të nevojshme.

Neni 526

1. Organizatat që përfitojnë përjashtim nuk mund të japin hua, me qira, të tjetërsojnë, falas apo kundrejt pageses, mallrat apo pajisjet e përmendura në nenin 523, për qëllime të ndryshme nga ato të përmendura në atë nen, pa njoftuar me parë për këtë qëllim autoritetet doganore kompetente

2. Në rast se mallrat dhe pajisjet e përmendura më sipër i jepen hua, me qira apo i tjetërsohen një organizatë që ka të drejtë të përfitojë përjashtim sipas nenit 523, përjashtimi jepet, me kusht që organizata e fundit të përdorë mallrat dhe pajisjet për qëllime që përputhen me arsyen e dhënies së përjashtimit. Në rast të kundërt, huadhënia, qiradhënia apo tjetërsimi bëhet vetëm pas pagesës të detyrimeve të importit sipas nivelit të zbatueshëm në datën e dhënies hua, dhënies me qira apo tjetërsimit, në bazë të llojit të mallrave dhe pajisjeve dhe vlerës doganore të verifikuar ose pranuar nga autoritetet doganore kompetente në atë datë.

Neni 527

1. Mallrat e përmendura në nenin 523(b), kur nuk përdoren me për viktimat e fatkeqësisë, nuk mund të jepen hua, me qira ose të tjetërsohen, falas apo kundrejt pagesës, pa njoftuar më parë autoritetet doganore kompetente.

2. Në rast se mallrat dhe pajisjet e përmendura më sipër i jepen hua, me qira apo i tjetërsohen një organizatë që ka të drejtë të përfitojë përjashtim sipas nenit 523, ose kur është rasti, një organizatë që ka të drejtë të përfitojë përjashtim sipas nenit

518 (1)(a), përjashtimi vazhdon të jetë në fuqi, me kusht që kjo organizatë të përdorë mallrat dhe pajisjet për qëllime që përputhen me kushtet e dhënies së përjashtimit. Në rast të kundërt, huadhënia, qiradhënia apo tjetërsimi bëhet vetëm pas pagesës së detyrimeve të importit sipas nivelit të zbatueshëm në datën e dhënies hua, dhënies me qira apo tjetërsimit, në bazë të llojit të mallrave dhe pajisjeve si dhe të vlerës doganore të verifikuar ose pranuar nga autoritetet doganore kompetente në atë datë.

Neni 528

1. Organizatave të cilave iu referohet neni 523, të cilat nuk përmbushin me kushtet për të cilat përfitonin përjashtim nga detyrimet e importit, ose të cilat propozojnë të përdorin mallrat e lejuara me përjashtim nga detyrimet e importit, për qëllime të ndryshme nga ato të përmendura në atë nen, duhet të informojnë për një gjë të tillë autoritetet doganore kompetente.

2. Në rastet e mallrave të mbetura në posedim të organizatave të cilat nuk përmbushin me kushtet për të cilat përfitonin përjashtim nga detyrimet e importit, kur këto mallra në vazhdim i janë transferuar një organizatë tjetër, edhe kjo e fundit me të drejtë të përfitojë përjashtim sipas nenit 523, ose nëse është rasti, një organizatë që përfiton përjashtim sipas nenit 518(1)(a), përjashtimi vazhdon të jepet, me kusht që këto organizata të përdorin mallrat dhe pajisjet në fjalë për kushte që përputhen me arsyen e dhënies së përjashtimit. Në rast të kundërt, mbi mallrat rëndon detyrimi për të paguar detyrimet e importit, sipas nivelit të zbatueshëm në datën në të cilën kushtet pushuan së egzistuari, në bazë të llojit të mallrave dhe pajisjeve dhe vlerës doganore të verifikuar ose pranuar nga autoritetet doganore kompetente në atë datë.

3. Për mallrat e përdorura nga organizatat që përfitojnë përjashtim, për qëllime të ndryshme prej atyre të përmendura në nenin 523 duhet të paguhet detyrimet e importit përkatëse sipas nivelit të zbatueshëm në datën në të cilën ato u përdoren për qëllim tjetër, në bazë të llojit të mallrave dhe të vlerës doganore të verifikuar ose pranuar nga autoritetet doganore kompetente në atë datë.

Neni 529

1. Instrumentat dhe pajisjet që destinohen për kërkime mjeksore, për përcaktim diagnoze ose kryerje të trajtimit mjeksor, të cilat dhurohen nga një organizatë filantropike ose nga një individ privat autoriteteve të shëndetësisë, departamenteve spitalore ose institucioneve kërkimore mjekësore, të miratuara nga autoritetet kompetente doganore të Republikës së Shqipërisë, të marrin këta artikuj pa paguar detyrimet e importit, ose pajisje e instrumenta të blera nga këto autoritete shëndetësore, spitale ose institucione kërkimore mjekësore krejtësisht me fonde të dhuruara nga organizata bamirëse apo filantropike ose me kontribute vullntare, përjashtohen nga detyrimet e importit, gjithmonë me kusht që të vërtetohet që:

- a) dhurimi i instrumentave ose aparateve në fjalë nuk fsheh në vetvete asnjë synim tregtar nga ana e dhuruesit; ose
- b) dhuruesi nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me prodhuesin e instrumentave ose aparateve për të cilat kërkohet përjashtim.

2. Përjashtimi zbatohet gjithashtu, duke iu nënshtruar të njëjtave kushte, për:

- a) pjeset e këmbimit, pjeset përberese ose aksesorët e përshtatshëm pikërisht për instrumentet ose aparatet e përmendura me sipër, me kusht që këto pjesë këmbimi, pjesë përbërëse ose aksesore importohen në të njëjten kohë me ato instrumenta ose aparate, ose kur janë importuar me vone, të mund të identifikohen se destinohen për instrumenta ose aparate të importuara me pare me përjashtim nga detyrimet e importit;
- b) vegla që do të përdoren për mirëmbajtjen, kontrollin, kalibrimin ose riparimin e instrumentave apo aparateve, me kusht që këto vegla të importohen në të njëjten kohë me instrumentat ose aparatet në fjalë, ose kur importohen me pas, të mund të identifikohen si vegla që destinohen për instrumenta ose aparate të importuara me parë me përjashtim nga detyrimet e importit.

Seksioni 12

Dekorata dhe shpërblime për tituj nderi

Neni 530

Me paraqitjen e provave të mjaftueshme nga i interesuari, me kusht që operacionet e përfshira të mos kenë karakter tregtar, autoritetet doganore kompetente lejojnë importimin me përjashtim nga detyrimet e importit për:

- a) dekoratat e dhëna nga qeveri të vendeve të tjera, personave banues në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;
- b) kupat, medaljet dhe artikuj të ngjashëm që në thelb kanë natyrë simbolike, të cilët, janë dhënë në një vend tjetër personave të cilët kanë vendbanim të zakonshëm në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, si nderim për aktivitetin e tyre në fusha të tilla si artet, shkencat, sportet ose shërbimi publik ose në shenjë mirënjohjeje për merita në një ngjarje të caktuar, të cilat importohen në Republikën e Shqipërisë nga vetë personi;
- c) kupat, medaljet dhe artikuj të ngjashëm që në thelb kanë natyrë simbolike, të cilat jepen falas nga autoritete ose persona me vendbanim në një vend tjetër, për tu paraqitur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për të njëjtat qëllime me ato të cilave u referohet

paragrafi (b);

- d) cmime, trofe dhe dhurata me natyrë simbolike dhe me vlerë të kufizuar që do t'u shpërndahen falas personave që zakonisht janë banues në një vend tjetër, në konferenca biznesi ose aktivitete ndërkombëtare të ngjashme me to që zhvillohen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Natyra, vlera për njësi ose cilësi të tjera të këtyre sendeve duhet të tregojë qartë se nuk po importohen për qëllime tregtare.

Seksioni 13

Dhurata të dhëna në kuadrin e marrëdhënieve ndërkombëtare

Neni 531

Pa rënë ndesh me zbatimin e neneve nga 506 deri 510, nëse këto janë të zbatueshme për rastin, dhe në përputhje me nenet 532 dhe 533 më poshtë, jepet përjashtim nga detyrimet e importit edhe për mallrat:

- a) që importohen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga persona të cilët kanë kryer vizitë zyrtare në një vend tjetër dhe që i kanë marrë këto sende si dhurata nga autoritetet mikpritëse për shkak të kësaj vizite;
- b) që importohen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga persona që kanë ardhur për vizite zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe kanë qëllim që tua dhurojnë këto mallra autoriteteve mikpritëse;
- c) që janë dërguar si dhuratë, në shenjë miqësie ose dëshirë të mire, nga një organ zyrtar, autoritete publike ose grupe, që ushtrojnë një aktivitet në interes publik në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe miratohen nga autoritetet kompetente doganore për të perfituar këto artikuj me përjashtim nga detyrimet e importit.

Neni 532

Asnjë përjashtim nga detyrimet e importit nuk jepet për produktet alkoolike, duhanin dhe produktet e duhanit.

Neni 533

Përjashtimi do të jepet vetëm kur:

- a) artikujt e destinuar për dhurata ofrohen mbi baza rastësore;
- b) nga vetë natyra e tyre, nga vlera apo sasia nuk paraqesin interes tregtar;
- c) nuk përdoren për qëllime tregtare.

Seksioni 14

Mallra për përdorim nga kryetarët shtetesh

Neni 534

1. Perjashtohen nga detyrimet e importit brenda kufijve dhe kushteve të percaktuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, artikujt e mëposhtem:

- a) dhurata për kryetarë shtetesh;
 - b) mallra për përdorim ose konsum nga kryetarë shtetesh të vendeve të tjera, ose persona të cilët i përfaqësojnë zyrtarisht ata, gjatë qëndrimit të tyre zyrtar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, përjashtimi mund t'i nënshtrohet bazave të reciprociteti.
2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm zbatohen gjithashtu edhe për persona që gëzojnë në nivel ndërkombëtar, të drejta të ngjashme me ato që gëzojnë monarket në fron dhe kryetarët e shteteve.

Seksioni 15

Mallra të importuara për qëllim të nxitjes së tregtisë

Neni 535

1. Pa rënë ndesh me nenin 539(1)(a), përjashtohen nga detyrimet e importit edhe mostrat e mallrave me vlerë të papërfillshme dhe që mund të përdoren vetëm për të nxitur porositjen e mallrave të llojit që ato përfaqësojnë, me qëllim që të importohen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Autoritetet doganore kompetente mund të kërkojnë që artikujt të caktuar të cilesuar për përjashtim, të behen krejtësisht të papërdorshëm duke u prerë, shpuar, ose duke u vendosur shenja që nuk mund të fshihen, ose nepermjet cdo procesi tjetër, me kusht që ky operacion nuk shkatërron karakterin e tyre si mostra.

3. Për qëllim të paragrafit 1, 'mostra mallrash' do të thotë cdo artikull që përfaqëson një lloj malli, mënyra e përfaqësimit dhe sasia e të cilit, për mallra të të njëjtit lloj ose cilesi, e bën të pamundur përdorimin e tij për qëllime të ndryshme prej atyre që kane të bëjnë me tërheqjen e porosive.

Neni 536

Pa rënë ndesh me nenin 537, materiale reklamash të shtypura, në forme katalogesh, lista çmimesh, udhëzime për përdorim ose broshura përjashtohen nga detyrimet e importit, me kusht që të kenë të bëjnë me:

- a) mallra për t'u shitur ose dhene me qira; ose
- b) transportin, sigurimin tregtar ose shërbime bankare të cilat ofrohen nga një person që nuk banon në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 537

Perjashtimi i përmendur në nenin 536 jepet vetëm për reklamat e shtypura, të cilat plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) materialet e shtypura duhet të përmbajne në vend të dukshëm emrin e ndermarrjes që prodhon, shet ose jep me qira mallrat, apo ofron shërbimet perkatese;
- b) cdo dergese duhet të përmbaje jo më shumë se një dokument, dhe nese përbehet prej disa dokumentesh, vetëm një kopje të secilit prej tyre. Megjithatë, dergesat që përmbajne me shume se një kopje të të njëjtit dokument mund të përjashtohen nga detyrimet e importit në qofte se pesha e tyre e përgjithshme bruto nuk kalon 1 kg;
- c) nëse materialet e shtypura janë vendosur në një grup dërgesash të veçanta nga i njëjtit dergues për të njëjtin marrës, nuk jepet përjashtim nga detyrimet e importit.

Neni 538

Përjashtohen nga detyrimet e importit edhe artikujt e reklames që në vetvete nuk kane vlere tregtare, dhe që dergohen falas nga furnizuesi tek klientet, dhe të cilët përveç përdorimit për qëllime reklame, nuk mund të përdoren për asnjë qëllim tjetër.

Neni 539

1. Në përputhje me nenet nga 540 deri 543, përjashtohen nga detyrimet e importit edhe:

- a) mostra të vogla demonstruese të mallrave të prodhuara jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, që do të përdoren për një panair tregtar ose një ngjarje të këtij lloji;
- b) mallrat e importuara vetëm me qëllimin për tu demonstruar vetë ose që shërbejnë për demonstrimin e makinave ose aparateve të prodhuara jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të paraqitura në një panair tregtar ose një aktivitet të ngjashëm;
- c) materiale të ndryshme me vlere të vogël, si p.sh. bojera, vernik, leter muresh, etj., që përdoren për ndertimim, sistemimin dhe zbukurimin e stendave të perkohshëm të pavioneve të vendeve të tjera, në një panair tregtar ose ngjarje të këtij karakteri, materiale keto të cilat humbasin vlerën e tyre për shkak të përdorimit;
- d) materiale të shtypura, kataloge, prospekte, lista çmimesh, poster reklame, kalendare të ilustruar ose jo, fotografi pa kornize dhe artikujt të tjere të dhene falas për reklamën e mallra të prodhuara jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të ekspozuara në një panair tregtar ose ngjarje të ngjashme që zhvillohet brenda këtij

territori.

2. Për qëllim të paragrafit 1, 'panair tregtar ose ngjarje e ngjashme' do të thotë:

- a) ekspozitat, panairot, shfaqjet dhe ngjarje të ngjashme, që kanë lidhje me tregtine, industrine, bujqësinë dhe artizanatin;
- b) ekspozitat dhe ngjarje të organizuara vetëm për qëllime bamiresie;
- c) ekspozitat dhe ngjarje të organizuara kryesisht për qëllime shkencore, teknike, artizanati, artistike, arsimore e kulturore, sportive, për qëllime fetare ose për qëllime kulti, për qëllime sindikaliste ose turistike, ose për të nxitur mirekuptimin mes popujve;
- d) takime e perfaqësuesve të organizatave ose grupeve ndërkombetare;
- e) ceremoni zyrtare ose perkujtime dhe manifestime, duke përjashtuar këtu ekspozitat e organizuara për qëllime private në dyqane dhe lokale tregtare për shitjen e mallrave të vendeve të tjera.

Neni 540

Perjashtimet të cilave u referohet neni 539(1)(a), do të jepen vetëm për mostrat që:

- a) importohen falas nga vende të tjera ose përfitohen në një ekspozitë nga mallrat të importuara rifuxho nga këto vende;
- b) shperndahen vetëm falas gjatë ekspozimit, për t'u përdorur për konsum nga personat të cilëve u ofrohen;
- c) janë të identifikueshem si mostra me karakter reklame, me vlerë të ulët për njësi;
- d) nuk janë lehtësisht të tregtueshem, dhe kur është rasti, vendosen në ambalazhe që përmbajnë një sasi më të vogël mallrash sesa sasia më e vogël e të njëjtit mall, e shitur realisht në treg;
- e) që konsumohen aty për aty gjatë ekspozimit, në rastin e produkteve ushqimore ose pijeve të papaketuara të cilave u referohet shkronja (d) më lart;
- f) për nga vlera dhe sasia e tyre në teresi, janë në përputhje me natyrën e ekspozitës, numrin e vizitoreve dhe shtrirjen e pjesëmarrësve në ekspozitë.

Neni 541

Perjashtimi parashikuar në nenin 539(1)(b) jepet vetëm për mallrat të cilat për nga vlera në teresi dhe sasia përshkruhen me natyrën e ekspozitës, numrin e vizitoreve dhe shtrirjen e pjesëmarrësve në ekspozitë.

Neni 542

Perjashtimi parashikuar në nenin 539(1)(d) jepet

vetëm për materialet e shtypura dhe artikujt për qëllime reklame, të cilët:

- a) destinohen vetëm për t'u shperndare falas publikut në vendin ku organizohet ekspozita;
- b) për nga vlera e tyre në teresi dhe sasia janë në përputhje me natyrën e ekspozitës, numrin e vizitoreve dhe shtrirjen e pjesëmarrësve në ekspozitë.

Neni 543

Perjashtimi i parashikuar në nenin 539(1)(a) dhe (b), nuk jepet për:

- a) produkte alkooli;
- b) duhan dhe produkte duhani;
- c) karburante, qofshin këto të ngurta, të lengeta apo të gazta.

Seksioni 16

Dergesa për organizata që mbrojnë të drejtat mbi pronësinë intelektuale

Neni 544

Perjashtohen nga detyrimet e importit markat tregtare, modelet ose skicat dhe dokumentet shoqëruese të tyre, si dhe kërkesat për patentat e shpikjeve ose të tjera të këtij karakteri, të cilat do të depozitohen pranë organeve kompetente që merren me mbrojtjen e të drejtës së autorit ose të mbrojtjes së të drejtave të patentave industriale ose tregtare.

Seksioni 17

Literature informimi turistik

Neni 545

Perjashtohen nga detyrimet e importit:

- a) dokumentacioni (fletëpalosjet, broshurat, librat, revistat, librat e guides, posterat në kornize ose jo, fotografite pa kornize dhe zmadhimet fotografike, hartat qofshin këto të ilustruara apo jo, letrat transparente dhe kalendare të ilustruar) për t'u shperndare falas dhe qëllimi kryesor i të cilëve është të nxirret publikun të vizitoje vende të tjera, vecanerisht për të ndjekur takime ose aktivitete kulturore, turistike, sportive, fetare ose tregtare apo profesionale, me kusht që një literature e tillë të mos përmbajë më shumë se 25% reklamë tregtare private, duke përjashtuar gjithë reklamën private tregtare për shoqëritë e Republikës së Shqipërisë, dhe që nga vetë natyra e këtyre aktiviteteve të pasqyrohet dukshëm qëllimi i nxitjes së tregtisë;

- b) lista hotelesh të huaja dhe vjetarë të botuar nga agjensi turistike zyrtare, ose nën kujdesin e tyre, orari për shërbimin e huaj të transportit, kur një literature e tillë destinohet të shperndahet falas dhe nuk përmban më shumë se 25% reklamë private tregtare, duke përjashtuar gjithë reklamën

tregtare të shoqërive shqiptare;

- c) materiale reference të paraqitura nga perfaqësues të akredituar ose korrespondente të emeruar nga agjensi turistike kombetare zyrtare, të cilat nuk destonohen për shpërndarje, si p.sh vjetarë, listat e abonentëve telefonik ose teleksit, lista e hoteleve, kataloget e panairëve, modele të mallrave të artizanatit me vlerë të paperfillshme, dhe literature mbi muzete, universitetet, qendrat termale ose institucione analoge.

Seksioni 18

Dokumenta dhe artikuj të ndryshëm

Neni 546

Perjashtohen nga detyrimet e importit, materialet e mëposhteme:

- a) dokumente të derguara falas institucioneve të shërbimeve publike të Republikës së Shqipërisë;
- b) botime të qeverive të huaja dhe botime zyrtare të institucioneve ndërkombetare, për shpërndarje falas;
- c) fletë votime për zgjedhje të organizuara nga institucione të ngritura në vende të tjera;
- d) objekte për t'u paraqitur si prove ose për qëllime të ngjashme në gjykata dhe agjensi të tjera zyrtare të Republikës së Shqipërisë;
- e) modele nënshkrimesh dhe qarkore që kanë të bëjnë me nënshkrimet e dërguara si pjesë e shkëmbimeve të zakonshme të informacionit midis shërbimeve publike ose institucioneve bankare;
- f) materiale zyrtare të shtypura që i dergohen bankave qendrore të Republikës së Shqipërisë;
- g) raporte, deklarata, shenime, programe, formulare kërkesash dhe dokumente të tjera të hartuara nga shoqëri me qënder në vende të tjera dhe të derguara në adrese të aksionereve dhe nënshkruesve të titujve të leshuar prej këtyre shoqërive;
- h) pajisje regjistrimi (skeda të cilat janë të pajisura me vrima, regjistrime zanore, mikrofilma, etj) të përdorura për transmetimin e informacionit të dërguar falas pritesve, me kusht që përjashtimi nga detyrimet e importit nuk krijon mundësi për abuzime ose shtrembërime të mëdha të parimeve të konkurrencës;
- i) fashikuj, arkiva, formulare të shtypur dhe dokumente të tjera për t'u përdorur në mbledhje, konferenca ose kongrese ndërkombetare, dhe raporte mbi këto mbledhje;
- j) vizatime, skica teknike, kopje vizatimesh, përshkrime dhe dokumente të tjera të ngjashme të importuara për të tërhequr ose kryer porosi në vende të tjera ose për të marrë pjesë në konkurse të organizuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;
- k) dokumente që do të përdoren gjatë provimeve të organizuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga institucione me qënder në vende të tjera;
- l) formulare të shtypur për t'u përdorur si dokumente zyrtare në qarkullimin ndërkombëtar të automjeteve ose mallrave, në kuadrin e konventave ndërkombetare;
- m) formulare, etiketa, bileta dhe dokumente të ngjashme të derguara nga agjensi transporti ose nga sipërmarrje të industrisë së hotelierisë në një vend tjetër për agjensi udhëtimi të krijuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;
- n) formularë dhe bileta, police ngarkesa, deklarata ngarkese, dhe dokumente të tjera tregtare ose zyrtare, të përdorura;
- o) formulare zyrtare të shtypur nga një vend tjetër ose nga autoritete ndërkombetare, dhe materiale të shtypura në përputhje me standartet ndërkombëtare, të dërguara për shpërndarje nga shoqata të vendeve të tjera në adresë të shoqatave homologe që gjenden në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;
- p) fotografi, diapozitive dhe kartona për matrica fotografish, që mund të përmbajne edhe udhëzime, të derguara nga agjensi shtypi ose agjensi botuese gazetash dhe revistash;
- q) pulla takse dhe pulla të ngjashme që tregojnë pagimin e detyrimeve në vende të tjera;
- r) kartmonedha dhe monedha, në përdorim, që i dërgohen bankave ose organeve shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Seksioni 19

Materiale ndihmëse për sistemimin dhe mbrojtjen e mallrave gjatë transportit

Neni 547

Përjashtohen nga detyrimet e importit edhe materiale të ndryshme si litarë, kashtë, copa tekstili, letër dhe karton, lëndë drusore dhe plastike, të cilat përdoren për sistemimin dhe mbrojtjen - përfshi këtu edhe mbrojtjen nga nxehësia, për mallrat gjatë transportit nga një vend tjetër për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, të cilat normalisht nuk ripërdoren.

Seksioni 20

Ushqime dhe pajisje që nevojiten gjatë transportit të kafsheve

Neni 548

Përfshihen nga detyrimet e importit ushqimet për kafshët, pajisjet për shërbime ndaj tyre, të cilat lloji, të cilat janë ngarkuar në mjetin e transportit që përdoret për dërgimin e kafshëve nga një vend tjetër në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për tu gjatë udhëtimit për qëllimet në fjalë.

Seksioni 21

Karburante dhe vajra lubrifikues që ndodhen në automjetet rrugore

Neni 549

1. Pa rënë ndesh me dispozitat e neneve nga 550 deri 553 përfshihen nga detyrimet e importit:

- a) karburantet që mbahen në serbatolet e zakonshëm të automjeteve tregtare private dhe motocikletat që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;
- b) karburante që mbahen në serbatolet të levizshme, të mbartur nga automjete private dhe motoçikleta, me një maksimum prej 10 l për automjet, pa rënë ndesh me dispozitat në fuqi lidhur me mbartjen dhe transportin e karburantit,

2. Për qëllim të paragrafit 1:

- a) 'automjet tregtar' do të thotë cdo automjet rrugor i motorizuar (përfshi edhe traktorët rrugorë me ose pa rimorkio), të cilët nga vetë lloji i ndërtimit dhe pajisjet që ka është i destinuar dhe është në gjendje për transportim, me ose pa pagesë, të
 - i) më shumë se nëntë personave, përfshirë këtu edhe shoferin,
 - ii) mallrave, si dhe cdo automjet rrugor për qëllime speciale, që në thelb janë të ndryshme nga transporti;
- b) 'automjet privat' do të thotë cdo automjet, përveç atyre të cilët përfshihen në përkufizimin e parashikuar në (a);
- c) 'serbatorë të zakonshëm' do të thotë serbatorët e vendosur në mënyrë të përhershme nga prodhuesi në gjithë automjetet e llojit të njëjtë me automjetin në fjalë, ndërtimi i të cilëve lejon përdorimin e drejtpërdrejtë të karburantit, për lëvizjen e automjeteve, ashtu edhe kur është rasti, për funksionimin gjatë transportit të sistemeve të ftohjes dhe të sistemeve të tjerë. Që kur po kështu serbatolet të zakonshëm serbatolet e gazit të vendosur në automjete që lejojnë përdorimin direkt të gazit si karburant, si dhe serbatorët që i

përshtaten sistemeve të tjera, me të cilat është pajisur automjeti.

Neni 550

Përsa i përket karburantit të ndodhur në serbatolet e zakonshëm të automjeteve tregtare, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave mund të kufizojë zbatimin e përjashtim deri në kufirin 200 litra për automjet dhe për cdo udhëtim.

Neni 551

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave mund të kufizojë sasinë e karburantit të lejuar me përjashtim, në rastin e:

- a) automjeteve tregtare që kryejnë transport ndërkombëtar nëpër zonën e tyre kufitare me thellësi maksimale prej 25 km në vijë ajrore, me kusht që udhëtimet të kryhen nga banues të zonës kufitare;
- b) automjete private që i përkasin banuesve të zonës kufitare të parashikuar në nenin 510 (3).

Neni 552

Karburantet e përjashtuara nga detyrimet e importit, në bazë të neneve nga 549 deri 551, nuk mund të përdoren në një automjet të ndryshëm prej atij në të cilin gjendeshin kur u importuan, as të transferohen nga ai automjet dhe të ruhen në vend tjetër, me përjashtim të rasteve kur duhen kryer riparime të nevojshme në atë automjet, dhe as nuk mund të transferohen nga vetë personi që përfiton prej përjashtimit, si kundrejt pageses ashtu edhe falas. Mosrespektimi i kësaj dispozite sjell zbatimin e detyrimeve të importit lidhur me produktet në fjalë, mbi bazën e nivelit të zbatueshëm në datën kur ndodhi mosrespektimi, llojit të mallrave dhe vlerës doganore të verifikuar ose pranuar prej autoriteteve doganore në atë datë.

Neni 553

Përjashtimi i parashikuar në nenin 549, zbatohet edhe për vajrat lubrifikues që gjenden në automjete dhe nevojiten për funksionimin normal të tyre gjatë udhëtimit.

Seksioni 22

Materiale për ndërtimin, mirëmbajtjen ose zbulimin e përkujtimeve dhe varrezave të të rënëve në luftë

Neni 554

Përfshihen nga detyrimet e importit edhe mallrat e cdo lloji, të importuara nga organizma të autorizuar për këtë qëllim nga autoritetet doganore kompetente, dhe të cilat destinohen të përdoren për ndërtimin, mirëmbajtjen ose zbulimin e varrezave, varreve, si dhe përkujtimeve për të rënë në luftë të vendeve të tjera, të cilët janë varrosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

S e k s i o n i 23

Arkivole dhe objekte të tjera funerali si dhe artikuj zbukurimi për to

Neni 555

Përfshihen nga detyrimet e importit edhe:

- a) arkivole të mbajne trupa dhe urnat me hirin e të vdekurve, si dhe lulet, zbukurimet funerale dhe objekte të tjera zbukurimi që i shoqërojnë;
- b) lulet, zbukurimet, dhe objekte të tjera zbukurimi të sjella nga persona banues në vende të tjera për të marrin pjesë në një funeral, ose të cilat vijnë për të zbukuruar varret në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që vlera e këtyre artikujve të jetë jo më shumë se 10 000 Lekë.

S e k s i o n i 24

Makineri dhe pajisje të tjera për tu përdorur në një zonë të lirë ose magazine të lirë, të importuara nga persona të licensuar të veprojnë në një zonë të lirë ose magazine të lirë

Neni 556

Në përputhje me dispozitat e Ligjit "Mbi Zonat e Lirë", pa rënë ndesh me masat në fuqi në Republikën e Shqipërisë lidhur me politikat tregtare dhe industriale, dhe pa rënë ndesh me nenet nga 557 deri 559, makineritë dhe pajisjet e tjera për përdorim të përhershëm në një zonë të lirë apo magazinë të lirë, përfshihen nga detyrimet e importit, në rast se importohen nga persona të licensuar në përputhje me dispozitat e Ligjit "Mbi Zonat e Lirë".

Neni 557

Përfshimi kufizohet për makineri dhe pajisje, të cilat:

- a) destinohen për përdorim të përhershëm në një zonë të lirë apo magazinë të lirë;
- b) destinohen të përdoren nga personi i licensuar;

- c) për nga natyra dhe lloji i përshtatën veprimtarisë që ushtron personi i licensuar.

Neni 558

Asnjë pëjashtim nuk jepet për:

- a) mjetet e transportit përveç atyre që përdoren si instrumenta në industrinë prodhuese dhe të shërbimeve.
- b) furnizimet për konsum njëriëzor të çdo lloji;
- c) karburant dhe furnizime të lëndëve të para, produktesh dhe gjysmë produktesh.

Neni 559

1. Makineritë dhe pajisjet që janë përfshirë nga detyrimet e importit, nuk mund të jepen hua, vendosen si garanci, jepen me qira apo tjetësohen, qoftë falas apo kundrejt pagesës, për një periudhë prej 36 muajsh, nga data në të cilën është pranuar vendosja e tyre në qarkullim të lirë, pa lajmëruar me parë autoritetet doganore mbikqyrese të zonës së lirë apo magazines së lirë.

2. Çdo huadhenie, lenie si garanci, dhenie me qira apo tjetësim, të kryera përpara skadimit të afatit të përmendur në paragrafin 1, sjell pagesën e detyrimeve të importit për mallrat në fjalë bazuar në nivelin e zbatueshëm në datën në të cilën u krye dhenia hua, vendosja garanci, dhenia me qira apo tjetësimi, llojin e mallrave dhe vlerën doganore të verifikuar apo pranuar prej autoritetet doganore kompetente që mbikqyrin zonën e lirë dhe magazinën e lirë, në atë datë.

3. Zhvendosja nga zona e lirë ose magazina e lirë, sjell si pasoje pagesën e detyrimeve të importit perkatese për mallrat në fjalë, bazuar në nivelin e zbatueshëm në datën e largimit, llojin e mallrave dhe vlerën doganore të verifikuar apo pranuar prej autoritetet doganore kompetente që mbikqyrin zonën e lirë dhe magazinën e lirë, në atë datë.

S e k s i o n i 25

Dispozita të Fundme

Neni 560

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përcakton udhëzime për zbatimin praktik të procedurave të përfshirimit.

PJESA IV

MALLRA TE RIKTHYERA

TITULLI I

MALLRAT E RIKTHYERA

Neni 561

Në përputhje me pjesën IV, kreu 2 të Kodit, ky titull përcakton dispozitat për zbatimin e procedurave që ndiqet për mallrat e rikthyera.

Neni 562

1. Në përputhje me nenin 200(2) (b) të Kodit, përfshihen nga detyrimet e importit mallrat, që kanë qënë objekt i ndonjë mase lidhur me

eksportimin e tyre në një vend tjetër, me kusht që këto mallra:

- a) nuk ka qënë e mundur vendosja në qarkullim të lire në vendin ku ishin dërguar për shkak të legjislacionit në fuqi në atë vend;
 - b) janë kthyer mbrapsht nga marresi sepse kanë qënë me defekt ose jo në përputhje me kushtet e kontratës që lidhet me to;
 - c) janë riimportuar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, sepse nuk mund të perdoreshin dot për qëllimet e parashikuara, për shkak rrethanash që janë teresisht jashtë kontrollit të eksportuesit.
2. Rrethanat e përmendura në paragrafin 1 (c) përfshijnë:
- a) mallrat janë rikthyer në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë si pasojë e ndonjë demtimie të ndodhur përpara dorëzimit tek marrësi, si të vetë mallrave ashtu edhe të mjeteve të transportit në të cilin ato ishin ngarkuar;
 - b) mallrat të cilat fillimisht ishin eksportuar për t'u konsumuar ose shitur në kuadrin e një panairi tregtar ose një ngjarje të këtij karakteri, por që nuk janë konsumuar apo shitur;
 - c) mallrat të cilat nuk i janë dorëzuar marrësit, për shkak të pamundësisë fizike ose juridike të këtij të fundit për të përmbushur detyrimet e tij, që rrjedhin nga kontrata në bazë të së cilës ishte kryer eksportimi;
 - d) mallrat, të cilat për shkak të crregullimeve natyrore, politike ose shoqërore, nuk ka qënë e mundur t'i dorëzohen marrësit, ose kanë mbërritur tek ky i fundit përtej afatit të detyruar të dorëzimit që parashikohet në kontratën, në bazë të së cilës ishin eksportuar mallrat;
 - e) frutat dhe perimet, e eksportuara dhe dërguara për shitje me *consegna*zion, kur këto fruta dhe perime nuk janë shitur në tregun e vendit të destinacionit.
3. Mallrat të cilave u referohet paragrafi 1, nuk përjashtohen nga detyrimet e importit, përveçse kur janë vendosur në qarkullim të lirë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë brenda 36 muajsh nga data e përmbushjes së formaliteteve doganore lidhur me eksportimin e tyre.

Neni 563

Mallrat e rikthyera përjashtohen nga detyrimet e importit, edhe kur ato përfaqësojnë vetëm një pjesë të mallrave të eksportuara me pare jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Ky parim zbatohet edhe kur mallrat janë pjesë ose aksesore që i perkasin makinerive, instrumentave, aparatave ose produkteve të tjera, të eksportuara

me pare jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 564

1. Duke anashkaluar nenin 201 të Kodit, përjashtohen nga detyrimet e importit mallrat e rikthyera, në njërin nga gjendjet e mëposhtme:

- a) mallra, kur kanë qënë eksportuar jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, nuk kanë përfituar ndonjë trajtim të vecantë përveç atyre që kanë të bëjnë me ruajtjen në gjendje të mirë, ose trajtime që kanë sjellë vetëm ndryshime të paraqitjes;
- b) mallrat, të cilat pasi kanë qënë eksportuar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, kanë përfituar një trajtim të ndryshme nga ato që janë të nevojshme për mirmbajtjen e tyre në klushte të mira, ose trajtime të ndryshme nga ato që i ndryshojnë pamjen, por për të cilat ka prova se janë me defekt ose janë të papershtatshme për që qëllimin përkatës, me kusht që të përmbushet të paktën njëra prej kërkesave të mëposhtme:

i) një trajtimi i tillë është kryer mbi mallrat vetëm për qëllim riparimi ose ruajtjeje në gjendje të mirë,

ii) papërshtatshmeria e tyre për t'u përdorur për qëllimin përkatës, doli në pah vetëm pasi trajtimi kishte filluar.

2. Kur mallrat e rikthyera i janë nënshtruar ndonjë trajtim të lejuar sipas paragrafit 1(b), dhe ky trajtim është i tillë që do t'i kishte bërë ato objekt të detyrimeve të importit, po që se ato do të ishin kthyer nën regjimin e përpunimit pasiv, do të zbatohen të gjitha normat e vendosjes së detyrimeve të importit në fuqi për regjimin në fjalë.

3. Megjithatë, nëse mallrat i janë nënshtruar një operacioni që konsiston në riparimin ose në ruajtjen në gjendje të mirë që bëhet e nevojshme për shkak të një rrethane të paparashikuar, të ndodhur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, dhe që i provohet bindshëm autoriteteve doganore, përjashtimi nga detyrimet e importit do të jepet me kusht që, si pasojë e këtij operacioni, vlera e mallrave të rikthyera të mos jetë më e madhe se vlera e këtyre mallrave në kohën që u eksportuan jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Për qëllim të paragrafit 3:

- a) 'riparim ose ruajtje në gjendje të mirë' do të thotë: cdo veprim për të riparuar defektet e funksionimit ose demtimet materiale, që peson një mall gjatë periudhës në të cilën ndodhet jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, pa të cilin këto mallra nuk mund të perdoren me në mënyrën normale të përdorimit për të cilin ishin synuar;

- b) konsiderohet që vlera e mallrave të rikthyera, si pasojë e operacioneve të pesuara, nuk bëhet me e lartë se vlera që mallrat kishin në castin e eksportimit jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, ne rast se operacioni nuk kapercen kufijtë e domosdoshëm për mallrat që t'i bëjë ato të vazhdojnë të përdoren në kushtet në të cilat gjendeshin në atë kohë. Kur riparimi dhe ruajtja në gjendje të mirë e mallrave ka nevojë për ndërrimin e pjesëve të këmbimit, ky ndërrim duhet të kufizohet në ato pjesë që janë të domosdoshme për t'i bërë këto mallra të përdorshme në të njëjtën mënyrë si në kohën kur ato u eksportuan.

Neni 565

1. Pranohen si mallra të rikthyera:

- a) mallrat për të cilat si dokumenta e mëposhtë duhet të praqiten në mbështetje të deklarates për vendosjen në qarkullim të lirë:
- i) kopja 3 e deklarates se eksportit që i është dhënë eksportuesit nga autoritetet doganore, ose një kopje e kësaj deklarate e vërtetuar nga këto autoritete;
 - ii) nuk kerkohen dokumentat e referuar në nendarjen (i), kur ne baze të provave që disponojnë autoritetet doganore të zyrës së riimportimit ose të dhëna nga personat e interesuar e të verifikuara nga ato atëherë rezultojnë se mallrat e deklaruar për qarkullim të lirë fillimisht ishin eksportuar jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe në atë kohë përmbushnin kushtet për t'u pranuar si mallra të rikthyera.

- b) mallrat e mbuluara nga një *Carnet ATA* i lëshuar në Republikën e Shqipërisë. Këto mallra mund të pranohen si mallra të rikthyera, brenda afateve kohore të caktuara në nenin 200 të Kodit, edhe në rast se afati i vlefshmërisë së *Carnetit ATA* ka skaduar. Në cdo rast duhet të kryhen formalitetet për mbylljen e *Carnetit ATA*.

2. Paragrafi 1(a) nuk zbatohet për qarkullimin nderkombetar të materialeve të ambalazhit, mjeteve të transportit ose mallrave të caktuara, të vendosura nën një regjim doganor të caktuar, kur dispozita autonome ose konvencionale përcaktojnë që për keto rrethana nuk kerkohen dokumenta doganore. Nuk zbatohen keto dispozita edhe në rastet kur mallrat mund të deklarohen për qarkullim të lirë me gojë ose me anë të cdo akti tjetër.

3. Kur e shohin të nevojshme, autoritetet doganore të zyrës doganore të riimportimit mund t'i kërkojnë personit të interesuar të paraqesë prova shtese, vecanerisht persa i përket identifikimit të mallrave të rikthyera.

Neni 566

Me kërkesën e autoriteteve të zyrës doganore të riimportimit, autoritetet e zyrës doganore të eksportimit i njoftojnë të parave gjithë informacionin që disponojnë, për t'i mundësuar ata të përcaktojnë nëse mallrat i përmbushin kushtet e nevojshme për të përfutur nga dispozitat e kësaj pjesë.

Neni 567

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të përcaktojë dispozita për zbatimin praktike të procedurës perkatese për mallrat e rikthyera.

TITULLI II

PRODUKTET E PESHKIMIT DETAR DHE PRODUKTE TE TJERA TE NXJERRA NGA MJETE PESHKIMI SHQIPTARE

Neni 568

Në përputhje me pjesën IV, kreu 3 i Kodit, ky titull përcakton dispozitat për zbatimin e përjashtimit nga detyrimet e importit për produktet e peshkimit detar dhe produkteve të tjera të nxjerra nga deti.

Neni 569

1. Përjashtimi nga detyrimet e importit për produktet të cilave u referohet neni 203(a) i Kodit, mund jepet vetëm nëse këto produkte plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) janë shkarkuar nga mjeti shqiptar i peshkimit i cili kryeu zenien e peshkut;
- b) janë përpunuar në bordin e një anije shqiptare fabrikë dhe peshkimi është bërë

nga një anije shqiptare peshkimi.

2. Për produktet për t'u vendosur në qarkullim të lirë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, kapiteni i mjetit të lundrimit shqiptar që ka bërë peshkimin, duhet të bëjë vërtetimin e të dhënave të vecanta të gjetisë. Nëse gjahu është përpunuar në bord, kapiteni i mjetit duhet gjithashtu të deklarojë edhe se cili mjet lundruar ka zënë gjahun.

3. Për qëllim të paragrafit 1 dhe 2:

- a) '*mjet peshkimi shqiptar*' do të thotë: një mjet i regjistruar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që mban flamur shqiptar, gjuan produkte deti dhe nëse është rasti, i përpunon ato në bord;
- b) '*anije fabrike shqiptare*' do të thotë: një mjet

lundrimi i regjistruar ne territorin doganor te Republikës së Shqipërisë dhe që mban flamur shqiptar, e cila nuk gjuan e produkte detit, por vetem i përpunon keto produkte ne bord.

4. Në mënyrë që të sigurohet respektimi i dispozitave të paragrafëve nga 1 deri 3, autoritetet doganore mund të kryejnë cdo kontroll që gjykojnë të nevojshëm për të siguruar që infomacioni i dhënë

është i saktë.

Neni 570

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të përcaktojë udhëzime për zbatimin në praktike të përjashtimit nga detyrimet e importit të produkteve peshkimit detar dhe produkte të tjera të marra nga deti.

PJESA V

BORXHI DOGANOR

TITULL I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Për qëllim të nenit 571 deri 613¹⁴:

- a) "Zyrë doganore e kontabilizimit" do të thotë: zyra doganore në të cilën kontabilizohen detyrimet e importit ose eksportit, për të cilat kërkohet rimbursimi ose shuarja e tyre;
- b) "Autoritet doganor vendimarrës" do të thotë: autoritetet doganore kompetente për të vendosur rimbursimin ose shuarjen e detyrimeve të importit ose eksportit;
- c) "Zyrë doganore mbikqyrëse" do të thotë: zyra doganore nën juridiksionin e së cilës gjenden edhe mallrat, për kontabilizimin e detyrimeve doganore të importit ose eksportit për të cilat kërkohet rimbursim ose shuarje, zyrë kjo që kryen kontrollin e nevojshme për vlerësimin e kërkesës;
- d) "Zyrë doganore zbatuese" do të thotë: zyra doganore që zbaton masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e rregullt të vendimit për rimbursimin ose shuarjen e detyrimeve të importit ose eksportit.

Neni 571

Në përputhje me pjesën VII të Kodit, kjo pjesë përcakton dispozitat për zbatimin në praktikë të procedurave që ndiqen për borxhin doganor.

GARANCIA

Neni 572

1. Llojet e garancisë, të ndryshme nga depozita në të holla dhe dorëzania, në kuptimin që japin nenet 208, 209, dhe 210 të Kodit, si dhe vetë depozita në të holla ose dhënia e garancive, të cilat mund të pranohen nga autoritetet doganore, edhe në rast se nuk përmbushen kushtet e parashikuara në nenin 209(1) të Kodit, janë si vijon:

- a) vendosja e një hipoteke, qoftë edhe hipotekë mbi tokën, një peng ose një të drejtë tjetër të barazvlefshme mbi pasurinë e paluajtshme;

- b) heqja dorë nga një e drejtë, lënia peng, me kalim të nëdorësisë ose jo, si dhe pengu mbi mallra, tituj ose të drejta, veçanërisht mbi një depozitë kursimi;
- c) marrja përsipër e përgjegjësisë kontraktore kolektive për të gjithë shumën e borxhit, nga një palë e tretë e miratuar për këtë qëllim nga autoritetet doganore dhe, veçanërisht, depozitimi i një kambiali, pagesa e të cilit garantohej nga pala e tretë në fjale;
- d) një depozite në të holla ose garanci me vlerë të barabartë me këtë depozitë, në një monedhë të ndryshme nga leku shqiptar;
- e) pjesëmarrja, kundrejt pagesës se një kontributi, në një skemë garancie të përgjithshme të administruar nga autoritetet doganore.

2. Rrethanat dhe kushtet sipas të cilave përdoren llojet e ndryshme të garancisë të përmendura në paragrafin 1 përcaktohen nga autoritetet doganore.

Neni 573

Kur dhënia e një garancie bëhet nëpërmjet depozitës bankare, asnjë interes nuk do të paguhet nga autoritetet doganore mbi shumën përkatëse të garancisë.

¹⁴ Shiko nenin 2(13). Ky tekst është rishikuar këtu për lehtësi përdorimi të termave të përkufizuar.

TITULLI II

LINDJA E BORXHIT DOGANOR

KREU 1

Parregullsi e nuk sjellin pasoja në funksionimin e magazinimit të përkohshëm ose të një regjimi doganor

Neni 574

1. Për qëllim të nenit 219(1) të Kodit, quhet se nuk kanë asnjë pasojë në funksionimin e rregullt të magazinimit të përkohshëm ose të një regjimi doganor parregullsitë e renditura në paragrafin 2, me kusht që:

- a) te mos përbëjnë në vetvete një përpjekje për të shmangur në mënyrë të paligjshme mallrat nga mbikqyrja doganore,
- b) të mos kenë të bëjnë me një neglizhencë të dukshme nga personi i interesuar, dhe
- c) te gjithë formalitetet e nevojshme për të rregulluar gjendjen e mallrave të jenë kryer me vonë.

2. Parregullsitë të cilave i referohet 1 janë si vijon:

- a) kapërcimi i afatit brenda të cilit mallrave duhet t'u ishte caktuar një nga destinacionet doganore të parashikuara në kuadrin e magazinimit të përkohshëm ose të regjimit përkatës, në rast se ky afat në qoftë se do të ishte kërkuar në kohe, do të ishte zgjatuar;
- b) kapërcimi i afatit të vendosur për paraqitje pranë zyrës së destinacionit, në rastin e mallrave të vendosura nën regjimin e tranzitit, kur kjo paraqitje bëhet në një datë të mëvonshme;
- c) manipulimet e kryera pa autorizim paraprak nga autoritetet doganore, në rastin e mallrave të vendosura në magazinim të përkohshëm, ose nën regjimin e magazinimit doganor, kur manipulime të tilla, nëse do të ishte bërë kërkesë, do të ishin autorizuar;
- d) përdorimi i mallrave në kushte të ndryshme nga ato që parashikohen në autorizim, në rastin e mallrave të vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm, kur ky përdorim për të njëjtin regjim, nëse do të ishte kërkuar, do të ishte autorizuar;
- e) lëvizja e paautorizuar e mallrave, në rastin e mallrave të vendosura në magazinim të përkohshëm ose nën një regjim doganor, me kusht që këto mallra të mund t'i paraqiten autoriteteve doganore me kërkesën e këtyre të fundit;
- f) dalja e mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ose hyrja në një zonë të lire ose magazine të lirë pa përmbytjen e formaliteteve të nevojshme,

në rastin e mallrave në magazinim të përkohshëm ose të vendosura nën një regjim doganor.;

- g) ekzistenca e njëres prej situatave të përmendura në nenin 219(1) (a) ose (b) të Kodit, në rastin e mallrave që përfitojnë përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit të përmendura sipas nenit 165 të Kodit, për shkak të vendosjes në qarkullim të lire, ndërkohë që mallrat në fjale, përpara vendosjes në qarkullim të lire, janë në magazinim të përkohshëm ose nën një regjim tjetër doganor;
- h) mosparaqitja e kërkesës për rinovimin e autorizimit përkatës, në rastin e operacioneve të përpunimit aktiv të kryer në mënyrë të vazhdueshme, edhe në qoftë se janë përmbytshur kushtet për lëshimin e këtij autorizimi.

Neni 575

Autoritetet doganore konsiderojnë gjithmonë se ka lindur një borxh doganor sipas nenit 219(1) të Kodit, përjashtuar rastet që personi që konsiderohet si debitor është në gjendje të vërtetë të përmbytshjen e kushteve të nenit 574.

Neni 576

Fakti që parregullsitë nuk sjellin lindjen e borxhit doganor, nuk përjashton zbatimin e dispozitave penale në fuqi, ose dispozitave që lejojnë anulimin ose shuarjen e autorizimit të lëshuar nën regjimin doganor në fjale.

KREU 2

Humbjet natyrore

Neni 577

1. Për qëllim të nenit 221 të Kodit, me kërkesën e të interesuarit, autoritetet doganore marrin parasysh sasi të që mungojnë, kur është në gjendje të provohet që humbjet e vërejtura, kanë ndodhur vetëm për shkak të vetë natyrës së mallrave, dhe nuk rrjedhin nga neglizhenca ose mashtrimi nga ana e të interesuarit.

2. Në mënyrë të veçantë, me neglizhencë ose mashtrim kuptohet, çdo parregullsi në lidhje me zbatimin e rregullave mbi transportin, magazinimin, manipulimin, ose punimin e përpunimin e mallrave në fjale, rregulla këto, të vendosura nga autoritetet doganore ose që normalisht zbatohen.

KREU 3

*Mallra në situata të veçanta**Neni 578*

Quhet shmangie e mallrave nga mbikqyrja doganore, në kuptimin e nenit 218(1) të Kodit, paraqitja e deklaratës doganore për mallrat në fjale, ose çdo akt tjetër me të njëjtat efekte juridike, si dhe paraqitja e çfarëdo dokumenti për konfirmim autoriteteve kompetente, kur një veprim i tillë sjell si pasojë njohjen gabimisht të statusit shqiptar për këto mallra.

Neni 579

Pa rene ndesh me dispozitat e parashikuara për ndalimet ose kufizimet që mund të zbatohen për mallrat në fjale, kur lind një borxh doganor në import në baze të nenit 217, 218, 219 dhe 220 të Kodit, dhe detyrimet e importit janë paguar, këto mallra quhen se janë mallra shqiptare, pa qënë nevoja të deklarohen për vendosje në qarkullim të lire.

Neni 580

Konfiskimi i mallrave në baze të nenit 246 (c) dhe

(d) të Kodit, nuk cënon statusin doganor të mallrave në fjale.

Neni 581

1. Mallrat jo shqiptare të cilat janë braktisur dhe kanë kaluar në favor të shtetit, ose sekuestruar apo konfiskuar, quhet se janë vendosur nën regjimin e magazinimit doganor.

2. Mallrat të cilave u referohet paragrafi 1, mund të shiten vetëm nga autoritetet doganore, me kusht që blerësi të kryejë menjëherë formalitetet për vendosjen e tyre në një destinacion doganor. Kur çmimi i shitjes përfshin edhe detyrimet e importit, shitja quhet e barazvlefshme me vendosjen në qarkullim të lire, dhe vetë autoritetet doganore përllogarisin detyrimet e importit dhe i shënojnë ato në librat e kontabilitetit. Në këto raste, shitja bëhet në përputhje me procedurat në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Kur administrata doganore për mallrat të cilave u referohet paragrafi 1, vendos të marre masa të ndryshme nga shitja, duhet të kryejë menjëherë formalitetet për t'i caktuar këtyre mallrave njërin prej destinacioneve doganore të parashikuara në nenin 8(15) (a), (b), (c) dhe (d) të Kodit.

TITULLI III

VJELJA E SHUMES SE BORXHIT DOGANOR

Neni 582

Nuk kryhet vjelje e detyrimeve të importit ose eksportit pas plotësimit të formaliteteve doganore kur shuma për çdo veprim vjeljeje është me e ulët se 1 500 lekë.

Neni 583

Autoritetet doganore mund të vendosin të mos regjistrojnë në librat kontabël detyrimet e importit që nuk janë vjelë:

- a) kur trajtimi tarifor preferencial është zbatuar në kuadrin e një kontigjenti tarifor, tavani tarifor ose të ndonjë rregullimi tjetër, ndërkohë që kushtet për përfitimin e një trajtimi të tillë kishin pushuar së vepruari në çastin e pranimit të deklaratës doganore, pa u publikuar para vendosjes në qarkullim të lire të këtyre mallrave, ose kur ky fakt nuk është publikuar por është bërë i njohur në një mënyrë të përshtatshme në Republikën e Shqipërisë, dhe personi përgjegjës për pagesën ka vepruar në mirëbesim dhe ka respektuar të gjithë dispozitat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi lidhur me deklaratën doganore;
- b) këto autoritete gjykojnë që kushtet e parashikuara në nenin 235(2) (b) të Kodit janë përmbushur, me kusht që shuma që nuk është vjelë nga operatori lidhur me një ose me shumë operacione importi ose eksporti, por si pasojë e një gabimi të

vetëm, të jete me e ulët sesa 300 000 lekë.

Neni 584

1. Autoritetet doganore pezullojnë detyrimin e një debitori për të paguar detyrimet deri sa ato të kenë marrë një vendim, në baze të një kërkesë siç përshkruhet në nënparagrafet nga (a) deri në (c) me poshtë, me kusht që, kur mallrat nuk ndodhen nën mbikqyrjen doganore, për shumën e këtyre detyrimeve është depozituar një garanci, dhe:

- a) kur është depozituar një kërkesë për zhvlefësim deklarate, mund të pranohet një e kërkesë e tillë;
- b) në rastet kur paraqitet një kërkesë për shuarje të detyrimeve, në baze të nenit 249 në lidhje me nenin 235(2)(b) të Kodit, ose kur një deklarate është bërë e pavlefshme pasi mallrat janë çliruar, ose kur autoritetet doganore shesin mallrat, autoritetet doganore gjykojnë se kushtet e përcaktuara në dispozitat përkatëse mund të konsiderohen të përmbushura;
- c) në raste të ndryshme nga ato të cilave u referohet paragrafi (b), është paraqitur një kërkesë për shuarje të detyrimeve në baze të nenit 249 të Kodit, dhe janë përmbushur kushtet e mëposhtme:
 - i) kur autoritetet doganore kanë arsye të forta të besojnë që vendimi në fjale nuk përputhet me legjislacionin doganor; ose

- ii) që personit të interesuar mund ti shkaktohet një dëm të pariparueshëm.

Nuk kërkohet garanci, kur një kërkesë e tillë, në rrethanat e debitorit, ka të ngjarë të shkaktojë vështirësi serioze sociale ose ekonomike.

2. Në rastet kur mallrat që ndodhen në ndonjërin prej rrethanave të referuara në nenin 246(c) ose në 246(d) të Kodit sekuestrohen, autoritetet doganore pezullojnë detyrimin për të paguar detyrimet e importit nëse gjykojnë që kushtet për konfiskimin quhen të përmbushura.

TITULLI IV

RIMBURSIMI OSE SHUARJA E DETYRIMEVE TË IMPORTIT OSE TË EKSPORTIT

KREU I

Dispozita për zbatimin e neneve nga 249 deri 252 të Kodit.

Seksioni 1

Kërkesat

Neni 585

1. Kërkesa për rimbursim ose shuarjen e detyrimeve të importit ose të eksportit, që tani e mëbrapa quhen shkurt 'kërkesa për rimbursim ose shuarje', bëhet nga vetë personi që ka paguar këto detyrime ose duhet t'i paguajë, ose nga personat të cilëve u kanë kaluar të drejtat dhe detyrimet e këtij personi. Kërkesat për rimbursim ose shuarje mund të bëhen edhe nga një përfaqësues i personit të cilit

i referohet fjalia e parë.

2. Pa rene ndesh me dispozitat mbi mallrat e eksportit mbi bazën e të cilave detyrimet e eksportit janë vendosur në çastin e eksportimit jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave përkatëse, kërkesa për rimbursimin ose shuarjen duhet të bëhet në një origjinal dhe në një kopje të formularit të përcaktuar sipas modelit të Aneksit 57. Megjithatë, kërkesa për rimbursim ose shuarje, me kërkesën e personit ose personave të përmendur në paragrafin 1, mund të bëhet edhe në letër të thjeshtë, me kusht që të përmbajë të gjithë informacionin e përmendura në Aneksin në fjale.

Neni 586

1. Kërkesa për rimbursim ose shuarje të detyrimeve, e shoqëruar nga dokumentat të cilave u referohet neni 18(1) i Kodit, depozitohet në zyrën doganore të kontabilizimit; kjo e fundit ia transmeton atë menjëherë pas pranimit autoriteteve doganore vendimore, nëse vetë zyra e parë nuk është autorizuar të jetë e tillë.

2. Zyra doganore të cilës i referohet paragrafi 1, mbi fletën origjinale dhe mbi kopjen e kërkesës shënon datën e marrjes në dorëzim. Kopja i kthehet kërkuarit. Kur kërkesa bëhet në letër të thjeshtë, zyra doganore në fjale i jep një vërtetim me shkrim kërkuarit për marrjen e kërkesës.

3. Në rastin kur autoritetet doganore kanë siguruar pagimin e një borxhi doganor në përputhje me nenin 245 të Kodit, autoritetet doganore do të konsiderojnë se detyrimi i debitorit për të paguar detyrimet përkatëse të importit është plotësuar nëse shuma e garantuar e mbulon borxhin doganor. Nëse shuma e garantuar mbulon vetëm një pjesë të borxhit doganor, autoritetet doganore do të konsiderojnë se detyrimi i debitorit për të paguar detyrimet është plotësuar vetëm për atë pjesë të borxhit që mbulohet nga garan

Neni 587

Kërkesa lidhur me mallra për të cilat është lëshuar licencë importi ose eksporti përpara depozitimit të deklaratës doganore përkatëse, duhet të shoqërohet edhe me një vërtetim të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse për lëshimin e kësaj licence, me anën e të cilit dëshmohet që janë marrë gjithë masat e nevojshme për të fshirë, kur është rasti, pasojat e licencës në fjalë. Megjithatë, ky vërtetim nuk kërkohet kur:

- nga njëra anë, kur autoritetet doganore pranë të cilave depozitohet kërkesa, është ngarkuar të lëshojë licencën në fjalë;
- nga ana tjetër, kur arsyet mbi bazën e të cilave u bë kërkesa kanë të bëjnë me një gabim material që nuk çënon dhënien e një licence të tillë.

Neni 588

1. Zyra doganore kontabilizuese mund të pranojë një kërkesë që nuk përmban të gjithë informacionin e parashikuar në formularin e Aneksit 57. Megjithatë, kjo kërkesë duhet të përmbajë të paktën informacionin që vendoset në kutitë 1; 2; 3 dhe 7.

2. Kur zbatohet paragrafi 1, zyra doganore në fjale cakton afatin brenda të cilit duhet të paraqiten i gjithë informacioni që dhe/ose dokumentat që mungojnë.

3. Kur nuk respektohet afati kohor i vendosur nga zyra doganore, në përputhje me paragrafin 2, kërkesa quhet e tërhequr. Për këtë njoftohet menjëherë kërkuari.

Neni 589

1. Për mallrat e rikthyera të cilat i janë nënshtruar detyrimeve të eksportit në kohën e eksportimit të tyre nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, rimbursimi ose shuarja e këtyre detyrimeve i nënshtrohet paraqitjes pranë autoriteteve doganore të një kërkesë të shoqëruar nga:

- dokumenti i lëshuar si prove pagese, kur shumat e detyrime në fjale janë vjelë;
- origjinali, ose kopja e deklaratës për vendosje

në qarkullim të lire lidhur me mallrat e kthjera, vërtetuar nga zyra doganore e riimportimit. Ky dokument duhet të mbajë konfirmimi e bërë nga autoritetet doganore të riimportimit: "Mallra të lejuara si mallra të rikthjera sipas nenit 200(2) (b) të Kodit" me bojë të kuqe;

- c) kopje të deklaratës së eksportit që i është dhënë eksportuesit në kohën kur formalitetet doganore lidhur me mallrat janë plotësuar, ose një kopje të deklaratës në fjalë të vërtetuar nga zyra doganore e eksportimit;

Kur autoritetet doganore vendimore disponojnë të dhëna të veçanta që gjenden në një ose me shume deklarata nga ato të cilave u referohen (a), (b) ose (c) me sipër, nuk depozitohet ndonjë deklaratë nga ato në fjalë.

2. Kërkesa të cilës i referohet paragrafi 1 mund të depozitohet në zyrën doganore kontabilizuese brenda 12 muajsh nga dita e pranimit të deklaratës së eksportit.

Seksi i 2

Procedura për dhënie rimbursimi ose shuarje e detyrimeve

Neni 590

1. Autoritetet doganore vendimore mund të autorizojnë kryerjen e formaliteteve doganore të cilat mund ti nënshtrohen rimbursimit ose shuarjes së detyrimeve, përpara dhënies së vendimit për rimbursim ose shuarje. Ky autorizim bëhet pa rene ndesh me vendimin përkatës mbi kërkesën.

2. Pa rene ndesh me paragrafin 1, dhe derisa të merret vendim mbi kërkesën për rimbursim ose shuarje, mallrat lidhur me të cilat është kërkuar rimbursim ose shuarje detyrimesh doganore nuk transferohen në një vend të ndryshëm nga vendi i treguar në kërkesë, përveç rastit kur kërkuesi njofton zyrën doganore të kontabilizimit paraprakisht, dhe kjo e fundit njofton autoritetet doganore vendimore.

Neni 591

Kur kërkesa për rimbursim ose shuarje lidhet me një rast në të cilin duhet marre informacion shtesë, ose duhet të kryhet kontrolli i mallrave, për të siguruar që janë plotësuar kushtet e parashikuara në Kod dhe në këtë Titull përse i përket rimbursimit ose shuarjes, autoritetet doganore vendimore marrin masat e nevojshme për këtë qëllim, nëse është e nevojshme edhe duke kërkuar ndihmën e zyrës doganore mbikqyrëse, duke specifikuar natyrën e informacionit që duhet marre ose të kontroleve që duhen kryer. Zyra doganore mbikqyrëse i përgjigjen menjëherë kësaj kërkesë dhe ja dërgon informacionin e mbledhur dhe rezultatet e kontroleve të kryera, brenda 30 ditësh autoriteteve doganore vendimore.

Neni 592

1. Kur autoritetet doganore vendimore disponojnë të gjithë të dhënat e nevojshme, lëshojnë një vendim me shkrim lidhur me kërkesën për rimbursim ose shuarje detyrimesh, në përputhje me nenin 18(2) dhe (3) të Kodit.

2. Kur miratohet kërkesa, vendimi përfshin gjithë të dhënat e veçanta që nevojiten për ekzekutimin e tij. Në varësi të rrethanave, në vendim duhet të figurojnë disa ose të gjithë të dhënat e përshkruara si më poshtë:

- te dhënat e nevojshme për të identifikuar mallrat për të cilat ai vendim zbatohet;
- arsyet mbi të cilat bazohet rimbursimi ose shuarja e detyrimeve të importit ose eksportit dhe neni përkatës i Kodit të cilit i korrespondon, dhe kur është rasti, nenin korrespondues të këtij Titulli;
- përdorimin ose destinacionin që i caktohet mallrave, në baze të dispozitave të Kodit për rastin në fjalë, dhe në varësi të rrethanave, mbi baze e një autorizimi të veçantë nga autoritetet doganore vendimore;
- afatin brenda të cilit duhet të plotësohen formalitetet lidhur me rimbursimin ose shuarjen e detyrimeve të importit ose eksportit;
- një angazhim që tregon që nuk do të rimbursohen ose shuhet detyrimet e importit ose eksportit, derisa zyra doganore ekzekutuese të ketë njoftuar autoritetet doganore vendimore përse i përket plotësimit të formaliteteve të cilave u nënshtrohet rimbursimi ose shuarja e detyrimeve;
- hollësira mbi kërkesat të cilave mallrat u nënshtrohen në pritje të ekzekutimit të vendimit;
- një lajmërim që njofton përfituesin që ai, kur paraqiten mallrat, duhet tja japë origjinalin e vendimit zyres doganore ekzekutuese të zgjedhur prej tij.

Neni 593

1. Zyra doganore ekzekutuese merr të gjitha masat për të siguruar që:

- janë përmbushur, sipas rastit, të gjitha kushtet e përcaktuara në vendimin për miratimin e rimbursimit ose shuarjes së detyrimeve;
- që në të gjitha rastet, mallrat janë përdorur ose u është dhënë destinacioni i parashikuar në vendimin për rimbursimin ose shuarjen e detyrimeve të importit ose eksportit.

2. Kur në vendim parashikohet mundësia e vendosjes së mallrave në një magazine doganore,

zone të lire ose magazine të lire, dhe përfituesi e përdor këtë mundësi, formalitetet e nevojshme duhet të plotësohen në zyrën doganore ekzekutuese.

3. Kur zyra doganore ekzekutuese bindet se kushtet e parashikuara në paragrafin 1 janë përmbushur, i dërgon autoriteteve doganore vendimore një vërtetim që dëshmon përmbushjen e kushteve të përcaktuara në vendim.

Neni 594

Autoritetet doganore vendimore, pasi miratojnë kërkesën për rimbursim ose shuarje të detyrimeve, kryen rimbursimin ose shuarjen e këtyre detyrimeve vetëm pasi merr vërtetimin nga zyra doganore ekzekutuese.

Neni 595

Kur kërkesa për rimbursimin ose shuarjen e detyrimeve bazohet në ekzistencën, në ditën e pranimi të deklarates për vendosje në qarkullim të lire të mallrave, të një tarifë të reduktuar ose zero të detyrimeve të importit që zbatohen në kuadrin e një kontingjenti tarifor preferencial, të një tavanit tarifor ose rregullimi tjetër preferencial, rimbursimi ose shuarja e detyrimeve jepet me kusht që, në ditën e depozitimit të kërkesës për rimbursim ose shuarje detyrimesh, e shoqëruar kjo nga dokumentat e nevojshëm:

- a) ne rastin e kontingjentit tarifor, vëllimi i tij nuk është plotësuar;
- b) ne rastet e tjera, shuma e detyrimeve për t'u paguar nuk është vendosur, në qoftë se kushtet e përcaktuara në paragrafin e mësipërm nuk janë plotësuar, rimbursimi kryhet megjithatë kur mos zbatimi i pagesës së reduktuar ose zero ishte rezultat gabimi nga ana e vetë autoriteteve doganore, dhe deklarata për vendosje në qarkullim të lire përmbante të gjithë të dhënat e veçanta dhe shoqërohej nga gjithë dokumentat e nevojshëm për zbatimin e nivelit të reduktuar ose zero.

Neni 596

Kur në mbështetje të kërkesës për rimbursim ose shuarje detyrimesh doganore është paraqitur një certifikate origjine, vërtetim qarkullimi, ose çdo dokument tjetër përkatës, i cili vërteton që mallrat e importuara, në çastin e pranimi të deklarates për vendosje në qarkullim të lire mund të kishin përfituar trajtim tarifor preferencial, autoritetet doganore vendimore pranon kërkesën në fjalë me kusht që të përcaktohet saktësisht që:

- a) dokumenti i lëshuar i referohet posaçërisht mallrave në fjalë dhe që janë përmbushur gjithë kushtet përkatëse për pranimin e këtij dokumenti;
- b) janë përmbushur gjithë kushtet e tjera për dhënien e trajtimit tarifor preferencial. Rimbursimi ose shuarja e detyrimeve doganore bëhet kundrejt paraqitjes së

mallrave. Kur mallrat nuk mund të paraqiten në zyrën doganore ekzekutuese, kjo e fundit bie dakord të japë rimbursimin ose shuarjen e detyrimeve doganore vetëm në rast se disponon të dhëna që tregojnë qartë që certifikata ose dokumenti i lëshuar a posteriori u referohet mallrave në fjalë.

Neni 597

Detyrimet e importit nuk rimbursohen ose shuhen sipas nenit 251 të Kodit kur:

- a) natyra defektive e mallrave ishte marrë në konsideratë gjatë caktimit të kushteve të kontratës, veçanërisht të çmimit, kushte sipas të cilave mallrat ishin vendosur nën një regjim doganor që nënkupton në vetvete detyrimin për të paguar detyrimet e importit;
- b) mallrat janë shitur nga importuesi pasi është vërtetuar se ato kanë defekte ose mospërputhja me kushtet e kontratës.

Neni 598

1. Pa rënë ndesh me nenin 604(1)(c), autoritetet doganore vendimore, për përmbushjen e formaliteteve doganore të cilave u nënshtrohet rimbursimi ose shuarja e detyrimeve doganore, caktojnë një afat deri në 2 muaj, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit mbi rimbursimin ose shuarjen e detyrimeve doganore të importit ose eksportit.

2. Mosrespektimi i afatit kohor të përmendur në paragrafin 1, shkakton humbjen e të drejtës për rimbursim ose shuarje të detyrimeve doganore, me përjashtim të rastit kur personi që përfiton nga vendimi provon se ishte penguar në respektimin e një afati të tillë për shkak rrethanash të paparashikueshme ose force madhore.

Neni 599

Kur nga shkatërrimi i mallrave, që autorizohet nga autoritetet doganore vendimarrëse, përftohen mbetje dhe hedhurina, këto të hekurishte dhe mbetje quhen mallra jo shqiptare, sapo merret vendim për pranimin e kërkesës për rimbursim ose shuarje të detyrimeve doganore.

Neni 600

Kur jepet autorizimi të cilit i referohet neni 251(2)(b) i Kodit, autoritetet doganore marrin gjithë masat e nevojshme për të siguruar që mallrat e vendosura në një magazinë doganore, zonë të lirë ose magazinë të lirë, në vijim mund të njihen si mallra jo shqiptare.

Neni 601

Kur jo i gjithë artikulli por vetëm një ose më shumë pjesë përbërës të tij eksportohen, rieksportohen ose shkatërrohen apo u caktohet një tjetër destinacion doganor i lejuar, shuma e detyrimeve të importit që rimbursohet ose shuhet përbëhet nga diferenca mes shumës së detyrimeve të importit për gjithë artikullin dhe shumës së detyrimeve të importit për t'u paguar për pjesën e materialit që mbetet, nëse

ky i fundit do të ishte vendosur në gjendje të pandryshuar nën një regjim doganor që sjell detyrimin për të paguar këto detyrime importi në datën në të cilën ky material është vendosur nën regjimin doganor në fjalë.

Neni 602

Shuma e referuar në nenin 253 të Kodit caktohet në masën 1 500 Lekë.

KREU 3

Dispozita të veçanta mbi zbatimin e nenit 252 të Kodit

Neni 603

Pa rënë ndesh me situata të tjera që vlerësohen rast pas rasti nga Ministri i Financave, kur autoritetet doganore vendimore konstatojnë që një kërkesë për rimbursim ose shuarje të detyrimeve doganore, e depozituar sipas nenit 252(2) të Kodit:

- a) bazohet mbi shkaqë të cilat i korrespondojnë ndonjëres prej situatave të neneve 604 dhe 607, dhe këto situata nuk janë shkaktuar prej mashtrimit ose prej neglizhencës së hapur të personit të interesuar, japin rimbursimin ose shuarjen e detyrimeve të importit në fjalë. Me 'të interesuar' kuptojmë personin ose personat të cilëve u referohet neni 16(1), ose përfaqësuesit e tyre, dhe çdo person tjetër që ka marrë pjesë në përmbushjen e formaliteteve doganore për mallrat në fjalë ose dha udhëzimet e nevojshme për plotësimin e këtyre formaliteteve;
- b) bazohet mbi shkaqë të cilat i korrespondojnë ndonjëres prej rrethanave të cilave u referohet neni 608, nuk rimbursojnë ose shuajnë detyrimet përkatëse të importit.

Neni 604

1. Detyrimet e importit rimbursohen ose hiqen kur:

- a) mallrat jo shqiptare, të vendosura nën një regjim doganor që sjell përjashtimin e plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit, janë vjedhur me kusht që mallrat të jenë rigjetur brenda një kohe të shkurtër dhe rivendosur në statusin e tyre doganor fillestar, në gjendjen që ishin kur u vodhën;
- b) mallrat jo shqiptare pa njoftim janë çliruar nga një regjim doganor që sjell përjashtimin e plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit të cilave u nënshtroheshin, me kusht që sapo të jetë konstatuar gabimi, mallrat vendosen menjëherë në statusin doganor në gjendjen në të cilën ishin vendosur fillimisht;
- c) mallrat që fillimisht janë vendosur në qarkullim të lirë, dhe më tej i janë kthyer furnizuesit jo shqiptar, nën regjimin e

përpunimit pasiv, për ta mundësuar atë, pa pagesë, të eliminojë defektet që ekzistojnë përpara çlirimit të mallrave (edhe nëse këto janë konstatuar pas çlirimit të mallrave), ose t'i sjellë atë në një gjendje që përputhet me kushtet e kontratës sipas së cilës ato ishin vendosur në qarkullim të lirë, dhe furnizuesi në fjalë vendos t'i mbajë mallrat përgjithmonë, për arsye se nuk ka mundësi të riparojë defektet ose për arsye se një riparim i tillë nuk është i justifikueshëm nga këndvështrimi ekonomik;

- d) autoritetet gjyqësore kanë ndaluar tregtimin e një artikulli që fillimisht ishte vendosur nën një regjim doganor që detyronte personin e interesuar të paguante detyrimet e importit në kushtet e zakonshme dhe më pas artikulli në fjalë është rieksportuar jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ose shkatërruar nën kontrollin e autoriteteve doganore, me kusht që të vërtetohet që artikulli në fjalë nuk është përdorur në fakt në Republikën e Shqipërisë;
- e) mallrat, të dërguara me një korier të veçantë, kanë qënë vendosur në një regjim doganor që shoqërohet me pagimin e detyrimeve nga një deklarues i autorizuar ta bëjë këtë me iniciativën e tij dhe që jo për faj të tij nuk ka qënë e mundur të dorëzohen mallrat tek marrësi.
- f) mallrat i janë dërguar marrësit gabimisht nga dërguesi;
- g) mallrat janë konstatuar të papërshtatshme për përdorimin e synuar nga marrësi, për shkak të një gabimi të dukshëm të hartimit të porosisë;
- h) pasi janë çliruar për një regjim doganor që shoqërohet nga detyrimi për të paguar detyrimet e importit, mallrat, në kohën e çlirimit konstatohen se janë të papërshtatshme me ligjet në fuqi lidhur me përdorimin e tyre ose tregtimin, për këto arsye nuk mund të përdoren për qëllimin e synuar nga marrësi;
- i) përdorimi i mallrave nga marrësi për qëllimin e synuar prej tij, është i pamundur ose kufizuar dukshëm për shkak të masave me karakter të përgjithshëm të marra nga një autoritet ose organ me fuqinë e duhur vendimore, pas datës në të cilën mallrat janë vendosur në regjimin doganor që shoqërohet nga detyrimi për të paguar detyrimet e importit ;
- j) përjashtimi i plotë ose i pjesshëm nga detyrimet e importit, kërkuar nga i interesuari në bazë të normave në fuqi, për shkaqë të pavarura nga ky person, nuk mund të jepet nga autoritetet doganore, për shkak të kuotave tarifore, tavaneve tarifore, ose masave antidumping, dhe autoritetet doganore, sipas rastit, bëjnë kontabilizimin

e detyrimeve të importit që duhen paguar;

- k) mallrat kanë mbërritur tek marrësi përtej afateve të dorëzimit të përcaktuara në kontratë, sipas së cilës mallrat janë vendosur nën regjimin doganor që shoqërohet nga detyrimi për të paguar detyrimet e importit;
- l) nuk ka qënë e mundur që mallrat të shiten në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe i janë dhënë falas organizatave bamirëse ndërkombëtare që:
 - ushtrojnë aktivitetin e tyre në një vend tjetër, me kusht që këto organizata të kenë përfaqësues në Republikën e Shqipërisë,
 - ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që ato të plotësojnë kushtet për të përfituar përjashtim nga detyrimet doganor në rastet e importimit për qarkullim të lirë të mallrave të ngjashme nga vende të tjera;
- m) borxhi doganor ka lindur në kushte të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 216 të Kodit, dhe i interesuari është në gjendje të paraqesë certifikatë origjine, vërtetim qarkullimi (EUR 1 dhe certifikata të ngjashme) ose dokumente të tjera përkatës, që dëshmojnë që në qoftë se mallrat e importit do të ishin vendosur në qarkullim të lirë, do të kishin përfituar nga trajtimi tarifor preferencial, me kusht që edhe kërkesat e tjera të parashikuara në nenin 595 të jenë plotësuar.

2. Pa rënë ndesh me paragrafin 3, rimbursimi ose shuarja e detyrimeve të importit në rastet e referuara në paragrafet 1(d) deri (l), me përjashtim të rasteve kur mallrat janë shkatërruar me urdhër të autoriteteve të publike, ose i janë dërguar falas enteve bamirëse që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, kryhet vetëm kundrejt rieksporimit të tyre nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë nën mbikqyrjen e autoriteteve doganore. Kundrejt kërkesës, autoritetet doganore vendimore lejojnë që rieksporimi i mallrave të zëvendësohet nga shkatërrimi i tyre ose me qëllim që të rieksporohen, të vendosen nën regjimin e tranzitit, nën regjimin e magazinimit doganor, ose në zonë të lirë apo magazinë të lirë. Megjithatë, lidhur me rastet e referuara në paragrafin 1(e) (g) dhe (j), autoritetet doganore vendimore, kundrejt kërkesës, mund të lejojnë që në vend të rieksporimit, mallrat të vendosen nën magazinim doganor, ose në një zonë të lirë apo magazinë të lirë. Mallrat që duhet të vendosen nën njërin prej këtyre destinacioneve quhen mallra jo shqiptare. Në këtë rast, autoritetet doganore marrin gjithë masat e nevojshme për t'u siguruar që mallrat e vendosura në një magazinë doganore, në një zonë të lirë ose magazinë të lirë, mund të njihen në vijim si mallra jo shqiptare.

3. Në rastet të cilave u referohet paragrafi 1(f),

rimbursimi ose shuarja e detyrimeve të importit kushtëzohet nga rieksporimi i mallrave në adresë të furnizuesit fillestar ose në një adresë tjetër të dhënë prej tij.

4. Gjithashtu, zyra doganore mbikqyrëse duhet të bindet që mallrat nuk janë përdorur ose shitur përpara rieksporimit të tyre.

Neni 605

1. Detyrimet e importit rimbursohen ose shuhen kur:

- a) mallrat e vendosura gabimisht nën regjimin doganor që sjell detyrimin për të paguar detyrime importi, janë rieksportuar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, pa u vendosur më parë nën regjimin doganor nën të cilin duhet të ishin vendosur, me kusht që gjithë kushtet e tjera që përcaktohen në nenin 250 të Kodit të jenë përmbushur;
- b) mallrat janë rieksportuar ose shkatërruar në përputhje me nenin 251(2)(b) të Kodit pa mbikqyrjen doganore, me kusht që kërkesat e tjera të parashikuara në nenin në fjalë të jenë përmbushur;
- c) mallrat janë rieksportuar ose shkatërruar pa mbikqyrjen doganore në bazë të nenit 604(1) (d) deri (f) deri në (n), me kusht që gjithë kërkesat e tjera të parashikuara në nenin 604(2) dhe (4) të jenë përmbushur.

2. Rimbursimi ose shuarja e detyrimeve të importit në rrethanat e përmendura në paragrafin 1, kushtëzohen nga:

- a) paraqitja e provave të nevojshme për të lejuar autoritetet doganore vendimore të sigurohen që mallrat për të cilat kërkohet rimbursimi ose shuarja e detyrimeve:
 - i) janë rieksportuar në fakt jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, ose
 - ii) janë shkatërruar nën mbikqyrjen e autoriteteve ose personave të cilët janë autorizuar të vërtetojnë zyrtarisht këtë shkatërrim;
- b) kthimi tek autoritetet doganore vendimore i çdo dokumenti që vërteton statusin shqiptar të mallrave në fjalë, të cilat shoqëronin këto mallra gjatë eksportimit jashtë territorit doganor, ose paraqitja e çfarëdo prove që autoritetet në fjalë shohin të nevojshme për t'u bindur që dokumenti në fjalë nuk mund të përdoret në vazhdim për importimin e mallrave në Republikën e Shqipërisë

Neni 606

1. Për qëllim të nenit 605(2):

- a) provat e nevojshme për të lejuar autoritetet

doganore vendimore të binden, që mallrat për të cilat kërkohet rimbursim ose shuarje e detyrimeve të importit në fakt janë rieksportuar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, përbëhen në vetvete nga paraqitja nga ana e kërkuesit e:

- i) originalit ose një kopjeje të vërtetuar të deklarates së eksportit të mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, dhe
- ii) vërtetimi i zyrës doganore nëpërmjet së cilës mallrat janë larguar faktikisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

Kur ky vërtetim nuk mund të paraqitet, provat lidhur me largimin e mallrave nga Republika e Shqipërisë, mund të paraqiten në formën e:

- vërtetimit nga autoritetet doganore të vendit të destinacionit që dëshmon që mallrat kanë mbërritur; ose
- origjinalit ose një kopjeje të vërtetuar të deklarates doganore për mallrat, hartuar në vendin e destinacionit.

Këto dokumente duhet të shoqërohen nga dokumente administrative ose tregtare që lejojnë autoritetet doganore vendimore të kontrollojnë nëse mallrat e eksportuara nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë janë të njëjta me mallrat që janë deklaruar për një regjim doganor që sjell detyrimin për të paguar detyrime importi, dhe konkretisht:

- origjinalit ose një kopjeje të vërtetuar të deklarates doganore për regjimin në fjalë, dhe
- kur autoritetet doganore vendimore e shohin të nevojshme, dokumente tregtare ose administrative (si fatura, të dhëna të speditonit, dokumente tranziti, ose certifikata mjeksore) që përmbajnë përshkrim të plotë të mallrave (përshkrime tregtare, sasie, marke dhe të dhëna të tjera të veçanta), të cilat ishin paraqitur bashkë me deklaraten për regjimin përkatës, ose me deklaraten doganore për eksport jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, sipas rastit;
- b) provat e nevojshme për të lejuar autoritetet doganore vendimore të binden se, mallrat për të cilat kërkohet rimbursim ose shuarje detyrimesh doganore janë shkatërruar në fakt nën mbikqyrjen e autoriteteve ose personave të autorizuar për të dëshmuar zyrtarisht një shkatërrim të tillë, përbëhen nga paraqitja nga ana e kërkuesit e:

- i) një raportit ose deklarate shkatërrimi, hartuar nga autoritetet doganore nën mbikqyrjen e të cilave mallrat janë shkatërruar, ose një kopje të vërtetuar të këtij akti; ose
- ii) një vërtetimi të hartuar nga personi i

autorizuar të vërtetojë shkatërrimin, shoqëruar nga prova e autorizimit që ai disponon për këtë qëllim.

Këto dokumente duhet të përmbajnë një përshkrim të plotë e të mjaftueshëm të mallrave të shkatërruara (përshkrime tregtare, sasie, marke dhe të dhëna të tjera të veçanta), që mundësojnë autoritetet doganore, që mbi bazën e krahasimit me të dhënat e paraqitura në deklaraten për një regjim doganor që shoqërohet me detyrimin për të paguar detyrimet e importit dhe dokumentet tregtare shoqëruese (fatura, të dhëna të speditonit etj.), të binden që mallrat e shkatërruara janë ato që ishin deklaruar për regjimin në fjalë.

2. Kur provat e përmendura në paragrafin 1 janë të pamjaftueshme për të lejuar autoritetet doganore vendimore të marrin vendim mbi rastin që u është paraqitur atyre, duke patur parasysh faktet, ose kur nuk disponohen prova të caktuara, të tilla prova mund të plotësohen ose zëvendësohen nga çdo dokument tjetër që këto autoritete e gjykojnë të nevojshëm.

Neni 607

1. Për mallrat e rikthyera, për të cilat janë vjelë detyrime eksporti kur ato ishin eksportuar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, vendosja në qarkullim të lirë sjell edhe të drejtën e rimbursimit të shumave të vjela.

2. Paragrafi 1 nuk zbatohet vetëm për mallrat të cilat ndodhen në njërin nga situatat e mëposhtme:

- a) nuk mund të vendosen në qarkullim të lirë në vendin në të cilin ishin dërguar për shkak të ligjeve në fuqi në atë vend;
- b) u kthyen nga marrësi për arsye defektesh, ose se nuk përputheshin me kushtet e parashikuara në kontratën përkatëse;
- c) ishin riimportuar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, sepse nuk mund të përdorreshin për qëllimet e synuara, për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të eksportuesit.

3. Rrethanat të cilave u referohet paragrafi 2(c) nuk përfshijnë:

- a) mallrat e rikthyera në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, si pasojë e një dëmtimi të ndodhur përpara dorëzimit të tyre marrësit, dëmtim ky i mallrave ose i mjetit të transportit ku ato ishin ngarkuar;
- b) mallrat që fillimisht ishin eksportuar për qëllim konsumi ose shitjeje në vazhden e një panairi tregtie ose rasti të ngjashëm, dhe të cilat nuk janë konsumuar apo shitur;
- c) mallrat të cilat nuk mund t'i dorëzoheshin marrësit për shkak të paafësisë së tij fizike ose ligjore për të përmbushur kushtet e kontratës sipas së cilës mallrat u eksportuan;

d) mallrat të cilat, për shkak çrregullimesh natyrore, politike ose shoqërore, nuk mund t'i dorëzoheshin marrësit, ose që mbërritën tek ky i fundit pas afatit të detyruar për dorëzimin që ishte përcaktuar në kontratën sipas së cilës u eksportuan;

e) frutat dhe perimet, e eksportuara ose të dërguara për shitje me konsenjacion, por të cilat nuk u shiten në tregun e vendit të destinacionit.

4. Fakti që mallrat janë në njërën nga situatat e referuara në nenin 200(2)(b) të Kodit duhet t'u provohet bindshëm autoriteteve të zyrës doganore ku mallrat deklarohen për vendosje në qarkullim të lirë.

5. Paragrafi 1 zbatohet edhe kur mallrat e rikthyera përbëjnë vetëm një pjesë të mallrave të eksportuara më parë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 608

Detyrimet e importit nuk rimbursohen ose shuhen kur shkakët mbi të cilat bazohet kërkesa për rimbursim ose shuarjen e këtyre detyrimeve, në përshtatje edhe me rastin, janë:

- a) riekспорт nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë i mallrave të vendosura më parë nën një regjim doganor që sjell detyrimin për të paguar detyrime doganore, për shkak që të ndryshme nga ato të cilave u referohet neni 250 ose 251 i Kodit, ose nenet 604 ose 605, dhe që është e qartë që nuk janë shitur dot;
- b) shkatërrimi, për çfarëdo arsye, me përjashtim të rasteve në të cilat parashikohet shprehimisht nga legjislacioni shqiptar, i mallrave të vendosura nën një regjim doganor që sjell detyrimin për të paguar detyrimet e importit pas çlirimit të këtyre mallrave nga autoritetet doganore;
- c) paraqitja, për të përfituar trajtim tarifor preferencial për mallrat e deklaruar për qarkullim të lirë, e dokumentave të cilat më pas konstatohet të jenë të rreme, të falsifikuar, ose janë të pavlefshme për këtë qëllim, edhe nëse këto dokumente ishin paraqitur në mirëbesim.

Neni 609

1. Kur autoritetet doganore vendimore të cilave u paraqitet një kërkesë për rimbursim ose shuarje detyrimesh doganore sipas nenit 252(2) të Kodit, nuk mund të marrin vendim në bazë të nenit 603, por kërkesa mbështetet nga prova të cilat mund të përbëjnë një situatë të veçantë që krijohet nga rrethanat në të cilat nuk mund të ketë mashtrim ose neglizhencë të dukshme nga ana e të interesuarit, autoriteti doganor vendimor ia transmeton çështjen Drejtorisë së përgjithshme të Doganave përzgjidhje sipas procedurës së përcaktuar për këto raste në gjithë rastet e tjera, autoritetet doganore vendimore refuzojnë kërkesën.

2. Çështja që i dërgohet Drejtorisë së përgjithshme të Doganave përmban edhe faktet e nevojshme për shqyrtim të hollësishëm të saj. Dosja

përkatëse duhet të përmbajë edhe një deklaratë të nënshkruar nga kërkuesi, përse i përket rimbursimit ose shuarjes së detyrimeve, duke vërtetuar se ai është njohur me çështjen dhe duke treguar se nuk ka asgjë për të shtuar, ose që parashtron të gjithë informacionin shtesë që ai gjykon të nevojshëm. Nëse vërtetohet se të dhënat e paraqitura nga autoritetet doganore vendimore nuk njaftojnë për të dhënë një vendim për rastin konkret, duke patur parasysh gjithë faktet, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave mund të kërkojë paraqitjen e informacionit shtesë.

3. Pa prituri përfundimin e procedurës së mësipërme, autoritetet doganore vendimore, kundrejt kërkesës, mund të lejojnë që formalitetet doganore që lidhen me rieksporimin ose shkatërrimin e mallrave të kryhet përpara se Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të japë vendim mbi kërkesën e paraqitur. Kjo lehtësi jepet pa rënë ndesh me vendimin përfundimtar për kërkesën.

Neni 610

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave vendos nëse situata e veçantë që është në vlerësim e justifikon ose jo rimbursimin ose shuarjen e detyrimeve doganore. Ky vendim merret brenda 90 ditësh nga data në të cilën çështja dorëzohet tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Kur ky i fundit e sheh të arsyeshme të kërkojë informacion shtesë nga autoritetet doganore vendimore përpara marrjes së vendimit, afati prej 90 ditësh zgjatet me një kohë të barazvlefshme me atë mes datës në të cilën Drejtori i Përgjithshëm i Doganave dërgoi kërkesën për informacion shtesë dhe datën që mori këtë informacion.

Neni 611

1. Autoritetet doganore vendimore njoftohen mbi vendimin e marrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave sa më shpejt të jetë e mundur, por sidoqoftë brenda 10 ditësh nga skadimi i afatit të vendosur për marrjen e këtij vendimi.

2. Kur vendimi përcakton që rrethanat në vlerësim janë të tilla që justifikojnë rimbursimin ose shuarjen, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, në kushtet e përcaktuara prej vetë atij mund të autorizojë autoritet doganore vendimore të rimbursojnë ose shuajnë detyrimet edhe në raste të tjera për çështje të ngjashme faktike ose të parashikuara në ligj.

Neni 612

Nëse Drejtori i Përgjithshëm i Doganave nuk merr vendim brenda afatit të caktuar për një gjë të tillë, ose nuk u njofton autoriteteve doganore vendimore vendimin brenda afatit të caktuar, këto të fundit brenda afatit të caktuar kohor, japin përgjigje pozitive për kërkesën.

Neni 613

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të nxjerrë udhëzime për zbatimin praktik të dispozitave për borxhin doganor.

PJESA VI
DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 614

1. Të gjitha referencat e bëra në këto dispozita zbatuese për një nen ose paragraf, pa specifikime të mëtejshme, i referohen nenit ose paragrafit përkatës në po këto dispozita zbatuese. Kur bëhen referenca për nene në ligje të tjera, referenca përkatëse specifikon se në cilin ligj ndodhet neni i referuar.
2. Referencat për dispozitat e shfuqizuara do të kuptohen si referenca për këto dispozita zbatuese.

Neni 615

Me hyrjen në fuqi të këtyre dispozitave zbatuese, të gjitha aktet nënligjore që janë nxjerrë në zbatim të akteve ligjore të përmendura në nenin 300 të Kodit, si dhe çdo dispozite tjetër që bie në kundërshtim me këto dispozita zbatuese, shfuqizohen.

Neni 616

Këto Dispozita Zbatuese hyjnë në fuqi datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"

Ato do të fillojnë të zbatohen nga 15 Maji i vitit 1999.

Këto dispozita janë të detyrueshme në tërësinë e tyre dhe zbatohen drejtpërsëdrejti në Republikën e Shqipërisë.

Tiranë, me 13.04.1999

Kryetari i Këshillit të Ministrave

PANDELI MAJKO

Aneksi I

në përputhje me Pjesën II, Titulli I Kreu 3, neni 10 i Dispozitave Zbatuese të Kodit.

Kategoria	Eprori i Drejtperdrejte	Kriteret e Arsimimit	Kriteret Profesionale	Kritere te Tjera
Drejtori i Përgjithshëm	Ministri i Financave	Diplomë Universitare në shkencat ekonomike, juridike ose natyrore.	Të paktën 3 vjet eksperiencë në Administratën Doganore ose të paktën 6 vjet eksperiencë menaxhimi në fusha të tjera të Shërbimit Publik	Njohje e të paktën një gjuhe të huaj. Kërkesat e vendit të punës.
Nën Drejtori i Përgjithshëm	Drejtori i Përgjithshëm	Diplomë Universitare në shkencat ekonomike, juridike ose natyrore.	Të paktën 2 vjet eksperiencë në Administratën Doganore ose të paktën 4 vjet eksperiencë menaxhimi në fusha të tjera të Shërbimit Publik	Njohje e të paktën një gjuhe të huaj. Kërkesat e vendit të punës.
Zyrtar i Kategorisë A	Drejtori i Përgjithshëm Nën Drejtori i Përgjithshëm përgjegjës për fushën	Diplomë Universitare në shkencat ekonomike, juridike ose natyrore.	Nuk është e domosdoshme por mund të përbëjë prioritet.	Njohje e të paktën një gjuhe të huaj. Kërkesat e vendit të punës.
Zyrtar i Kategorisë B	Drejtori i Drejtorisë	Diplomë Universitare në shkencat ekonomike, juridike ose natyrore.	Nuk është e domosdoshme por mund të përbëjë prioritet.	Njohje e të paktën një gjuhe të huaj. Kërkesat e vendit të punës.
Zyrtar i Kategorisë C1	Drejtori i Drejtorisë, ose Shefi i sektorit në drejtori, ose Kryetari i degës Doganore	Diplomë Universitare në shkencat ekonomike, juridike ose natyrore. Kimistët e Drejtorisë së Laboratorit Kimik duhet të kenë diplomë në Kimi.	Nuk është e domosdoshme por mund të përbëjë prioritet.	Njohje e të paktën një gjuhe të huaj. Kërkesat e vendit të punës.

Kategoria	Eprori i Drejtperdrejte	Kriteret e Arsimimit	Kriteret Profesionale	Kritere te Tjera
Zyrtar i Kategorisë C2	Përgjegjësi i Zyrës Doganore Drejtuesi i Drejtorive dhe Sektorëve të Departamentit Operativ dhe Hetimor Kryetari i Sektorit të Anti-Kontrabandës në Drejtorinë Rajonale	Diplomë Universitare në shkencat ekonomike, juridike ose natyrore.	Nuk është e domosdoshme por mund të përbëjë prioritet.	Njohje e të paktën një gjahe të huaj. Kërkesat e vendit të punës.
Personel i kategorisë D1	Kryetari i Zyrës Doganore Drejtuesi i Drejtorive dhe Sektorëve të Departamentit Operativ dhe Hetimor Shef i sektorit të Anti-Kontrabandës në Drejtorinë Rajonale	Diplomë e shkollës së mesme	Nuk është e domosdoshme por mund të përbëjë prioritet.	Kërkesat e vendit të punës.
Personel i Kategorisë D2	(si për D1)	Deftesë e shkollës tetëvjeçare si dhe çdo certifikatë shtesë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen e detyrës.	Nuk është e domosdoshme por mund të përbëjë prioritet.	Kërkesat e vendit të punës.

Data

KOPJE PER DOGANEN	2	1 Autoritetet doganore kompetente	2 Referenca e ITD
		3 Mbajtësi (emri dhe adresa) confidencial	4 Data e fillimit të vlefshmërisë
		Shënimi i rëndësishëm Pa rënë ndesh me dispozitat e nenit 22 (4) dhe (5) të Kodit Doganor ky ITD mbetet i vlefshëm për 6 vjet duke filluar nga data në të cilën bëhet i vlefshëm. Informacioni i dhënë do të ruhen në një data-base të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për qëllime të zbatimit të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor. Mbajtësi ka të drejtë të ankohet kundër këtij ITD.	5 Data dhe referenca e kërkesës 6 Klasifikimi i mallrave në nomenklaturën doganore
	2	7 Përshkrimi i mallrave	
	8 Emërtimi tregtar dhe informacion plotësues		confidencial
	9 Justifikim i klasifikimit të mallrave		
	10 Ky ITD është lëshuar mbi bazën e materialeve të mëposhtme të dhëna nga kërkuesi: Përshkrim ☐ Broshura ☐ Foto ☐ Mostra ☐ Të tjera ☐ Vendi Firma Vula Data		

KOPJE PER LABORATORIN

4

11 Autoritetet doganore kompetente që duhet të kontaktohen për informacion shtesë (emri, adresa e plotë, telefon, fax)

☐

12 Referenca e ITD

KOPJE PER DOGANEN

4

4 Fjalë kyçe:

--

--

--

--

--

--

--

--

--

--

--

--

--

1. Consignor (Dërguesi)		Nr. 000000		ORIGINAL ORIGINAL
		(Shënohet numri rendor i lëshimit)		
2. Consignee (Marrësi)		REPUBLIC OF ALBANIA (REPUBLIKA E SHQIPERISE) CERTIFICATE OF ORIGIN (ÇERTIFIKATE ORIGJINE)		
		3. Place of origin (Vendi i origjinës)		
4. Transport details (Optional) (Detaje të transportit (Fakultative))		5. Remarks (Shënime)		
6. Item number, marks, numbers, number and kind of packages; description of goods (Numri i artikullit, markat, numri dhe lloji i kolive; përshkrimi i mallrave)				7. Quantity (Sasia)
8 THE UNDERSIGNED AUTHORITY CERTIFIES THAT THE GOOODS DESCRIBED ABOVE ORIGINATE IN THE COUNTRY SHOWN IN BOX 3 (AUTORITETI NENSHKRUES VERTETON SE MALLRAT E PERSHKRUARA ME SIPER E KANE ORIGJINEN NE VENDIN E TREGUAR NE KUTINE 3)				
Place and date of issue, name, signature and stamp of competent authority (Vendi dhe data e lëshimit, emri, firma dhe vula e autoriteteve kompetente)				

1. Consignor (Dërguesi)	Nr. 000000	COPY KOPJE
	(Shënohet numri rendor i lëshimit)	
2. Consignee (Marrësi)	REPUBLIC OF ALBANIA (REPUBLIKA E SHQIPERISE) CERTIFICATE OF ORIGIN (ÇERTIFIKATE ORIGJINE)	
	3. Place of origin (Vendi i origjinës)	
4. Transport details (Optional) (Detaje të transportit (Fakultative))	5. Remarks (Shënime)	
6. Item number, marks, numbers, number and kind of packages; description of goods (Numri i artikullit, markat, numri dhe lloji i kolive; përshkrimi i mallrave)		7. Quantity (Sasia)
8. THE UNDERSIGNED AUTHORITY CERTIFIES THAT THE GOOODS DESCRIBED ABOVE ORIGINATE IN THE COUNTRY SHOWN IN BOX 3 (AUTORITETI NENSHKRUES VERTETON SE MALLRAT E PERSHKRUARA ME SIPER E KANE ORIGJINEN NE VENDIN E TREGUAR NE KUTINE 3)		
Place and date of issue, name, signature and stamp of competent authority (Vendi dhe data e lëshimit, emri, firma dhe vula e autoriteteve kompetente)		

1. Consignor (Dërguesi)		Nr. 000000		APPLICATION	
		(Shënohet numri rendor i lëshimit)		KERKESE	
2. Consignee (marrësi)		REPUBLIC OF ALBANIA (REPUBLIKA E SHQIPERISE)			
		CERTIFICATE OF ORIGIN (ÇERTIFIKATE ORIGJINE)			
		3. Place of origin (Vendi i origjinës)			
4. Transport details (Optional) (Detaje të transportit (Fakultative))		5. Remarks (Shënime)			
6. Item number, marks, numbers, number and kind of packages; description of goods (Numri i artikullit, markat, numri dhe lloji i kolive; përshkrimi i mallrave)				7. Quantity (Sasia)	
8. Unë, i nënshkruari, KERKOJ lëshimin e një çertifikate origjine që tregon se mallrat e përshkruara më lart e kanë origjinën në vendin e treguar në kutinë 3, DEKLAROJ se të dhënat e shënuara në këtë kërkesë si dhe dokumentet mbështetëse dhe informacioni i dhënë autoriteteve kompetente me qëllim që të lëshojnë këtë çertifikatë janë të sakta, se mallrat me të cilat lidhen këto dokumente dhe informacione janë mallrat në lidhje me të cilat është bërë kjo kërkesë, se mallrat përmbushin kushtet e përcaktuara nga rregullat në lidhje me përkufizimin e zakonshëm të konceptit të origjinës së mallrave, MARR PERSIPER të jap, me kërkesë të autoriteteve kompetente, informacion plotësues dhe dokumente mbështetëse siç mund të kërkojnë për lëshimin e çertifikatës.					
9. Kërkuesi (Në rast se nuk është dërguesi) Vendi dhe data Firma e					
kërkuesit (1)					

(1) Firma e një agjenti duhet të ndiqet nga emri i tij i shkruar me shkronja të mëdha.

**LISTA E VEPRIMEVE PUNUESE OSE PËRPUNUESE QË KËRKOHEN PËR T'U KRYER MBI
MATERIALET JO-ORIGJINUESE ME QËLLIM QË PRODUKTI I FABRIKUAR TË PËRFTOJE
STATUSIN E ORIGJINËS (SPP)**

Kodi N.K.	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo-origjinues që u jep statusin origjinues
(1)	(2)	(3)
0201	mish i gjedhëve, i freskët apo i ftohtë	Produkte nga materiale të çdo kreu, përveç mishit të gjedhëve, të ngrirë të kreut Nr.0202.
0202	mish i gjedhëve, i ngrirë	Produkte nga materiale të çdo kreu, përveç mishit të gjedhëve, i freskët apo i ngrirë të kreut Nr.0202.
0206	Të brendshmet e ngrënshme të gjedhëve, derrave, deleve, dhive, kuajve, gomerëve, mushkave apo hibridit të gomaricës me kalin të freskëta, të ftohta ose të ngrira.	Produkte nga materiale të çdo kreu përveç mishit karkasë të krerëve Nr. 0201 deri 0205
2010	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit të kriposura në ujë me kripë, të thara apo të tymosura; pudër e ngrënshme e mishit dhe e të brendshmeve të mishit.	Produkte nga materiale të çdo kreu përveç mishit dhe të brendshmeve të krerëve Nr.0201 deri 0206 dhe 0208 ose mëlqive të shpezëve të kreut Nr 0207
0302 deri 0305	Peshk jo i gjallë	Produkte në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 3 që përdoren duhet të jenë origjinues.
0402, 0404 0406 deri	Produkte blegtorale	Produkte nga materiale të çdo kreu përjashtuar qumështin ose kremi të krerëve Nr.0401 deri 0402
0403	Dhallë, qumësht dhe krem i prerë, kos, kefir dhe qumësht e kremëra të tjera të fermentuara apo të acidifikuara, nëse janë apo jo të koncentruara apo që përmbajnë sheqer shtesë apo lëndë të tjera ëmbëlsuese apo lëndë aromatizuese apo që përmbajnë fruta, arra apo kakao shtesë	Produkte në të cilat: - të gjitha materialet e kapitulli 4 që përdoren duhet të jenë origjinues. - çdo lloj lëng frutash të kreut 2009 ose sukrozë duhet të jetë origjinues, dhe - vlera e të gjitha materialeve të kapitulli 18 që përdoren nuk duhet të kalojë 40% të ex-works price të produktit.
0408	Vezët e zogjve, jo në guacka, dhe të verdhat e vezëve, të freskëta, të thara, të gatuar në avull apo nga zierja në ujë, të dhena formë, të ngrira apo të ruajtura ndryshe, nëse përmbajnë apo jo sheqer shtesë apo lëndë të tjera ëmbëlsuese shtesë	Produkte nga materialet të çdo kreu përveç vezëve të zogjve të kreut Nr.0407

Ex 0506	Kocka ose palca e brirëve, e papunuar	Produkte në të cilat të gjitha materialet e kapitulli 2 duhet të jenë origjinues
0710 deri 0713	Zaravate të ngrënshme, të ngrira ose të thara, të ruajtura përkohësisht, përveç krerëve Nr.ex 0710 dhe ex 0711, për të cilat rregullat përshkruhen më poshtë	Produkte në të cilat të gjitha materialet që përdoren duhet të jenë origjinues
ex 0710	Misër i ëmbël (i pa gatuar me avull ose zierje në ujë) i ngrirë.	Produkte nga misër i ëmbël, i freskët apo i ftohtë.
ex 0710	Misër i ëmbël i ruajtur përkohësisht.	Produkte nga misër i ëmbël i freskët apo i ftohtë
0811	Fruta dhe arra, të pa gatuar apo të gatuar me avull ose të zier në ujë, të ngrira, nëse përmbajnë apo jo sheqer shtesë apo lëndë të tjera ëmbëlsuese shtesë: - që përmbajnë sheqer shtesë -të tjera (2)	Produkte në të cilat të gjitha materialet që përdoren duhet të jenë origjinues. Produkte në të cilat të gjitha frutat dhe arrat që përdoren duhet të jenë origjinues
0812	Fruta dhe arra, të ruajtura përkohësisht (psh, nga gazi i dioksidit të sulfurit, në ujë me kripë, në ujë sulfuror apo në solucione të tjera ruajtëse), por të papërshtatshme në atë gjendje për konsum të menjëhershëm.	(3) Produkte në të cilat të gjitha frutat dhe arrat që përdoren duhet të jenë origjinues
0813	Fruta të thara përveç atyre të krerëve Nr.0801 deri 0806; përzierjet e arrave apo të frutave të thara të këtij kapitulli.	Produkte në të cilat të gjitha frutat dhe arrat që përdoren duhet të jenë origjinues
0814	Lëkura e agrumeve apo pjepave (përfshirë shalqinjët), të freskëta, të ngrira, të thara apo të ruajtura përkohësisht në ujë me kripë, në ujë sulfuror apo në solucione të tjera ruajtëse.	Produkte në të cilat të gjitha frutat dhe arrat që përdoren duhet të jenë origjinues

ex kapitulli 11	Produktet e industrisë bluajtëse; malt, niseshte, inulinë, gluteni i grurit; përveç kreut Nr.ex 1106	Produkte në të cilat të gjitha drithërat, zarzavatet e ngrënshme, rrënjët e bulbet të kreut Nr.0714 ose fruta që përdoren duhet të jenë origjinuese.
ex 1106	Miell, kokriza pluhur i zarzavateve të thara leguminoze të kreut Nr.0713	Tharja dhe bluarja e zarzavateve leguminoze të kreut Nr.0708
1301	Lac; goma natyrale, rrëshirat, gome – rrëshirat dhe oleorëshirat	Produkte në të cilat të gjitha materialet që përdoren të kreut Nr.310 nuk duhet të kalojnë vlerën 50% të ex-works price te produktit.
1501	Sallo:dhjamra të tjera derri dhe shpendësh i përfituar nga presimi ose me anë të tretjes. -dhjamra nga kockat e mbetura të tjera	Produkte nga materiale të çdo kreu përveç atyre të krerëve Nr.0201, 0202, 0204, 0206 Produkte nga mishi ose të brendëshmet e derit të krerëve Nr.0203 ose 0206 ose nga mishi ose të brendëshmet e shpezëve të kreut Nr.0207
1502	Dhjamra të gjedhëve, deleve apo dhive, si material i parë ose i përfituar nga presimi ose me anë të tretjes. -dhjamra nga kockat e mbetura - të tjera	Produkte nga materiale të çdo kreu përjashtuar ato të krerëve Nr. 0201, 0202, 0204 ose 0206 ose kockat e kreut Nr.0506 Produkte në të cilat të gjitha materialet kafshore të Kapitullit duhet të jenë origjinuese
1504	Dhjamra dhe vajra dhe fraksionet e tyre, të peshkut apo sisorëve detare, nëse janë apo jo të rafinuar, por jo të modifikuara kimikisht:	
1504 (vazh)	-Fraksione solide të dhjamrave dhe vajrave dhe sisorëve detare. - të tjera	Produkte nga materiale të çdo kreu të përfshirë edhe materialet të tjerë të kreut Nr.1504 Produkte në të cilat të gjitha materialet kafshore të Kapitullit 2 dhe duhet të jenë origjinuese.
Ex 1505	Lanolinë e rafinuar	Produkte nga vaji i leshit te papërpunuar të kreut Nr.1505
1506	Dhjamra dhe vajra dhe fraksione të tyre me origjinë kafshore, të rafinuar ose jo, por jo të modifikuara kimikisht. -fraksione solide -të tjera	Produkte nga materiale të çdo kreu përfshirë materialet e kreut Nr.1506 Produkte në të cilat të gjitha materialet kafshore të Kapitullit 2 duhet të jenë origjinuese.
Ex 1507 deri 1515	Vaj soje dhe fraksionet e tyre, të rafinuar apo jo, por jo të modifikuara kimikisht. -fraksione solide përveç vajit të jojobas (2) -të tjera,përveç -tung oil;dyl mersine dhe dyll Japonez -ato të cilat përdoren për përdorim teknik ose industrial të ndryshëm me prodhimin e produkteve ushqimore për njerëzit	Produkte nga materiale të tjera të krerëve Nr.1507 deri 1515 (3) Produkte në të cilat të gjitha materialet perimore duhet të jenë origjinuese.
ex 1516	Yndyrna me origjinë kafshore ose vegjetale, dhe fraksionet e tyre, të riesterifikuara, të rafinuara ose jo, por jo më tej të përgatitura.	Produkte në të cilat të gjitha materialet perimore dhe kafshore duhet të jenë origjinuese.
ex 1517	Përzierje të ngrënshme likuide të vajrave vegjetale të krerëve Nr.1507 deri 1515	Produkte në të cilat të gjitha materialet e përdorura perimore duhet të jenë origjinuese.
ex 1519	Alkole vajrash industriale që kanë cilesitë e dylrave.	Produkte nga materiale të çdo kreu përfshirë edhe acidet yndyrore të Kreut Nr.1519

1601	Sallame dhe produkte të ngjashme prej mishi, prej të brendshmeve të mishit apo prej gjakut, përgatitjet ushqimore në bazë të këtyre produkteve.	Produkte nga kafshët e Kapitulli I
1602	Mish, të brendshme të mishit apo gjaku, të përgatitura apo të ruajtura në mënyra të tjera.	Produkte nga kafshët e Kapitullit I
1603	Ekstraktet dhe lengjet e mishit, peshkut apo krustaceve, molusqeve apo kafshëve të tjera jo vertebrorë ujore.	Produkte nga kafshët e Kapitullit I. Të gjithë peshqit, molusket apo jo vertebrorët ujore e tjerë duhet të jenë origjinues.
1604	Peshk i përgatitur apo i konservuar; havjar dhe zëvendësuesit e havjarit të përgatitur prej vezëve të peshkut.	Produkte në të cilat të gjithë peshqit ose vezët e peshqve duhet të jenë origjinues.
1605	Krustacet, molusqet dhe kafshë të tjera jo vertebrorë ujore, të përgatitur apo të konservuar	Produkte në të cilat të gjithë krustacet, moluskë ose vertebrorë ujorë të tjerë duhet të jenë origjinues.
ex 1701	Sheqer i prodhuar nga kallam sheqeri ose panxhar sheqeri dhe saharoza kimikisht të pastër, në gjendje të ngurtë, të aromatizuar apo të ngjyrosur	Produkte nga materiale jo të klasifikuara brenda të njëjtit kre si trodunkte. Megjithatë, të gjitha materialet aromatike ose ngjyrosëse duhet të jenë origjinues.
1702	Sheqer tjetër, duke përfshirë laktozën, maltozën, glukozën dhe fruktozën kimikisht të pastra, në gjendje të ngurtë; shurupet e sheqerit që nuk përmbajnë lëndë aromatizuese dhe ngjyuese shtesë; mjaltë artificial, nëse është apo jo i përzier me mjaltë natyral; karamel: -Maltozë dhe fruktozë kimikisht të pastra -Të tjera	Produkte nga materiale të cdo kreu përfshirë edhe materialet e tjera të kreut Nr.1702 Produkte në të cilat të gjitha materialet duhet të jenë origjinues.
ex 1703	Melasat e rezultuara nga ekstragimi apo rafinimi i sheqerit, të aromatizuara ose të ngjyrosura.	Produkte nga materiale jo të klasifikuara brenda të njëjtit kre. Megjithatë, të gjitha materialet aromatike ose ngjyrosëse duhet të jenë origjinues.
1704	Embelsirat prej sheqeri (përfshirë çokollatën e bardhë), që nuk përmbajnë kakao	Produkte nga materiale jo të klasifikuara brenda Kapitullit 17. Megjithatë, të gjitha materialet aromatike dhe ngjyrosëse duhet të jenë origjinues.
1804	Gjalp kakao, e ngurtë apo e ngrirë	Produkte në të cilat arrat e kokosit duhet të jenë origjinues.
1806	Çokollatat dhe përgatitje të tjera ushqimore që përmbajnë kakao	Produkte në të cilat materialet e përdorura janë të klasifikuara brenda një kreu të ndryshëm nga ajo e produktit, nëse çdo material i përdorur i Kapitullit 18 nuk kalon 40% të vlerës së <i>ex-works price</i> të produktit dhe gjithë sheqeri që përdoret i kreut Nr.1701 duhet të jetë origjinues.
1901	Ekstrakte të nxjerra nga malto, përgatitje ushqimesh nga gruri, mielli, niseshte ose produkte nga malto, që nuk përmbajnë pluhur kakao apo që përmbajnë pluhur kakao në proporcion të peshës 50% më të vogël, e paspecifikuar ose përfshirë tjetër kund; ushqime të përgatitura nga mallrat e artikujve Nr.0401 deri 0404, që nuk përmbajnë pluhur kakao në proporcion të peshës 10 % më të vogël, e pa specifikuar ose përfshirë në ndonjë vend tjetër. -Ekstrakte nga malto - Të tjera	Produkte nga drithërat e Kapitullit 10 Produkte në të cilat të gjitha materialet e përdorura janë të klasifikuara brenda një kreu të ndryshëm nga ajo e produktit, Megjithatë, sheqeri i kreut Nr.1701 nuk mund të përdoret.
1902	Makaronat, të pagatuara ose jo, apo të mbushura (me mish ose substanca të tjera), apo ndryshe të përgatitura, si spaghetti, makarona, nudëll, llasanja, Sgnochi, ravioli, kanelloni, kus-kus, të përgatitura ose jo.	Produkte në të cilat të gjitha drithërat (përveç grurit durum) mish, të brendshme kafshësh, krustacew, ose molusqe që përdoren duhet të jenë origjinues. Produkte në të cilat të gjitha materialet që përdoren duhet të jenë origjinues.
1903	Zëvendësues të tapiokas të përgatitur nga niseshteja, në formë kokrrizash, gruri, të shoshitura ose në forma të ngjashme.	Produkte në të cilat të gjitha materialet duhet të jenë origjinues.
ex 1904	Ushqime të përgatitura me anë të bymimit ose pjekjes së drithërave ose nënprodukteve të drithërave (për shëmbull corn flakes), drithëra të ndryshme me misrin (corn) në formë gruri, të paragatuar ose të përgatitur ndryshe: -Nuk përmbajnë kakao -Që përmbajnë kakao	Produkte nga materiale të cdo kreu, përfshirë edhe materialet e kreut Nr.1904, përveç sheqerit të kreut Nr.1701, nëse vlera e çdo materiali të përdorur e Kapitulli 18 nuk kalon vlerën 40% të <i>ex-works price</i> të produktit.

1905	Bukë, prodhime pastigjere, kekë, biskota dhe produkte të pjekura të ngjashme, që përmbajnë kakao ose jo, vafer, stampime boshe të lloji të përshtatshëm për produkte farmaceutike, vafer të lidhur, letër orizi dhe produkte të ngjashëm.	Produkte nga materiale të çdo kreu përveç atyre të Kapitullit 11.
2001	Zarzavate, fruta, arra dhe pjesë të tjera të ngrënshme të pemëve, të përgatitura ose të ruajtura nga uthulla ose acidi acetik.	Produkte në të cilat të gjitha frutat, arrat ose frutat që përdoren duhet të jenë origjinuese.
2002	Domate të përgatitura ose të ruajtura ndryshe nga metoda me uthull dhe acid acetik.	Produkte në të cilat të gjitha domatet e përdorura duhet të jenë origjinuese
2003	Kërpudha dhe zhardhoku i kërpudhave të përgatitura ose të ruajtura ndryshe nga metoda me uthull ose acid acetik.	Produkte në të cilat të gjitha kërpudhat ose zhardhokët e kërpudhave që përdoren duhet të jenë origjinuese.
2004 deri 2005	Zarzavate të tjera të përgatitura ose të ruajtura ndryshe nga metoda me uthull ose acid acetik, të ngrira ose të pa ngrira	Produkte në të cilat të gjitha zarzavatet duhet të jenë origjinuese.
2006	Fruta, arra, lëkurë frutash dhe pjesë të tjera të bimëve, të ruajtura me sheqer (të kulluara, të sheqerosura, ose të kristalizuar)	Produkte në të cilat të gjitha frutat, arrat ose pjesë të tjera të bimëve dhe të gjithë sheqernat e Kapitulli 17 duhet të jenë origjinuese.
2007	Reçe, xhelatinë frutash, pure frutash apo arrash, ose brumë frutash apo arrash, në gjendje të përgatitur gatimi, nëse përmbajnë apo jo sheqer ose materiale të tjera të ëmbla.	Produkte në të cilat të gjitha frutat ose arrat dhe çdo lloj sheqeri që përdoren, të Kapitullit 17 duhet të jenë origjinuese.
ex 2008	Fruta, arra dhe pjesë të ngrënshme të bimëve, të përgatitura apo të ruajtura ndryshe, nëse përmbajnë apo jo sheqer ose materiale të tjera të ëmbla, të paspecifikuara ose të përfshira diku tjetër. -Fruta dhe arra të përgatitura, jo me avull ose ujë të zier, që nuk përmbajnë sheqer shtesë, të ngrira -Të tjera	Produkte në të cilat të gjitha frutat dhe arrat që përdoren duhet të jenë origjinuese. Produkte në të cilat të gjitha frutat, farat dhe arrat dhe materiale të tjera të Kapitujve 8 dhe 9 dhe të gjitha sheqernat dhe pijet alkolike, uthulla të kapitujve 17 deri 22 duhet të jenë origjinuese.
Ex 2009	Lëngje frutash (përfshirë mushtin e rrushit) dhe lëngje zarzavatesh, të pa fermentuara që nuk përmbajnë lëndë alkolike shtesë, nëse përmbajnë sheqer apo lëndë të tjera ëmbëlsuese shtesë	Produkte në të cilat të gjitha frutat, farat, arrat ose zarzavatet e Kapitujve 7 dhe 8 dhe çdo lloj sheqeri i Kapitulli 17 që përdoren duhet të jenë origjinuese.
Ex 2101	Çikore e pjekur dhe ekstraktet, esencat dhe koncentratet prej saj.	Produkte në të cilat të gjitha çikoret duhet të jenë origjinuese.
ex 2103	Salcat dhe përgatitjet prej tyre; erëza të përziera dhe aromatizues të përzier dhe përgatitjet prej tyre	Produkte në të cilat të gjitha materialet që përdoren janë të klasifikuara brenda në kreu të ndryshëm nga ajo e produktit. Megjithatë, ushqimi ose mielli mustard dhe mustarda e përgatitur mund të përdoren.
ex 2103	Mustardë e përgatitur.	Produkte nga miell ose ushqim mustarde
ex 2104	Supat dhe lëngjet e mishit si dhe përgatitjet prej tyre, përgatitjet ushqimore të përbëra, të homogjenizuara -Supa dhe lëngje mishi dhe përgatitjet prej tyre. -Ushqime të përbëra të homogjenizuara	Produkte nga materiale të çdo kreu përveç perimeve të përgatitura ose të konservuara të kërërve Nr.2002 deri 2005. Rregulli për kreun në të cilin produkti duhet të klasifikohet në bazë të masës do zbatohet në këtë rast.
ex 2105	Akulllore dhe akuj të tjerë të ngrënshëm që përmbajnë çokollatë	Produkte në të cilat të gjitha materialet e përdorura janë të klasifikuara brenda një kreu ndryshe nga ajo e produktit, nëse çdo material që përdoret i Kapitullit 18 nuk e kalon vlerën 40% të çmimit të <i>ex-works price</i> të produktit.
Ex 2106	Shurupë sheqeri, të aromatizuar apo të ngjyrosur	Produkte në të cilat të gjitha materialet që përdoren duhet të jenë origjinuese.
2201	Ujra, përfshirë ujrat natyrale ose artificiale dhe ujrat e gazuar, që nuk përmbajnë sheqer apo lëndë të tjera ëmbëlsues apo aromatizuese shtesë; akulli dhe bora.	Produkte në të cilat produktet që përdoren duhet të jenë origjinuese.
2202	Ujrat, përfshirë ujrat minerale dhe ujrat e gazuar, që përmbajnë sheqer apo lëndë të tjera ëmbëlsuese apo aromatizuese shtesë, dhe pije të tjera jo-alkolike pa përfshirë lëngun e frutave apo të zarzavateve të kreut Nr.2009.	Produkte në të cilat të gjitha materialet që përdoren janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm me atë të produktit. Megjithatë, të gjitha lëngjet e frutave duhet të jenë origjinuese.

ex 2204	Verë prej rrushit të freskët, përfshirë verërat e pasuruara me alkol.	Produkte nga mushti i rrushit.
ex 2205 ex 2207 ex 2208 dhe ex 2209	Materialet e mëposhtme që përmbajnë rrush. -vermuth dhe verëra të tjera të freskëta të amoratizuara me bimë dhe substanca aromatike; - alkol etilik i denaturuar ose jo, dhe likerna apo pije të tjera; Përgatitje të ndryshme të përbëra të llojit të prodhimit të pijeve. -Uthull	Produkte nga materiale të çdo kreu përveç rrushit ose materialeve me prejardhje nga rrushi.
Ex 2208	Uhiski i një force alkoli në volum të më pak se 50% vol.	Produkte në të cilat vlera e drithërave që perdoret\$ nuk kalon 15% të vlerës të <i>ex-works price</i> të produktit.
ex 2303	Mbetjet e prodhimit të niseshtesë nga gruri (përfshijtur likernat e koncentruar të lagësht), me një përmbajtje proteinë, e llogaritur mbi produkt të tharë, që tejkalon 40% të peshës.	Produkte në të cilat të gjitha misrat që përdoren duhet të jenë origjinuese.
2306	Bërsi dhe mbetje të tjera të forta të fituara nga ekstragimi i vajit të ullirit, që përmban më shumë se 3% vaj ulliri.	Produkte në të cilat të gjithë ullinjët që përdoren duhet të jenë origjinues.
2309	Përgatitjet e një lloji të përgatitur në ushqimet e kafshëve	Produkte në të cilat të gjitha drithërat, sheqeri, molaswt, mish ose qumësht që përdoren duhet të jenë origjinuese.
2402	Puro, cigare dhe cigarillos prej duhanit apo prej zëvendësuesve të duhanit.	Produkte në të cilat të paktën 70% e peshës së duhanit ose mbetjeve të duhanit të pa fabrikuar të kreut Nr.2401 duhet të jenë origjinuese.
ex 2403	Duhan i gatshëm për pirje	Produkte në të cilat të paktën 70% e peshës së duhanit ose mbetjeve të duhanit të pa fabrikuar të kreut Nr.2401 duhet të jenë origjinuese.
ex 2504	Grafrit natyral kristalin, me përmbajtje të pasuruar karboni, i pasuruar dhe pllakë.	Pasurimi i përmbajtjes së karbonit, purifikimi dhe prerja e grafrit kristalin të papërpunuar.
ex 2515	Mermer i ndarë me anë të prerjes ose ndryshe, në blloqe ose pllakë të formës rektangulare (përfshirë katror) të një trashësie që nuk kalon 25 cm.	Ndarja me anë të prerjes e gurëve (edhe nëse janë prerë) të një trashësie që kalon 25 cm.
ex 2516	Granit i purpurte, basalt, gurë dhe gurë të tjerë monumentale ose ndërtime, të ndarë me prerje ose ndryshe, në blloqe ose pllaka të formës rektangulare (përfshirë katror), të një trashësie që nuk kalon 25 cm trashësi.	Ndarja me anë të prerjes e gureve (edhe nëse janë prerë) të një trashësie që kalon 25 cm.
Ex 2518	Dolomit i kalçinuar	Kalçinimi i dolomitit të pakalçinuar.
ex 2519	Karbonat magneziumi i pluhurëzuar (magnezite) në kontenerë të vulosur hermetikisht, dhe oksid magnezi, i pastër apo i papastër, të ndryshëm me magnezin e nxehtë ose të djegur (i sintetizuar pas djegjes).	Produkte në të cilat të gjitha materialet janë të klasifikuara brenda një kreu që ndryshojnë nga ajo e produktit. Megjithatë, karboni natyral i magnezit (magneziti) mund të përdoret.
ex 2520	Gips i përdorur veçanërisht për dentist	Produkte në të cilat vlera e të gjitha materialeve që përdoren nuk kalon 50% të vlerës të <i>ex-works price</i> të produktit
ex 2524	Fibra natyrale azbesti	Produkte nga koncentrat azbesti.
ex 2525	Pluhur mike	Grirje e mike ose mbetje mike
ex 2530	Bojra dheu, të kalçinuara ose të pluhurizuara	Kalçinim ose grirje të bojrave të dheut.
ex 2707	Vajra dhe produkte të tjera të distilimit në temperaturë të lartë të katranit të qymyrit; produkte të ngjashme në të cilat pesha e përbërësve aromatike e tejkalon atë të atyre jo aromatikeve, duke qenë vajra të ngjashëm me vajrat minerale të përfutur nga distilimi në temperaturë të lartë të katranit të qymyrit, prej së cilës me shumë se 65% e volumit distilohet në një temperaturë deri 250°C (përfshirë përzierjet e petroleum spirits dhe benzolit), për përdorim energjie të karburanteve ngrohës.	Operacione të rafinimit dhe/ose të një ose më shumë procese specifike (shikoni shënimin 6) Operacione të tjera në të cilat materialet e përdorura janë të klasifikuara brenda një kreu të ndryshëm me atë të produktit. Megjithatë materialet e përdorura brenda të njëjtit kre mund të përdoren nëse vlera nuk kalon 50 % të çmimit të <i>ex works price</i> të produktit.
ex 2709	Vajrat e naftës dhe vajrat e fituara prej materialeve bituminoze, bruto.	Distilime shpërbërëse të mineraleve bituminoze.

2710 deri 2712	Vajrat e naftës dhe vajra të fituara prej mineraleve bituminoze, ndryshe nga bruto; preparate të pa specifikuara dhe të pa përfshira diku tjetër, që përmbajnë ndaj peshës 70% apo më shumë vajra naftë të fituara nga mineralet bituminoze, këto vajra duhet të jenë përbërësit bazë të preparatit: Gaze naftë dhe gazra të tjera hidrokarburesh	Operacione të rafinimit dhe/ose të një ose më shumë proceseve. (shikoni shënimin 6) Operacione të tjera në të cilat materialet e përdorura janë të klasifikuara brenda të njëjtit kre të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë materialet e klasifikuara brenda të njëjtit kre mund të përdoren nëse vlera e tyre nuk kalon 50% të <i>ex-works price</i> të produktit.
(Vazhd) 2710 deri 2712	Xhelatinë naftë, dylle parafine, dyllë i naftës mikrokristalin, dylle i shpërberës i ozoceritit, dyllë linjiti, dyllë torfe, dylle të tjera minerale të fituar nga sinteza ose disa procese, nëse janë apo jo të ngjyrosur	
2713 deri 2715	Koks naftë, bitum naftë, dhe mbetje të tjera të vajrave të naftës apo të vajrave të fituar prej minerali bituminoz. Bitum dhe asfalt natyral; apo rreshpë naftë dhe rërë katrani; asfaltite dhe gurët asfaltikë. Përzjerje bituminoze të përziera të bazuara në asfaltin natyral, në bitumin natyral, në katranin mineral apo në terpininën e mineralit mineral (psh mastice bituminoze, bitum i lëngëzuar):	Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese (shikoni shënimin 6) Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorura janë të klasifikuara brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë materialet e klasifikuara brenda të njëjtit kre mund të përdoren nëse nuk kalohet vlera 50% e <i>ex-works price</i> të produktit.
ex kapitulli 28	Kimikatet inorganike, përbërjet inorganike dhe organike të metaleve të çmuar, të metaleve të rrallë, të elementeve radioaktive apo të izotopeve; përveç krerëve Nr.2811 dhe ex 2833 për të cilat rregullat janë dhënë më poshtë.	Produkte në të cilat të gjitha materialet e përdorura janë klasifikuar brenda të njëjtit kre të ndryshëm me atë të produktit, megjithatë materialet e klasifikuara brenda të njëjtit kre mund të përdoren nëse nuk kalohet vlera 20% <i>ex-works price</i> të produktit.
ex 2811	Trioksid sulfuri	Produkte nga trioksidi sulfurik.
ex 2833	Sulfat alumini	Produkte në të cilat të gjitha materialet që përdoren nuk e kalojnë vlerën 50% të <i>ex-works price</i> të produktit.
ex kapitulli 29	Kimikatet organike përveç krerëve Nr. ex 2911, ex 2902, ex 2905, ex 2933 dhe ex 2934 pozicioni i të cilave është i përcaktuar më poshtë	Produkte në të cilat të gjitha materialet e klasifikuara brenda një kreu të ndryshëm me atë të produktit, megjithatë materialet e klasifikuara brenda të njëjtit kre mund të përdoren nëse nuk kalohet vlera 20% të <i>ex-works price</i> të produktit.
ex 2901	Hidrokarbone aciklike që përdoren si karburante me fuqi djegëse fuqie ose ngrohëse	Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike. (shikoni shënimin 6) Përgatitje të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorura janë të klasifikuara brenda të njëjtit kre të ndryshëm me atë të produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara brenda të njëjtit kre mund të përdoren nëse nuk kalohet vlera 50% e <i>ex-works price</i> të produktit.
ex 2902	Ciklanet dhe ciklenet, benzen, toluen, si lëndë djegëse fuqie ose ngrohëse.	Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike. (shikoni shënimin 6) Përgatitje të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorura janë të klasifikuara brenda të njëjtit kre të ndryshëm me atë të produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara brenda të njëjtit kre mund të përdoren nëse nuk kalohet vlera 50% e <i>ex-works price</i> të produktit.
ex 2905	Derivatet e alkoleve metalike të këtij kreu dhe të etanolit ose glicerolit.	Produkte nga materialet të çdo kreu, përfshirë edhe materialet të kreut Nr.2905. Megjithatë, derivatet e alkoleve metalikë të këtij kreu mund të përdoren nëse nuk kalohet vlera 20% e <i>ex-works price</i> të produktit.
2915	Acidet monokarboksilike aciklike të saturuara dhe anhidritet, halidet, peroksidet, dhe peroksiacidet e tyre; derivatet e tyre të halogjenizuara, të sulfonatuara, të nitratuara apo të nitrosatuara.	Produkte nga materialet të çdo kreu. Megjithatë vlera e materialeve që përdoren krerëve Nr.2915 dhe 2916 nuk duhet të kalojnë vlerën 20% të <i>ex-works price</i> të produktit.
ex 2932	Eteret e brendshme dhe derivativët e tyre të halogjenizuar, të sulfonuar, të nitruar ose të nitrosaturuar. Acetale ciklike dhe heniactal të brendshëm dhe derivativët e tyre të halogjenizuar, të sulfonuar, të nitruar ose të nitrosaturuar.	Produkte nga materialet të çdo kreu. Megjithatë, vlera e të gjitha materialeve që përdoren të krerëve Nr.2909 nuk duhet të kalojë vlerën 20% të <i>ex-works price</i> të produktit.
2933	Përbërje heterociklike vetëm me nitrogjen hetero-atom(e)sh, acide nukleike dhe kripërat e tyre.	Produkte nga materialet të çdo kreu. Megjithatë vlera e të gjithë materialeve që përdoren të krerëve Nr.2932 dhe 2933 që nuk duhet të kalojnë vlerën 20% të <i>ex-works price</i> të produktit.
2934	Përbërje të tjera heterociklike	Produkte nga të gjitha krerët. Megjithatë, materialet e krerëve Nr.2932, 2933, 2934 nuk duhet të kalojnë vlerën 20% të <i>ex-works price</i> të produktit.

ex kapitulli 30	Produkte farmaceutike përjashtuar kërret Nr.3002, 3003, 3004, 3005 dhe ex 3006 për të cilat rregullat janë përcaktuar më poshtë.	Produkte në të cilat materialet e përdorura janë të klasifikuara brenda një kreu të ndryshëm me atë të produktit. Megjithatë materialet e klasifikuara brenda të njëjtit kre mund të përdoren nëse nuk kalojnë vlerën 20% të ex-works price të produktit
3002	Gjaku i njerëzve; gjaku i kafshëve i përgatitur për përdorime teraupike, profilaktike apo diagnostikuese; antiseria dhe fraksione të tjera të gjakut dhe produktet e modifikuara imunologjike, nëse janë apo jo të fituara me anë të proceseve bioteknologjike; vaksinat, toksinat, kulturat e mikro organizmave (përjashtojnë tharë) dhe produkte të ngjashme -Produkte që përmbajnë një ose më shumë përbërës të cilat janë përzier të bashku për përdorim terapeutik ose profilaktik ose produkte të pa përziera për këto lloj përdorimesh, të vendosura në doza me masë ose në formë ose paketime për shitje me pakicë. -Të tjera -Gjak njerëzish -Gjak kafshësh i përdorur për terapi ose profilaktike, -Fraksione të gjakut të ndryshëm nga antiserume, hemoglobininë dhe serumit të globulinës sera Hemoglobinë, globulin gjaku dhe globulin serum -Të tjera	Produkte nga materialet e çdo kreu, përfshirë edhe materialet e kreut 3002. Materiale të këtij përshkrimi mund të përdoren nëse nuk kalojnë vlera 20% të ex-works price të produktit. Produkte nga materialet e çdo kreu, përfshirë edhe materialet të kreut 3002. Materiale të këtij përshkrimi mund të përdoren nëse nuk kalojnë vlera 20% të ex-works price të produktit. Produkte nga materialet e çdo kreu, përfshirë edhe materialet të kreut 3002. Materiale të këtij përshkrimi mund të përdoren nëse nuk kalojnë vlera 20% të ex-works price të produktit. Produkte nga materialet e çdo kreu, përfshirë edhe materialet të kreut 3002. Materiale të këtij përshkrimi mund të përdoren nëse nuk kalojnë vlera 20% të ex-works price të produktit. Produkte nga materialet e çdo kreu, përfshirë edhe materialet të kreut 3002. Materiale të këtij përshkrimi mund të përdoren nëse nuk kalojnë vlera 20% të ex-works price të produktit.
3003 dhe 3004	Medikamente (përjashtuar mallrat e kërre Nr.3002, 3005 ose 3006)	Produkte nga materialet e ndryshme me substancat aktive. Megjithatë, materialet e kërre Nr.3003 ose 3004 mund të përdoren nëse nuk kalojnë vlera 20% të ex works price të produktit.
3005	Mbushjet, garzat, fashot dhe artikuj të ngjashëm (psh veshjet leukoplast, poultices), të mbuluara apo të ngopura me substanca farmaceutike apo vendosur në formë apo paketa për shitje me pakicë për qëllime mjeksore, kirurgjikale, dentare apo veterinare.	Produkte nga materialet e çdo kreu, përveç substancave farmaceutike. Megjithatë, nuk duhet të kalojnë vlera 20% të materialeve të kreut Nr.3005 të ex works price të produktit.
ex 3006	Përgatitjet nga kontrceptivet kimike të bazuar në hormone ose spermicide; ose gipse për strukturat e kockave.	Produkte nga materialet e çdo kreu, përveç substancave aktive.
ex kapitulli 31	Plehëruesit përjashtuar kreun Nr. 3105 për të cilin rregulli është përcaktuar më poshtë.	Produkte në të cilat të gjitha materialet janë të klasifikuara brenda një kreu të ndryshëm me atë të produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara brenda të njëjtit kre mund të përdoren nëse nuk kalojnë vlera 20% të ex-works price të produktit, dhe
ex 3105	Plehërues mineralë ose kimikë që përmbajnë 2 ose 3 nga elementët plehërues nitrogen, fosfor dhe potas; plehërues të tjerë të këtij kapitulli në formë ose paketa të një peshe bruto që nuk kalon 10 kg, përjashtuar: -Nitrat sode -Ksianimi kalçiumi -Sulfat potasi -Sulfat i potasiumit të magnezit	Produkte në të cilat: -të gjitha materialet janë klasifikuar brenda të njëjtit kre të ndryshëm me atë të produktit. Megjithatë materialet e klasifikuara brenda të njëjtit kre mund të përdoren nëse nuk kalojnë vlera 20% të ex works price të produktit. -vlera e të gjitha materialeve që përdoren që nuk kalojnë vlerën 50% të ex-works price të produktit.
ex kapitulli 32	Ekstraktet ngjyrosës dhe tanike; taninet dhe derivativët e tyre, ngjyrosësit, pigmentet dhe lëndë të tjera ngjyrosës; bojrat dhe ilustruesit; stuko dhe mastiçet e tjera; bojrat e shkrimit.	Produkte në të cilat të gjitha materialet që përdoren janë të klasifikuara brenda të njëjtit kre të ndryshëm me atë të produktit. Megjithatë materialet që përdoren nuk duhet të kalojnë vlerën 20% të ex-works price të produktit
ex 3201	Ekstraktet tanine dhe kripërat e tyre, etere, estere dhe derivativët e tyre.	Produkte nga ekstraktet tanine të origjinës zarzavatore.

3205	Llaqet ngjyrosës, preparatet e bazuara në llaqet ngjyrosës të specifikuara në Shënimin 3 të këtij kapitulli.	Produkte nga materiale të çdo kreu përveç kreut Nr.3203 dhe 3204 nëse vlera e materialeve të klasifikuara brenda kreut Nr.3205 nuk kalon vlerën 20% të <i>ex-works price</i> të produktit.
